


Liahona

A photograph of a man in a blue suit and red tie, smiling and speaking at a wooden podium. He is looking towards the right. The background is dark and out of focus, suggesting a large audience.

Fjalime në Konferencën e Përgjithshme

**Thirren Të Shtatëdhjetë
të rinj dhe Presidencë
e re e Përgjithshme
e Të Rejave**

**U Njoftuan Dy Tempuj
të Rinj**



© JOSEPH BRICKEY, NUK LEJOHET KOPIMI

Seeking Shiloah [Në Kërkim të Siloeut], nga Joseph Brickey

Pellgu i Shiloah-ut (Siloeut) në Jerusalem ushqehet nga një burim që ndodhet jashtë mureve të qytetit. Si burimi i vetëm i ujit të freskët në zonë, ujërat e Siloeut kanë qenë prej kohësh një simbol i mbrojtjes dhe i fuqisë mbështetëse të Perëndisë. Siç shënohet tek Isaia 8:6–8, Isaia profetizoi se mbretëria e Izraelit do ta refuzonte Zotin në favor të dy mbretërve. Kjo ndodhi. Megjithatë, në ndryshim nga njerëzit në kohën e Isaia, kjo grua po kërkon ujërat e freskëta të Siloeut – pra, po kërkon simbolikisht dashurinë dhe mbrojtjen e vazhdueshme të Perëndisë.

SESIONI I PARADITES TË SË SHTUNËS

- 4 Mirësevini në Konferencë
Presidenti Tomas S. Monson
- 6 Këto Gjëra i Di
Presidenti Boyd K. Paker
- 9 Një Themel i Sigurt
Peshkopi Din M. Dejvis
- 12 Ne Jemi Bija të Atit Tonë Qiellor
Elen S. Dalton
- 15 Shpëtimtari Dëshiron të Falë
Plaku Krejg A. Kardon
- 18 "Kjo Është Vepra Ime dhe Lavdia Ime"
Plaku M. Rasëll Ballard
- 22 "Ejani tek Unë"
Presidenti Henri B. Ajring

SESIONI I PASDITES TË SË SHTUNËS

- 26 Mbështetja e Drejtuesve të Kishës
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 28 Raporti i Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2012
Robert W. Kentuell
- 28 Raporti Statistikor, 2012
Bruk P. Hejls
- 29 Për Paqe në Shtëpi
Plaku Riçard G. Skot
- 32 Paqja Vetjake: Shpërblimi i Drejtësisë
Plaku Kuentin L. Kuk
- 36 Mënyra e Zotit
Plaku Stenli G. Elis
- 39 Çuarja e Ungjillit në Gjithë Botën
Plaku Xhon B. Dikson
- 41 Ne Besojmë në Qenien të Dëlirë
Plaku Dejvid A. Bednar
- 45 Kapeni Valën
Plaku Rasëll M. Nelson

SESIONI I PRIFTËRISË

- 48 Qëndroni të Paepur në Vende të Shenjta
Plaku Robert D. Hejls
- 52 Fuqia e Priftërisë te një Djalë
Plaku Ted R. Kelister
- 55 Detyra Juaj e Shenjtë për të Shërbyer
Dejvid L. Bek
- 58 Katër Tituj
Presidenti Diter F. Uhtdorf

- 62 Jemi të Bashkuar
Presidenti Henri B. Ajring
- 66 Ejani, Bij 'Per' ndis'
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PARADITES TË SË DIELËS

- 70 Shpresa e Dritës së Perëndisë
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 77 Është një Mrekulli
Plaku Nil L. Andersen
- 81 Fjalët që Them
Rozmari M. Uiksom
- 83 Martesa: Shikoni dhe Mësoni
Plaku L. Uitni Klejton
- 86 Bindja ndaj Ligjit Është Liri
Plaku L. Tom Peri
- 89 Bindja Sjell Bekime
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PASDITES TË SË DIELËS

- 93 "Unë Besoj, o Zot"
Plaku Xhefri R. Holland
- 96 Pasues të Krishtit
Plaku Dallin H. Ouks
- 99 Ati dhe Biri
Plaku Kristofel Golden i Riu
- 102 Shtëpia: Shkolla e Jetës
Plaku Enrike R. Falabela
- 104 Të Pranohesh nga Zoti
Plaku Erik W. Kopishke
- 107 Mëngjese të Bukura
Plaku Brus D. Porter
- 109 Shëlbimi
Plaku D. Tod Kristoferson
- 113 Derisa Prapë të Takohemi
Presidenti Tomas S. Monson

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E TË REJAVE

- 115 Vendet Tuaja të Shenjta
En M. Dib
- 118 Kur Shpëtoni një Vajzë, Ju Shpëtoni Breza
Meri N. Kuk
- 121 Mos Lëvizni!
Elen S. Dalton
- 125 Udhëtimi Juaj i Mrekullueshëm për në Shtëpi
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 72 Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme
- 130 Ata na Folën Neve: Ta Bëjmë Konferencën Pjesë të Jetës Sonë
- 132 Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë
- 133 Mësime për Kohën Tonë
- 133 Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndihmëse
- 134 Lajme të Kishës



Përmbledhje për Konferencën e Përgjithshme Vjetore të 183-të

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË SHTUNËS, 6 PRILL 2013

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.
Lutja e hapjes: Plaku Randall K. Benet.
Lutja e mbylljes: Xhin A. Stivens.
Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Riçard Eliot dhe Adru Ansuorth, organistë: “Shëlbues i Izraelit”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 5; “In Hymns of Praise” [“Me Himne Lëvdimi”], *Hymns*, nr. 75; “Hark, All Ye Nations!” [“Dëgjoni, të Gjithë Ju Kombe!”] *Hymns*, nr. 264, përshtatur nga Wilberg; “Punës Le t’i Vihemi”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 10; “Faith” [“Besim”], *Children’s Songbook*, 96, përshtatur nga Elliott, i pabotuar; “My Redeemer Lives” [“Shëlbuesi Im Jeton”], *Hymns*, nr. 135, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË SHTUNËS, 6 PRILL 2013

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.
Lutja e hapjes: Rasëll T. Osguthorp.
Lutja e mbylljes: Plaku J. Devn Kornish.
Muzika nga një kor i përzier nga Universiteti “Brigam Jang”; Ronald Shteli dhe Rozalind Holl, drejtues; Boni Gudlajf, organiste: “Jesus, the Very Thought of Thee” [“Jezus, Vetë Mendimi për Ty”], *Hymns*, nr. 141, përshtatur nga Staheli, bot. Jackman; “Lutjen a e The?” *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 48, përshtatur nga Xhonsen, bot. Johnson; “Rejoice, the Lord Is King!” [“Gëzohuni, Zoti Është Mbret!”] *Hymns*, nr. 66; “More Holiness Give Me” [“Më Shumë Shenjtëri më Jep”], *Hymns*, nr. 131, përshtatur nga Staheli, bot. Jackman.

SESIONI I PRIFTËRISË I MBRËMJES TË SË SHTUNËS, 6 PRILL 2013

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.
Lutja e hapjes: Plaku Ronald A. Rasband.
Lutja e mbylljes: Leri M. Gibson.
Muzika nga një kor i priftërisë nga kunjet e të rinjve në moshë madhore beqarë në Solt-Lejk-Siti të Jutas; Xhastin Bills, drejtues; Klej Kristiansen, organist: “Arise, O God, and Shine” [“Ngrihu, O Per’ndi, e Shkëlqe”], *Hymns*, nr. 265, përshtatur nga Wilberg, bot. Oxford; “Nearer, My God, to Thee” [“Më Pranë Teje, Per’ndia Im”], *Hymns*, nr. 100, përshtatur nga Bills, i pabotuar; “Hope of Israel” [“Shpresë e Izraelit”], *Hymns*, nr. 259; “Ye Elders of Israel” [“Ju Pleq t’Izraelit”],

Hymns, nr. 319, përshtatur nga Bills, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË DIELËS, 7 PRILL 2013

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.
Lutja e hapjes: Plaku Stiven E. Snou.
Lutja e mbylljes: Plaku O. Vinsent Halek.
Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mek Uilberg, drejtues; Endriu Ansuorth dhe Klej Kristiansen, organistë: “Go Forth with Faith” [“Shko Përpara me Besim”], *Hymns*, nr. 263; “Let Zion in Her Beauty Rise” [“Le t’Ngrihet Sioni n’Bukuri”], *Hymns*, nr. 41, përshtatur nga Kasen, bot. Jackman; “Come, Follow Me” [“Ejani, Më Ndiqni”], *Hymns*, nr. 116, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar; “Guide Us, O Thou Great Jehovah” [“Na Udhëhiq, O Ti Jehova i Madh”], *Hymns*, nr. 83; “Where Love Is” [“Aty Ku Është Dashuria”], *Children’s Songbook*, 138, përshtatur nga Cardon, i pabotuar; “Eni Shenjtorë” *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 2, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË DIELËS, 7 PRILL 2013

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.
Lutja e hapjes: Karol M. Stivens.
Lutja e mbylljes: Plaku Leri Y. Uilson.
Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mek Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Linda Margets dhe Boni Gudlajf, organiste: “Eni F’mij’ të Zotit”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 4, përshtatur nga Murphy, i pabotuar; “Tell Me the Stories of Jesus” [“Historitë e Jezusit m’Trego”], *Children’s Songbook*, nr. 57, përshtatur nga Murphy, i pabotuar; “Tani Le të Gëzojmë”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 32; “Lord, Dismiss Us with Thy Blessing” [“Zot na Liro me Bekimin Tënd”], *Hymns*, nr. 163, përshtatur nga Wilberg, i pabotuar.

Mbledhja e Përgjithshme e Të Rejave e Mbrëmjes të Së Shtunës, 30 Mars 2013

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Elen S. Dalton.
Lutja e hapjes: Ela Exhli.
Lutja e mbylljes: Emili Maksuell.
Muzika nga kori i Të Rejave nga kunjet në Hailend të Jutas; Meril Ueb, drejtuese; Linda Margets, organiste: “Lart në Majën e Malit”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 30, me melodinë e “Arise” [“Ngrihu”]; “In That Holy Place” [“Në At Vend t’Shenjtë”], DeFord, bot.

DeFord; “More Holiness Give Me” [“Më Shumë Shenjtëri më Jep”], *Hymns*, nr. 131, përshtatur nga Goates, i pabotuar; “O Thou Rock of Our Salvation” [“O Ti Shkëmb i Shpëtimit Tonë”], *Hymns*, nr. 258, përshtatur nga Kasen, bot. Jackman; “Let Zion in Her Beauty Rise” [“Le t’Ngrihet Sioni n’Bukuri”], *Hymns*, nr. 41, përshtatur nga Webb, i pabotuar.

MUNDËSOHEN BISEDAT E KONFERENCËS

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në internet në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org. Pastaj përzgjidhni një nga gjuhët. Përgjithësisht, brenda dy muajve pas konferencës, regjistrime zanore mundësohen edhe në qendrat e shpërndarjes.

MESAZHET E MËSIMIT TË SHTËPISË DHE TË VIZITËS MËSIMORE


Për mesazhet e mësimi të shtëpisë dhe të vizitës mësimore, ju lutemi zgjidhni atë fjalim që u përgjigjet më mirë nevojave të atyre që vizitoni.

NË KOPERTINË

Përpara: Fotografi nga Leslie Nilsson
Prapa: Fotografi nga Leslie Nilsson

FOTOGRAFIMI I KONFERENCËS

Pamjet nga konferenca e përgjithshme në Solt-Lejk-Siti u morën nga Cody Bell, Randy Collier, Weston Colton, Scott Davis, Craig Dimond, Lloyd Eldredge, Sarah Jenson, Collin King, Ashlee Larsen dhe Leslie Nilsson; në Arizona, SHBA, nga Mindy Sue Evans; në Australi nga Colin Ligertwood; në Brazilia, Brazil nga Tomé Siqueira; në Sobral, Brazil, nga Francisco Flávio Dias Carneiro; në Kaliforni, SHBA, nga Rhonda Harris; në Kili nga Oscar Schmittner; në Danimarkë nga Ann-Mari Lindberg; në Ekuador nga Jimmy Padilla Pin; në El-Salvador nga Josué Peña; në Nju-Jork, SHBA, nga Mark Weinberg; në Skoci nga Sylvia Mary Brown; dhe në Afrikën e Jugut nga Jeremy Rakotomamonjy.



MAJ 2013 VËLLIMI 15 NR. 2
LIAHONA 10785 101

Revista ndërkombëtare zyrtare e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Presidenca e Parë: Tomas S. Monson, Henri B. Ajring, Diter F. Uhtdorf

Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve: Bojd K. Paker, L. Tom Perri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Ricard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson, Nil L. Andersen

Botues: Craig A. Cardon

Këshilltarë: Shayne M. Bowen, Bradley D. Foster, Christoffel Golden Jr., Anthony D. Perkins

Drejtor Administrimi: David T. Warner
Drejtor i Mbështetjes së Familjes dhe Anëtarit: Vincent A. Vaughn

Drejtor i Revistave të Kishës: Allan R. Loyborg
Administrues i Punëve: Garff Cannon

Redaktor Administrimi: R. Val Johnson
Ndihmësredaktor Administrimi: Ryan Carr, LaRene Porter Gaunt

Ndihmës i Botimeve: Melissa Zenteno

Grupi i Shkrimit dhe i Redaktimit: Susan Barrett, David Dickson, David A. Edwards, Matthew D. Flitton, Mindy Raye Friedman, Lori Fuller, Garrett H. Garff, Jennifer Grace Jones, Hikari Loftus, Michael R. Morris, Richard M. Romney, Paul VanDenBerghe

Drejtor Administrimi i Artit: J. Scott Knudsen
Drejtor Arti: Tadd R. Peterson

Grupi i Dizajnimit: Jeanette Andrews, Fay P. Andrus, C. Kimball Bott, Thomas Child, Nate Gines, Kerry Lynn C. Herin, Colleen Hinckley, Eric P. Johnsen, Susan Lofgren, Scott M. Mooy, Brad Teare

Bashkërendues i Pronës Intelktuale:

Collette Nebeker Aune

Administrimi i Prodhimit: Jane Ann Peters

Grupi i Prodhimit: Kevin C. Banks, Connie Bowthorpe Bridge, Julie Burdett, Bryan W. Gygi, Denise Kirby, Ginny J. Nilson, Ty Pilcher, Gayle Tate Rafferty

Përgatitja për Shtyp: Jeff L. Martin

Drejtor i Prodhimit: Craig K. Sedgwick

Drejtor i Shpërndarjes: Evan Larsen

Mbikëqyrës i Përkthimit Shqip: Attila Böröcz

Për pajtimet dhe për çmimet jashtë Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, ju lutemi të lidheni me qendrën tuaj vendore të shpërndarjes të Kishës ose me udhëheqësin e lagjes apo degës.

Paraqitni dorëshkrimet dhe pyetjet në internet në liahona.lds.org; nëpërmjet postës elektronike liahona@ldschurch.org; ose nëpërmjet postës në *Liahona*, Rm. 2420, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150-0024, USA.

Liahona (një term nga Libri i Mormonit, që do të thotë "busull" apo "drejtues") botohet në anglisht, armenisht, bislamisht, bullgarisht, çekisht, danisht, estonisht, fihisht, finlandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, islandisht, italisht, japonisht, kamboxhisht, kinezisht, kiribatisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, lituanisht, malagasisht, marshallisht, mongolisht, norvegjisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, samoaisht, sebuanisht, slovenisht, spanjisht, suahilisht, suedisht, shqip, tagalogisht, tahitisht, taisht, tongaisht, ukrainisht, urduisht dhe vietnamsisht. (Periodiciteti ndryshon sipas gjuhës.)

© 2013 nga Intellectual Reserve, Inc. I rezervohen të gjitha të drejtat. Shtypur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lënda e shkruar dhe ajo figurative e *Liahonës* mund të kopjohet për ta përdorur me raste në kishë ose në shtëpi, jo për tregti. Lënda figurative nuk mund të kopjohet nëse ajo shoqërohet me kufizime të shënimi i meritave për punën artistike. Çështjet e së drejtës së autorit duhet të adresohen te: Intellectual Property Office, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150, USA; adresa elektronike: cor-intellectualproperty@ldschurch.org.

For Readers in the United States and Canada:

May 2013 Vol. 15 No. 2. LIAHONA (USPS 311-480) Albanian (ISSN 1521-4753), is published four times a year (April, May, October and November) by The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints, 50 E. North Temple St., Salt Lake City, UT 84150. USA subscription price is \$3.00 per year; Canada, \$3.60 plus applicable taxes. Periodicals Postage Paid at Salt Lake City, Utah. Sixty days' notice required for change of address. Include address label from a recent issue; old and new address *must* be included. Send USA and Canadian subscriptions to Salt Lake Distribution Center at address below. Subscription help line: 1-800-537-5971. Credit card orders (Visa, MasterCard, American Express) may be taken by phone. (Canada Poste Information: Publication Agreement #40017431)

POSTMASTER: Send all UAA to CFS (see DMM 707.4.12.5). NONPOSTAL AND MILITARY FACILITIES: Send address changes to Distribution Services, Church Magazines, P.O. Box 26368, Salt Lake City, UT 84126-0368, USA.



TREGUESI I FOLËSVE

Ajring, Henri B., 22, 62
Andersen, Nil L., 77
Ballard, M. Rasëll, 18
Bednar, Dejvid A., 41
Bek, Dejvid L., 55
Dalton, Elen S., 12, 121
Dejvis, Din M., 9
Dib, En M., 115
Dikson, Xhon B., 39
Elis, Stenli G., 36
Falabela, Enrike R., 102
Golden, Kristofel, i Riu, 99
Hejls, Robert D., 48
Holland, Xhefri R., 93
Kardon, Krejg A., 15
Kelister, Ted R., 52
Klejton, L. Uitni, 83
Kopishke, Erik W., 104
Kristoferson, D. Tod, 109
Kuk, Kuentin L., 32
Kuk, Meri N., 118
Monson, Tomas S., 4, 66, 89, 113
Nelson, Rasëll M., 45
Ouks, Dallin H., 96
Paker, Bojd K., 6
Peri, L. Tom, 86
Porter, Brus D., 107
Skot, Riçard G., 29
Uhtdorf, Diter F., 26, 58, 70, 125
Uiksom, Rozmari M., 81

TREGUESI TEMATIK

Aktivizimi, 55
Besëlidhjet, 104
Besimi, 83, 93
Besnikëria bashkëshortore, 83
Bindja, 48, 86, 89
Dashuria, 66, 83, 125
Dëgjimi, 81
Dëshmia, 18, 66, 93
Dishepullimi, 58
Ekzistenca para lindjes, 125
E vërteta, 89
Falja, 15
Familja, 6, 18, 29, 55, 83, 102, 118
Fatqeqësia, 12, 70, 107, 118
Fëmijët, 81, 102
Fryma e Shenjtë, 6, 115
Historia familjare, 118
Jezu Krishti, 22, 29, 48, 70, 89, 96, 99, 107, 109
Komunikimi, 81
Libri i Mormonit, 45
Liria e zgjedhjes, 86
Lutja, 9, 113
Martesa, 83, 102
Mirëbesimi, 52
Mirënjohja, 113
Moraliteti, 6, 41, 121
Natyra hyjnore, 12, 18, 58
Paqja, 29, 32

Pendimi, 15, 41, 83, 109
Përndia, Ati, 36, 99
Përgatitja, 66
Përlësia, 83, 104
Plani i shpëtimit, 41, 125
Priftëria, 18, 52, 55, 62
Profetët, 36
Puna misionare, 4, 39, 45, 62, 66, 77
Respekti, 83
Rivendosja, 45
Rritja e Kishës, 39
Sakramenti, 9
Sakrifica, 104
Standardet, 48
Studimi i shkrimeve të shenjta, 9
Shenjtëria, 115
Shërbimi, 22, 55, 58, 109
Shërimi, 58, 70
Shkrimet e Shenjta, 66, 102
Shlyerja, 12, 109, 121
Shpresa, 70, 107
Shtëpia, 29, 102
Tempujt, 4, 32, 121
Të rejtat, 12
Udhëheqja, 52
Uniteti, 62
Urthërimet, 86, 89
Vdekja, 118
Vdekshmëria, 125
Zbulesa, 52



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Mirësevini në Konferencë

Ju nxis fort të jeni të vëmendshëm dhe rrokës të mesazheve që do të dëgjojmë. Është lutja ime që të mund ta bëjmë këtë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, sa i kënaqur jam që t'ju uroj mirëseardhjen në Konferencën e Përgjithshme Vjetore të 183-të të Kishës.

Gjatë gjashtë muajve që kur u takuam për herë të fundit, kam pasur mundësi të udhëtoja paksa dhe të takohem me disa prej jush në vetë zonat tuaja. Pas konferencës së përgjithshme në tetor, udhëtova për në Gjermani, ku ishte privilegji im të takohesha me anëtarët tanë në vendndodhje të ndryshme në atë vend, si dhe në pjesë të Austrisë.

Në fund të tetorit, përkushtova Tempullin e Kalgarit në Alberta të Kanadasë, me ndihmën e Plakut dhe motrës M. Rasëll Ballard, Plakut e motrës Krejg C. Kristensen dhe Plakut e motrës Uilliam R. Uolker. Në nëntor, ripërkushtova Tempullin e Bojzit në Ajdaho. Gjithashtu, në udhëtim me mua dhe pjesëmarrës në përkushtim ishin Plaku dhe motra Dejvid A. Bednar, Plaku dhe motra Krejg C. Kristensen dhe Plaku e motra Uilliam R. Uolker.

Kretime të kulturore të mbajtura së bashku me këto dy përkushtime,

qenë të jashtëzakonshme. Nuk mora pjesë personalisht në kremtimin kulturor në Kalgari, duke qenë se ishte ditëlindja e 85-të e motrës Monson dhe ndjeva se duhet të isha me të. Sidoqoftë, ajo dhe unë u privileguam duke e parë kremtimin në dhomën tonë të ndjenjës përmes televizorit me qark të mbyllur dhe më pas unë shkova me avion mëngjesin vijues për në Kalgari për përkushtimin. Në Bojzi, mbi 9.000 të rinj nga distrikti i tempullit morën pjesë në kremtimin kulturor. Kishte kaq shumë të rinj të përfshirë, sa që nuk kishte vend që anëtarët e familjes të merrnin pjesë tek arena në të cilën ata interpretuan.

Vetëm një muaj më parë, Presidenti Diter F. Uhtdorf, i shoqëruar nga motra Uhtdorf, Plaku e motra Xhefri R. Holland dhe Plaku e motra Gregori A. Shvicer, udhëtuan për në Tegusigalpa të Hondurasit, për të përkushtuar tempullin tonë të sapopërfunduar atje. Një kremtim mahnitës nga të rinjtë ndodhi mbremjen përpara përkushtimit.

Ka tempuj të tjerë që janë njoftuar dhe që janë në faza të ndryshme të



procesit parapërgatitor ose që janë në ndërtim e sipër.

Është privilegji im këtë mëngjes të njoftoj dy tempuj të tjerë, të cilët në muajt dhe vitet e ardhshme do të ndërtohen në vendet në vijim: dhe Sidër Siti në Juta dhe Rio de Zhaneiro në Brazil. Vëllezër e motra, ndërtimi i tempujve vazhdon pa u ngadalësuar.

Siç e dini, në konferencën e përgjithshme të tetorit, njoftova ndryshime për moshën në të cilën të rinjtë



dhe të rejat mund të shërbejnë si misionarë kohëplotë, me të rinjtë që tani mund të shërbejnë në moshën 18-vjeçare dhe të rejat në moshën 19-vjeçare.

Reagimi i rinisë sonë ka qenë i mahnitshëm e frymëzues. Deri më 4 prill – dy ditë më parë – ne kemi 65.634 misionarë kohëplotë që po shërbejnë, me 20.000 të tjerë që i kanë marrë thirrjet e tyre, por që nuk kanë hyrë ende në një qendër trajnimi për

misionarët dhe mbi 6.000 të tjerë në proces interviste me peshkopët dhe presidentët e kunjeve të tyre. Ka qenë e nevojshme që ne të krijojmë 58 misione të reja për të mirëpritur numrin e rritur të misionarëve.

Për të ndihmuar në ruajtjen e kësaj force misionare dhe për shkak se shumë prej misionarëve tanë vijnë nga rrethana të përlurura, ju ftoj ju, sipas mundësisë që keni, që të dhuroni bujarisht për Fondin e

Përgjithshëm Misionar të Kishës.

Tani, vëllezër e motra, do të dëgjojmë mesazhe të frymëzuara sot dhe nesër. Ata që do të na drejtohen, kanë kërkuar të dinë me lutje atë që Zoti do të dëshironte që ne ta dëgjojmë në këtë kohë.

Ju nxis fort të jeni të vëmendshëm dhe rrokës të mesazheve që do të dëgjojmë. Është lutja ime që ne të mund ta bëjmë këtë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Presidenti Bojd K. Paker,
President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Këto Gjëra i Di

Nga gjithë ajo që kam lexuar, kam dhënë mësim dhe kam mësuar vetë, një nga të vërtetat më të çmuara dhe më të shenjta që kam për t'ju dhënë, është dëshmia ime e veçantë për Jezun Krishtin.

Në vitin 1992, pasi kisha shërbyer nëntë vjet si Asistent i Të Dymbëdhjetëve dhe 22 vjet si anëtar i Të Dymbëdhjetëve, arrita moshën 68-vjeçare. Pata mbresë që të filloja atë që e quajta një “Kompozim i Pambaruar”. Pjesa e parë e asaj vepre tingëllon kështu:

*Natën që shkoi një mendim pata,
Një mendim të thellë shumë'.
Më erdhi kur mjaft i lodhur isha,
Sa më s'më vinte as gjum'.*

*Një ditë plot punë kisha kaluar
Dhe fatin kisha sjellë ndër mend.
Këtë gjë pata menduar:
Kur isha i ri, s'kisha qenë 68 vjeç!*

*Pa çaluar mund të ecja;
Supi nuk më dhimbte kurrë.
Një rresht dy her' ta lexoja,
Përmendsh ta përsërisja un'.*

*Mund të punoja orë pa fund,
Edhe për frymë pa ndalur.
Gjërat që tash t'i bëj, më s'mund,
I bëra me lehtësi dikur.*

*Vitet pas nëse mund t'i ktheja,
Këtë gjedhje në dorë po ta kisha,*

*Vjetërsinë me rininë s'do ta ndërroja,
Se shumë do të humbisja.*

*I kënaqur jam që përpara të shkoj,
Pas ta lë rininë, sado të madhërishme.
Është ajo gjë që sot kuptoj,
Që nëse pas kthehesha, do të më humbiste.*

Dhjetë vjet më vonë, vendosa t'i shtoj disa rreshta më shumë kësaj poeme:

*Dhjetë vjet ku shkuan, më s'dihet,
Me to dhe shumë' nga dhembja shkoi.
Çalimi nga këllqë metali hiqet;
Sërish mjaft drejt po nxitoj.*

*Fletë tjetër metali qafën ma shtrëngon –
I mrekullueshëm krijim!
Nga unë tërë poliomielitit largoi;
Kokëfortë është tani brezi im.*

*Shenjat e moshës mund të shihen.
Ato gjëra s'bëhen më të mira.
E vetmja gjë që në forcë rritet
Me mua bashkë është harresa.*

*Më pyet: “A më mban mend?”
Sigurisht, je po njësoj.
Nëse emri yt s'më kujtohet,
Tani gjithë inat mos u bëj.*

*Dakord jam, ca gjëra kam mësuar,
Që s'do doja t'i dija,
Por moshë ka sjellë të vërtetën e çmuar,
Që Shpirtit më pranë t'i rrija.*

*Nga gjithë bekimet që kam marrë,
Gjëja më e mirë në jet',
Shoqërimi dhe ngushëllimi është
Që te gruaja ime gjej.*

*Gjithë fëmijët tanë mirë u martuan,
Familjet e tyre i kan',
Të gjithë sa shpejt u shtuan,
Me fëmijët, nipërit dhe mbesat.*

*Mendjen aspak s'e kam ndryshuar
Që rininë përsëri ta rikthej.
Të gjithë kemi për t'u moshuar
Që të vërtetën ta gjejm'.*

*Më pyet: “E ardhmja ç'do të sjellë?
Fati im ç'do të jet?”
Pa u ankuar bisedën përcjell.
Më pyet kur të jem 88!*

Dhe vitin e kaluar shtova këto strofa:

*Tani e shihni, jam 88.
Vitet shumë shpejt më shkuan.
Ecja, çalimi, bastuni që mbajta vet',
Te karroca përfunduan.*

*Dremis herë pas here,
Por fuqia e priftërisë mbetet.
Për mungesat e gjithë gjërave
trupore
Fitim shpirtëror më gjendet.*

*Nëpër botë miliona kilometra
Unë vetë kam udhëtuar.
Prej satelitëve udhëtimet e mia
Prapë sot s'kanë të mbaruar.*

*Tani mund të them me siguri të plot'
Se Zotin e dua, e njoh.
Kur fjalën e Tij të shenjtë predikoj
Me të lashët dhe unë dëshmoj.*

*E di se atë që ndjeu në Gjetseman,
Ne nuk mund ta kuptojmë.
E di se për ne bëri gjithçka,
Mik më të madh s'kërkojmë.*

*E di sërish Ai do të vijë
Me fuqi dhe në laudi.
E di vërtet unë do ta shoh përsëri
Kur jetës sime t'i arrijë fundi.*

*Në gjunjë te këmbët e Tij do të ulem;
Do ndiej të shkëlqej' Shpirtin.
Me zë të dridhur do t'i them:
"O Zot, Perëndi, e di."¹*

Dhe unë vërtet e di!

Dritaret nga prapa shtëpisë sonë shohin mbi një kopsht të vogël lulësh dhe drurësh, të cilat kufizohen nga një rrëke e vogël. Njëri mur i shtëpisë kufizohet me kopshtin dhe është tërësisht i mbuluar me bimë kacavjerrëse. Shumicën e viteve kjo bimë kacavjerrëse ka qenë vendi i foleve të trishtilave. Fole të në degët kacavjerrëse janë të sigurta nga dhelprat, rakunët dhe macet që vërtiten përreth.

Një ditë pati një zhurmë të madhe në bimën kacavjerrëse. Thirrje të dëshpëruara shqetësimi bënë që 8 ose 10 trishtilë nga drurët përreth të vinin që të bashkoheshin me këtë thirrje alarmi. Shpejt e pashë burimin e zhurmës. Një gjarpër kishte rrëshqitur pjesërisht poshtë bimës kacavjerrëse dhe ishte varur përpara dritares për aq kohë sa më duhej ta tërhiqja nga bima. Pjesa e mesit e trupit të gjarpërit kishte dy xhunga – provë e qartë që tregonte se ai kishte marrë dy zogj të vegjël nga foleja. Asnjëherë në 50 vjet që kishim jetuar në shtëpinë tonë, nuk kishim parë diçka të tillë. Ishte një përvojë që ndodhte vetëm një herë në jetë – ose kështu menduam ne.

Pak ditë më vonë, pati një zhurmë tjetër, këtë herë në degët kacavjerrëse që mbulonin kolibën e qenit tonë.



Dëgjuam të njëjtat thirrje alarmi, grumbullimin e trishtilave fqinjë. E dinim se cili ishte grabitqari. Një nip u ngjit mbi kolibe dhe tërhoqi një gjarpër tjetër që ende nuk po e lëshonte zogun nënë që e kishte zënë në fole dhe e kishte vrarë.

Thashë me vete: “Çfarë po ndodh? A po pushtohet përsëri Kopshti i Edenit?”

Atje më erdhën në mendje paralajmërimet e thëna nga profetët. Ne nuk do të jemi gjithmonë të sigurt ndaj ndikimit të kundërshtarit, madje edhe brenda vetë shtëpive tona. Ne kemi nevojë t'i mbrojmë të vegjlit tanë.

Ne jetojmë në një botë shumë të rrezikshme, e cila i kërcënon ato gjëra që janë më shpirtëroret. Familja, organizata themelore në kohë dhe përjetësi, po i nënshtrohet sulmit nga forca të dukshme dhe të padukshme. Kundërshtari gjendet përreth. Qëllimi i tij është të shkaktojë dëmtim. Nëse mund ta dobësojë dhe ta shkatërrojë familjen, ai do t'ia ketë dalë mbanë.

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme e njohin rëndësinë e jashtëzakonshme të familjes dhe përpiqen të jetojnë në një mënyrë të tillë që kundërshtari nuk

mund të hyjë vjedhurazi në shtëpitë tona. Ne gjejmë siguri dhe mbrojtje për veten tonë dhe për fëmijët tanë nëpërmjet respektimit të besëlidhjeve që kemi bërë, dhe nëpërmjet të jetuarit sipas veprimeve të thjeshta të bindjes, të kërkuara prej pasuesve të Krishtit.

Isaia tha: “Pasoje e drejtësisë do të jetë paqja, rezultat i drejtësisë qetësia dhe siguria përjetë”².

Po ajo paqe premtohet në zbulesat në të cilat Zoti shpall: “Nëse jeni të përgatitur, ju s'do të frikësoheni”³.

Fuqia përfunduese e priftërisë është dhënë për ta mbrojtur shtëpinë dhe banorët e saj. Babai ka autoritetin dhe përgjegjësinë t'i mësojë fëmijët e tij dhe t'i bekojë e t'iu japë atyre ordiancat e ungjillit dhe çdo mbrojtje tjetër të nevojshme të priftërisë. Ai duhet të tregojë dashuri dhe besnikëri e nderim ndaj nënës, në mënyrë që fëmijët e tyre të mund ta shohin atë dashuri.

Kam arritur të di që besimi është një fuqi reale, jo thjesht një shprehje e bindjes. Ka vetëm pak gjëra më të fuqishme sesa lutjet besnike të një nëne të drejtë.

Mësojeni veten tuaj dhe i mësoni familjet tuaja rreth dhuratës së Frymës



së Shenjtë dhe Shlyerjes së Jezu Krishtit. Ju nuk do të bëni punë më të madhe të përjetshme sesa ajo brenda mureve të vetë shtëpisë suaj.

Ne e dimë se jemi fëmijë shpirtërorë të prindërve qiellorë, këtu në tokë për të marrë trupat tanë të vdekshëm dhe për t'u vënë në provë. Ne që kemi trupa të vdekshëm, kemi fuqi mbi qeniet që nuk kanë trupa.⁴ Ne jemi të lirë të zgjedhim atë që duam dhe t'i zgjedhim veprimet tona, por nuk jemi të lirë të zgjedhim pasojat. Ato vijnë ashtu siç do të vijnë.

Liria e zgjedhjes përcaktohet në shkrimet e shenjta si "liri morale [e] zgjedhjes", që do të thotë se ne mund të zgjedhim midis së mirës dhe së ligës. Kundërshtari kërkon të na tundojë që ta keqpërdorim lirinë tonë të zgjedhjes.

Shkrimet e shenjta na mësojnë "që çdo njeri të mund të veprojë në përputhje me doktrinën dhe parimin që i përshtaten së ardhmes, lidhur me lirinë morale të zgjedhjes që unë i kam dhënë atij, që çdo njeri të mund të jetë i përgjegjshëm për mëkatet e veta në ditën e gjykimit"⁵.

Alma na mësoi se "Zoti nuk mund të shikojë mëkatin as me lëshimin më të vogël"⁶. Me qëllim që ta kuptojmë këtë, ne duhet ta veçojmë mëkatarin nga mëkati.

Për shembull, kur sollën përpara Shpëtimtarit një grua që kishte shkelur kurorën, sigurisht fajtoje, Ai e përfundoi çështjen me pesë fjalë: "Shko dhe mos mëkato më"⁷. Ky është shpirti i shërbesës së Tij.

Toleranca është një virtyt, por, si të gjitha virtytet, kur ekzagjerohet, ajo vetëshndërrohet në një ves. Ne duhet të jemi të kujdesshëm ndaj "kurthit të tolerancës" që të mos përpohemi prej tij. Lejueshmëria e siguruar nga dobësimi i ligjeve të vendit për të toleruar veprime të ligjëruara të mungesës së moralit nuk i pakëson pasojat e rënda shpirtërore që vijnë si rezultat i dhunimit të ligjit të Perëndisë për delirësinë.

Të gjithë linden me Dritën e Krishtit, një ndikim udhërrëfyes i cili e lejon çdo njeri të dallojë të drejtën nga e gabuara. Ajo që bëjmë me atë dritë dhe mënyra se si i përgjigjemi atyre nxitjeve për të jetuar me drejtësi, është pjesë e provës së vdekshmërisë.

"Pasi vini re, Shpirti i Krishtit i jepet çdo njeriu, që ai të dallojë të mirën nga e keqja; prandaj, unë do t'ju tregoj mënyrën sesi të gjykoni; pasi çdo gjë që ju fton të bëni mirë dhe t'ju bindë të besoni në Krisht, është dërguar nëpërmjet fuqisë dhe dhuratës së Krishtit; prandaj ju mund të dini me

një njohuri të përsosur se është nga Perëndia."⁸

Secili prej nesh duhet të qëndrojë në gjendje për t'iu përgjigjur frymëzimit dhe nxitjeve të Frymës së Shenjtë. Zoti e ka një mënyrë për të derdhur njohuri të pastër në mendjet tona për të na nxitur, për të na udhëhequr, për të na mësuar dhe për të na paralajmëruar. Secili bir ose bijë e Perëndisë mund t'i dijë gjërat që ata kanë nevojë t'i dinë menjëherë. Mësoni se si të merrni frymëzim e zbulësë dhe se si të veproni sipas tyre.

Nga gjithë ajo që kam lexuar, kam dhënë mësim dhe kam mësuar vetë, një nga të vërtetat më të çmuara dhe më të shenjta që kam për t'ju dhënë, është dëshmia ime e veçantë për Jezu Krishtin. Ai jeton. Unë e di se Ai jeton. Unë jam dëshmitar i Tij. Dhe për Të unë mund të dëshmoj. Ai është Shpëtimtari ynë, Shëlbuesi ynë. Për këtë jam i sigurt. Për këtë unë dëshmoj në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Boyd K. Packer, "Unfinished Composition", 2012.
2. Isaia 32:17.
3. Doktrina e Besëlidhje 38:30.
4. *Shih Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 222.
5. Doktrina e Besëlidhje 101:78.
6. Alma 45:16.
7. Gjonit 8:11.
8. Moroni 7:16.



Nga Peshkopi Din M. DeJvis,
Këshilltar i Dytë në Peshkopatën Kryesuese

Një Themel i Sigurt

E pranofshim ftesën e Shpëtimtarit që të vijmë tek Ai. E ndërtofshim jetën tonë mbi një themel të sigurt e të siguruar.

Më 17 tetor 1989, teksa po ngisja makinën për në shtëpi pas pune, po i afrohesha një semafori në kryqëzimin e rrugëve “Market” dhe “Bill” në San-Francisko të Kalifornisë. Në atë çast e ndjeva makinën të tundej dhe mendova: “Duhet të jetë shfryrë ndonjë gomë”. Teksa makina vazhdonte të tundej, vura re një autobus mjaft afër meje dhe mendova: “Ai autobus sapo më goditi!” Pastaj makina u tund gjithnjë e më shumë dhe mendova: “Duhet të jenë katër goma të shfryra!” Por nuk ishin as gomat e shfryra, as autobusi – ishte një tërmet i fuqishëm! Kur ndalova te drita e kuqe, në rrugën e shtruar kishte valëzime si dallgë deti që rrokulliseshin teposhtë rrugës “Market”. Përpara meje, një ndërtesë e lartë zyrash po lëkundej nga njëra anë në tjetrën, dhe tulla filluan të binin nga një ndërtesë më e vjetër në të majtën time teksa toka vazhdonte të tundej.

Tërmeti Loma Prieta e goditi zonën e gjirit të San-Franciskos në orën 17:04 atë ditë dhe la 12.000 njerëz pa shtëpi.

Tërmeti shkaktoi dëm të rëndë në zonën e gjirit të San-Franciskos, veçanërisht më shumë në tokën e paqëndrueshme të San-Franciskos dhe Oklandit. Në San-Francisko, distrikti i Marinës kishte qenë ndërtuar mbi një vend groposjeje të mbushur me një

përzierje rëre, dheu, mbetje rrënojash, . . . dhe materialesh të tjera që përmbanin një përqindje të lartë uji. Një pjesë e materialit mbushës ishin mbetje rrënojash të hedhura në gjirin e San-Franciskos pas tërmetit të San-Franciskos në 1906–ën.¹

Rreth vitit 1915, mbi vendin e groposjes u ngritën ndërtesa apartamentesh. Në tërmetin e 1989–ës, lluca e pakonsoliduar e zhytur në ujë, rëra dhe mbetjet e rrënojave u shndërruan në një masë të lëngshme, duke shkaktuar rrëzimin e ndërtesave.



Ndërtesat nuk qenë ndërtuar mbi një themel të sigurt.

Tërmeti Loma Prieta preku shumë jetë, përfshirë timen. Meditimi për ngjarjet e asaj dite ripohon në mendjen dhe në zemrën time se për t’u bërë ballë me sukses stuhive, tërmeteve dhe katastrofave të jetës, ne duhet të mbështetemi mbi një themel të sigurt.

Profeti nefit, Helamani, i dha qartësi të pagabueshme rëndësisë së ndërtimit të jetës sonë mbi një themel të sigurt, madje themelin e Jezu Krishtit: “Dhe tani bijtë e mi, mbani mend, mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, po, shigjetat e tij në shtjellë të erës, po, kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi mbi ju, që t’ju tërheqë në humnerën e mjerimit dhe të vuajtjes së pafund, për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar, që është një bazë e sigurt, një bazë mbi të cilën në qoftë se njerëzit ndërtojnë, nuk mund të bien” (Helamani 5:12).

Në ngritjen e tempujve të kohëve të sotme, vëmendje e veçantë u jepet projektimit, ndërtimit dhe përdorimit të materialeve të ndërtimit. Bëhet një testim i tërësishëm i dherave dhe i gjeologjisë në vendin ku do të ndërtohet tempulli. Merren parasysh studimet mbi erën, shiun dhe ndryshimet e motit për zonën kështu që tempulli i përfunduar të mund t’u bëjë ballë jo vetëm stuhive dhe klimës së zakonshme të një zone, por tempulli projektohet dhe pozicionohet që t’u bëjë ballë tërmeteve, tajfuneve, përmbytjeve dhe katastrofave të tjera natyrore të papritura që mund të ndodhin. Në shumë tempuj, shtylla betoni ose çeliku futen thellë në



tokë për të mbështetur themelin e tempullit.

Njësoj si projektuesit dhe ndërtuesit e kohës sonë, Ati ynë i dashur e i mirë në Qiell dhe Biri i Tij kanë përgatitur plane, mjete dhe burime të tjera për përdorimin tonë kështu që të mund ta ndërtojmë dhe ta mbështesim jetën tonë që të jetë e sigurt dhe e patundur. Plani është plani i shpëtimit, plani i madh i lumturisë. Plani parashtron para nesh një pamje dhe kuptueshmëri të qartë të fillimit e të fundit dhe hapat themelorë, përfshirë ordinancat, që janë të nevojshme për secilin prej fëmijëve të Atit, që të jenë në gjendje të kthehen në praninë e Tij dhe të jetojnë me Të përgjithmonë.

Besimi, pendimi, pagëzimi, dhurata e Frymës së Shenjtë dhe durimi deri në fund janë pjesë e planeve strukturore të jetës. Ata ndihmojnë që të formohen blloqe të përshtatshme ndërtimi që do ta mbështesin jetën tonë të Shlyerja e Krishtit. Këta i japin formë dhe e përcaktojnë strukturën mbështetëse të jetës së një njeriu. Pastaj, ashtu si planet e tempullit që kanë hollësira që japin udhëzime të detajuara rreth mënyrës se si formohen dhe bashkohen përbërësit thelbësorë, lutja, leximi i shkrimeve të shenjta, marrja e sakramentit dhe marrja e ordinancave thelbësore të priftërisë bëhen “hollësira”

që ndihmojnë për të bashkuar dhe lidhur strukturën e jetës.

Drejtuesimi në zbatimin e këtyre hollësirave është jetik. Për shembull, në procesin e krijimit të betonit përdoren sasi të sakta rëre, zhavorri, çimentoje dhe uji në mënyrë që të arrihet forca maksimale. Një sasi e pasaktë apo përjashtimi i ndonjë pjese të këtyre elementeve, do ta bënte betonin të dobët dhe jo në gjendje për të kryer funksionin e tij të rëndësishëm.

Në mënyrë të ngjashme, edhe ne, nëse nuk sigurojmë në jetën tonë një drejtuesim të duhur të lutjes së përditshme vetjake e të ushqyerjes nga shkrimet e shenjta, të forcimit javor nga marrja e sakramentit e të pjesëmarrjes së vazhdueshme në ordinancat e priftërisë të tilla si ordinancat e tempullit, jemi në rrezik për t'u dobësuar në forcën tonë strukturore shpirtërore.

Pali, në një letër drejtuar Efesianëve, u shpreh në këtë mënyrë në lidhje me nevojën e një zhvillimi të drejtësuar dhe të harmonizuar të karakterit dhe të shpirtit tonë: “Mbi të cilin gjithë ndërtesa, e lidhur mirë, rritet për të qenë një tempull i shenjtë në Zotin” (Efesianëve 2:21).

Lutja është një prej blloqeve më kryesore e të rëndësishme të ndërtimit të themelit të besimit dhe të karakterit tonë. Përmes lutjes ne mund të shprehim mirënjohjen, dashurinë dhe

përkushtimin tonë ndaj Perëndisë. Përmes lutjes ne mund t'ia nënshtrijmë vullnetin tonë të Tijit dhe në këmbim marrim forcë për ta pajtuar jetën tonë me mësimet e Tij. Lutja është udha që mund të ndjekim për të kërkuar ndikimin e Tij në jetën tonë, madje zbulesën.

“Këshillohu me Zotin për të gjitha veprimet e tua dhe ai do të të drejtojë për të mirë; po, kur të biesh në mbrëmje, bier për Zotin, që ai të mund të të ruajë në gjumin tënd; dhe kur të ngrihesh në mëngjes, le të jetë zemra jote plot falënderime ndaj Perëndisë; dhe në qoftë se i bën këto gjëra, ti do të ngrihesh në ditën e fundit” (Alma 37:37).

Ndarja e mendimeve, ndjenjave dhe dëshirave tona me Perëndinë përmes lutjes së singertë e të përzemërt, duhet të bëhet për secilin prej nesh po aq e rëndësishme dhe e natyrshme sa frymëmarrja dhe të ngrënit.

Studimi i shkrimeve të shenjta çdo ditë do ta forcojë gjithashtu besimin dhe karakterin tonë. Ashtu siç kemi nevojë për ushqim që të ushqejmë trupat tanë fizikë, shpirti dhe fryma jonë do të rimbushet e do të forcohet duke u ushqyer me bollëk me fjalët e Krishtit siç gjendet te shkrimet e profetëve. Nefi dha mësim: “Ushqehuni me bollëk me fjalët e Krishtit; pasi, vini re, fjalët e Krishtit do t'ju tregojnë të gjitha gjërat që ju duhet të bëni” (2 Nefi 32:3).

Ndërkohë që leximi i shkrimeve të shenjta është i mirë, thjesht leximi është i pamjaftueshëm për të rrokur gjerësinë dhe thellësinë e mësimet të Shpëtimtarit. Hetimi, meditimi dhe zbatimi i fjalëve të Krishtit siç jepet mësim në shkrimet e shenjta, do të sjellin urtësi dhe dituri përtej të kuptuarit tonë të vdekshëm. Kjo do ta forcojë zotimin tonë dhe do të sigurojë rezerva shpirtërore që të bëjmë më të mirën tonë në të gjitha situatat.

Një prej hapave më të rëndësishëm që mund të hedhim për të forcuar jetën tonë dhe për të mbetur vendosmërisht të kapur pas themelit të Shpëtimtarit, është që ta marrim sakramentin denjësisht çdo javë. Ordinanca e sakramentit i jep çdo anëtar të Kishës mundësinë që të meditojë mbi jetën e tij ose të saj që më përpara, të marrë parasysh veprimet ose mosveprimet për të cilat duhet të pendohet, dhe më pas të marrë nga buka e uji si emblema të shenjta në kujtim të trupit dhe të gjakut të Krishtit, një dëshmi e Shlyerjes së Tij. Nëse bëhet me sinqeritet dhe përlësi, ne i përtërijmë besëlidhjet tona të përjetshme, pastrohemi e shenjtërohemi dhe marrim premtimin se do ta kemi Shpirtin e Tij me ne gjithmonë. Shpirti vepron si një lloj llaçi, një hallkë bashkuese që jo vetëm shenjtëron, por edhe i sjell të gjitha gjërat në kujtesën tonë dhe dëshmon vazhdimisht për Jezu Krishtin. Marrja e sakramentit denjësisht e forcon lidhjen tonë vetjake me shkëmbin e themelit, madje Jezu Krishtin.

Gjatë shërbesës së Tij, Shpëtimtari

dha mësim me dashuri dhe qartësi doktrinat, parimet dhe veprimet e nevojshme që do të na mbanin në jetë dhe do të na forconin karakterin. Në fund të Predikimit në Mal, Ai shpalli:

“Prandaj, kushdo që i dëgjon këto fjalët e mia dhe i bën ato, unë do ta krahasoj me një njeri të urtë që ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi një shkëmb—

Dhe shiu ra dhe përmytjet erdhën, dhe erërat frynë e u përplasën mbi atë shtëpi; dhe ajo nuk ra, pasi qe ndërtuar mbi një shkëmb.

Dhe çdo njeri që i dëgjon këto fjalët e mia dhe nuk i vë në zbatim, do t'i ngjajë një të marri që ka ndërtuar shtëpinë e tij në rërë—

Më pas ra shiu, erdhi përmytja, frynë erërat dhe u përplasën mbi atë shtëpi; ajo u shemb dhe rrënimi i saj qe i madh” (3 Nefi 14:24–27; shih edhe Mateu 7:24–27).

Vëllezër e motra, asnjëri prej nesh nuk do t'i ndërtonte shtëpitë, vendet e punës apo shtëpitë e shenjta të adhurimit me dijeni mbi rërë, mbetet

rrënojash ose pa plane dhe materiale të përshtatshme. E pranofshim ftesën e Shpëtimtarit që të vijmë tek Ai. E ndërtofshim jetën tonë mbi një themel të sigurt e të siguruar.

Unë dëshmoj përlësisht se, duke e mbështetur jetën tonë te Jezu Krishti e te Shlyerja e Tij dhe duke i zbatuar me kujdes planet e Tij për lumturinë tonë, përfshirë lutjen e përditshme, studimin e përditshëm të shkrimeve të shenjta dhe marrjen javore të sakramentit, ne do të forcohemi, do të përjetojmë rritje reale vetjake dhe kthim të qëndrueshëm në besim, do të jemi të përgatitur më mirë për t'u bërë ballë stuhive dhe katastrofave të jetës me sukses, do të përjetojmë gëzimin e lumturinë e premtuar dhe do të kemi sigurinë se jeta jonë është ndërtuar mbi një themel të sigurt – një themel që nuk do të rrëzohet kurrë. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIM

1. Shih “1989 Loma Prieta Earthquake,” wikipedia.org/wiki/1989_Loma_Prieta_earthquake.





Nga Elen S. Dalton,
Presidentja e Përgjithshme e Të Rejave
e Liruar së Fundi nga Thirrja

Ne Jemi Bija të Atit Tonë Qiellor

Si bija të Perëndisë, ne jemi secila e veçantë dhe e ndryshme në rrethanat dhe përvojat tona. Dhe sidoqoftë rolet tona kanë rëndësi – sepse ne kemi rëndësi.

Cdo javë, të rejat anembanë botës përsërisin temën e Të Rejave. Cilado qoftë gjuha, sa herë që i dëgjoj këto fjalë: “Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor, i cili na do ne dhe ne e duam Atë”¹, Shpirti ia pohon shpirtit tim se ato janë të vërteta. Nuk është vetëm një pohim i identitetit tonë – se cilat jemi – por edhe një pranim i faktit se të kujt jemi. Ne jemi bijat e një genieje të ekzaltuar!

Në çdo shtet dhe në çdo kontinent, kam takuar të reja me besim në vete, me aftësi oratorike, të mbushura me dritë, të përmirësuara përmes të punuarit fort dhe sprovës, që zotërojnë besim të pastër e të thjeshtë. Ato janë të virtytshme. Ato janë mbajtëse të besëlidhjes që “qëndrojnë] si dëshmitar[e] të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet”². Ato e dinë cilat janë dhe që kanë një rol të rëndësishëm për të luajtur për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë.

Kur isha në kolegji, isha anëtare e Valltarëve Folklorikë Ndërkombëtarë të UBJ-së. Një verë, grupi ynë pati privilegjin e pashoq për të shëtitur në misionet e Europës. Qe një verë e

vështirë për mua, sepse disa muaj më parë im atë kishte ndërruar jetë papritmas. Kur ishim në Skoci, u ndjeva vetëm dhe u dëshpërova në mënyrë të veçantë. Ne vallëzuam atë natë në një godinë kishtare dhe, pas interpretimit tonë, shkuam te dera ngjitur me shtëpinë e misionit. Teksa vazhdova ecjen, pashë një gur të vendosur pranë derës në një kopsht të mbajtur mirë.

Mbi të lexova fjalët: “Pavarësisht se kush je, luaje mirë rolin tënd”. Në atë çast, ato fjalë më depërtuan thellë në zemër dhe i ndjeva fuqitë e qiellit të vinin e të më aviteshin e të më jepnin një mesazh. E dija se më njihte një Atë i dashur Qiellor. Ndjeva se nuk isha vetëm. Qëndrova atje në atë kopsht me lot në sy. “Pavarësisht se kush je, luaje mirë rolin tënd.” Ajo shprehje e thjeshtë e përtëriu këndvështrimin tim se Ati Qiellor më njihte dhe kishte një plan për jetën time.

Më vonë, mësova se kjo shprehje dikur i kishte dhënë shtysë profetit Dejvid O. Mek-Kei teksa po shërbente si misionar i ri në Skoci. Ai e kishte parë atë mbi një gur në një ndërtesë, në një periudhë shkurruese të misionit të tij dhe ato fjalë i dhanë zemër atij. Vite më vonë, teksa ndërtesa po rrëzohej, ai mori masa që ta merrte gurin dhe e vendosi te kopshti në shtëpinë e misionit.³

Si bija të Perëndisë, ne jemi secila e veçantë dhe e ndryshme në rrethanat dhe përvojat tona. Dhe sidoqoftë rolet tona kanë rëndësi – sepse *ne*



Sidnei, Australi

kemi rëndësi. Kontributet tona të përditshme të edukimit, të mësimdhënies dhe të përkujdesjes ndaj të tjerëve mund të duken edhe të rëndomta, të zbehta, të vështira, pa vlerë ndonjëherë dhe prapëseprapë teksa kujtojmë atë rresht të parë të tema e Të Rejave – “Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor, i cili na do ne” – kjo do të sjellë ndryshimin madhor në reagimet dhe marrëdhëniet tona.

Së fundi, nëna ime e mrekullueshme 92-vjeçare, ndërroi jetë. Ajo e la këtë ekzistencë në vdekshmëri pasi kishte jetuar – në qetësi. Jeta e saj nuk ishte siç e kishte planifikuar. I shoqi, im atë, ndërroi jetë kur qe 45 vjeç, duke e lënë atë me tre fëmijë – mua dhe dy vëllezërit e mi. Ajo jetoi 47 vjet si vejushë. Ajo e mbajti familjen tonë duke dhënë mësim në shkollë gjatë ditës dhe duke dhënë mësim pianoje natën. Ajo u kujdes për të atin e moshuar, gjyshin tim, që jetonte ngjitur me ne. Ajo u siguroi që secili prej nesh të merrte arsimim të lartë. Në fakt, ajo këmbënguli te kjo që ne të bëheshim “kontribues”. Dhe ajo kurrë nuk u ankua. Ajo i mbajti besëlidhjet e saj dhe, për shkak se i mbajti ato, bëri që fuqitë e qiellit ta bekonin shtëpinë tonë dhe të dërgonin mrekulli. Ajo u mbështet te fuqia e lutjes, te priftëria dhe te premtimet e besëlidhjes. Ajo ishte besnike në shërbimin e saj ndaj Zotit. Përkushtimi i saj i patundur na forcoi ne, fëmijët e saj. Ajo shpesh përsëriste shkrimin e shenjtë: “Unë, Zoti, lidhem kur ju bëni çfarë ju them; por kur nuk e bëni çfarë ju them, ju nuk keni premtim”⁴. Kjo ishte motoja e saj dhe ajo e dinte se kjo ishte e vërtetë. Ajo e kuptoi se ç’do të thoshte të ishte një mbajtëse e besëlidhjes. Ajo nuk u njoh kurrë nga bota. Ajo nuk e dëshironte këtë gjë. Ajo e kuptoi cila ishte dhe e kujt ishte – një bijë e Perëndisë. Në të vërtetë, mund të thuhet



për nënën tonë që ajo e luajti mirë rolin e saj.

Për gratë dhe nënat, Presidenti Gordon B. Hinkli tha dikur:

“Ne nuk duhet ta harrojmë kurrë forcën e grave. . . . Janë nënat që ndikojnë më drejtpërdrejt në jetën e fëmijëve të tyre. . . . Janë nënat që i edukojnë dhe i rrisin ata sipas mënyrave të Zotit. Ndikimi i tyre është i pashoq. . . .

. . . Ato janë krijueset e jetës. Ato janë edukueset e fëmijëve. Ato janë mësueset e të rejave. Ato janë shoqet tona të domosdoshme. Ato janë bashkëpunëtorët tona për ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë. Sa i madh është roli i tyre, sa e mahnitshme ndihma tyre.”⁵

Si e rrënjos një nënë ose baba te një bijë e dashur të vërtetën fisnikëruese dhe të përjetshme që ne jemi bija të Perëndisë? Si i ndihmojmë ato ta lënë botën dhe t’i afrohen më shumë mbretërisë së Perëndisë?

Në një botë moralisht të pandjeshme, të rejtat kanë nevojë që burrat dhe gratë të “qëndrojnë si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet”. Kjo nuk ka qenë kurrë më e rëndësishme se tani. Të rejave u duhen nëna dhe u duhen mësueset që të japin shembull rreth të qenit grua

e virtutshme. Nëna, marrëdhënia me bijën tuaj është me rëndësi të skajshme dhe po kështu shembulli juaj. Mënyra si e respektoni babanë e saj, priftërinë e tij dhe rolin e tij hyjnor do të pasqyrohet dhe ndoshta do të theksohet më shumë te qëndrimet dhe sjellja e bijës suaj.

Cili është ai rol që të gjithë duhet “ta luaj[më] mirë”? Proklamata e familjes është e qartë:

“Nëpërmjet planit hyjnor, etërit duhet të kryesojnë familjet e tyre me dashuri e drejtësi dhe janë përgjegjës për të siguruar gjërat e nevojshme për jetën dhe mbrojtjen për familjet e tyre. Nënata janë kryesisht përgjegjëse për edukimin e fëmijëve të tyre. Në këto përgjegjësi të shenjta, etërit dhe nënat kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë. . . .

Ne paralajmërojmë se individët që shkelin besëlidhjet e dëlirësisë, që abuzojnë me bashkëshorten, bashkëshortin ose fëmijët apo që nuk pëmbushin përgjegjësitë familjare, do të qëndrojnë një ditë përgjegjës përpara Perëndisë.”⁶

Në shoqërinë e rënë të kohës së Mormontit, ai shprehu keqardhjen se grave iu rrëmbye ajo që ishte më e dashur dhe më e çmueshme përmbi të gjitha gjërat – virtyti dhe dëlirësia e tyre.⁷



Sërish, e përsëris thirrjen për një kthim te virtyti. Virtyti është forca dhe fuqia e bijave të Perëndisë. Si do të ishte bota nëse virtyti – zakonet e të menduarit dhe të sjelljes në pajtim me standardet e larta të moralshmërisë⁸ – do të rivendoseshin në shoqërinë tonë si vlera më e çmuar? Nëse pamoralshmëria, pornografia dhe abuzimi do të pakësoheshin, a do të kishte më pak martesë të prishura, jetë të shkatërruara dhe zemra të thyera? A do të mundesh media t'i fisnikëronte dhe t'u jepte mundësi bijave të çmuara të Perëndisë, në vend që t'i trajtonte si objekt dhe t'i ulte? Nëse i gjithë njerëzimi do ta kuptonte vërtet rëndësinë e shprehjes: “Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor”, si do të shiheshin e si do të trajtoheshin gratë?

Disa vite më parë, teksa Qendra e Konferencave ishte pranë përfundimit, unë hyra në këtë ndërtesë të shenjtë te ballkoni me një kapele të

rëndë dhe syze mbrojtëse, gati për të fshirë me fshesën me korrent qilimin, të cilin bashkëshorti im po ndihmonte të vendosej. Aty ku tani është foltorja, ishte një traktor i vogël, i lëvizshëm, që hiqte mbetjet e ndërimit, që do të thotë se pluhuri në këtë ndërtesë ishte i dendur. Kur ndaloj, e pluhurosi qilimin e ri. Roli im ishte të fshija me fshesë me korrent. Dhe kështu unë fshiva e fshiva pareshtur. Dhe pas tri ditësh, fshesa ime e vogël me korrent u dogj!

Pasditen përpara konferencës së përgjithshme të parë në këtë ndërtesë të bukur e të re, më thirri im shoq. Ai qe gati të vendoste pjesën e fundit të qilimit – nën këtë foltore historike.

Ai pyeti: “Çfarë shkrimi të shenjtë duhet të shkruaj prapa këtij qilimi?”

Dhe i thashë: “Mosia 18:9: ‘Qëndro si dëshmitar [i] Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet’”.

Në një kohë jashtë mase sfiduese, kjo është ajo që po bëjnë të rejtat dhe të gjitha gratë e kësaj Kishe. Ato janë një ndikim për mirë. Ato janë të virtytshme dhe shembullore, të zgjuara dhe punëtore. Ato po sjellin një ndryshim, sepse ato janë të ndryshme. Ato po e luajnë mirë rolin e tyre.

Vite më parë, kur po e fshija këtë qilim me fshesën e korrentit – duke u përpjekur ta luaja mirë rolin tim të vogël – nuk e dija se një ditë do të qëndroja më këmbë mbi qilimin nën këtë foltore.

Sot, si bijë e Perëndisë, unë qëndroj dhe jap dëshminë time se Perëndia jeton. Jezusi është Krishti. Ai është Shëlbuesi ynë. Është nëpërmjet sakrificës së Tij të pafundme shlyese që një ditë unë do të kthehem të jetoj me Të – e sprovuar, e pastër dhe e vulosur në një familje të përjetshme. Do t'i thur gjithnjë lavde Atij për privilegjin e të qenit grua, bashkëshorte dhe nënë. Unë dëshmoj se ne udhëhiqemi nga një profet i Perëndisë, Presidenti Tomas S. Monson dhe jam mirënjohëse për burrat e drejtë, fuqia e priftërisë e të cilëve më bekon jetën. Dhe do të jem gjithnjë mirënjohëse për forcën që marr përmes fuqisë ndihmuese të Shpëtimtarit, teksa vazhdoj të përpiqem që ta “luaj [rolin tim] mirë”. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Përparimi Personal i Të Rejave* (broshurë, 2009), f. 3.
2. Mosia 18:9.
3. Shih Matthew O. Richardson, “‘What E'er Thou Art, Act Well Thy Part’: John Allan's Albany Crescent Stone,” *Journal of Mormon History*, vol. 33 (Fall 2007), 31–61; Francis M. Gibbons, *David O. McKay: Apostle to the World, Prophet of God* (1986), f. 45.
4. Doktrina e Besëlidhje 82:10
5. Gordon B. Hinckley, “Standing Strong and Immovable”, *Worldwide Leadership Training Meeting*, 10 janar 2004, f. 21.
6. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
7. Shih Moroni 9:9.
8. Shih *Të Rejtat Përparimi Personal*, f. 70.



Nga Plaku Krejg A. Kardon,
i Të Shtatëdhjetëve

Shpëtimtari Dëshiron të Falë

*Zoti na do dhe dëshiron që të kuptojmë gatishmërinë
e Tij për të falur.*

Gjatë shërbesës në vdekshmëri të Shpëtimtarit tonë shumë njerëz e ndoqën Atë, përfshirë skribët dhe farisenjtë “nga të gjitha fshatrat e Galileës, të Judesë dhe nga Jeruzalemi”¹. Një burrë që dergjej në shtrat e i paralizuar që dëshironte të shërohej, u soll te një turmë e madhe njerëzish, por miqtë e tij, duke mos qenë në gjendje ta çonin afër Shpëtimtarit, e morën te çatia e shtëpisë në të cilën që Shpëtimtari dhe e u ulën poshtë. Duke parë këtë shfaqje të besimit, me një qëllim të madh, ende të panjohur për dëgjuesit e Tij, Shpëtimtari shpalli: “Njeri, mëkatet e tua të janë falur”².

Kjo duhet ta ketë habitur burrin dhe, ndonëse shkrimet e shenjta nuk thonë gjë për reagimin e tij, ai mund të ketë pyetur veten nëse Shpëtimtari e kuptonte vërtet arsyen përse ai kishte ardhur.

Shpëtimtari e dinte se shumë njerëz e ndiqnin për shkak të mrekullive të Tij të mëdha. Tashmë kishte kthyer ujin në verë³; kishte dëbuar frymëra të ndyra⁴; kishte shëruar djalin e nëpunësit të mbretit⁵, një lebroz⁶, vjehrrën e Pjetrit⁷ e shumë të tjerë⁸.

Por me këtë burrë të paralizuar, Zoti zgjodhi t’u jepte si dishepuje të

Tij edhe mosbesimtarëve një provë të rolit të Tij unik si Shpëtimtari i botës. Me të dëgjuar fjalët e Shpëtimtarit, skribët dhe farisenjtë kishin filluar të arsyetonin mes tyre, duke folur në padituri për blasfemi ndërsa dolën në përfundimin se vetëm Perëndia mund ta falte mëkatet. Duke i njohur mendimet e tyre, Shpëtimtari iu drejtua duke thënë:

“Ç’po arsyetoni në zemrat tuaja?

Çfarë është më e lehtë, të thuhet: ‘Mëkatet e tua të janë falur’, apo të thuhet: ‘Çohu dhe ec?’”

“Tani, pra, me qëllim që ju ta dini se Biri i njeriut ka pushtet *mbi tokë* të falë mëkatet, unë të them ([atëherë u kthye nga i] paralizuari), çohu, merre vigun tënd dhe shko në shtëpinë tënde!”¹⁰ Dhe ai u çua!


Përmes këtij shërimi fizik të mrekullueshëm, Shpëtimtari na pohoi të gjithë neve këtë të vërtetë shpirtërore, pafundësisht më të fuqishme: Biri i Njeriut fal mëkatet!

Ndërsa kjo e vërtetë pranohet me lehtësi nga të gjithë besimtarët, jo kaq lehtësisht e pranueshme është e vërteta thelbësore shoqërore: Shpëtimtari i fal mëkatet “mbi tokë” dhe jo vetëm në Gjykimin Përfundimtar. Ai

nuk na shfajëson *në* mëkatet tona.¹¹ Ai nuk na lejon të kthehemi te mëkatet e së shkuarës.¹² Por kur pendohe mi dhe i bindemi ungjillit të Tij, Ai na fal.¹³

Në këtë falje ne shikojmë të zbatohet fuqia ndihmuese *dhe* shëlbuese e Shlyerjes në mënyrë të harmonishme dhe të hirshme. Nëse ushtrojmë besim në Zotin Jezu Krisht, fuqia ndihmuese e Shlyerjes së Tij na *forcon* në çastin kur kemi nevojë¹⁴, dhe fuqia e Tij shëlbuese na *shenjtëron* kur “zhvesh[im] njeriun e natyrshëm”¹⁵. Kjo sjell shpresë për të gjithë, veçanërisht për ata që mendojnë se dobësia njerëzore që përsëritet, është përtej gatishmërisë së Shpëtimtarit për të ndihmuar e shpëtuar.

Duke i dhënë Shpëtimtarit një mundësi për të ndriçuar kuptimin tonë¹⁶, Pjetri një herë kërkoi të dinte se sa herë duhet ta falte vëllanë e tij, dhe pastaj pyeti: “Deri shtatë herë?” Sigurisht kjo





do të qe më se e mjaftueshme. Por përgjigja e Shpëtimtarit na hapi dyert për të kuptuar zemrën e *Tij* të mëshirshme: “Unë *nuk* të them deri shtatë herë, por deri shtatëdhjetë herë shtatë”¹⁷.

Zoti na do dhe dëshiron që të kuptojmë gatishmërinë e *Tij* për të falur. Në më shumë se 20 raste te Doktrina e Besëlidhje, Zoti u tha atyre të cilëve po u fliste: “Mëkatet e tua të janë falur”, ose fjalë të ngjashme.¹⁸ Në pothuajse gjysmat e atyre rasteve, fjalët e Zotit i drejtoheshin veçanërisht Profetit Jozef Smith, hera–herës duke iu drejtuar vetëm atij, hera–herës atij bashkë me të tjerët.¹⁹ I pari nga këto raste u shkrua në vitin 1830, i fundit në vitin 1843. Pra, gjatë një intervali prej shumë vitesh, Zoti i tha Jozefit në mënyrë të përsëritur: “Mëkatet e tua të janë falur”.

Ndonëse Jozefi nuk qe “fajtor për mëkate të mëdha ose të liga”²⁰, ne bëjmë mirë të mbajmë mend se me përjashtime shumë të rralla, [premtimi i] Zotit [për të falur] “shtatëdhjetë herë shtatë” nuk e kufizon faljen sipas seriozitetit të mëkatit.

Ndërsa po u fliste pleqve të mbledhur në Kirtland, Zoti tha: “Unë dëshiroj që ju ta mundni botën; *prandaj*

do të kem dhembshuri për ju”²¹. Zoti e njeh dobësinë tonë dhe pasojat e përjetshme të “botë[s]” te burrat e gratë e papërsosura.²² Fjala *prandaj* në këtë varg është pohimi i *Tij* se është vetëm përmes dhembshurisë së *Tij* që ne përfundimisht mund “ta mund[im] botën”. Si shfaqet kjo dhembshuri? Po të njëjtëve pleq në Kirtland, Ai u tha: “Jua kam falur mëkatet tuaja”²³. *Shpëtimtari dëshiron të falë*.

Askush nuk duhet të mendojë se kjo falje vjen pa pendim. Në të vërtetë, Zoti ka shpallur: “Unë, Zoti, ua fal mëkatet atyre që i rrefejnë mëkatet e tyre përpara meje dhe kërkojnë falje”, dhe pastaj i paralajmëron për një kërkesë tjetër, “atyre që nuk kanë mëkatuar me vdekje”²⁴. Ndërsa Zoti “nuk mund ta shoh mëkatin as me shkallën më të vogël të lejimit”²⁵, përsëri Ai bën dallimin në seriozitetin përkatës të disa mëkateve. Ai përcakton se nuk do të ketë falje për “blasfemi[në] kundër Frymës së Shenjtë”²⁶. Ai shpall seriozitetin e vrasjes²⁷ dhe thekson peshën e mëkatit seksual të tillë si shkëlja e kurorës.²⁸ Në lidhje me përsëritjen e mëkatit serioz seksual, Ai bën të ditur vështirësinë në rritje të marrjes së faljes prej *Tij*.²⁹ Dhe Ai ka thënë se: “Ai që mëkaton kundër

dritës më të madhe, do ta marrë dënimin më të madh”³⁰. Përsëri, në mëshirën e *Tij*, Ai lejon për përmirësim me kohë në vend që të kërkojë përsosje të menjëhershme. Edhe me numrin e madh të mëkateve që janë rezultat i dobësisë në vdekshmëri, aq herë sa pendohemi dhe kërkojmë faljen e *Tij*, Ai na fal, vazhdimisht.³¹

Për shkak të kësaj, të gjithë ne, përfshirë ata që po përpiqen të mposhtin sjelljet e varësisë të tilla si abuzimin me substancat ose pornografinë, si dhe ata që janë pranë tyre, mund ta dinë se Zoti do t’i pranojë përpjekjet tona të drejta dhe, kur pendimi është i plotë, do të na falë me dashuri “deri shtatëdhjetë herë shtatë”. Por kjo nuk do të thotë që mund t’i kthehesh *me gatishmëri* mëkatit pa u ndëshkuar.³²

Zoti është gjithmonë i interesuar për zemrën³³ që kemi dhe besimi i rremë me arsyetime nuk e justifikon mëkatin.³⁴ Në këtë periudhë ungjillore, Zoti e paralajmëroi një prej shërbëtorëve të *Tij* kundër këtyre arsyetimeve duke thënë: “[Ai] duhet të turpërohet për bandën e nikolaitëve dhe për gjithë fëlliqësitë e tyre të fshehta”³⁵. Nikolaitët qenë sekt i lashtë fetar që pretendonin se kishin leje për të kryer mëkat seksual për shkak të hirit të Zotit.³⁶ Kjo nuk është e pëlqyeshme për Zotin.³⁷ Dhembshuria dhe hiri i *Tij* nuk na shfajësojnë kur “zemrat t[ona] nuk kënaqen . . . [d]he . . . nuk i binde[m]i të] vërtetës, por kënaq[emi] në padrejtësi”³⁸. Përkundrazi, pasi bëjmë gjithçka që mund të bëjmë³⁹, dhembshuria dhe hiri i *Tij* janë mjetet me anë të të cilave “me kalimin e kohës”⁴⁰ e mposhtim botën përmes fuqisë ndihmuese të Shlyerjes. Ndërsa e kërkojmë me përlësi këtë dhuratë të çmuar “gjërat e dobëta . . . bëhen të forta në [ne]”⁴¹ dhe përmes fuqisë së *Tij*, ne jemi në gjendje të bëjmë atë që nuk mund ta bëjmë kurrë të vetëm.

Zoti sheh dritën që kemi marrë⁴², dëshirat e zemrës sonë⁴³ dhe veprimet tona⁴⁴ dhe, kur pendohemi e kërkojmë faljen e Tij, Ai na fal. Ndërsa marrim parasysh vetë jetën tonë dhe jetën e të dashurve e të njohurve tanë, ne duhet të jemi njësoj të gatshëm të falim veten dhe të tjerët.⁴⁵

Predikoni Ungjillin Tim flet për vërshtirësinë e mposhtjes së sjelljes së varësisë dhe i nxit udhëheqësit e priftërisë dhe anëtarët që “të [mos] befasohen apo të dekurajohen” nëse kërkuesit ose anëtarët e rinj vazhdojnë të luftojnë me probleme të tilla. Përkundrazi, ne këshillohemi “të tregojmë besim tek individit dhe të mos jemi paragjykyer; . . . [duke e] konsideruar këtë si një dështim të përkohshëm dhe të kuptueshëm”⁴⁶. A mund të bëjmë më pak përpjekje me vetë fëmijët apo anëtarët e familjes sonë që luftojnë me probleme të ngjashme, ngaqë kanë dalë përkohësisht nga shtegu i drejtësisë? Me siguri, ata e meritojnë qëndrueshmërinë, durimin dhe dashurinë tonë – dhe sigurisht, faljen tonë.

Në konferencën e përgjithshme, pikërisht tetorin që shkoi, Presidenti Monson këshilloi:

“Ne duhet ta ngulisim në mendje që njerëzit mund të ndryshojnë. Ata mund t’i lënë pas veset e këqija. Ata mund të pendohen për shkeljet. . . .

. . . Ne mund t’i ndihmojmë ata t’i mposhtin të metat e tyre. Ne duhet të zhvillojmë aftësinë për t’i parë njerëzit jo siç janë në këtë çast, por si mund të bëhen.”⁴⁷

Në një konferencë më të hershme të Kishës, të ngjashme me këtë konferencë, Zoti u tha anëtarëve:

“Në të vërtetë unë ju them, ju jeni të pastër, por jo të gjithë. . . .

Pasi *gjithë mishi* është i prishur përpara meje.

. . . Pasi në të vërtetë disa nga ju janë fajtorë para meje, por unë do

të jem i mëshirshëm ndaj dobësisë suaj.”⁴⁸

Mesazhi i Tij është po i njëjti sot. Ati ynë Qiellor e di me çfarë po përballemi, se të gjithë mëkatojmë dhe vazhdimisht “priv[ohemi] nga lavdia e Perëndisë”⁴⁹. Ai dërgoi Birin e Tij, i cili “e njezh dobësinë e njeriut dhe se si të ndihmojë ata që tundohen”⁵⁰. Biri i Tij na mëson të “lutemi] gjithmonë që të mos hyjmë në tundim”⁵¹. Na është thënë që t’i “përgjero[hem] [Perëndisë] për mëshirë; pasi ai është i fuqishëm të shpëtojë”⁵². Shpëtimtari na urdhëron që të pendohemi⁵³ dhe të falim⁵⁴. Dhe megjithëse pendimi nuk është i lehtë, ndërsa përpjekimi me gjithë zemrën tonë që t’i bindemi ungjillit të Tij, Ai na jep këtë premtim: “Në të vërtetë unë ju them, pavarësisht nga mëkatet [tuaja], *brendësia ime mbushet me dhembshuri për [ju]*. Unë nuk do t’[ju] dëboj . . . tërësisht; *dhe në ditën e zemërimit do t’[ju] kujtoj me mëshirë.*”⁵⁵ Shpëtimtari dëshiron të falë.

Çdo javë, Kori Mormon i Tabernakullit e fillon transmetimin e tij frymëzues me fjalët moralisht lartësuese të



himnit të njohur të Uilliam W. Felpsit “Gently Raise the Sacred Strain [Këng’n e Shenjt’ Ti Butë Ngri]”. [Por] nuk janë aq të njohura fjalët ngushëlluese të vargut të katërt:

I Shenjt’, i shenjt’ është’ Zoti.

E çmuar fjala e Tij: . . .

Pendim t’jetosh, . . .

*Dhe sikur shumë’ m’kate t’kesh,
O, pendohu që të falesh.*⁵⁶

Ju ftoj t’i kujtoni dhe t’i besoni fjalët e Zotit dhe të ushtroni besim në Të në pendim.⁵⁷ Ai ju do. Ai dëshiron të falë. Unë dëshmoj kështu, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lluca 5:17; shih edhe Marku 2:2.
2. Lluca 5:20; shih edhe Mateu 9:2; Marku 2:5.
3. Shih Gjoni 2:1–11.
4. Shih Marku 1:21–28; Lluca 4:33–37.
5. Shih Gjoni 4:46–54.
6. Shih Mateu 8:1–4; Marku 1:40–45; Lluca 5:12–15.
7. Shih Mateu 8:14–15; Marku 1:29–31; Lluca 4:38–39.
8. Shih Mateu 8:16–17; Marku 1:32–34; Lluca 4:40–41.
9. Lluca 5:22–23; shih edhe Mateu 9:3–5; Marku 2:6–9.
10. Lluca 5:24; theksimi i shtuar; shih edhe Mateu 9:6–7; Marku 2:10–12.
11. Shih 1 Korintasve 6:9–10; Alma 11:34, 37; Helamani 5:10–11.
12. Shih 2 Pjetrit 2:20; Jakobit [Bibël] 2:10; Doktrina e Besëlidhje 82:7.
13. Shih Isaia 1:18; Jeremia 31:34; Lluca 7:36–50; Enosi 1:5; Alma 24:10; Moroni 6:8; Doktrina e Besëlidhje 1:32; 58:42–43.
14. Shih Jakobit 4:7; Alma 14:26; Moroni 10:7.
15. Mosia 3:19; shih edhe 2 Nefi 10:24–25.
16. Shih Alma 32:28, 34.
17. Mateu 18:21–22; theksimi i shtuar; shih edhe Lluca 17:1–4.
18. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:5–7; 25:3; 29:3; 31:5; 36:1; 50:36; 60:6–7; 61:2; 62:3; 64:1–4, 5–7, 15–17; 75:6–8; 82:1; 84:60–61; 90:1, 6; 108:1; 110:5; 112:3; 124:74–76, 78; 132:50.
19. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:5–7; 29:3; 60:6–7; 61:2; 62:3; 64:5–7; 84:60–61; 90:1; 110:5; 132:50.
20. Joseph Smith—Historia 1:28.
21. Doktrina e Besëlidhje 64:2; theksimi i shtuar.

22. Shih 1 Nefi 20:9–11; Doktrina e Besëlidhje 24:2; 50:41; 63:47; 108:1–8.
23. Doktrina e Besëlidhje 64:3.
24. Doktrina e Besëlidhje 64:7.
25. Doktrina e Besëlidhje 1:31; shih edhe vargjet 32–33; Alma 45:16.
26. Doktrina e Besëlidhje 132:27; shih edhe Mateu 12:31; Lluca 12:10.
27. Shih Eksodi 20:13; Mosia 13:21; Doktrina e Besëlidhje 132:19; Moisiu 5:31–36.
28. Shih Alma 39:5; Doktrina e Besëlidhje 42:24–26.
29. Shih Doktrina e Besëlidhje 42:22–26, 75–78, 80–82; 63:13–17; 76:103.
30. Doktrina e Besëlidhje 82:3; shih edhe Gjoni 15:22.
31. Shih Moroni 6:8.
32. Shih Mosia 15:26.
33. Shih 1 Samuelit 16:7; Psalmeve 24:3–4; Fjalët e Urta 23:7; Mateu 15:18–20; Marku 7:20–23; Hebrejve 3:12; 3 Nefi 12:19; Doktrina e Besëlidhje 59:8; 64:34.
34. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:29–30; 121:37.
35. Doktrina e Besëlidhje 117:11.
36. Shih Bible Dictionary, “Nicolaïtans”.
37. Shih Zbulesa 2:6, 15.
38. Doktrina e Besëlidhje 56:15.
39. Shih 2 Nefi 25:23; Doktrina e Besëlidhje 138:4.
40. Moisiu 7:21.
41. Ethëri 12:27.
42. Shih Gjoni 15:22; Doktrina e Besëlidhje 1:33; 82:3.
43. Shih Alma 41:5–6; 3 Nefi 9:20; Doktrina e Besëlidhje 137:9.
44. Shih 1 Nefi 15:33; Alma 41:3–4; Doktrina e Besëlidhje 137:9.
45. Shih Mateu 6:14–15; Doktrina e Besëlidhje 64:8–10; 98:39–48.
46. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2005), f. 196.
47. Tomas S. Monson, “Shihni të Tjerët ashtu siç Mund të Bëhen”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 68, 69; theksimi i shtuar.
48. Doktrina e Besëlidhje 38:10–1, 14; theksimi i shtuar.
49. Romakëve 3:23.
50. Doktrina e Besëlidhje 62:1; shih edhe Alma 7:12.
51. Doktrina e Besëlidhje 61:39; theksimi i shtuar.
52. Alma 34:18; theksimi i shtuar; shih edhe 2 Nefi 31:19; Alma 7:14.
53. Shih Helamani 13:11; Doktrina e Besëlidhje 19:4, 13–21.
54. Shih Doktrina e Besëlidhje 64:8–10.
55. Doktrina e Besëlidhje 101:9; theksimi i shtuar; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 82:1–7.
56. “Gently Raise the Sacred Strain [Këng’n e Shenjt’ Ti Butë Ngril]”, *Hymns*, nr. 146.
57. Shih Alma 34:15–17.



Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“Kjo Është Vepra Ime dhe Lavdia Ime”

Perëndia ua ka dhënë lirisht fuqinë e Tij atyre që e pranojnë dhe e nderojnë priftërinë e Tij, që çon te bekimet e premtuara të pavdekësisë dhe të jetës së përjetshme.

Presidenti Paker, ne të gjithë mezi po e presim variantin e 98-të të asaj poeme të mrekullueshme.

Çfarë mësimi të jashtëzakonshëm na dha ai!

Disa javë përpara, në një natë të ftohtë e të errët dimri, bashkëshortja ime, Barbara dhe unë pamë me dritërimë lart në qiell. Milionat e yjeve dukeshin veçanërisht të ndritshëm dhe të bukur. Unë iu ktheva atëherë Perlës me Vlerë të Madhe dhe e lexova përsëri me habi atë që Zoti Perëndi i tha Moisiut: “Dhe botë pa numër kam krijuar; dhe unë gjithashtu i krijova ato për qëllimin tim; dhe me anë të Birit i krijova ato, që është i Vetëmlinduri im” (Moisiu 1:33).

Në kohën tonë teleskopi i hapësirës së thellë Habëll ka vërtetuar rëndësinë e asaj që pa Moisiu. Shkençetarët e Habëllit thonë se galaktika e Udhës së Qumështit, ku toka dhe dielli ynë janë vetëm një pjesëz e vogël, vlerësohet të jetë vetëm një nga më shumë se 200 miliard galaktikat si kjo. Për mua është e vështirë ta kuptoj, e pamundur ta mendoj, kaq të mëdha dhe të pafundme janë krijimet e Perëndisë.

Vëllezër e motra, fuqia me të cilën qiejt dhe toka u krijuan dhe krijohen është priftëria. Ata prej nesh që janë anëtarë të Kishës, e dinë se burimi i kësaj fuqie të priftërisë është Perëndia i Plotfuqishëm dhe Biri i Tij, Jezu Krishti. Jo vetëm që priftëria është fuqia me të cilën u krijuan qiejt dhe toka, por ajo është edhe fuqia që Shpëtimtari përdori në shërbesën e Tij tokësore për të kryer mrekulli, për të bekuar dhe shëruar të sëmurë, për të sjellë të vdekurin në jetë dhe, si Biri i Vetëmlinduri i Atit tonë, të duronte dhembjen e padurueshme të Gjetsemanit dhe të Golgotës – duke i përmbushur kështu ligjet e drejtësisë me mëshirë e duke siguruar një Shlyerje të pafund, dhe duke e mposhtur vdekjen fizike nëpërmjet Ringjalljes.

Janë çelësat e këtij autoriteti të priftërisë dhe rezultati i fuqisë që Ai i dha Pjetrit, Jakobit dhe Gjonit dhe Apostujve të tjerë të Tij, për të bekuar të tjerët dhe për të lidhur në qiell atë që është lidhur në tokë.

Fuqia e priftërisë është një dhuratë e shenjtë dhe thelbësore e Perëndisë. Ajo është e ndryshme nga autoriteti i priftërisë, i cili është autorizimi për të



vepruar në emër të Perëndisë. Autorizimi apo shugurimi jepet me anë të vendosjes së duarve. Fuqia e priftërisë vjen vetëm kur ata që e ushtrojnë atë, janë të denjë dhe duke vepruar në përputhje me vullnetin e Perëndisë. Siç shpalli Presidenti Spenser W. Kimball: “Zoti na ka dhënë të gjithëve ne, si mbajtës të priftërisë, një pjesë të autoritetit të tij, por ne mund t’i përdorim fuqitë e qiellit vetëm mbi bazën e drejtësisë sonë vetjake” (“Boys Need Heroes Close By”, *Ensign*, maj 1976, f. 45).

Gjatë ditëve të mrekullueshme të Rivendosjes dhe rithemelimit së Kishës së Jezu Krishtit sot në botë, Gjon Pagëzori; Pjetri, Jakobi dhe Gjoni; Moisiu; Eliasi dhe Elija erdhën në tokë dhe rivendosën nëpërmjet Profetit Jozef Smith të gjithë çelësat dhe autoritetin e priftërisë për punën e Perëndisë në këto ditë të mëvonshme.

Është me anë të këtyre çelësave, këtij autoriteti dhe kësaj fuqie që Kisha e Jezu Krishtit është e organizuar

sot, me Krishtin në krye që drejton profetin e Tij të gjallë, Tomas S. Monson, dhe ndihmohet duke thirrur e shuguruar në mënyrën e duhur Apostujt.

Në planin e mrekullueshëm të Atit tonë Qiellor që u jep burrave fuqinë e priftërisë, burrat kanë përgjegjësinë e vetme për të administruar priftërinë, por ata nuk janë priftëria. Burrat dhe gratë kanë role të ndryshme por njësoj të vlerësuara. Ashtu si një grua nuk mund të krijojë një fëmijë pa një burrë, edhe një burrë nuk mund ta ushtrojë plotësisht fuqinë e priftërisë për të krijuar një familje të përjetshme pa një grua. Me fjalë të tjera, në këndvështrimin e përjetësisë, si fuqia krijuese edhe fuqia e priftërisë janë të përbashkëta për një bashkëshort dhe një bashkëshorte. Dhe si bashkëshort dhe bashkëshorte, një burrë dhe një grua duhet të përpiqen ta ndjekin Atin tonë Qiellor. Virtytet e krishtera të dashurisë, përlësisë dhe durimit duhet të jenë qendra e vëmendjes së

tyre ndërsa kërkojnë bekimet e priftërisë në jetën e tyre dhe për familjen e tyre.

Është vendimtare që ne të kuptojmë se Ati Qiellor ka siguruar një mënyrë për të gjithë bijtë dhe bijat e Tij që të kenë qasje te bekimet e fuqisë së priftërisë dhe të forcohen prej saj. Qendrore te plani i Perëndisë për fëmijët e Tij shpirtërorë është vetë thënia e Tij: “Kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut” (Moisiu 1:39).

Në një zbulësë dhënë Profetit Jozef Smith te seksioni 81 i Doktrinës e Besëlidhjeve, Zoti shpjegon se fuqia e priftërisë duhet përdorur për të “ndihm[uar] të dobëtit, ngrit[ur] duart që varen poshtë dhe forc[uar] gjunjët e këputur” (vargu 5).

“Dhe duke i bërë këto gjëra, ti do t’u bësh të mirën më të madhe bashkëqenieve të tua dhe do të nxisësh lavdinë e atij që është Zoti yt” (DeB 81:4).

Ndërsa mendojmë rreth përfytyrimit të ndihmës për të dobët, ngritjes së duarve që varen poshtë, dhe forcimit të gjunjëve të këputur, mua më kujtohet një vajzë e dashur shtatëvjeçare duke i treguar gjyshit të saj një bimë të vogël domateje që e pati mbjellë qysh kur ishte farë, si pjesë e një detyre shkollë të klasës së dytë.

Ajo shpjegoi se nga një farë e vockël do të bëhej një bimë. Dhe nëse për bimën do të bëhej kujdes, ajo do të rriste shumë domate ku secila do të kishte shumë fara.

Ajo tha: “Dhe nëse të gjitha ato fara do të mbilleshin dhe do të rrisnin më shumë domate, dhe ju do t’i mbillnit të gjitha ato fara, në disa periudha ju do të kishit miliona domate”.

“*Të gjitha*”, tha ajo e mahnitur, “nga një farë e vogël”.

Por pastaj ajo tha: “Unë gati e vrava bimën time. E lashë në një dhomë të errët dhe harrova ta ujitja. Kur u kujtova për bimën, ajo ishte e dobët dhe dukej e tharë. Unë qava ngaqë mendova për gjithë ato miliona domate që nuk do të rriteshin kurrë.”

Ajo qe emocionuar pra që t’i tregonte gjyshit të saj rreth “mrekullisë” që ndodhi.

Ajo shpjegoi: “Mami tha se ndoshta bima nuk qe tharë. Ndoshta gjithçka që nevojitej ishte pak ujë dhe pak dritë që t’i sillte përsëri jetën.

Dhe ajo kishte të drejtë. Unë i dhashë bimës pak ujë dhe e vura në dritare për dritë. Dhe gjejeni se ç’ndodhi?” pyeti ajo. “Ajo u kthye në jetë, dhe tani ajo do të rrisë miliona domate!”

Bima e saj e vogël e domates, aq përplot me potencial, por aq e dobësuar dhe e fishkur nga shpërfillja e paqëllimshme, qe forcuar dhe rigjallëruar nëpërmjet një trajtimi të thjeshtë me ujë dhe dritë nga duart e dashura dhe përkujdesëse të vajzës së vogël.

Vëllezër e motra, si fëmijë të vërtetë shpirtërorë të Atit tonë të dashur Qiellor, ne kemi një potencial të pakufizuar hyjnor. Por nëse ne nuk jemi të kujdesshëm, ne mund të bëhemi si bima e fishkur e domates. Ne mund të largohemi nga doktrina e ungjilli i vërtetë i Krishtit dhe të bëhemi shpirtërisht të paushqyer dhe të fishkur, duke e larguar veten nga drita hyjnore dhe ujërat e gjalla të dashurisë së përjetshme dhe të fuqisë së priftërisë të Shpëtimtarit.

Ata që mbajnë priftërinë dhe nuk përpiqen vazhdimisht për ta respektuar atë duke u shërbyer familjeve të veta dhe të tjerëve, do të jenë si ata që nuk *marrin* bekimet që janë te fuqia e priftërisë dhe me siguri do të fishken



shpirtërisht, duke ia ndaluar vetes ushqyesit thelbësorë shpirtërorë, dritën dhe fuqinë e Perëndisë në jetën e tyre – thuajse njësoj si bima e domates aq përplot me potencial por e braktisur dhe e fishkur.

Po ajo fuqi e priftërisë që krijoi botët, galaktikat dhe universin mund dhe duhet të jetë pjesë e jetës sonë për të ndihmuar, forcuar dhe bekuar familjet tona, miqtë tanë dhe fqinjët tanë – me fjalë të tjera, për të bërë gjërat që Shpëtimtari do të bënte nëse Ai do të qe duke shërbyer mes nesh sot.

Dhe qëllimi kryesor i kësaj fuqie të priftërisë është të na bekojë, shenjëtojë dhe pastrojë në mënyrë që të mund të jetojmë së bashku me familjet tona në prani të prindërve tanë qiellorë, të lidhur nga vulosje të priftërisë, duke marrë pjesë në punën e mrekuallueshme të Perëndisë dhe Jezu Krishtit, në përhapjen e dritës dhe lavdisë së *Tyre* përgjithmonë.

Për këtë qëllim, disa muaj më parë pata rastin të marr pjesë në bërjen e një prezantimi të paraqitur me video për trajnimin mbarëbotëror të udhëheqjes, të quajtur *Forcimi i Familjes dhe i Kishës përmes Priftërisë*.

Kjo DVD e re dhe udhëzuese është përkthyer në 66 gjuhë. Ajo na mëson se si fuqia e priftërisë mund ta bekojë, ta gjallërojë dhe ta rigjallërojë jetën tonë, jetën e familjeve tona dhe jetën e të gjithë anëtarëve të Kishës.

Ajo na tregon ne të gjithëve – burra, gra, fëmijë; të martuar, të ve, apo beqarë/e; pavarësisht nga rrethanat tona – se si mund të jemi marrës të bekimeve të priftërisë. Ka disa segmente 8 deri 12-minutëshe që shpjegojnë çelësat, autoritetin dhe fuqinë e priftërisë dhe se si ajo forcon individët, familjet dhe Kishën.

Një skenë e veçantë u filmua në shtëpinë shumë të vogël pioniere të stërgjyshes së nënës sime, Meri Filding

Smith. Ajo qe vejusha e Hajrëmit, vëllait më të madh të Profetit Jozef. Si prind i vetëm, nëpërmjet besimit të saj të fortë te priftëria, ajo e thirri atë fuqi dhe u mbështet në të për t'i rritur dhe bekuar fëmijët e saj në dashurinë dhe dritën e ungjillit. Sot pasardhësit e saj që numërohen në mijëra udhëheqës dhe anëtarë besnikë të Kishës, e falënderojnë atë për besimin, kurajën dhe shembullin e saj.

Ky trajnim i ri për udhëheqjen është tani i disponueshëm në internet te LDS.org që të shihet dhe të përjetohet nga të gjithë (wwlt.llds.org). Ju mund ta shihni drejtpërdrejt nga LDS.org, ose mund ta shkarkoni në kompjuterin, smartfonin, apo panelin tuaj kompjuterik.

Presidenca e Parë u ka kërkuar “presidencave të kunjeve dhe peshkopave që një ose më shumë mbledhje të këshillit të kunjit apo të lagjes t’ia kushtojnë shikimit të [të gjithë] DVD-së. Këshillat e kunjeve dhe të lagjeve duhet të diskutojnë se si t’i zbatojnë mësimet që paraqiten” (Letër e Presidencës së Parë, 1 shkurt 2013).

Përmbajtja do t’i frymëzojë dhe motivojë anëtarët në mbledhjet e kuorumeve të priftërisë, Shoqatës së Ndihmës, Shkollës të së Dielës, të Të Rejave, të Të Rinjve (sidomos atyre që përgatiten për misione) dhe të Fillores ose në mbledhjet e përbashkëta në të dielat e pesta. Anëtarët e këshillit do të jenë atëherë në gjendje të nxisin individë dhe prindër që ta përdorin këtë prezantim me familjet e tyre. Vëllezër e motra, ky trajnim për udhëheqjen është për çdo anëtar të Kishës. Prindër, rishikojeni, ndajeni dhe diskutojeni atë që mësoni dhe ndieni me fëmijët tuaj dhe i lini ata ta shohin dhe të bëjnë po kështu me ju, që familjet tuaja të mund të forcohen nëpërmjet priftërisë.

Jezusi tha:

“Nëse dikush ka etje, le të vijë tek unë e të pijë” (Gjoni 7:37).



“Kush pi nga uji që do t’i jap unë nuk do të ketë më kurrë etje përjetë; por uji që unë do t’i jap do të bëhet në të një burim uji që gufon në jetë të përjetshme” (Gjoni 4:14).

“Unë jam drita e botës; kush më ndjek . . . do të ketë dritën e jetës” (Gjoni 8:12).

Nëse ndonjë nga ju ndien se besimi apo dëshmia e tij për planin e Atit Qiellor është më e vogël sesa e dini se duhet të jetë, atëherë drejtohuni më plotësisht te Shpëtimtari. Lëreni dritën e Tij dhe ujin e Tij të gjallë të bëjë për ju dhe familjen tuaj atë që pak ujë dhe dritë bënë për t’i risjellë jetën bimës së dobësuar të domates.

Tani, unë fillova me habinë dhe drithërimën për krijimet e Perëndisë nëpërmjet fuqisë së priftërisë. Unë qëndroj këtu duke pyetur veten, siç hamendësoj se bën edhe shumica prej jush, nëse mund të kuptohet ndonjëherë plotësisht fuqia e Perëndisë për të na udhëzuar dhe bekuar. Ajo është kaq e madhe, kaq

madhështore, kaq e mrekullueshme.

Jozef Smithi tha: “Priftëria është një parim i përjetshëm dhe ekzistonte me Perëndinë që nga përjetësia, dhe do të ekzistojë në përjetësi, pa fillim të ditëve ose fund të viteve” (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 108).

Perëndia ua ka dhënë lirisht fuqinë e Tij atyre që e pranojnë dhe e nderojnë priftërinë e Tij, që çon te bekimet e premtuara të pavdekësisë dhe të jetës së përjetshme.

Unë dëshmoj se puna e Jezu Krishtit është përmbushur nëpërmjet priftërisë. Ajo është fuqia me anë të së cilës Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij i Dashur e krijuan këtë tokë dhe vunë në zbatim planin e madh të lumturisë për përfitim tonë. Qofshim të urtë dhe le të kërkojmë të forcojmë nëpërmjet fuqisë së priftërisë së Perëndisë vetë jetën tonë, jetën e familjeve tona dhe Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, është lutja ime e përlur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

“Ejani tek Unë”

Me anë të fjalëve të Tij dhe shembullit të Tij, Krishti na ka treguar se si të afrohem me pranë Tij.

Jam mirënjohës që jam me ju në këtë konferencë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Kjo është Kisha e Tij. Ne marrim emrin e Tij mbi vete kur hyjmë në mbretërinë e Tij. Ai është Perëndia, Krijuesi, dhe është i përsosur. Ne jemi genie që i nënshtrohemi vdekjes dhe të prirur ndaj mëkatit. Përsëri, për shkak të dashurisë së Tij për ne dhe familjet tona, Ai na fton të jemi pranë Tij. Këto janë fjalët e Tij: “M’u afroni pranë dhe unë do të afrohem pranë jush; kërkoni me zell dhe do të më gjeni; lypni dhe do të merrni; trokisni dhe do t’ju çelet”¹.

Në këtë stinë Pashke, ne na sillet ndërmend arsyeja përse e duam Atë dhe premtimi që Ai u bën dishepujve të Tij besnikë për t’u bërë miqtë e Tij të dashur. Shpëtimtari e bëri atë premtim dhe na tregoi se si, nëpërmjet shërbimit tonë ndaj Tij, Ai vjen te ne. Një shembull është në një zbulësë dhënë Oliver Kauderit, kur i shërbeu Zotit bashkë me Profetin Jozef Smith në përkthimin e Librit të Mormonit: “Vër re, ti je Oliveri dhe unë të kam folur për shkak të dëshirave të tua; si rrjedhim, mbajti këto fjalë thesar në zemrën tënde. Ji besnik e i zellshëm në zbatimin e urdhërimeve të Perëndisë dhe unë do të të rrethoj me krahët e dashurisë sime.”²

Unë përjetova gëzimin e ardhjes më pranë Shpëtimtarit dhe të ardhjes së Tij më pranë meje, më shpesh nëpërmjet veprimeve të thjeshta të bindjes ndaj urdhërimeve.

Ju keni pasur përvoja të tilla. Mund të kenë ndodhur kur zgjodhët të merrnit pjesë në një mbledhje sakramenti. Më ndodhi mua në një Shabat, kur isha shumë i ri. Në ato kohë, ne e merrnin sakramentin gjatë një mbledhjeje në mbrëmje. Kujtimi i një dite më shumë se 65 vite më parë, kur e zbatova urdhërimin për t’u mbledhur me familjen time dhe me shenjtorët, ende më afron më pranë Shpëtimtarit.

Jashtë ishte errësirë dhe ftohtë. Më kujtohet që ndjeva dritë dhe ngrohtësi në kishë atë mbrëmje me prindërit e mi. Ne morëm sakramentin, e administruar nga mbajtës të Priftërisë Aarone, duke besëlidhur me Atin tonë të Amshuar për ta kujtuar gjithmonë Birin e Tij dhe për t’i zbatuar urdhërimet e Tij.

Në fund të mbledhjes kënduam himnin “Abide with Me; ’Tis Eventide” [“Me Mua Rri; Është Muzg Tani”], që kishte fjalët “O Shpët’us, pran’ k’të nat’ më mi”³.

E ndjeva dashurinë dhe afërsinë e Shpëtimtarit atë mbrëmje. Dhe ndjeva ngushëllimin e Frymës së Shenjtë.

Doja t’i ndizja edhe njëherë ndjenjat e dashurisë për Shpëtimtarin dhe afërsinë e Tij, të cilat i ndjeva gjatë

mbledhjes së sakramentit në rininë time. Kështu që kohët e fundit zbatova një urdhërim tjetër. Hetova në shkriemet e shenjta. Në to, e dija se mund të kthehesha përsëri për ta pasur Frymën e Shenjtë që të më lejonte të ndieja atë që dy dishepujt e Zotit të ringjallur kishin ndier, kur Ai i ishte përgjigjur ftesës së tyre për të shkuar në shtëpinë e tyre dhe për të qëndruar me ta.

Lexova për ditën e tretë pas Kryqëzimit dhe varrimit të Tij. Gra besnike dhe të tjerë e gjetën gurin të larguar nga varri dhe panë se trupi i Tij nuk ishte më atje. Ato kishin ardhur për t’ia vajosur trupin, për shkak të dashurisë për Të.

Dy engjëj qëndruan pranë dhe i pyetën përse kishin frikë, duke thënë: “Pse e kërkoni të gjallin midis të vdekurve?”

Ai nuk është këtu, por është ringjallur; kujtohuni si ju foli, kur ishte ende në Galile,

duke thënë se Biri i njeriut duhej të dorëzohej në duar të njerëzve mëkatarë, duhej kryqëzuar dhe do të ringjallej ditën e tretë.”⁴

Ungjilli sipas Markut shton udhëzimin nga një prej engjëjve: “Por shkoni dhe u thoni dishepujve të tij dhe Pjetrit se ai po ju pararend në Galile; atje do ta shihni, ashtu siç ju pati thënë”⁵.

Apostujt dhe dishepujt ishin mbledhur në Jerusalem. Sikurse do të ishim ndier ne, ata patën frikë dhe vranë mendjen ndërsa folën së bashku rreth asaj se çfarë do të thoshte për ta vdekja dhe rrëfimet për ringjalljen e Tij.

Dy nga dishepujt ecën atë mbrëmje nga Jerusalem në rrugën për në Emaus. Krishti i ringjallur u shfaq në rrugë e sipër dhe eci me ta. Zoti kishte ardhur tek ata.

Libri i Llukës na lejon të ecim me ta: “Dhe ndodhi që, ndërsa po flisnin dhe bisedonin bashkë, vetë Jezusi u afrua dhe nisi të ecë me ta.

Por sytë e tyre ishin të penguar kështu që të mos e njihnin.

Dhe ai u tha atyre: ‘Ç’janë këto biseda që bëni me njëri-tjetrin udhës? Dhe pse jeni të trishtuar?’

Dhe një nga ata, me emër Kleopa, duke u përgjigjur tha: ‘Je ti i vetmi i huaj në Jeruzalem, që nuk i di gjërat që kanë ndodhur këtu në këto ditë?’⁶

I treguan Atij për trishtimin e tyre ngaqë Jezusi kishte vdekur, kur ata kishin besuar se Ai do të ishte Shëlbuesi i Izraelit.

Duhej të kishte pasur dhembshuri në zërin e Zotit të ringjallur, kur ai u foli këtyre dy dishepujve të hidhëruar dhe të pikëlluar:

‘Atëherë ai u tha atyre: ‘O budallenj dhe zemërngathët për të besuar gjithçka që kanë thënë profetët!’

Por a nuk duhej që Krishti të vuajë gjëra të tilla që të hyjë kështu në lavdinë e tij?’

Dhe, duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij.’⁷

Atëherë erdhi një çast që e ka ngrohur zemrën time, që kur isha djalë i vogël:

‘Kur iu afruan fshatit për ku ishin drejtuar, ai bëri sikur do të vazhdonte më tutje.

Por ata e detyruan duke thënë: ‘Rri me ne, sepse po ngryset dhe dita po mbaron’. Dhe ai hyri që të rrijë me ta.’⁸

Shpëtimtari e pranoi atë natë ftesën për të hyrë në shtëpinë e dishepujve të Tij pranë fshatit Emaus.

U ul të hante me ta. Ai mori bukën, e bekoji, e theu dhe ua dha atyre. Sytë e tyre u çelën, kështu që ata e njohën Atë. Atëherë, Ai u zhduk prej syve të tyre. Lluka shënoi për ne ndjenjat e atyre dishepujve të bekuar: ‘Dhe ata i thanë njeri tjetrit: ‘Po a nuk na digjej zemra përbrenda, kur ai na fliste udhës dhe na hapte Shkrimet?’⁹



Në po atë çast, të dy dishepujt u kthyen me nxitim në Jeruzalem për t’iu thënë të njëmbëdhjetë Apostujve se çfarë u kishte ndodhur. Në atë çast Shpëtimtari u shfaq përsëri.

Ai përmendi profecitë e misionit të Tij për të shlyer për mëkatet e të gjithë fëmijëve të Atit të Tij dhe për të këputur rripat e vdekjes.

‘Dhe u tha atyre: ‘Kështu është shkruar dhe kështu ishte e nevojshme që Krishti të vuante dhe të ngjallej së vdekuri ditën e tretë,

dhe që në emër të tij të predikohet pendimi dhe falja e mëkateve ndër të gjithë popujt, duke filluar nga Jeruzalemi.

Dhe ju jeni dëshmitarët e këtyre gjërave.’¹⁰

Fjalët e Shpëtimtarit janë po aq të vërteta për ne sa ishin për dishepujt e Tij në atë kohë. Ne jemi dëshmitarë të këtyre gjërave. Dhe detyra e lavdishme që pranuar kur u pagëzuam në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, u bë e qartë për ne nga profeti Alma shekuj më parë tek ujërat e Mormonit:

‘Dhe ndodhi që ai u tha atyre: Vini re, këtu janë ujërat e Mormonit (pasi kështu quheshin) dhe tani, pasi ju dëshironi të hyni në grigjën e Perëndisë dhe të quheni populli i tij dhe jeni të gatshëm të mbani barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta –

Po, dhe jeni të gatshëm të vajtoni me ata që vajtojnë; po, dhe të ngushëlloni ata që kanë nevojë të



ngushëllohen dhe të qëndroni si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që ju të gjendeni, madje deri në vdekje, që ju të mund të shëlbheni nga Perëndia dhe të numëroheni me ata të ringjalljes së parë, që ju të mund të keni jetën e përjetshme –

Tani unë ju them, në qoftë se kjo është dëshira e zemrave tuaja, çfarë keni kundër pagëzimit në emrin e Zotit, si një dëshmi para tij që ju keni hyrë në një besëlidhje me të, se ju do t'i shërbeni atij dhe do të zbatoni urdhërimet e tij, që ai të mund të derdhë mbi ju Shpirtin e tij më me shumicë?

Dhe tani, kur njerëzit kishin dëgjuar këto fjalë, ata përplasën duart e tyre nga gëzimi dhe thirrën: Kjo është dëshira e zemrave tona.¹¹

Ne kemi besëlidhur për të lartësuar ata që janë në nevojë dhe gjithashtu për të qenë dëshmitarë të Shpëtimtarit për aq kohë sa jetojmë.

Ne vërtet do të jemi në gjendje ta bëjmë atë pa dështuar, vetëm kur ndiejmë dashuri për Shpëtimtarin dhe kur ndiejmë dashurinë e Tij për ne. Kur jemi besnikë ndaj premtimeve që kemi bërë, ne vërtet do ta ndiejmë dashurinë tonë për Të. Ajo do të rritet, sepse ne do ta ndiejmë vërtet fuqinë e Tij dhe tërheqjen e Tij pranë nesh në shërbim të Tij.

Presidenti Tomas S. Monson na ka kujtuar shpesh për premtimin e Zotit ndaj dishepujve të Tij besnikë: “Dhe

kushdo që ju pranon ju, atje do të jem unë gjithashtu, sepse unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja dhe engjëjt e mi përreth jush, për t'ju ngritur lart.”¹²

Ka një mënyrë tjetër që ju dhe unë e kemi ndier Atë të na vijë më pranë. Kur i japim shërbim të përkushtuar Atij, Ai u afrohet më pranë atyre që i duam në familjet tona. Sa herë që jam thirrur në shërbim të Zotit për ta shpërngulur familjen time ose për ta lënë atë, kam arritur të kuptoj se Zoti po i bekonte bashkëshorten time dhe fëmijët e mi. Ai përgatiti shërbëtorë të dashur të Tij dhe mundësi për ta afruar familjen time më pranë Tij.

Ju e keni ndier po atë bekim në jetën tuaj. Shumë prej jush kanë njerëz të dashur që po enden larg shtegut për te jeta e përjetshme. Ju vrisni mendjen se ç'mund të bëni më shumë për t'i kthyer ata përsëri. Ju mund të mbështeteni te Zoti për t'u afruar më pranë tyre, ndërkohë që i shërbeni Atij me besim.

Kujtoni premtimin e Zotit dhënë Jozef Smithit dhe Sidni Ridgonit, kur ata ishin larg familjeve të tyre duke bërë punët e Tij: “Miqve të mi Sidney dhe Joseph, familjet tuaja janë mirë; ato janë në duart e mia dhe unë do të bëj me ta si të më duket mirë; sepse në mua është gjithë fuqia”¹³.

Sikurse Alma dhe mbreti Mosia, disa prindër besnikë i kanë shërbyer

Zotit kaq gjatë dhe kaq mirë, por përsëri kanë pasur fëmijë që u endën pavarësisht nga sakrificat e prindërve të tyre për Zotin. Ata kanë bërë gjithë çka mundeshin pa ndonjë dobi të dukshme, madje edhe me ndihmë prej miqve të dashur dhe besnikë.

Alma dhe shenjtorët e ditës së tij u lutën për birin e tij dhe bijtë e mbretit Mosia. Një engjëll erdhi. Lutjet tuaja dhe lutjet e atyre që e ushtrojnë besimin e tyre, do të sjellin shërbëtorët e Zotit për t'i ndihmuar anëtarët e familjes suaj. Do t'i ndihmojnë ata të zgjedhin rrugën për t'u kthyer te Perëndia, edhe kur sulmohen nga Satani dhe pasuesit e tij, qëllimi i të cilëve është të shkatërrojnë familjet në këtë jetë dhe në përjetësi.

I kujtoni fjalët që engjëlli i foli Almës, të Riut, dhe bijve të Mosias gjatë rebelimit të tyre: “Dhe engjëlli tha përsëri: Shiko, Zoti ka dëgjuar lutjet e popullit të tij dhe gjithashtu lutjet e shërbëtorit të tij, Almës, i cili është ati yt; pasi ai është lutur me besim të madh në lidhje me ty, që ti të mund të sillesh në njohurinë e së vërtetës; prandaj, për këtë shkak unë erdha të të bind ty për fuqinë dhe autoritetin e Perëndisë, që lutjet e shërbëtorëve të tij të mund të marrin përgjigje, sipas besimit të tyre”.¹⁴

Premtimi im për ju që i luteni dhe i shërbeni Zotit, nuk mund të jetë që ju do të keni çdo bekim që mund të dëshironi për veten dhe familjen tuaj. Por mund t'ju premtoj se Shpëtimtari do të afrohet më pranë jush dhe do t'ju bekojë ju dhe familjen tuaj me atë që është më e mira. Ju do të keni ngushëllimin e dashurisë së Tij dhe do ta ndieni përgjigjen e afrimit të Tij më pranë, ndërsa e shtrini dorën tuaj për t'u dhënë shërbim të tjerëve. Ndërsa lidhni plagët e atyre që kanë nevojë dhe u ofroni pastrimin e Shlyerjes së Tij atyre që ndiejnë trishtim për



Los Anxhelos, Kaliforni, SHBA

mëkatin, fuqia e Zotit do t'ju mbësh-tesë. Duart e Tij shtrihen së bashku me tuajat për t'i ndihmuar dhe bekuar fëmijët e Atit tonë Qiellor, duke përfshirë edhe ata në familjen tuaj.

Një kthim i lavdishëm në shtëpi përgatitet për ne. Ne vërtet do të shohim atëherë premtimin e përmbushur të Zotit që e kemi dashur. Është Ai që na mirëpret në jetën e përjetshme me Të dhe me Atin tonë Qiellor. Jezu Krishti e përshkroi atë në këtë mënyrë:

“Kërko të sjellësh dhe të ndërtosh Sionin tim. Zbato urdhërimet e mia në të gjitha gjërat.

Dhe, nëse i zbaton urdhërimet e mia e duron deri në fund, ti do të kesh jetë të përjetshme, dhuratë e cila është më e madhja nga të gjitha dhuratat e Perëndisë.”¹⁵

“Sepse ata që jetojnë, do të trashëgojnë tokën dhe ata që vdesin, do të prehen nga gjithë punët e tyre dhe veprat e tyre do t'i ndjekin; dhe ata do të marrin një kurorë në banesat e atit tim, të cilat i kam përgatitur për ta.”¹⁶

Unë dëshmoj se ne, me anë të Shpirtit, mund ta ndjekim ftesën e Atit Qiellor: “Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!”¹⁷

Me anë të fjalëve të Tij dhe shembullit të Tij, Krishti na ka treguar se si të afrohem me pranë Tij. Çdo fëmijë i Atit Qiellor, i cili ka zgjedhur të hyjë nëpërmjet portës së pagëzimit në Kishën e Tij, do të ketë mundësinë që t'i mësohet ungjilli i Tij dhe që ta dëgjojë nga shërbëtorët e Tij të thirrur ftesën e Tij për të “[ardhur] tek unë”¹⁸.

Çdo shërbëtor i Tij i besëlidhjes brenda mbretërisë së Tij në tokë dhe në botën e shpirtave do ta marrë drejtimin e Tij me anë të Shpirtit, kur ata i bekojnë të tjerët dhe u shërbejnë atyre për Të. Atëherë ata do të ndiejnë dashurinë e Tij dhe do të gjejnë gëzim në afrimin me pranë Tij.

Unë jam dëshmitar i Ringjalljes së Zotit, me po aq siguri sikur të kisha qenë atje në mbrëmjen me dy di-shepujt në shtëpinë në rrugën për në Emaus. E di se Ai jeton me po aq siguri sa e dinte edhe Jozef Smithi kur pa Atin dhe Birin në dritën e një mëngjesi të shkëlqyeshëm në korijen e drurëve në Palmira.

Kjo është Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit. Vetëm te çelësat e priftërisë, të mbajtura nga Presidenti Tomas S. Monson, është fuqia për ne që të

vulosemi si familje për të jetuar përgjithmonë me Atin tonë Qiellor dhe Zotin Jezu Krisht. Ne vërtet do të qëndrojmë në Ditën e Gjykimit përpara Shpëtimtarit, ballë për ballë. Ajo do të jetë një kohë gëzimi për ata që janë afruar pranë Tij në shërbimin e Tij në këtë jetë. Do të jetë gëzim të dëgjojnë fjalët: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik”¹⁹. Unë dëshmoj kështu, si dëshmitar i Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë të ringjallur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 88:63.
2. Doktrina e Besëlidhje 6:20.
3. “Abide with Me; 'Tis Eventide”, *Hymns*, nr. 165.
4. Lluca 24:5–7.
5. Marku 16:7.
6. Lluca 24:15–18.
7. Lluca 24:25–27.
8. Lluca 24:28–29.
9. Lluca 24:32.
10. Lluca 24:46–48.
11. Mosia 18:8–11.
12. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
13. Doktrina e Besëlidhje 100:1.
14. Mosia 27:14.
15. Doktrina e Besëlidhje 14:6–7.
16. Doktrina e Besëlidhje 59:2.
17. Joseph Smith – Historia 1:17.
18. Mateu 11:28.
19. Mateu 25:21.



Paraqitur nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Propozohet që ne të mbështesim Tomas Spenser Monson, si profet, shikues dhe zbulues, si dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorf, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë atë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Bojd Kenet Paker, si President të

Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ata që vijojnë, si anëtarë të atij kuorumi: Bojd K. Paker, L. Tom Peri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson dhe Nil L. Andersen.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë në të njëjtën mënyrë.

Propozohet që ne të mbështesim këshilltarët në Presidencën e Parë

dhe Dymbëdhjetë Apostujt si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Plaku Uolter F. Gonzáles është liruar nga thirrja si anëtar i Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne në një votim vlerësimi, lutemi ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështesim Plakun Ulises Soares si anëtar të Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne të lirojmë sa vijojnë nga thirrjet si Të Shtatëdhjetë Zonalë, duke filluar nga data 1 maj 2013: Rubén V. Aliod, Serxho M. Anaia, Nolan D. Arçibald, Karlos L. Astorga, Hektor Avila, M. Entoni Bërns, Dejvid Kabrera, Milton Kamargo, Robert E. Çembërs, Viktor Ka Keng Çen, Kuo Çiang Çung, Nelson D. Kórdova, Geri L. Kritenden, Eduard Dubi, Methju J. Ajring, Sion M. Fineanganofu, Alfredo L. Xhezati, Xhejms B. Gibson, Xhovenço A. Guancon, Mario E. Guerra, Luiz S. Hernandez, Hernan I. Herrera, Zhavier Ibanjez, Paulo H. Ixhonose, Daglas W. Xhesop, Stivën C. Ker, Xhoni L. Koh, Faustino López, Riçard K. Melçin, Fribadi A. Mensah, Benson E. Misaluka, Abelardo Morales, W. T. Dejvid Mërrri, K. Bret Netres, S. Giford Nilsen, Satoshi Nishihara, Majkëll D. Pikërd, Uilliam F. Reynolds, Majkëll A. Roberts, Fernando A. R. Da Roha, Manfred Shyce, Terrens C. Smith, Rubén L. Spitale, Xhoshua Subandrijo, Frenk V. Traithëll, Miguel R. Valdez, Arnulfo Valencuela, Karlos A. C. Vilianova, Terens M. Vinson, Luis





Vaidman dhe Riçard C. Sambrano.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohjen tonë për shërbimin e tyre të shkëlqyer, lutemi ta tregojnë.

Propozohet që ne të lirojmë nga thirrjet me një votë vlerësimi të sinqertë Motrat Elen S. Dalton, Meri N. Kuk dhe En M. Dib, si presidenca e përgjithshme e Të Rejave.

Gjithashtu ju drejtojmë lirim nga thirrjet të gjitha anëtareve të bordit të përgjithshëm të Të Rejave.

Të gjithë ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin këtyre motrave për shërbimin dhe përkushtimin e tyre të shquar, lutemi ta tregoni.

Propozohet që ne të mbështesim si anëtarë të rinj të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve Eduard Dubi, S. Giford Nilsen dhe Arnulfo Valencuela; dhe si anëtarë të rinj të Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve Timothy J. Daiks, Rendi D. Fank, Kevin S. Hamilton, Adrián Oçoa dhe Terens M. Vinson.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata kundër, me të njëjtën shenjë.

Për shkak të thirrjes së tij si anëtar i Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve, gjithashtu lirojmë nga thirrja Vëllanë Adrián Oçoa si këshilltar të dytë në

presidencën e përgjithshme të Të Rinjve.

Ata të cilët dëshirojnë të shprehin një votë vlerësimi, mund ta tregojnë në të njëjtën mënyrë.

Propozohet që të mbështesim personat që vijojnë si Të Shtatëdhjetë Zonalë të rinj: Ruben Akosta, Frederik O. Akinbo, Omar A. Alvarez, Serxho Antunes, Alen C. Bet, Grent C. Benet, Fernando E. Kalderón, Uilson B. Kalderón, H. Marselo Kardus, Jok Sang (Fred) Çan, Kristofer Çarls, Valeri V. Kordón, Pol R. Kouard, M. T. Ben Dejvis, Masimo De Feo, Marion B. De Antunjano, Françisko J. Ruis de Mendoza, Robert A. Driden, Robert J. Dadfilld, Daniel F. Danigen, Xhefri D. Erekson, E. Havier Espinoza, Meliula M. Fata, Sam M. Galvez, Klaud R. Gamiet, Mervin C. Gidi, Zhao R. Gral, Dejvid P. Homer, Daniel W. Xhons, Xhon A. Koranteng, Stivën O. Leng, Aksel H. Laimer, Gustavo Lopez, Hosé E. Maravilla, Alfredo Miron, Hugo Montoia, Xhoahim J. Moreira, Katsujuki Otahara, Hosé C. Pineda, Geri S. Prais, Mikuel A. Rijes, Geri B. Seibin, Alfredo L. Salas, Necahualkojotl Salinas, Siro Shmail, D. Zakeri Smith, Majkëll L. Southuard, G. Lorens Spekmen, Vërn P. Stenfill, Uilliam H. Stodard, Stivën E. Tompson, Xhorxh J. Tobajas, 'Aisak K. Tukuafu,

Zhak A. Van Rinen, Raul E. Visencio, Raul S. Vilanueva, Elen R. Uolker, Kith P. Uolker dhe Hoi Seng Leonard Uo.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne të mbështesim Boni Li Grin Oskarson si presidente të përgjithshme të Të Rejave, me Karol Luis Foli Mek-Konki si këshilltar të parë dhe Evelin Nill Fut Mariot si këshilltar të dytë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër, mund ta tregojë po ashtu.

Propozohet që ne të mbështesim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetë Zonalë dhe presidentat e përgjithshme të organizatave ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë.

Faleminderit, vëllezër dhe motra, për votimin tuaj mbështetës dhe për besimin dhe lutjet tuaja të vazhdueshme në emrin tonë.

I ftojme Autoritetet e Përgjithshme dhe presidencën e përgjithshme të Të Rejave të sapothirrura që të vijnë e të zenë vendet e tyre në panel. ■

Raporti i Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2012

Paraqitur nga Robert W. Kentuell,

Drejtor Administrimi, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës

Drejtuar Presidencës së Parë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Të dashur Vëllezër: Siç përshkruhet me anë të zbulës në seksionin 120 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Këshilli mbi Planifikimin e Të Dhjetave autorizon shpenzimin e fondeve të Kishës. Ky këshill përbëhet nga Presidencia e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese.

Ky këshill miraton buxhetet për departamentet e veprimtaritë e Kishës dhe shpërndarjet përkatëse për njësitë kishtarë. Subjektet e Kishës i shpenzojnë fondet në përputhje me buxhetet e miratuara dhe në harmoni me politikat e procedurat e Kishës.

Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës i është dhëna e drejta e disponimit të të gjitha dokumenteve dhe sistemeve të nevojshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e kontroleve për fondet e marra, shpenzimet, si dhe mbrojtjen e pasurive të Kishës. Departamenti i Kontrollit Financiar të

Kishës është i pavarur nga të gjitha departamentet dhe veprimtaritë e tjera të Kishës, dhe stafi përbëhet nga contabilistë publikë të licencuar, kontrollorë të brendshëm të licencuar, kontrollorë të licencuar të sistemeve të informacionit dhe nga profesionistë të tjerë të licencuar.

Bazuar mbi kontrollet financiare të kryera, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës është i mendimit se, të gjithë vlerat materiale, kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe pasuritë e Kishës për vitin 2012, janë regjistruar dhe administruar në harmoni me praktika të përshtatshme llogaritëse, buxhetet e aprovuara dhe politikat e procedurat e Kishës.

I paraqitur me respekt nga
Departamenti i Kontrollit
Financiar të Kishës
Robert W. Kentuell
Drejtor Administrimi ■

Raporti Statistikor, 2012

Paraqitur nga Bruk P. Hejls,

Sekretar i Presidencës së Parë

Për informimin e anëtarëve të Kishës, Presidencia e Parë ka nxjerrë raportin statistikor që vijon, lidhur me rritjen dhe gjendjen e Kishës deri më 31 dhjetor 2012.

Njësi të Kishës

Kunje.....	3,005
Misione.....	347
Distrikte	591
Lagje dhe Degë.....	29,014

Anëtarësia e Kishës

Anëtarësia e Përgjithshme.....	14,782,473
Fëmijë të Vegjël të Regjistruar gjatë vitit 2012	122,273
Të Kthyer në Besim të Pagëzuar gjatë vitit 2012	272,330

Misionarë

Misionarë Kohëplotë.....	58,990
Misionarë në Shërbim të Kishës.....	22,961

Tempuj

Tempuj të Përkushtuar gjatë vitit 2012 (Kansas–Siti në Misuri, Manausi në Brazil, Brigam–Siti në Juta dhe Kalgari në Alberta)	4
Tempuj të Ripërkushtuar gjatë vitit 2012 (Buenos–Ajresi në Argjentinë dhe Boisi në Ajdaho)	2
Tempuj në Funkcionim	140





Nga Plaku Riçard G. Skot,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Për Paqe në Shtëpi

Një nga bekimet më të mëdha që mund t'i ofrojmë botës, është fuqia e një shtëpie të përqendruar te Krishti, ku mësohet ungjilli, mbahen besëlidhjet dhe ka shumë dashuri.

Shumë zëra nga bota në të cilën jetojmë, na thonë se duhet të jetojmë me një ritëm të furishëm. Ka gjithmonë më shumë për të bërë dhe më shumë për të arritur. Por thellë brenda secilit prej nesh, ndodhet një nevojë për të pasur një vend strehimi, ku paqja dhe qetësia të mbizotërojnë, një vend ku mund të rifillojmë, rimbledhim dhe rifitojmë energji që të përgatitemi për trysnitë e së ardhmes.

Vendi i përsosur për atë paqe është brenda mureve të vetë shtëpive tona, ku ne kemi bërë gjithçka mundemi për ta bërë Zotin Jezu Krisht përqendrimin kryesor.

Disa shtëpi kanë një atë që është mbajtës i denjë i priftërisë, dhe gjithashtu një nënë besnike, të përkushtuar, të cilët së bashku udhëheqin me drejtësi. Shumë shtëpi kanë një situatë të ndryshme. Pavarësisht nga rrethanat tuaja, ju mund ta përqendroni shtëpinë tuaj dhe jetën tuaj te Zoti Jezu Krisht, sepse Ai është burimi i paqes së vërtetë në këtë jetë.

Sigurohuni që çdo vendim që merrni, qoftë material apo shpirtëror, të kushtëzohet nga ajo që Shpëtimtari do të donte të bënit. Kur Ai është qendra e shtëpisë suaj, ka paqe dhe qetësi. Ka një shpirt sigurie që mbush

shtëpinë dhe ndihet nga të gjithë ata që banojnë atje.

Përmbushja e kësaj këshille nuk qëndron vetëm te prindërit, edhe pse është roli i tyre për të drejtuar. Fëmijët mund të jenë përgjegjës për t'i përmirësuar në shtëpi përpjekjet e përqendruara te Krishti. Është e rëndësishme që prindërit t'i mësojnë fëmijët të kuptojnë se si veprimet e tyre ndikojnë te çdo individ që jeton në shtëpi. Fëmijët, të cilët mësohen të ndihen përgjegjës për veprimet e tyre, qofshin ato të drejta apo jo, rriten për t'u bërë qytetarë të besueshëm në mbretërinë e Perëndisë.

Jam i sigurt se ju mund t'i dalloni parimet themelore që e përqendrojnë shtëpinë tuaj te Shpëtimtari. Këshillat profetike për të bërë lutje të përditshme vetjake dhe familjare, studim të përditshëm vetjak e familjar të shkrimeve të shenjta dhe mbremje familjare javore, janë trarët thelbësorë, peshëmbajtës në ndërtimin e një shtëpie të përqendruar te Krishtit. Pa këto praktika të rregullta, do të jetë e vështirë të gjendet paqja e dëshiruar dhe shumë e nevojitur, si dhe strehimi nga bota.

Bindjuni mesimeve profetike që Krishti dëshiron që ju t'i ndiqni. Mos e lini pas dore lumturinë e ardhshme duke i rënë shkurt, në vend që të vini



Sidnei, Australi

në jetë parimet e shëndetshme të ungjillit. Mbani mend: gjëra të vogla çojnë te gjëra të mëdha. Pamaturia ose lënia pas dore, në dukje e parëndësishme, mund të çojë në probleme të mëdha. Më e rëndësishme, zakone të thjeshta, të vazhdueshme, të mira çojnë drejt një jete plot me bekime bujare.

Ju fëmijë të Fillores, ju të rinj e të reja në programet e rinisë dhe ju misionarë të paepur që po shërbeni tani, po bëni shumë gjëra në mënyrë më frytdhënëse sesa isha unë në gjendje të bëja në moshën tuaj. Në jetën para lindjes, ju u provuat të ishit trima, të bindur dhe të dëlirë. Atje ju punuat shumë për të zhvilluar talente dhe aftësi që të përgatiteshit për të përballuar jetën në tokë me kurajë, dinjitet, nder dhe sukses.

Jo shumë kohë më parë, ju erdhët në vdekshmëri me të gjitha ato aftësi të madhërishe dhe mundësi të pafundme. Por ende gjendet rrezik i vërtetë në mjedisin që ju rrethon.

Mundësia dhe aftësia juaj e madhe mund të kufizohen ose shkatërrohen, në qoftë se i dorëzoheni ndotjes së frymëzuar nga djalli përreth jush. Megjithatë, Satani nuk mund ta mposhtë Shpëtimtarin. Fati i Satanit është i vendosur. Ai e di se ka humbur, por dëshiron të marrë me vete sa më shumë që të mundet. Ai do të përpiket ta shkatërrojë mirësinë tuaj dhe t'i shkatërrojë aftësitë tuaja duke shfrytëzuar dobësitë tuaja. Qëndroni në anën e Zotit dhe do të fitoni çdo herë.

Ju jetoni në një botë ku përparimet teknologjike ndodhin me një ritëm befasues. Është e vështirë për shumë nga brezi im që të vazhdojnë në një hap me mundësitë. Në varësi të mënyrës se si përdoret teknologjia, këto përparime mund të jenë një bekim ose një pengesë. Teknologjia, kur kuptohet dhe përdoret për qëllime të drejta, nuk ka përse të jetë një kërcënim, por më tepër një përmirësim i komunikimit shpirtëror.

Për shembull, shumë prej nesh kanë një mjet elektronik vetjak që futet në xhep. Rrallë na mungon ai; ne mund ta përdorim atë shumë herë gjatë ditës. Për fat të keq, këto mjete mund të jenë një burim fëlliqësie dhe kohe të humbur. Por, e përdorur me rregull, kjo teknologji mund të jetë një mjet mbrojtjeje nga ligësia më e madhe e shoqërisë.

Kush mund ta kishte menduar jo shumë vite më parë se veprat standarde të plota dhe vite të tëra të mesazheve të konferencave të përgjithshme do t'i nxinte xhepi? Thjesht të pasurit e tyre në xhep nuk do t'ju mbrojnë, por studimi, meditimi dhe dëgjimi i tyre gjatë çasteve të qeta çdo ditë do ta rrisë komunikimin me anë të Shpirtit.

Jini të urtë në mënyrën se si e përdorni teknologjinë. Shënmoni shkrime të shenjta të rëndësishme në mjetin

tuaj dhe kthehuni shpesh tek ato. Nëse ju të rinj do ta rishikonit një varg të shkrimit të shenjtë aq shpesh sa disa prej jush dërgojnë mesazhe celulari, ju shpejt do të kishit mësuar përmendsh qindra pjesë nga shkrimi i shenjtë. Ato pjesë do të bëheshin një burim i fuqishëm frymëzimi dhe udhëzimi nga Fryma e Shenjtë në kohë nevojë.

Bërja e gjithë çka mundemi për ta ftuar ndikimin e butë, udhëzues të Frymës së Shenjtë në jetën tonë është jetike në përpjekjet tona për t'i përqendruar shtëpitë tona te Shpëtimtari. Të vepruarit me bindje ndaj atyre nxitjeve na forcon edhe më shumë.

Paqe më e madhe do t'ju vijë kur i shoqëroni përpjekjet tuaja për të qenë të bindur me shërbimin ndaj njerëzve përreth jush. Kaq shumë individë, të cilët kanë çfarë i mendojnë të jenë talente të pakta, me përlësi dhe bujari


i përdorin ato talente për të bekuar jetën e njerëzve përreth tyre. Egoizmi është rrënja e ligësisë së madhe. Kundërveprimi për atë ligësi paraqitet në jetën e Shpëtimtarit. Ai na tregon se si ta përqendrojmë jetën tonë drejt shërbimit bujar ndaj të tjerëve.

Kam mësuar një të vërtetë që është përsëritur kaq shpesh në jetën time, sa kam arritur ta njoh si një ligj të padyshimtë. Ajo përcakton mënyrën se si bindja dhe shërbimi lidhen me fuqinë e Perëndisë. Kur iu bindemi urdhërimeve të Zotit dhe u shërbejmë fëmijëve të Tij pa egoizëm, pasoja e natyrshme është fuqi nga Perëndia – fuqi për të bërë më shumë se ç'mund të bëjmë të vetëm. Mendimet tona, talentet tona, aftësitë tona zgjerohen, ngaqë ne marrim forcë dhe fuqi nga Zoti. Fuqia e Tij është pjesa përbërëse themelore për të krijuar një shtëpi të mbushur me paqe.

Ndërsa e përqendroni shtëpinë tuaj te Shpëtimtari, ajo do të bëhet në mënyrë të natyrshme një vend strehimi, jo vetëm për vetë familjen tuaj, por edhe për miqtë që jetojnë në rrethana më të vështira. Ata do të tërhiqen te qetësia që ndiejnë atje. I mirëprisni miq të tillë në shtëpinë tuaj. Ata do të përparojnë në atë mjedis të përqendruar te Krishti. Bëhuni miq me miqtë e fëmijëve tuaj. Jini një shembull i denjë për ta.

Një nga bekimet më të mëdha që mund t'i ofrojmë botës, është fuqia e një shtëpie të përqendruar te Krishti, ku mësohet ungjilli, mbahen besëlidhjet dhe ka shumë dashuri.

Vite më parë, pas vizitës te një mision, bashkëshortja ime, Xhanina, më tregoi rreth një misionari që kishte takuar. Xhanina e kishte pyetur për familjen e tij. Ajo u habit kur ai u përgjigj se nuk kishte familje. Më tej ai shpjegoi se, kur kishte lindur, nëna e kishte lënë atë që ta rriste qeveria. E kishte kaluar fëmijërinë e tij nga





Nju-Jork-Siti, Nju-Jork, SHBA

një shtëpi kujdestarie në tjetrën. Ishte bekuar që, si adoleshent kishte gjetur ungjillin. Lagjja, si një familje e dashur, e kishte ndihmuar atë të kishte mundësinë për të shërbyer një mision.

Më pas Khanina pyeti gruan e presidentit të misionit për këtë misionar të mirë. Ajo mësoi se pak muaj më parë, ky misionar kishte qenë në shtëpinë e misionit për pak ditë për shkak të një sëmundjeje. Gjatë asaj kohe ai kishte qenë me ta për një mbremje familjare. Përpara se të largohej për t'u kthyer në punën misionare, ai i kërkoi presidentit të misionit nëse mund të kalonte përsëri dy ose tri ditë në fund të misionit të tij në shtëpinë e misionit. Ai donte të shihte se si vepron një familje e përqendruar te Krishti. Ai dëshironte të ishte në gjendje ta formonte familjen e tij sipas familjes së tyre.

Bëni ç'është e mundur që të keni vërtet një shtëpi të tillë. Ndhmoni ata që jetojnë në rrethana të vështira. Jini një mik i vërtetë. Kjo lloj miqësie e qëndrueshme është si asfalti që mbush gropat e jetës dhe e bën udhëtimin tonë më të rehatshëm dhe më të këndshëm. Ajo nuk duhet të jetë një burim i përdorur për të pasur përfitim

vetjak, por një thesar që do të vlerësohet dhe ndahet. Mirëprisni në shtëpinë tuaj ata që kanë nevojë të forcohen nga një përvojë e tillë.

Unë ofroj disa mendime përfundimtare për ata që e duan një anëtar të familjes, i cili nuk po bën zgjedhje të mira. Kjo gjë mund të vërë në provë durimin dhe durueshmërinë tonë. Ne duhet të kemi besim në Zotin dhe në kohën e Tij, që një përgjigje pozitive ndaj lutjeve dhe ndaj përpjekjeve tona shpëtuese mund të ndodhë. Ne bëjmë gjithçka mundemi për të shërbyer, për të bekuar dhe për të pranuar me përlësi vullnetin e Perëndisë në të gjitha gjërat. Ne ushtrojmë besim dhe kujtojmë se ka disa gjëra që duhet t'i lihen Zotit. Ai na fton t'i vendosim barrat tona te këmbët e Tij. Me besim ne mund të dimë se ky njeri i dashur, i dalë nga udha, nuk është i braktisur, por është në përkujdesin e një Shpëtimtari të dashur.

Vlerësoni të mirën te të tjerët, jo njollat e tyre. Herë pas here një njollë ka nevojë për vëmendjen e duhur që të pastrohet, por gjithmonë përqendrohuni te virtytet e tij ose të saj.

Kur ndieni se ka vetëm një fill të

hollë shprese, në të vërtetë nuk është një fill, por një linjë lidhëse e gjerë, si një ruajtës jete për t'ju forcuar dhe për t'ju lartësuar. Do t'ju sigurojë ngushëllim që të mund ta ndalni frikën. Përpiquni të jetoni me denjësi dhe vendoseni mirëbesimin tuaj në Zotin.

Nuk kemi përse të shqetësohemi nëse nuk mund të bëjmë në të njëjtën kohë të gjitha gjërat që Zoti na ka këshilluar të bëjmë. Ai ka folur për një kohë dhe një stinë për të gjitha gjërat. Në përgjigje të lutjeve tona të sinqerta për udhëzim, Ai do të na drejtojë tek ajo që duhet të theksohet në secilën periudhë të jetës sonë. Ne mund të mësojmë, të rritemi dhe të bëhemi si Ai me hapa të vazhdueshëm një e nga një.

Unë jap dëshminë time se të jetuarit e një jete të bindur, të rrenjosur në mënyrë të qëndrueshme në ungjillin e Jezu Krishtit, jep sigurinë më të madhe për paqe dhe mbrojtje në shtëpitë tona. Do të ketë ende mjaft sprovë apo dhembje, por edhe në mes të trazirës, ne mund të gëzojmë paqe të brendshme dhe lumturi të thellë. Dëshmoj se Shlyerja e Jezu Krishtit është burimi i asaj paqeje të madhe, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Paqja Vetjake: Shpërblimi i Drejtësisë

Madje edhe me sprovat e jetës, në saje të Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe të hirit të Tij, jetesa e drejtë do të shpërblehet me paqe vetjake.

Përvojat e fundit më kanë bërë të mendoj mbi doktrinën e paqes dhe, veçanërisht, mbi rolin e Jezu Krishtit për ta ndihmuar secilin prej nesh që të fitojë paqe vetjake të qëndrueshme.

Dy ngjarje brenda pak muajve të kaluar, më kanë prekur thellë. E para, fola në ceremoninë e varrimit të Emili Parkerit, një gjashtëvjeçareje të çmuar e cila humbi jetën bashkë me 25 të tjerë, që përfshinin 19 fëmijë të vegjël, në një atentat tragjik në Njutaun të Konektikatit. U pikëllova tok me familjen e saj dhe pranova se shumëkujt i qe grabitur paqja. Gjeta forcë dhe besim te prindërit e saj, Robert dhe Alisa Parker.

Së dyti, u takova me mijëra anëtarë besnikë të Kishës në qytetin Abixhan të Bregut të Fildishtë.¹ Ky vend frëngjishtfolës afrikanoperëndimor ka duruar vështirësi ekonomike, një grusht ushtarak dhe dy luftëra të fundit civile që përfunduan në 2011–ën. Megjithatë, ndjeva një paqe të veçantë në praninë e tyre.

Shpeshherë ndodhin ngjarje që na e grabisin paqen dhe na bëjnë të ndihemi më të cenueshëm.

Kush mund t'i harrojë sulmet e liga të 11 shtatorit 2011 mbi disa vende të SHBA-së? Ngjarje të tilla na kujtojnë se sa shpejt mund të shkatërrohen ndjenjat tona të paqes e të sigurisë.

Djali ynë më i madh dhe bashkeshortja e tij, të cilët po prisnin fëmijën e tyre të parë, jetonin tre blloqe ndërtesash larg Qendrës Tregtare Botërore, në qytetin e Nju-Jorkut, kur aeroplani i parë u përplas në Kullën Veriore. Ata shkuan në tarracën e banesës së tyre dhe u tmerruan teksa shihnin atë për të cilën menduan se ishte ndonjë aksident i tmerrshëm. Pastaj ata dëshmuar përplasjen e aeroplanit të dytë në Kullën Jugore. E kuptuan menjëherë që ky nuk ishte aspak aksident dhe besuan që Manhatanin jugor ishte nën një sulm. Kur Kulla Jugore u shemb, banesa e tyre u përfshi nga reja e pluhurit që u derdh mbi Manhatanin jugor.

Të hutuar për sa kishin parë dhe të shqetësuar për sulme të mëtejshme, ata mundën të shkonin në një zonë më të sigurt dhe, më pas, te ndërtesa e Kishës për kunjin e Manhatanit, në Qendrën Linkoln. Kur mbërritën, ata mësuan se dhjetëra anëtarë të tjerë

të Manhatanit jugor kishin vendosur po ashtu të mblidheshin te qendra e kunjit. Telefonuan që të na vinin në dijeni se ku ndodheshin. Unë u lehtësova që ishin të sigurt, por nuk u çudita për vendndodhjen. Zbulesa moderne na mëson se kunjet e Sionit janë një mbrojtje dhe “strehim nga stuhia dhe nga zemërimi, kur të derdhen pa u zvogëluar mbi tërë dheun”².

Ata nuk mundën të riktheheshin te banesa e tyre për mbi një javë dhe qenë të rrënuar nga humbja e mijëra jetëve të pafajshme, por nuk pësuan asnjë dëmtim të përhershëm.

Duke sjellë ndër mend këto ngjarje, më ka bërë përshtypje dallimi doktrinor mes paqes së përgjithshme apo të botës dhe paqes vetjake.³

Në lindjen e Shpëtimtarit, një shumicë e ushtrisë qiellore lëvdoi Perëndinë dhe shpalli: “Lavdi Perëndisë në vendet më të larta, dhe *paqe* mbi tokë njerëzve mbi të cilët qëndron mirëdashja e tij!”⁴

Megjithatë, vërehet me pikëllim se, madje në këtë periudhë përjetësisht të rëndësishme që pason lindjen e Birit të Perëndisë, mbreti Herod kreu masakrën e foshnjave të pafajshme në Bethlehem.⁵

Liria e zgjedhjes është thelbësore për planin e lumturisë. Lejon atë dashuri, sakrificë, rritje vetjake dhe përvojë të domosdoshme për përparimin tonë të përgjithshëm. Kjo liri e zgjedhjes lejon po ashtu të ndodhë e gjithë dhembja dhe vuajtja që ne përjetojmë në jetën e vdekshme, madje dhe kur shkaktohen nga gjëra që nuk i kuptojmë, dhe nga zgjedhjet e liga shkatërrimtare të të tjerëve. Vetë Lufta në Qiell u bë për të mbrojtur lirinë tonë të zgjedhjes morale dhe është thelbësore për të kuptuar shërbesën tokësore të Shpëtimtarit.

Siç përsëritet në kapitullin e 10-të të Mateut, Shpëtimtari i udhëzoi Të

Dymbëdhjetët dhe pohoi se misioni i Tij nuk do ta realizonte paqen e përgjithshme në këtë jetë të vdekshme. Apostujve iu tha që të linin paqe mbi shtëpitë e denja që ata vizitonin, por u paralajmëruan se do të ishin “në mes të ujërve . . . [dhe] do t’ju urrejnë për shkak të emrit tim; por ai që do të qëndrojë deri në fund, do të shpëtojë”⁶. Një shpallje me rëndësi bëhet te vargu 34: “Mos mendoni se unë erdha të sjell paqen mbi tokë”⁷. Është e qartë se paqja e përgjithshme nuk ekzistonte në tokë gjatë shërbesës së Krishtit në jetën e vdekshme, dhe nuk ekziston tani.

Te parathënia e Zotit për Doktrinën e Besëlidhjet, jepen mësim një numër parimesh shumë të rëndësishme. Në lidhje me ata të cilët nuk pendohen, Shpirti i Tij (Shpirti i Krishtit), i cili i jepet çdo njeriu që vjen në botë⁸, “nuk do të ndeshet gjithmonë me njeriun”⁹. Gjithashtu, “paqja do të merret nga toka”¹⁰. Profetët kanë shpallur se paqja, në të vërtetë, është hequr nga toka.¹¹ Luciferi ende nuk është lidhur dhe ushtron fuqi në sundimin e tij.¹²

Aspirata qiellore e njerëzve të mirë kudo, ka qenë dhe përherë do të jetë për paqen në botë. Nuk duhet të dorëzohemi asnjëherë në arritjen e këtij synimi. Por, Presidenti Jozef F. Smith dha mësim: “Botës kurrë nuk mund t’i vijë ai shpirt paqeje dhe dashurie . . . derisa njerëzimi ta marrë të vërtetën e Perëndisë dhe mesazhin e Perëndisë . . . e ta njohë fuqinë dhe autoritetin e tij, i cili është hyjnor”¹³.

Ne sinqerisht shpresojmë e lu-temi për paqen e përgjithshme, por ne e arrijmë pikërisht si individë dhe familje atë lloj paqeje që është shpërblimi i premtuar për drejtësinë. Kjo paqe është dhuratë e premtuar e misionit dhe e sakrificës shlyese të Shpëtimtarit.

Ky parim shprehet përmbledhtazi te Doktrina e Besëlidhje: “Por mësoni



se ai që bën veprat e drejtësisë, duhet të marrë shpërblimin e tij, madje paqe në këtë botë dhe jetë të përrjetshme në botën që vjen”¹⁴.

Presidenti Xhon Teljor dha mësim se paqja jo vetëm që është e dëshirueshme, por “është dhurata e Perëndisë”¹⁵.

Paqja për të cilën e kam fjalën, nuk është thjesht një qetësi e përkohshme. Është lumturi e thellë e kënaqësi shpirtërore e qëndrueshme.¹⁶

Presidenti Hiber J. Grant e përshkroi kështu paqen e Shpëtimtarit: “Paqja e Tij do të na lehtësojë vuajtjen, do të na fashojë zemrën e thyer, do të na heqë urrejtjet, do të na sjellë në kraharor një dashuri për shoqi-shoqin që do t’i mbushë shpirtat tanë me qetësi dhe lumturi”¹⁷. Në takimet e mia me prindërit e Emili Parkerit, pashë se paqja e Shpëtimtarit ua ka lehtësuar vuajtjen e po ndihmon për t’u fashuar zemrën e thyer. Është i rëndësishëm fakti që, fill pas atentatit, Vëllai Parker i shprehu falje autorit të krimit. Sikurse tha Presidenti Grant, paqja e Shpëtimtarit arrin “të na heqë urrejtjet”. Gjykimi është i Zotit.

Shenjtoret e Bregut të Fildishtë, gjatë periudhës së luftës civile në vendin e tyre, gjetën paqe duke u

përqendruar tek të jetuarit e ungjillit të Jezu Krishtit, me theks të veçantë mbi historinë familjare dhe punën e tempullit për paraardhësit e tyre.¹⁸

Të gjithë jemi të dëshiruar për paqe. Paqja nuk është thjesht siguri ose mungesë lufte, dhune, konflikti dhe grindjeje. Paqja vjen ngaqë dimë se Shpëtimtari e di cilët jemi dhe e di se kemi besim tek Ai, se e duam dhe i zbatojmë urdhërimet e Tij, madje e veçanërisht, edhe mes sprovave dhe tragjediive shkatërruese të jetës. Përgjigja e Zotit drejtuar Profetit Jozef Smith në Burgun e Libertisë, i jep ngushëllim zemrës:

“Biri im, paqe i qoftë shpirtit tënd; fatkeqësia jote dhe mjerimet e tua do të jenë veçse një çast i shkurtër;

Dhe atëherë, në qoftë se i duron mirë ato, Perëndia do të të lartësojë nga lart.”¹⁹

Mbani mend: “Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por [Perëndi] paqtimi”²⁰. Për ata të cilët refuzojnë Perëndinë, nuk ka paqe. Të gjithë ne morëm pjesë në këshillat e qiellit që siguruan lirinë e zgjedhjes morale, duke e ditur që do të kishte dhembje të jetës së vdekshme e madje tragjedi të tmerrshme për shkak të abuzimit me lirinë e zgjedhjes. Ne e kuptuam



se kjo mund të shkaktoje që ne të bëheshim të zemëruar, të hutuar, të pambrojtur dhe të cenueshëm. Por gjithashtu e dinim se Shlyerja e Shpëtimtarit do t'i mposhte e do të zhdëmtonte të gjitha padrejtësitë e jetës së vdekshme dhe do të na sillte paqe. Plaku Marion D. Henks mbante në mur një kornizë me thënien e Ugo Bettit: “Të besosh në Perëndi, do të thotë të dish se të gjitha rregullat do të jenë të drejta dhe se do të ketë të papritura të habitshme”²¹.

Cilat janë burimet e paqes? Shumëkush e kërkon paqen me mënyrat e botës, të cilat kurrë nuk ia kanë dalë mbanë dhe kurrë nuk do t’ia dalin. Paqja nuk gjendet duke arritur pasuri, fuqi ose famë të madhe.²² Paqja nuk gjendet duke kërkuar kënaqësinë, zbavitjen apo çlodhjen. Asnjëra nuk mundet, edhe atëherë kur arrihet me bollëk, të krijojë një lumturi ose paqe të qëndrueshme.

Himni i çmuar i Ema Lu Tejnit shpreh pyetjet e duhura: “Ku mund të gjej paqe? Ku kam ngushëllim, kur tjera burime nuk më shërojnë?”²³ Përgjigja është Shpëtimtari, i cili është burimi dhe autori i paqes. Ai është “Princ i paqes”²⁴.

Si t’i qëndrojmë pranë Shpëtimtarit? Përlulja e vetes para Perëndisë, lutja gjithmonë, pendimi për mëkatet, hyrja në ujin e pagëzimit me zemër të thyer e shpirt të penduar dhe kthimi në dishepuj të vërtetë të Jezu Krishtit, janë shembuj shumë të mirë të drejtësisë që shpërblehet me paqe të qëndrueshme.²⁵ Pasi Mbreti Beniamin e dha mesazhin e tij nxitës lidhur me Shlyerjen e Krishtit, turma ra përdhe. “Shpirti i Zotit erdhi mbi ta dhe ata u mbushën me gëzim, pasi kishin marrë një heqje të mëkateve të tyre dhe pasi kishin *paqe të ndërgjegjes*, për shkak të besimit të jashtëzakonshëm që ata kishin në Jezu Krishtin.”²⁶ Pendimi

dhe jetesa me drejtësi lejon që të ketë *paqe të ndërgjegjes*, e cila është thelbësore për kënaqësinë.²⁷ Kur ka pasur shkelje serioze, kërkohet rrëfim që të sillt paqja.²⁸ Ndoshta nuk ka asgjë që të krahasohet me paqen e cila i vjen një shpirti të munduar prej mëkatit nga shkarkimi i barrës së vet te Zoti dhe nga kërkimi i bekimeve të Shlyerjes. Sikurse e shpreh këtë një tjetër himn i përhapur në Kishë: “Barrën do të të këmbët e Tij dhe me këngë shkoj gjithmonë”²⁹.

Më gëzohet zemra kur kuptoj se në kohën tonë dhjetëra mijë të rinj, të reja dhe misionarë në moshë e kanë pranuar thirrjen që të jenë të dërguar të Zotit e Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Ata po i çojnë botës ungjillin e rivendosur të paqes, herë një personi e herë një familje – një vepër drejtësie për t’ua sjellë këtë paqe fëmijëve të Atit Qiellor.

Kisha është një strehë ku pasuesit e Krishtit e arrijnë paqen. Disa të rinj në botë thonë se janë shpirtërorë, por jo fetarë. Të ndihesh shpirtëror është një hap i parë i mirë. Megjithatë, është Kisha vendi ku ne shoqërohemi, marrim mësim dhe ushqehemi me fjalën e mirë të Perëndisë. Më e rëndësishmja, është autoriteti i priftërisë në Kishë ai që siguron ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që i lidhin familjet tok dhe e kualifikojnë secilin prej nesh që të kthehet te Perëndia, Ati, dhe te Jezu Krishti në mbretërinë çelestiale. Këto ordinanca sjellin paqe ngaqë ato janë besëlidhje me Zotin.

Tempujt janë vendi ku ndodhin shumë prej këtyre ordinancave të shenjta dhe janë gjithashtu burim i një strehimi paqësor nga bota. Ata që i vizitojnë terrenet e tempujve ose marrin pjesë në shtëpinë e hapur të tempullit, gjithashtu e ndiejnë këtë paqe. Një përvojë që më kujtohet mjaft mirë, është shtëpia e hapur dhe

përkushtimi i Tempullit të Suvas në Fixhi. Kishte pasur trazira politike si rrjedhojë e të cilave rebelët dogjën dhe plaçkitën qendrën e qytetit Suva, zaptuan ndërtesat e parlamentit dhe mbajtën peng ligjvënësit. Vendi ishte nën ligjin ushtarak. Ushtarakët e Fixhit i dhanë Kishës leje të kufizuar për të mbledhur njerëz për shtëpinë e hapur dhe një grup shumë të vogël për përkushtimin. Anëtarët nuk u ftuan në tërësi, për shkak të shqetësimit për sigurinë e tyre. Ishte i vetmi përkushtim tempulli, që nga Tempulli i hershëm i Navusë, që mbahej nën rrethana shumë të vështira.

Një person i ftuar në shtëpinë e hapur ishte një grua e dashur hindu me prejardhje indiane, një anëtare e Parlamentit e cila fillimisht u mbajt peng, por u lirua ngaqë ishte femër.

Në dhomën çelestiale, e lirë prej trazirës së botës, ajo u tret në lot ndërsa shprehte ndjenjat e paqes që e pushtuan. Ndjeu Frymën e Shenjtë ta ngushëllonte e t'i jepte dëshmi për natyrën e shenjtë të tempullit.

Shpëtimtari është burimi i paqes së vërtetë. Madje edhe me sprovat e jetës, në saje të Shlyerjes së Shpëtimtarit dhe të hirit të Tij, jetesa e drejtë do të shpërblehet me paqe vetjake. Në brendinë e dhomës së Pashkës, Shpëtimtari u premtoi Apostujve të Tij se do të bekoheshin me "[Ngushëlluesin, Frymën] e Shenjtë" dhe pastaj shprehu këto fjalë të rëndësishme: "Unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po ua jap, po jo si e jep bota"³⁰. Më pas, vetëm pak para Lutjes së Tij Ndërmjetësuese: "Jua kam thënë këto gjëra, që ta keni paqen në mua; në botë do të keni mundime, por merrni zemër, unë e munda botën!"³¹

Eliza R. Snou shkroi bukur për këtë koncept:

*Lavd'rim Perëndis' i ngrini;
G'zimi juaj kurr' të mos rresht'.
Dhe pse shqet'sime shpesh hasni,
Krishti thot': "Në mua paqe është".³²*

Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Dy konferenca u mbajtën në Abixhan të dielën, më 10 shkurt 2013; 9.693 veta merrnin pjesë – 619 nga të cilët nuk ishin ende anëtarë të Kishës. Anëtarësia e përgjithshme e Kishës në Bregun e Fildishtë është afro 19.000 veta.
2. Doktrina e Besëlidhje 115:6.
3. Fjala *paqe* ka kuptime të ndryshme. Në greqishten klasike ajo tregon për pushim, ndërprerje ose mungese gjendjeje lufte mes forcave kundërshtare. Në hebraisht ajo fjalë ka një kuptim më gjithëpërmblëdhës dhe nganjëherë, është thjesht një përsëritje. Paqja është gjithashtu një "gjendje ekzistence që i vjen njeriut sipas termave dhe kushteve të vendosura nga Perëndia" (Howard W. Hunter, në Conference Report, tetor 1966, f. 14–17).
4. Lluca 2:14; theksimi i shtuar.
5. Shih Mateu 2:16; shih edhe Ross Douthat, "The Loss of Innocents", *New York Times*, 16 dhjetor 2012, f. 12.
6. Mateu 10:16, 22.
7. Mateu 10:34.
8. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:46.
9. Doktrina e Besëlidhje 1:33.
10. Doktrina e Besëlidhje 1:35.
11. Presidenti Udraf e shpalli këtë më 1894 dhe sërish më 1896. Shih *The Discourses of Wilford Woodruff*, red. G. Homer Durham (1946), f. 251–252; shih edhe Marion G. Romney, në Conference Report, prill 1967, f. 79–82.
12. Shih Joseph Fielding Smith, *The Predicted Judgments*, Brigham Young University Speeches of the Year (21 mars 1967), f. 5–6. Megjithatë, sikurse tha Plaku Nil A. Maksiell: "Mund të kemi paqe të brendshme megjithëse paqja është marrë nga toka . . . [dhe] 'gjithë gjërat [janë] në rremujë'" ("Behold, the Enemy Is Combined", *Ensign*, maj 1993, f. 79).
13. *Teachings of Presidents of the Church: Joseph F. Smith* (1998), f. 400.
14. Doktrina e Besëlidhje 59:23.
15. *Teachings of Presidents of the Church: John Taylor* (2001), f. 151.
16. Që nga grekët e lashtë e deri në kohën tonë, këto fjalë – *lumturi* dhe *kënaqësi* – janë analizuar, shqyrtuar dhe studiuar jo vetëm për sa i përket kuptimit të tyre, por edhe drejtimit që i japin jetës sonë. Shih David Malouf, *The Happy Life: The Search for Contentment in the Modern World* (2011). Shih edhe një recension nga libri i Mr. Malouf, në R. Jay Magill Jr., "How to Live Well", *Wall Street Journal*, 26–27 janar 2013, C6.
17. *Teachings of Presidents of the Church: Heber J. Grant* (2002), f. 226.
18. "Tre nga të pesë kunjet e Bregut të Fildishtë janë ndër 25 më të mirët e



Kopenhagë, Danimarkë

Kishës në përqindjen e të rriturve [që dërgojnë] emra të familjes për ordianca të tempullit” dhe Kunji Cocody Cote d’Ivoire ka përqindjen më të lartë (C. Terry Warner and Susan Warner, “Apostle Visits Ivory Coast, Is ‘Impressed with Exceptional Spirit’”, *Church News*, 3 mars 2013, f. 4, 14). Duke marrë parasysh se kishte luftë civile dhe tempulli më i afërt ishte 12 orë larg me autobus, në Akra të Ganës, ky është një fakt i mahnitshëm i besimit dhe ka sjellë si rezultat paqe vetjake dhe familjare.

19. Doktrina e Besëlidhje 121:7–8. Presidenti Harold B. Li dha mësim: “Prandaj, ne duhet të përmirësohemi; duhet të vihemi në provë, në mënyrë që të provojmë forcën dhe fuqinë që janë te ne” (*Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* [2000], f. 208).
20. 1 Korintasve 14:33.
21. Në Marion D. Hanks, “A Loving, Communicating God”, *Ensign*, nëntor 1992, f. 63.
22. Shih Jeffrey R. Holland, *For Times of Trouble* (2012), f. 79. Plaku Xhefiri R. Holland jep mësim se “varfëria e vërtetë mund të bëjë më shumë për të shkatërruar shpirtin njerëzor, sesa cilado gjendje tjetër, përveç vetë mëkatit”. Por përdorimi i drejtë i të hollave mund ta shtojë paqen.
23. “Where Can I Turn for Peace?” *Hymns*, nr. 129.
24. Isaia 9:5.
25. John Greenleaf Whittier e shprehu këtë thjesht: “Ki mendjen për mënyrën si jeton. Mos vepra gjatë ditës në atë mënyrë që të ta largojë paqen gjatë natës” (“Conduct [From the Mahabharata]”, në *The Complete Poetical Works of John Greenleaf Whittier* [1802], f. 484).
26. Mosia 4:3; theksimi i shtuar; shih edhe Marion G. Romney, në Conference Report, prill 1967, f. 79–82.
27. Ndërgjegjja është një busull morale që na udhëheq drejt paqes. Ajo vihet në veprim nga të paktën dy burime: Drita e Krishtit, një e drejtë trashëgimie e lavdishme prej Atit tonë Qiellor (shih Doktrina e Besëlidhje 88:6–13; 93:2) dhe dhurata e Frymës së Shenjtë (shih Doktrina e Besëlidhje 39:6).
28. “Kërkohen dy palë faljeje që shkelësit t’i sillen paqe – një nga autoritetet e duhura të Kishës së Zotit dhe një nga vetë Zoti. [Shih Mosia 26:29.]” (*Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* [2006], f. 41).
29. “How Gentle God’s Commands”, *Hymns*, nr. 125.
30. Gjoni 14:26–27.
31. Gjoni 16:33.
32. “Though Deepening Trials”, *Hymns*, nr. 122.



Nga Plaku Stenli G. Elis,
i Të Shtatëdhjetëve

Mënyra e Zotit

Mënyra e Zotit është që t’u vëmë veshin mësimëve të udhëheqësve tanë, të kuptojmë parimet e drejta dhe të qeverisim veten.

I Shtatëdhjetë

Unë shërbej si I Shtatëdhjetë. Të Shtatëdhjetët thirren për të qenë lajmëtarë – për ta shpërndarë fjalën e Zotit siç e marrim nga apostujt dhe profetët e nga Shpirti, dhe për të qenë dëshmitarë të veçantë të emrit të Krishtit, në predikimin e ungjillit në të gjithë botën, në ngritjen e Kishës dhe në rregullimin e punëve të saj (shih DeB 107:25, 34).

Djalë Ferme

U rrita në një fermë afër Bërlit në Ajdaho – një “djalë [i vërtetë] ferme nga Ajdaho!” Si i tillë, mësova:

1. Të punoj – nëse nuk mbjell, nuk korr.
2. Të punoj me mençuri – nëse ujit dhe plehëron, korr më shumë.
3. Rëndësinë e kohës – nëse nuk mbjell në kohën e duhur, një ngricë e hershme mund ta shkatërrojë të korrën.
4. Të bëj atë që nevojitet ose duhet të bëhet, pavarësisht se çfarë është e kënaqshme, e pëlqyeshme apo e rehatshme – ti e mjel lopën kur ka nevojë të milet, jo kur do ti.
5. Të jem i drejtpërdrejtë – i përfshirë me bagëtinë dhe makineritë, nuk ke kohë t’i “biesh rreth e qark” apo të shqetësohesh për të qenë

politikisht i saktë. (Në lidhje me këtë, ndërsa kam shërbyer gjithandej në Kishë, shpesh kam pyetur: “Dëshironi që t’ju flas drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë?” Në përgjithësi, shenjtorët kanë preferuar [të jem] “i drejtpërdrejtë!” Sot do të jem i drejtpërdrejtë.)

6. Së fundmi, si një djalë ferme nga Ajdaho, mësova të përqendrohem te parimet themelore.

Asgjë nuk është më themelore për të gjithë ne dhe për doktrinën tonë, sesa të vërtetat e nenit të parë të besimit: “Ne besojmë në Perëndinë, Atin e Përvetshëm, dhe në Birin e Tij, Jezun Krishtin, dhe në Frymën e Shenjtë” (Nenet e Besimit 1:1).

Përveç kësaj, Ai është Ati *ynë* Qiellor, i cili na njeh, na do dhe dëshiron të kthehemi tek Ai. Jezusi është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi *ynë*, i cili nëpërmjet Shlyerjes garantoj se *ne* do ta mposhtim vdekjen dhe do të jetojmë sërish, dhe bëri të mundur që *ne* të ekzaltohemi dhe të kemi jetë të përvetshme. Fryma e Shenjtë është ngushëlluesi, zbuluesi, mësuesi, dëshmuesi dhe udhërrëfytyes *ynë*.

Mendoni për këtë, vëllezër e motra – ne nuk jemi jetimë shpirtërorë! Ne nuk jemi vetëm.

Cilat janë përparësitë e të pasurit prindër – e të mos qenit jetim? Ne mund të mësojmë prej tyre, të përfitojmë nga përvoja e tyre, të shmangim kurthet për të cilat na paralajmërojnë dhe të kuptojmë më mirë për shkak të këndvështrimit të tyre. Ne nuk kemi pse të jemi të humbur, të pështjelluar, të mashtruar apo më pak të dobi-shëm. Kjo është veçanërisht e vërtetë në rastin e Atit tonë Qiellor, i cili na ka mësuar dhe treguar jo thjesht një mënyrë por të *vetmen* mënyrë.

Perëndia e ka Mënyrën

Në fakt, Perëndia e ka mënyrën si të jetojmë¹, si të duam², si të ndihmojmë³, si të lutemi⁴, si të bisedojmë⁵, si të ndërveprojmë me njëri-tjetrin⁶, si të udhëheqim⁷, si të martohemi⁸, si t'i rrisim fëmijët⁹, si të mësojmë¹⁰, si të njohim të vërtetën¹¹, si të ndajmë ungjillin¹², si të zgjedhim me urtësi atë që hamë¹³, etj.

Së bashku me shkrimet e shenja, disa burime të mrekullueshme për të gjetur mënyrën e Zotit janë *Të Vërtetë ndaj Besimit, Për Forcën e Rinisë* dhe te mësimet të tjera të apostujve e profetëve të gjallë.

1. Për shembull, Zoti na ka dhënë mësim në shkrimet e shenja:

“Duke qenë se mendimet e mia nuk janë mendimet tuaja, dhe as rrugët tuaja nuk janë rrugët e mia”, thotë Zoti.

‘Ashtu si qiejtë janë më të lartë se toka, kështu edhe rrugët e mia janë më të larta se rrugët tuaja dhe mendimet e mia janë më të larta se mendimet tuaja’” (Isaia 55:8–9).
2. Një nga të këqijat e këtyre ditëve të fundit është që “çdokush ecën në udhën e vet” (DeB 1:16). Te Fjalët e Urta paralajmërohemi që të “mos e mbaj[më] veten të ditur në sytë [tanë]” dhe të “mos mbështet[emi]



Sidnei, Australi

- në gjykimin [tonë]” (shih Fjalët e Urta 3:5–7).
3. Neve na është mësuar se, nëse i bëjmë gjërat sipas mënyrës së Zotit, Ai lidhet të na bekojë dhe ne kemi të drejtë të kërkojmë premtimet e Tij; dhe nëse nuk veprojmë sipas mënyrës së Tij, ne nuk kemi premtim (shih DeB 82:10).
 4. Zoti e krahasoi mënyrën e Tij me mënyrën tonë kur Ai përgatiti profetin Samuel, i cili qe dërguar për të gjetur një mbret të ri: “Por Zoti i tha Samuelit: ‘Mos ia shiko as pamjen as shtatgjatësinë, sepse unë e kam refuzuar, sepse Zoti nuk shikon si shikon njeriu, njeriu shikon pamjen, kurse Zoti shikon zemrën’” (1 Samuelit 16:7).
 5. Edhe me dëshirën e pranuar në mënyrë universale për të ndihmuar të varfërit dhe nevojtarët, Zoti pajtohet në qëllimin tonë por paralajmëron: “Por duhet të bëhet sipas mënyrës sime” (DeB 104:16). Përndryshe, gjatë përpjekjeve tona për t'i ndihmuar, në të vërtetë ne mund t'i dëmtojmë ata. Zoti na ka mësuar mbi nevojën për të nxitur mbështetjen te vetja. Edhe sikur të jemi në gjendje për të ndihmuar,

ne nuk duhet të japim apo të sigurojmë atë që ata mund dhe duhet ta bëjnë vetë. Është provuar kudo, bota merr mësim nga të këqijat e lëmshës. Perëndia me të vërtetë e di më mirë.

Le të marrim parasysh disa shembuj të tjerë. Zoti ka mënyrën për të bërë punën misionare. Kjo është shpjeguar në shkrimet e shenja dhe në manualin *Predikoni Ungjillin Tim* dhe zbatohet sipas drejtimit të Shpirtit.

Zoti ka mënyrën e Tij për të dashur, që është mënyra e *drejtë*. Njerëzit e botës thonë se ajo që ka vërtet rëndësi është që dy njerëz ta duan njëri-tjetrin. Ati ynë në Qiell na mëson se kjo është e rëndësishme, por Ai na mëson më shumë: se ka një mënyrë dhe kohë të autorizuar për ta shprehur atë dashuri.

Të Qeverisim Vetën

Jozef Smithit iu mësuar që në rini mënyrat e Zotit. Kur u pyet se si e drejtonte Kishën, ai shpjegoi se jepte mësim parime të drejta dhe anëtarët qeverisnin veten.¹⁴ Vëllezër e motra, apostujt dhe profetët tanë të gjallë ende janë duke dhënë mësim parime të drejta. Pyetja është: “A jemi duke i

përdorur këto parime për të qeverisur veten?”

Një gjë që na është dhënë mësim shpesh, është të lulëzojmë aty ku jemi mbjellë. Ende ndonjëherë ne tundohemi të shpërngulemi në ndonjë zonë të re, duke menduar se fëmijët tanë do të kenë më shumë miq dhe si rrjedhojë programe më të mira për rininë.

Vëllezër e motra, a mendojmë vërtet se faktori themelor për shpëtimin e fëmijëve tanë është lagjja ku ne jetojmë? Apostujt dhe profetët shpesh kanë dhënë mësim se, ajo që ndodh brenda shtëpisë, është shumë më tepër e rëndësishme sesa ajo çfarë fëmijët tanë ndeshin jashtë. *Mënyra* si i rrisim fëmijët tanë është më e rëndësishme sesa *vend* ku i rrisim ata.

Natyrisht, ka faktorë të tjerë që përfshihen në vendimin se ku të jetojmë dhe, fatmirësisht, Zoti do të na udhëheqë nëse kërkojmë miratimin e Tij.

Një tjetër pyetje është: “Ku nevojiteti?” Për 16 vjet unë shërbeva në presidencën e Kunjit Verior të Hjustonit në Teksas. Shumë njerëz u shpërngulën në zonën tonë gjatë atyre viteve. Shpesh do të merrnim një telefonatë që lajmëronte se dikush po shpërngulej dhe pyeste se cila ishte lagjja më e mirë. Vetëm një herë në 16 vjet mora një telefonatë që pyeste: “Cila lagje ka nevojë për një familje të mirë? Ku mund të ndihmojmë?”

Në vitet e para të Kishës, Presidenti Brigam Jang dhe të tjerë, u bënë thirrje anëtarëve që të shkonin në një vend të caktuar për të ngritur Kishën atje. Është ironike që edhe tani ne kemi kudo anëtarë besnikë të Kishës, që do të shkonin kudo që profeti do t’u kërkonte të shkonin. A presim me të vërtetë që Presidenti Monson t’i thotë secilit në mënyrë individuale se ku nevojitet familja jonë, [kur jemi] më shumë se 14 milionë prej nesh? Mënyra e Zotit është që t’u vëmë veshin



mësimeve të udhëheqësve tanë, të kuptojmë parimet e drejta dhe të qeverisim veten.

Veçanërisht e Rëndësishme

Me gjithçka që po ndodh në Kishë sot, dhe ndërsa Zoti po e përshpejton punën e Tij në çdo drejtim, është akoma edhe më me rëndësi kritike që ne ta bëjmë gjithçka që bëjmë sipas mënyrës së Tij!

Sidomos në punën e shpëtimit, ne mësojmë se “në dhuratën e Birit të tij, Zoti përgatiti një udhë më të shkëlqyer” (Ethëri 12:11). Doktrina e Krishtit “është udha; dhe s’ka udhë tjetër dhe as emër të dhënë nën qiell, nëpërmjet të cilit njeriu mund të shpëtohet në mbretërinë e Perëndisë” (2 Nefi 31:21).

Përfundim

Kur shohim kaq shumë njerëz në botë sot që jetojnë në pështjellim apo, më keq, duke u endur në shtigje të ndaluara dhe duke vuajtur në mënyrë të panevojshme pasojat e zgjedhjeve të këqija, më bën të dëshiroj që të thërras ashtu siç bëri Alma:

“O sikur të isha një engjell dhe të mund të plotësoja dëshirën e zemrës sime, që të mund të shkoja dhe të njoftoja me borinë e Perëndisë, me një zë që tund tokën dhe të thërrisja pendim në çdo popull!

Po, unë do t’i shpallja çdo shpirti . . . planin e shëlbimit, që ata duhet të pendohen dhe të vijnë te Perëndia ynë [dhe mënyrat e Tij], kështu që të mos ketë më pikëllim mbi të gjithë faqen e dheut” (Alma 29:1–2).

Përsëri, unë dëshmoj se Zoti e ka mënyrën! Ati ynë Qiellor na njeh, na do dhe dëshiron të ndihmojë. Ai e di më mirë si të ndihmojë. Ne nuk jemi jetimë shpirtërorë!

Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti është “udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6; shih edhe Alma 38:9). Mënyra e Tij bazohet mbi të vërtetën e përjetshme dhe na çon drejt “paq[ë] në këtë botë dhe jet[ë] [së] përjetshme në botën që vjen” (DeB 59:23). Unë dëshmoj kështu në emrin e Jezus Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih 2 Nefi 5:27; Mosia 4:27; Alma 7:23–25.
2. Shih Eksodi 20:14; Ligji i Përtërirë 6:5; Gjoni 13:34–35; Romakëve 1:24–32; 1 Thesalonikasve 4:3; Alma 39:3–5.
3. Shih Mosia 4:21–27; Doktrina e Besëlidhje 104:15–18.
4. Shih Mateu 6:5–13; 2 Nefi 32:8–9; 3 Nefi 18:21; Doktrina e Besëlidhje 10:5.
5. Shih Fjalët e Urta 15:1; Kolosianëve 4:6; Jakobi [Bibël] 5:12; 3 Nefi 11:29–30.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 64:10–11; 121:41–46.
7. Shih Mateu 25:14–30; Gjoni 10:1–14; Doktrina e Besëlidhje 50:26; 107:99–100; 121:34–40.
8. Shih Zanafilla 2:24; Jakobi [LiM] 2:27; Doktrina e Besëlidhje 42:22; 132:19.
9. Shih Mosia 4:14–15; Doktrina e Besëlidhje 68:25–28.
10. Shih Doktrina e Besëlidhje 43:8–9; 88:77–79, 118.
11. Shih Moroni 7:15–19; 10:3–5; Doktrina e Besëlidhje 9:7–9.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 33:8–10; 100:3–8.
13. Shih Doktrina e Besëlidhje 89.
14. Shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 299.



Nga Plaku Xhon B. Dikson,
i Të Shtatëdhjetëve

Çuarja e Ungjillit në Gjithë Botën

*Kisha ka lëvizur në mënyrë të qëndrueshme kudo në botë,
nga kombi në komb, nga kultura në kulturë, nga populli
në popull, sipas kalendarit të Zotit dhe në kohën e Tij.*

Shërbesa në vdekshmëri e Shpëtimtarit kishte përfunduar. Vuajtja e Tij në Gjetseman dhe në kryq mbaroi. Mësojmë nga Veprat e Apostujve 1 se Ai kishte shërbyer për 40 ditë pas Ringjalljes së Tij, “duke u parë” nga Apostujt dhe “duke folur për gjëra [të] mbretërisë së Perëndisë” (Veprat e Apostujve 1:3).

Ai u tha atyre se “ju do të merrni fuqi kur Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ju dhe do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut” (Veprat e Apostujve 1:8).

Pak pas kësaj, ai “u ngrit lart; dhe një re e përfshiu dhe ua hoqi prej syve të tyre.

Dhe, si ata po i mbanin sytë e ngulitur në qiell, ndërsa ai po largohej, ja dy burra në rroba të bardha iu paraqitën atyre,

dhe thanë: ‘Burra Galileas, pse qëndroni e shikoni drejt qiellit? Ky Jezus, që u është marrë në qiell nga mesi juaj, do të kthehet në të njëjtën mënyrë, me të cilën e keni parë të shkojë në qiell’ (Veprat e Apostujve 1:9–11).

Me të vërtetë, Shpëtimtari do të vijë sërish në Ardhjen e Tij të Dytë, por

ndërkohë, ungjilli i Jezu Krishtit duhej të shkonte “deri në skajin e dheut”.

Nga Mateu ne mësojmë për një urdhër të veçantë dhënë Apostujve, që t’ia çonin ungjillin të gjitha kombeve:

“Pastaj Jezusi u afrua dhe u foli atyre duke thënë: ‘Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë.

Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë’” (Mateu 28:18–19).

Gjatë ditëve të hershme të Kishës, në meridianin e kohës, ungjilli u çua vetëm te shtëpia e Izraelit; pastaj Pjetrit, Apostullit më të vjetër, i erdhi zbulesa se kishte ardhur koha që ta çonin ungjillin përtej Izraelit dhe te johebrenjtë. Kapitujt 10 dhe 11 të Veprave të Apostujve na ndihmojnë të kuptojmë procesin dhe modelin me anë të të cilit ky zgjerim i nevojshëm i Kishës ndaj më shumë fëmijëve të Perëndisë, u ishte bërë i njohur drejtuesve kryesues dhe anëtarësisë së përgjithshme.

Duke përdorur Kornelin, i cili ishte një johebre, një centurion dhe një njeri i mirë, Zoti e ndihmoi Pjetrin të kuptonte se ungjilli do t’u shkonte johebrenjve, një koncept i ri dhe i huaj

për shenjtoret e asaj kohe. Zbulesa që bëri atë ndryshim në punët e Kishës, i erdhi Pjetrit, Apostullit më të vjetër. Ne e dimë se më pas ungjilli u përhap me shpejtësi te kombet e johebrenjve.

Një shembull i zgjerimit të Kishës në atë kohë ishte kthimi në besim i Palit, i cili u bë Apostulli i madh për johebrenjtë. Ai pati një vegim teksa ishte në rrugën për në Damask, ku pa një dritë e dëgjoji një zë, u pendua për mëkatet e tij dhe u thirr nga Perëndia (shih Veprat e Apostujve 22:6–18) e më pas u bë një forcë shumë e madhe në përhapjen e ungjillit të Jezu Krishtit.

Tani le të shkojmë 1.800 vite më tej, deri në kohën e Rivendosjes së ungjillit ose ripërtëritjes së të gjitha gjërave përpara Ardhjes së Dytë. Unë dëshmoj se nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Kisha është rivendosur dhe vazhdon të shkojë përpara nën drejtimin e Presidencës së Parë dhe të Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Urdhri për ta, për t’ia çuar ungjillin botës, është i njëjti me atë të Apostujve të lashtë.

Që nga koha e organizimit të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme në 1830–ën, Kisha ka lëvizur në mënyrë të qëndrueshme kudo në botë, nga kombi në komb, nga kultura në kulturë, nga populli në popull, sipas kalendarit të Zotit dhe në kohën e Tij.

Në vitin 1978, në vazhdim të modelit të vendosur të zbulesës nëpërmjet Apostullit më të vjetër, Presidentit Spenser W. Kimball, erdhi një zbulesë, këtë herë për dhënien e bekimeve të priftërisë të gjithë meshkujve të denjë kudo në botë. Kjo do të thotë se në kohën tonë, të gjithë fëmijët e Atit Qie-llor kudo në botë mund të marrin nga të gjitha bekimet e ungjillit të rivendosur. Ky është një veprim shumë i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë në tokë në ditët e afrimit të Ardhjes së Dytë të Krishtit.



Në rastin tim personal, sapo isha thirrur si president misioni, dhe motra Dikson dhe unë ishim gati ta çonim familjen tonë në Meksikë kur Plaku Riçard G. Skot, në atë kohë anëtar i Të Shtatëdhjetëve, më tregoi për ardhjen e kësaj zbuluese të veçantë. Ndërsa më tregoi atë që kishte ndodhur, më kujtohet që më dolën lotë nga sytë. Isha i kënaqur sa s'thuhet me fjalë pasi e dija se ishte e drejtë dhe se kishte ardhur koha për të gjithë njerëzimin që të kishte të drejtën për të gjitha ordinancat, besëlidhjet dhe bekimet e ungjillit.

Kjo ndodhi afërsisht 35 vite më parë dhe në atë kohë nuk ma merrote mendja se do t'i kaloja disa vite të shërbesës sime si I Shtatëdhjetë në Zonën e Afrikës Perëndimore të Kishës, midis njerëzve besimtarë e besnikë, jetët e të cilve do të ishin kaq të ndikuara nga zbulesa e 1978–ës mbi priftërinë. Motra Dikson dhe unë kemi jetuar atje për katër vjet dhe përvoja ka qenë e mrekullueshme, dhe ka ndryshuar jetët tona.

Afrikano-perëndimorët, si popull, besojnë në Perëndi, nuk kanë absolutisht turp në shpalljen dhe ndarjen e besimit të tyre me të tjerët dhe kanë aftësi shumë të madhe drejtuese. Qindra njerëz po kthehen në besim në Kishë, dhe pak a shumë çdo javë krijohen disa lagje ose degë diku në Zonën e Afrikës Perëndimore, thuajse në çdo rast, me udhëheqje priftërie dhe të organizatave ndihmëse tërësisht afrikane.

Sa do të doja të bashkoheshit me shenjtorët në tempullin e Abas në Nigeri apo të Akras në Ganë, ku ju do të mund të ndienit zotimin e shenjtorëve dhe do të arrinit të njihnit presidencat e tempujve tërësisht afrikane. Ose sa do të doja t'ju prezantoja me Të Shtatëdhjetët Zonalë afrikane, që sot janë bashkuar me ne këtu në Qendrën e Konferencave dhe janë avokatë, profesorë dhe administrues biznesi, apo t'ju njihja me udhëheqës afrikane për kunje dhe lagje dhe me familjet e tyre.

T'i bashkohesh një ore mësimore të Shkollës të së Dielës, të një organizate ndihmëse apo të priftërisë nëpër Afrikë, është një përvojë e shenjtë, ku zbatohet programi mësimor i Kishës dhe ka kuptueshmëri, mësimdhënie dhe nxënie të madhe të ungjillit me anë të Shpirtit.

Ungjilli në Afrikë po i shkon një populli të lumtur, që nuk është aq i shqetësuar për pamjen e jashtme, e cila ndikon në jetën e shumë njerëzve në Perëndim. Ata nuk shqetësohen që të kenë zotërimi të pafundme materiale.

Është thënë për afrikanët se ata kanë shumë pak nga ajo që ka më pak rëndësi dhe shumë më tepër nga ajo që ka më shumë rëndësi. Ata kanë pak interes për shtëpi shumë të mëdha dhe makinat më të mira, por kanë interes të madh në njohjen e Atit të tyre Qiellor dhe Birit të Tij, Jezu Krishtit, dhe në pasjen e familjeve të përjetshme. Si pasojë e natyrshme e besimit të tyre, Zoti po i lartëson ata në mënyra kuptimplote.

Duke i njohur siç i njohim ne, nuk jemi të çuditur që ata do të ishin një pjesë kaq e rëndësishme e zgjerimit të Kishës së Jezu Krishtit në ditët e fundit. Kur Danieli, profeti i Dhiatës së Vjetër, parashikoi se mbretëria e Perëndisë në ditët e fundit “do të përhapel] deri në fundet e dheut, ashtu si [një] gur që shkëputet pa duar nga mali, do të përhapel] derisa të [kishte] mbushur tërë tokën” (DeB 65:2), është me shumë vend që vëllezërit dhe motrat tona të mrekullueshme afrikane do të ishin një pjesë e rëndësishme e përmbushjes së asaj profecie dhe se zbulesat që e bënë të tillë, do të ndiqnin modelet e vendosura nga Zoti.

Unë dëshmoj se Ati ynë Qiellor i do të gjithë fëmijët e Tij, se Jezusi është Krishti dhe se ungjilli është i disponueshëm për të gjithë, të gjallë dhe të vdekur. Në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ne Besojmë në Qenien të Dëlirë

Bindja ndaj ligjit të dëlirësisë do ta shtojë lumturinë tonë në vdekshmëri dhe do të bëjnë të mundur përparimin tonë në përjetësi.

Mesazhi im trajton një pyetje themelore me rëndësi të madhe shpirtërore: Përse është ligji i dëlirësisë kaq i rëndësishëm? Unë lutem që Fryma e Shenjtë do ta pohojë vërtetësinë e parimeve që theksoj.

Plani i Atit për Lumturinë

Rëndësia e përjetshme e dëlirësisë mund të kuptohet vetëm brenda kontekstit më të gjerë të planit të lumturisë të Atit tonë Qiellor për fëmijët e Tij. “Të gjitha qeniet njerëzore – meshkuj e femra – janë krijuar sipas shëmbëlltysë së Perëndisë. Secili është një bir ose bijë shpirtërore e dashur e prindërve qiellorë dhe . . . ka një natyrë dhe destinacion hyjnor” (“Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f.129). Të gjithë burrat dhe gratë jetuan me Perëndinë si fëmijët e Tij shpirtërorë përpara ardhjes në tokë si qenie të vdekshme. Plani i Atit u jep mundësi bijve dhe bijave të Tij shpirtërorë që të marrin trupa fizikë, të fitojnë përvojë në vdekshmëri dhe të përparojnë drejt ekzaltimit.

Rëndësia e një Trupi Fizik

Trupat tanë fizikë bëjnë të mundur një llojshmëri, thellësi dhe fuqi përvojë që thjesht nuk mund të fitohet në ekzistencën tonë para lindjes. Kështu, marrëdhëniet tona me njerëz të tjerë, zotësia jonë për të njohur dhe vepëruar në përputhje me të vërtetën dhe aftësia jonë për t’iu bindur parimeve e ordinancave të ungjillit të Jezu Krishtit, përforcohen nëpërmjet trupave tanë fizikë. Në shkollën e vdekshmërisë, ne përjetojmë dhembshuri, dashuri, mirësi, lumturi, hidhërim, zhgënjim, dhembje dhe madje sfidat e kufizimeve trupore në mënyra që na përgatitin për përjetësinë. E thënë thjesht, ka mësim që duhet t’i mësojmë dhe përvoja që duhet t’i kemi, siç i përshkruajnë shkrimet e shenjta, “sipas mishit” (1 Nefi 19:6; Alma 7:12–13).

Fuqia e Riprodhimit

Pasi u krijua toka, Adami u vendos në Kopshtin e Edenit. Sidoqoftë, në mënyrë të rëndësishme, Perëndia tha: “Nuk ishte mirë që njeriu të ishte i vetëm” (Moisiu 3:18; shih edhe Zanafilla 2:18) dhe Eva u bë gruaja dhe ndihmuesja e tij. Qe e nevojshme



zbuluar, një dëshirë për t'u kënaqur, ose një lloj kalimi kohe apo argëtimi për t'u ndjekur me egoizëm. Ato nuk janë një trofe për t'u arritur apo thjesht një veprim për t'u kryer. Përkundrazi, në vdekshmëri ato janë një prej shprehjeve bazë të natyrës e potencialit tonë hyjnor dhe një mënyrë për të forcuar lidhjet emocionale dhe shpirtërore midis bashkëshortit dhe bashkëshortes. Ne jemi veprues, të bekuar me liri morale të zgjedhjes dhe karakterizohemi nga trashëgimia jonë hyjnore si fëmijë të Perëndisë – dhe jo nga sjelljet seksuale ose qëndrimet dhe ligjet bashkëkohore.

Njeriu i Natyrshëm

Në njëfarë shkalle, njeriu i natyrshëm, i përshkruar nga Mbreti Benjamin, është gjallë dhe mirë brenda çdonjërit prej nesh (shih Mosia 3:19). Burri apo gruaja e natyrshme është i/e papenduar, është prej mishi dhe epshor/e (shih Mosia 16:5; Alma 42:10; Moisiu 5:13), është tolerues/e dhe i/e ekzagjeruar, dhe është krenar/e dhe egoist/e. Sikurse na mësoi Presidenti Spenser W. Kimball: “Njeriu i natyrshëm’ është ‘njeriu tokësor’ që i ka lejuar pasionet e pahijshme kafshërore t’i errësojnë prirjet e tij shpirtërore” (“Ocean Currents and Family Influences”, *Ensign*, nëntor 1974, 112).

Ndryshe nga kjo, “[burri ose gruaja] e Krishtit” (Helamani 3:29) është shpirtëror/e dhe i frenon të gjitha pasionet (shih Alma 38:12), është i/e matur dhe i/e përmbajtur dhe është dashamirës/e dhe vetëmohues/e. Burrat dhe gratë e Krishtit kapen pas fjalës së Perëndisë, e mohojnë veten dhe marrin mbi vete kryqin e Tij (shih Mateu 16:24; Marku 8:34; Lluka 9:23; DeB 56:2), dhe çajnë përpara përgjatë një shtegu të ngushtë e të ngushtuar besnikërie, bindjeje dhe përkushtimi ndaj Shpëtimtarit dhe ungjillit të Tij.

ndërthurja e pashoqe e aftësive shpirtërore, fizike, mendore dhe emocionale si të meshkujve dhe femrave për ta realizuar planin e lumturisë. “Në Zotin as burri s’është pa gruan, as gruaja pa burrin” (1 Korintasve 11:11). Burri dhe gruaja janë paracaktuar të mësojnë nga njëri-tjetri, ta forcojnë, ta bekojnë, ta plotësojnë dhe ta bëjnë të përkryer njëri-tjetrin.

Mënyra me anë të së cilës krijohet jeta e vdekshme, caktohet në mënyrë hyjnore. “Urdhërimi i parë . . . [që] Perëndia i dha Adamit dhe Evës, ishte rreth potencialit të tyre për të qenë prindër si burrë dhe grua” (*Liahona*, nëntor 2010, f. 129). Urdhërimi që të shumoheshin dhe të mbushnin tokën, mbetet i vlefshëm sot. Kështu, martesë mes një burri e një gruaje është mënyra e autorizuar përmes së cilës shpirtat para lindjes hyjnë në vdekshmëri. Moskryerja tërësisht e marrëdhënieve seksuale përpara martesës dhe besnikëria e plotë gjatë martesës mbrojnë shenjtërinë e kësaj përgjegjësie të shenjtë.

Fuqia e krijimit është domethënëse nga ana shpirtërore. Keqpërdorimi i kësaj fuqie i shkatërron qëllimet e planit të Atit dhe të ekzistencës sonë në vdekshmëri. Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij i Dashur janë krijues dhe i kanë besuar secilit prej nesh një pjesë të fuqisë së Tyre krijuese. Porositë e posaçme për përdorimin e duhur të aftësisë për

të krijuar jetë janë elemente jetike në planin e Atit. Mënyra si ndihemi rreth asaj fuqie hyjnore dhe mënyra si e përdorim atë, do të përcaktojnë në shkallë të gjerë lumturinë tonë në vdekshmëri dhe fatin tonë në përjetësi.

Plaku Dallin H. Oaks shpjegoi:

“Fuqia për të krijuar jetë të vdekshme është fuqia më e ekzaltuar që Perëndia u ka dhënë fëmijëve të Tij. Përdorimi i saj u kërkua që në urdhërimin e parë, por një urdhërim tjetër i rëndësishëm u dha për ta ndaluar keqpërdorimin e saj. Theksi që vendosim te ligji i dëlirësisë, shpjegohet nga të kuptuarit prej nesh të qëllimit të fuqive tona krijuese në përmbushjen e planit të Perëndisë. . . .

Jashtë lidhjeve martesore, të gjitha përdorimet e fuqisë krijuese janë në një shkallë apo në një tjetër një zvetënim dhe shtrembërim mëkatar i tiparit më hyjnor të burrave dhe grave” (“The Great Plan of Happiness”, *Ensign*, nëntor 1993, 74).

Standardi i Moralshmërisë Seksuale

Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme ka një standard të vetëm, të pandryshueshëm të moralshmërisë seksuale: marrëdhëniet intime janë me vend vetëm mes një burri dhe një gruaje në marrëdhënien martesore të paracaktuar në planin e Perëndisë. Marrëdhënie të tilla nuk janë thjesht një kuriozitet për t'u

Si bij dhe bija të Perëndisë, ne kemi trashëguar aftësi hyjnore prej Tij. Por tani ne jetojmë në një botë të rënë. Vetë elementet me të cilat trupat tanë u krijuan, janë për nga natyra të rëna dhe gjithmonë të ndjeshëm ndaj ndikimit të mëkatit, korrupsionit dhe vdekjes. Si rrjedhojë, Rënia e Adamit dhe pasojat e saj shpirtërore dhe trupore na prekin më drejtpërdrejt te trupat tanë fizikë. Dhe prapëseprapë ne jemi qenie të dyfishta, pasi shpirti ynë, që është pjesa e jonë e përjetshme, vendoset në një trup fizik që i nënshtrohet Rënies. Ashtu si Jezusi ia theksoi apostullit Pjetër: “Fryma është gati, por mishi është i dobët” (Mateu 26:41).

Natyra e saktë e provës së vdekshmërisë, atëherë, mund të përmblihdhet në pyetjen vijuese: A do t’u përgjigjem prirjeve të njeriut të natyrshëm, apo do t’iu hap rrugë mbresave të Shpirtit të Shenjtë dhe do ta zhvesh njeriun e natyrshëm e do të bëhem shenjtor përmes Shlyerjes së Krishtit, Zotit (shih Mosia 3:19)? Kjo është prova. Çdo oreks, dëshirë, prirje dhe shtysë e njeriut të natyrshëm mund të mposhtet nga Shlyerja e Jezu Krishtit dhe nëpërmjet saj. Jemi këtu në tokë për të zhvilluar cilësi të perëndishme dhe për t’i frenuar të gjitha pasionet e mishit.

Qëllimi i Kundërshtarit

Plani i Atit hartohet që të sigurojë drejtim për fëmijët e Tij, t’i ndihmojë ata të bëhen të lumtur dhe t’i kthejë të sigurt në shtëpi tek Ai, me trupa të ringjallur e të ekzaltuar. Ati Qiellor dëshiron që të jemi së bashku në dritë dhe të mbushur me shpresë. Në të kundërt, Luciferi mundohet t’i bëjë të ngatërruar dhe të brengosur bijtë dhe bijat e Perëndisë dhe ta pengojë përparimin e tyre të përjetshëm. Qëllimi kryesor i atit të gënjeshtrove



është që të gjithë ne të bëhemi “të mjeruar sikurse është ai vetë” (2 Nefi 2:27). Luciferi dëshiron që ne përfundimisht të jemi të vetëm në errësirë dhe pa shpresë.

Satani punon pa mëshirë për t’i shtrembëruar pjesët më të rëndësishme të planit të Atit. Ai nuk ka një trup dhe përparimi i tij i përjetshëm është ndalur. Ashtu si rrjedhja e ujit në një shtrat lumi ndalohet nga një digë, po kështu përparimi i përjetshëm i kundërshtarit pengohet ngaqë ai nuk ka trup fizik. Për shkak të rebelimit të tij, Luciferi ia ka mohuar vetes gjithë bekimet dhe përvojat e vdekshmërisë, të bëra të mundura me anë të një trupi prej mishi e kockash. Ai nuk mund t’i mësojë mësimet që vetëm një shpirt brenda një trupi, mund t’i mësojë. Ai e ka zët realitetin e një ringjalljeje të vërtetë dhe universale të të gjithë njerëzimit. Një nga kuptimet e fuqishme sipas shkrimit të shenjtë të fjalës *i mallkuar* ilustron në paaftësinë e tij që të vazhdojë të zhvillohet dhe të bëhet si Ati ynë Qiellor.

Për shkak se një trup fizik është kaq qendror për planin e Atit për lumturinë dhe zhvillimin tonë

shpirtëror, Luciferi kërkon ta prishë përparimin tonë duke na tunduar t’i përdorim në mënyrë të gabuar trupat tanë. Një nga ironitë bazë të përjetësisë është që kundërshtari, i cili është i mjeruar pikërisht ngaqë nuk ka trup fizik, na josh që ta ndajmë mjerimin e tij me të me anë të përdorimit të gabuar të trupave tanë. Vetë mjeti që ai nuk e ka, është kështu objekti parësor i orvatjeve të tij që të na tërheqë drejt shkatërrimit shpirtëror.

Shkelja e ligjit të dëlirësisë është një mëkat i rëndë dhe një keqpërdorim i tabernakujve tanë fizikë. Për ata që e njohin dhe e kuptojnë planin e shpëtim, përdhosja e trupit është një vepër rebelimi (shih Mosia 2:36–37; DeB 64:34–35) dhe një mohim i identitetit tonë të vërtetë si bij e bija të Perëndisë. Teksa shohim përtej vdekshmërisë dhe në brendësi të përjetësisë, është e lehtë të dallojmë se shoqërimi i shtirë, i mbrojtur nga kundërshtari është i përkohshëm dhe i zbrazët.

Bekimet e Qenies të Dëlirë

Alma e këshilloi birin e tij, Shiblonin, që “të freno[nte] të gjitha pasionet [e tij], që të mund të mbushesh [me



dashuri” (Alma 38:12). Në mënyrë domethënëse, disiplinimi i njeriut të natyrshëm brenda secilit prej nesh, bën të mundur një dashuri më të pasur, më të thellë dhe më të durueshme për Perëndinë dhe fëmijët e Tij. Dashuria shtohet nëpërmjet vetëpërbajtjes së drejtë dhe pakësohet nëpërmjet dhënies së rrëmbyeshme ndaj dëshirave.

Presidenti Marion G. Romney shpalli: “Nuk mund të mendoj për bekime që dëshirohen më me zjarr se ato që u premtohen të pastërve dhe të virtytshmeve. Jezusi foli për shpërblime të posaçme për virtyte të ndryshme, por i ruajti shpërblimet më të mëdha, kështu më duket mua, për të pastërtit në zemër ‘sepse ata’, tha ai, ‘do ta shohin Perëndinë’ (Mateu 5:8). Dhe ata, jo vetëm që do ta shohin patjetër Zotin, por me siguri do të ndihen rehat në praninë e tij.

Ja . . . premtimi i Shpëtimtarit: “Virtyti duhet t’i stolisë mendimet e tua pa pushim; atëherë do të forcohet vetëbesimi yt në prani të Perëndisë” (DeB 121:45) (“Trust in the Lord,” *Ensign*, maj 1979, f. 42).

Gjithashtu na premtohet se, kur e ndjekim shtegun e virtytit, “Fryma e Shenjtë do të jetë shoqëruesi [ynë] i përhershëm” (DeB 121:46). Prandaj, të jetuarit e ligjit të dëlirësisë fton disa prej bekimeve më të mëdha që burrat dhe gratë mund të marrin në vdekshmëri: siguri të duhur shpirtërore në

prani të familjes, miqve, të njohurve të Kishës dhe, më së fundi, të Shpëtimtarit. Dëshira jonë e natyrshme për të qenë pjesë e kësaj, përmbushet në drejtësi teksa ecim me shpresë në dritë.

Parimi i Pendimit

Disa nga ju, që e marrin këtë mesazh, kanë nevojë të pendohen për mëkate seksuale ose mëkate të tjera. Shpëtimtari shpesh quhet Mjeku i Madh dhe ky titull ka kuptim si simbolik, ashtu edhe të drejtpërdrejtë. Të gjithë ne e kemi përjetuar dhembjen që shoqëron një dëmtim apo plagë trupore. Kur kemi dhembje, ne zakonisht kërkojmë lehtësim dhe jemi mirënjohës për ilaçet dhe mjekimet që ndihmojnë për të na e lehtësuar vuajtjen. Konsiderojeni mëkatin si plagë shpirtërore që shkakton ndjenjë faji ose, siç ia përshkroi Alma të birit, Koriantonit, “brejtje të ndërgjegjes” (Alma 42:18). Ndjenja e fajit është për shpirtin tonë ashtu siç është dhembja për trupin tonë – një paralajmërim për rrezikun dhe një mbrojtje nga dëmi shtesë. Nga Shlyerja e Shpëtimtarit rrjedh balsami qetësues që mund të na i shërojë plagët tona shpirtërore dhe ta largojë ndjenjën e fajit. Sidoqoftë, ky balsam mund të zbatohet vetëm përmes parimeve të besimit në Zotin Jezu Krisht, të pendimit dhe bindjes së qëndrueshme. Rezultatet e pendimit të sinqertë janë paqja e ndërgjegjes,

ngushëllimi dhe shërimi e përtëritja shpirtërore.

Peshkopi ose presidenti juaj i degës është ndihmësi i mjekut shpirtëror, që autorizohet t’ju ndihmojë të pendoheni dhe të shëroheni. Megjithatë, ju lutem mbani mend se shkalla dhe fuqia e pendimit tuaj duhet të përkohet me natyrën dhe faktin se sa të rënda janë mëkatet tuaja – veçanërisht për shenjtore të ditëve të mëvonshme që kanë bërë besëlidhje të shenjtë. Plagë të rënda shpirtërore kërkojnë mjekim të qëndrueshëm dhe kohë për t’u shëruar plotësisht dhe tërësisht.

Një Premtim dhe një Dëshmi

Doktrina që kam përshkruar, do të duket se është pak e vjetëruar dhe e dalë mode për shumë njerëz në një botë e cila e tall gjithnjë e më shumë shenjtërinë e riprodhimit dhe e ul skajshëm vlerën e jetës njerëzore. Por e vërteta e Zotit nuk ndryshohet sipas modës, popullaritetit apo sondazheve të opinionit publik. Unë premtoj se bindja ndaj ligjit të dëlirësisë do ta shtojë lumturinë tonë në vdekshmëri dhe do të bëjnë të mundur përparimin tonë në përjetësi. Dëlirësia dhe virtyti janë tani, kanë qenë përherë dhe do të jenë gjithnjë “më [të] dashur[at] dhe më [të] çmueshme[t] përmbi të gjitha gjërat” (Moroni 9:9). Kështu dëshmoj në emrin e shenjtë të Zotit Jezu Krisht, amen. ■



Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuoromit të Dymbëdhjetë Apostujve

Kapeni Valën

Unë falënderoj Perëndinë dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin, për Rivendosjen dhe fuqinë e saj për të çuar përpara një valë vërtetësie dhe drejtësie në mbarë botën.


Të dashur vëllezër e motra, unë bashkohem me Presidentit Tomas S. Monson dhe të tjerët, në lavdërimin e atyre që iu përgjigjën thirrjes së profetit për më shumë misionarë të denjë. Tani, një valë e paparë entuziazmi për punë misionare po përfshin gjithë tokën. Që prej njoftimit historik tetorin e kaluar nga Presidenti Monson, janë thirrur mijëra pleq [eldra], motra e çifte dhe shumë të tjerë po përgatiten.¹ Tani neve na vijnë pyetje si: “Çfarë do të bëni me gjithë këta misionarë?” Përgjigjja është e thjeshtë. Ata do të bëjnë atë që misionarët kanë bërë gjithmonë. Ata do të predikojnë ungjillin! Ata do të bekojnë fëmijët e Perëndisë së Plotfuqishëm!

Të rinj dhe të reja, më shumë prej jush do ta kapin këtë valë ndërsa përpiqeni të jeni të denjë për thirrje misioni. Ju e shihni këtë si një valë të së vërtetës dhe së drejtës. Ju e shihni mundësinë tuaj që është në kreshtën e asaj vale.

Ju adoleshentë, përvetësojeni programin tuaj të ri mësimor dhe mësojini njëri-tjetrit doktrinën e Jezu Krishtit. Tani është radha juaj që të përgatiteni për t’u mësuar të tjerëve rreth mirësisë së Perëndisë.

Të rinj dhe të reja, arsimimi juaj është gjithmonë i rëndësishëm – për

ne, për ju dhe për Perëndinë. Kur është e mundshme, nëse dëshironi të shkoni në një kolegji apo universitet *pas* misionit tuaj, ne ju nxisim të bëni kërkesë te institucioni që zgjidhni *përpara* fillimit të misionit tuaj. Shumë institucione studimesh të larta do të ofrojnë për misionarë të ardhshëm një shtyrje nga 18 deri 30 muaj pas pranimit të kërkesës. Kjo do t’ju mundësojë ju pleq dhe motra të shërbeni pa u shqetësuar se ku do ta filloni arsimin tuaj të lartë. Ne jemi shumë mirënjohës ndaj udhëheqësve të institucioneve arsimore që



po e bëjnë të mundur një planifikim të tillë.

Ju prindër, mësues dhe të tjerë, kapeni valën ndërsa e përgatisni brezin tonë të ri për të qenë i denjë për shërbim misionar. Ndërkohë, jeta juaj shembullore do të tërheqë interesin e miqve dhe të fqinjve tuaj. Jini të gatshëm t’u jepni një përgjigje atyre që pyesin përse jetoni në këtë mënyrë. Jini të gatshëm të jepni një arsye për shpresën dhe gëzimin që ata shohin te ju.² Kur pyetje të tilla bëhen, ju mund t’u përgjigjeni duke thënë: “Le të pyesim misionarët! Ata mund të na ndihmojnë! Dhe nëse dëshironi, do të jem përkrah jush teksa misionarët ju përgjigjen dhe ju japin mësim.”

Ju të rritur, kapeni valën duke ndihmuar për përgatitjen shpirtërore, fizike dhe financiare të misionarëve të ardhshëm. Kursimi i parave ju bëhet zakon. Ju çifte më të moshuar, ju bëni plane për ditën kur mund të shkoni në misionin tuaj. Ne do të jemi shumë mirënjohës për shërbimin tuaj. Deri atëherë, ndoshta disa nga ju mund t’i përdorni paratë tuaja për të mbështetur punën misionare duke kontribuar në Fondin e Përgjithshëm Misionar, siç është sugjeruar sërish këtë mëngjes nga Presidenti Monson.³

Një numër në rritje burrash të përzgjedhur dhe të bashkëshorteve të tyre të dashura, kapin valën kur thirren të kryesojnë në misionet e Kishës. Në atë shërbim, ata do të ndikojnë tek e ardhmja e brezave të lindur e të palindur. Presidentët e misionit mbajnë çelësat e përgjegjesisë për mirëqenien, sigurinë dhe suksesin e misionarëve të tyre. Pas këshillimit me presidentët e kunjeve dhe distrikteve në misionin e tij, çdo president misioni cakton misionarë për të shërbyer në kunje, lagje dhe degë të veçanta.

Presidentët e kunjeve dhe peshkopët e kapin valën kur shpenzojnë



e paraqiti Jozef Smithin e ri te Zoti Jezu Krisht. Ato shtatë fjalë filluan Rivendosjen e ungjillit të Tij. Përse? Sepse Perëndia ynë i gjallë është një Perëndi i dashur! Ai do që fëmijët e Tij ta njohin Atë dhe Jezu Krishtin, të cilin Ai e dërgoi!⁹ Dhe Ai do që fëmijët e Tij të fitojnë pavdekësi dhe jetë të përjetshme!¹⁰

Për këtë qëllim të lavdishëm, misionarët tanë japin mësim rreth Rivendosjes. Ata e dinë se rreth 2.000 vite përpara, Zoti krijoi Kishën e Tij. Pas kryqëzimit të Tij dhe vdekjes së Apostujve të Tij, njerëzit e ndryshuan Kishën dhe doktrinën e saj. Atëherë, pas brezash errësire shpirtërore dhe sikurse u parashikua nga profetë të mëparshëm¹¹, Ati Qellor dhe Jezu Krishti rivendosën Kishën, doktrinën e saj dhe autoritetin e priftërisë së saj. Në saje të asaj Rivendosjeje, njohuria dhe ordinancat thelbësore për shpëtimin dhe ekzaltimin janë përsëri të disponueshme për të gjithë njerëzit.¹² Në fund, ai ekzaltim e lejoi secilin prej nesh të jetojë me familjet tona në praninë e Perëndisë dhe të Jezu Krishtit përgjithmonë!

Unë nuk mund të flas për Rivendosjen pa emocion. Ky fakt i historisë është absolutisht i jashtëzakonshëm! Ai është mahnitës! Është tronditës! Sa mahnitëse është që lajmëtarë nga qielli erdhën për t'i dhënë autoritet dhe fuqi kësaj pune!

Ati ynë i Amshuar dhe Jezu Krishti iu shfaqën shumë herë Profetit Jozef Smith.¹³ Nën drejtimin e Tyre, lajmëtarë të tjerë qiellorë erdhën, secili me një qëllim të posaçëm. Për shembull:

- Engjëlli Moroni zbuloi Librin e Mormonit.¹⁴
- Gjon Pagëzori rivendosi Priftërinë Aarone.¹⁵
- Pjetri, Jakobi dhe Gjoni rivendosën Priftërinë Melkizedeke.¹⁶

gjithnjë e më shumë orë duke intervistuar misionarë të ardhshëm. Këta udhëheqës priftërie mbajnë çelësa të përgjegjësive për punën misionare në njësitë e tyre dhe i frymëzojnë anëtarët për të marrë pjesë.

Vëllezër dhe motra në secilin këshill lagjeje po fillojnë ta kapin valën. Në atë këshill është udhëheqësi i misionit të lagjes.⁴ Unë do të doja të flisja posaçërisht për secilin nga ju udhëheqës të misionit të lagjes. Ju jeni thirrur nga peshkopi juaj për të udhëhequr punën misionare në lagje. Dhe disa nga ju janë aq të suksesshëm, sa që është thirrur edhe një ndihmës që t'ju ndihmojë. Bashkë me të tjerët në këshillin e lagjes, ju gjeni anëtarë më pak aktivë, familje jo tërësisht të anëtarësuar dhe fqinj të interesuar. Ju takoheni rregullisht me misionarë kohëplotë të caktuar. Ju i këshilloni dhe i ndihmoni misionarët. Ju lutem, ndihmohini ata të mbushin kohën çdo ditë me mundësi mësimdhënieje të përqendruara e të rëndësishme. Kjo është përgjegjësia juaj. Roli juaj është jetik, vërtet jetik për suksesin e kësaj

pune. Nëse e kapni valën me besim dhe entuziazëm, edhe të tjerët do të bëjnë të njëjtën gjë. Ju, si udhëheqës i misionit të lagjes, jeni *hallka* lidhëse midis anëtarëve dhe misionarëve në këtë punë të shenjtë për shpëtimin e fëmijëve të Perëndisë.⁵

Miq të dhe fqinjët tanë që nuk janë anëtarë të Kishës por që kanë pyetje rreth saj, gjithashtu mund ta kapin valën. Ne i nxisim ata të mbajnë gjithçka që është e mirë dhe e vërtetë në jetën e tyre. Dhe ne i ftojme ata të marrin më shumë, veçanërisht të vërtetën e lavdishme se, nëpërmjet planit të përjetshëm të Perëndisë, familjet mund të jenë së bashku përgjithmonë.⁶

Kjo valë e së vërtetës dhe e drejtësisë është e mrekullueshme! Ajo *nuk* është krijuar nga njeriu! Ajo vjen nga Zoti që tha: “Unë do ta përshpejtoj veprën time në këtë kohë”⁷. Kjo valë është fuqizuar nga një njoftim hyjnor i bërë 193 vite përpara. Ajo përbëhet nga vetëm shtatë fjalë: “Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!”⁸ Shqiptuar nga Perëndia i Plotfuqishëm, ai njoftim

- Moisiu dha çelësat për mbledhjen e Izraelit.¹⁷
- Eliasi dha çelësat për njohurinë rreth Abrahamit.¹⁸
- Elija rivendosi çelësat për autoritetin vulosës.¹⁹

Përveç këtyre, Rivendosja shtoi njohurinë që shenjtoret patën në lashtësi. Zoti siguroi një libër të ri shkrimi të shenjtë. Biblës së Shenjtë, Ai i shtoi Librin e Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit. Ai është një anal për profecitë dhe shërbesën e Zotit të ringjallur te njerëzit e Amerikës së lashtë. Ai shpjegon planin e madh të Perëndisë për lumturinë²⁰ – planin e shpëtimit.²¹ Libri i Mormonit është në harmoni të plotë me Biblën. Të dyja analet e shenjta pohojnë të vërtetën e ungjillit të Jezu Krishtit dhe rëndësinë e Shlyerjes së Tij.²²

Rivendosja përmbush shumë profeci biblike. Për shembull, Isaia

profetizoi se shtëpia e Zotit do të vendoset në majën e maleve.²³ Eksodi i pionierëve mormonë në malet e Amerikës perëndimore është një përmbushje e sagës së sakrificës dhe besimit. Isaia parashikoi gjithashtu se Perëndia do të bëjë “mrekulli dhe çudi”²⁴. Kjo tani po përmbushet nga puna e shenjtë e grupit tonë në rritje të misionarëve.

Mësimet e Dhiatës së Vjetër rreth të dhjetës janë rivendosur.²⁵ Si rezultat, më shumë pagues të së dhjetës janë bekuar për shkak të bindjes së tyre. Përmendjet e Melkizedekut janë sqaruar nga shkrime të shenjta të Rivendosjes.²⁶ Profecitë që druri i Jozefit (Libri i Mormonit) dhe druri i Judës (Bibla) do të jenë një në dorën e Perëndisë, tani janë përmbushur.²⁷

Rivendosja sqaron gjithashtu shkrimet e shenjta të Dhiatës së Re. Referenca e saj për pagëzimin për të vdekurit tani kuptohet më mirë.²⁸

Ordinancat për paraardhësit tanë të vdekur tani kryhen me përfaqësues në 141 tempuj kudo në botë! Nuk ka mënyrë tjetër për të ofruar shpëtim për paraardhësit tanë që vdiqën pa njohuri për ungjillin!²⁹ Vegimi i Gjon Zbuluesit për një “engjëll tjetër [duke fluturuar] në mes të qiellit dhe që kishte ungjillin e përjetshëm, që t’ua predikojë banorëve të dheut”, parashikoi misionin e engjëllit Moroni dhe Librin e Mormonit.³⁰

Libri i Mormonit është pjesa qendrore e Rivendosjes. Ai u shkrua, u ruajt dhe u përhap nën drejtimin e Zotit. Ai u përkthye “me anë të dhuratës dhe fuqisë së Perëndisë”³¹. Libri i Doktrina e Besëlidhjeve përmban shumë zbulesa shtesë dhënë Profetit Jozef Smith. Prej tij, kemi marrë më shumë faqe shkrimi të shenjtë nga sa kemi pasur prej çdo profeti tjetër. Në atë që duhet të ketë qenë një çast i trishtuar, ai u tha shenjtoreve në Navu të Illinoisit: “Kurrë nuk ju thashë se jam i përsosur, por nuk ka gabim në zbulësat që ju kam mësuar”³².

Së bashku, anëtarë dhe misionarë ftojini të gjithë të mësojnë për Perëndinë, për Jezu Krishtin dhe për ungjillin e Tij. Çdo individ i interesuar duhet të kërkojë me zell dhe të lutet me gjithë shpirt për sigurinë që këto gjëra janë të vërteta. E vërteta do të tregohet nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë.³³

Unë falënderoj Perëndinë dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin, për Rivendosjen dhe fuqinë e saj për të çuar përpara një valë vërtetësie dhe drejtësie në mbarë botën. E kapshim këtë valë dhe le të përmbushim urdhrin e Zotit për t’ia çuar ungjillin “çdo kombi dhe fisi, dhe gjuhe, dhe populli”³⁴, lutem unë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Tomas S. Monson, “Mirësevini në Konferencë”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 4–5.
2. Shih 1 Pjetrit 3:15.





Nga Plaku Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

3. Shih Tomas S. Monson, “Është Konferencë Sërisht”, *Liahona*, maj 2011, f. 6.
4. Shih *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 5.1.
5. Ne jemi mirënjohës për shenjtoret që janë duke u përpjekur sinqerisht për t’u shenjtëruar. Ata po përpiqen të jenë më të shenjtë. Ata kërkojnë “para së gjithash . . . të ndërtojnë mbretërinë e Perëndisë dhe të vendosin drejtësinë e tij” (Përkthimi prej Joseph Smith-it, Mateu 6:38 [te Mateu 6:33, shënimi në fund të faqes a]).
6. Shih “Families Can Be Together Forever”, *Hymns*, nr. 300; sqarim shtesë gjendet te Doktrina e Besëlidhje 132:7, 19.
7. Doktrina e Besëlidhje 88:73.
8. Joseph Smith – Historia 1:17.
9. Shih Gjoni 17:3.
10. Shih Moisiu 1:39.
11. Shih Mateu 17:11; Veprat e Apostujve 3:20–21; Efesianëve 1:10; 2 Nefi 30:8; Doktrina e Besëlidhje 132:40, 45.
12. Shih 3 Nefi 27:13–14, 21; Doktrina e Besëlidhje 39:6; Nenet e Besimit 1:4.
13. Shih Karl R. Anderson, *The Savior in Kirtland* (2012), f. 228–243.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 27:5; shih edhe Joseph Smith – Historia 1:33–34.
15. Shih Doktrina e Besëlidhje 13.
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 20:2–3; 27:12; 128:20; shih edhe Larry C. Porter, “Dating the Restoration of the Melchizedek Priesthood”, *Ensign*, qershor 1979, f. 4–10.
17. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:11.
18. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:12.
19. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:13–16.
20. Shih Alma 42, sidomos vargun 8.
21. Shih, për shembull, Alma 12:28–30.
22. Shih, për shembull, 1 Korintasve 15:22; Alma 34:9.
23. Shih Isaia 2:2.
24. Isaia 29:14.
25. Shih Zanafilla 14:18–20; Malakia 3:8–10; Doktrina e Besëlidhje 119–120.
26. Shih Zanafilla 14:18; Psalmeve 110:4; shih edhe Alma 13:14–18; Doktrina e Besëlidhje 84:14–22.
27. Shih Ezekieli 37:16, 19; Doktrina e Besëlidhje 27:5.
28. Shih 1 Korintasve 15:29; Doktrina e Besëlidhje 128.
29. Shih Doktrina e Besëlidhje 137:7; 138:31–34.
30. Zbulesa 14:6; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 133:36–39.
31. Faqja e titullit të Librit të Mormonit, me autorësi nga Moroni; Doktrina e Besëlidhje 135:3.
32. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 556.
33. Shih Moroni 10:4–5.
34. Zbulesa 14:6; shih edhe 1 Nefi 19:17; Doktrina e Besëlidhje 133:37.

Qëndroni të Paepur në Vende të Shenjta

Duke qëndruar të bindur dhe të paepur në doktrinën e Perëndisë tonë, ne qëndrojmë në vende të shenjta, pasi doktrina e Tij është e shenjtë dhe nuk do të ndryshojë.

Vëllezër, është nder të jesh me mbajtës të priftërisë mbretërore të Perëndisë. Ne po jetojmë në ditët e fundit, në “kohë të vështira”¹. Si mbajtës të priftërisë, kemi përgjegjësinë për të qëndruar të paepur, me një mburojë besimi kundër shigjetave të zjarra të kundërshtarit. Ne jemi shembuj për botën, duke mbrojtur të drejtat dhe liritë e patjetërsueshme të dhëna nga Perëndia. Ne qëndrojmë në mbrojtje të shtëpive tona dhe familjeve tona.

Kur isha në vit të parë të shkollës së mesme, u ktheva nga ndeshja ime e parë jashtë qytetit me ekipin e bejsbollit. Babai im e ndjeu se, në udhëtimin e gjatë me autobus për në shtëpi, kisha dëshmuar gjuhë e sjellje që nuk ishte në harmoni me standardet e ungjillit. Duke qenë një artist profesionist, ai u ul dhe pikturoi një kalorës – një luftëtar të zotin për të mbrojtur kështjella e mbretëri.

Teksa vizatoi dhe lexoi nga shkriimet e shenjta, mësova se si të jem një mbajtës besnik i priftërisë – për ta ruajtur dhe mbrojtur mbretërinë e

Perëndisë. Fjalët e Apostullit Pal qenë udhërrëfyesi im:

“Prandaj merreni të gjithë armatimin e Perëndisë, që të mund të rezistoni në ditën e mbrapshtë dhe të *mbeteni më këmbë* pasi t’i keni kryer çdo gjë.

Qëndroni, pra, të fortë, duke patur në ijë brezin e së vërtetës, të veshur me parzmoren e drejtësisë,

dhe duke mbathur këmbët me gatishmërinë e ungjillit të paqes, mbi të gjitha, duke marrë mburojën e besimit, me të cilën mund të shuani të gjitha shigjetat e zjarra të të ligut.

Merrni edhe përkrenaren e shpëtimimit dhe shpatën e Frymës, që është fjala e Perëndisë.”²

Vëllezër, nëse jemi besnikë në priftëri, ky armatim do të na jepet si një dhuratë nga Perëndia. Na nevojitet ky armatim!

Të rinj, etërit dhe gjyshërit tuaj kurrë nuk i hasën tundimet që ju hasni rregullisht. Ju po jetoni në ditët e fundit. Nëse babai juaj donte të futej në telashe, ai duhej të shkonte t’i kërkonte. Jo më! Tani tundimi ju gjen

vetë! Ju lutem, mbajeni mend këtë! Sautani dëshiron t'ju ketë ju dhe "mëkati shtrihet te pragu"³. Si do t'u bëni ballë taktikave të tij sulmuese? Vishni të gjithë armatimin e Perëndisë.

Më lejoni t'ju mësoj nga një përvojë tjetër e jetës sime:

Në janar të 1982–shit, fola në një takim shpirtëror në kompleksin e UBJ-së në Provo të Jutas. I ftova studentët të përfytyronin sikur Kisha të ishte në një rënë anë të podiumit, pikërisht këtu, dhe bota të ishte në anën tjetër, vetëm një ose dy hapa larg. Kjo përfaqësoi "distancën shumë të shkurtër midis vendit ku ishte bota dhe vendit ku ishin standardet e Kishës", kur isha në universitet. Më pas, duke qëndruar përpara studentëve, 30 vjet më vonë, ngrita duart lart në të njëjtën mënyrë dhe shpjegova: "Bota ka shkuar shumë larg; [ka udhëtuar; është atje ku nuk mund të shihet;] ka vazhduar rrugën, shumë larg, tepër larg jashtë kësaj [ndërtese dhe përreth botës]. . . .

Ajo që ne, fëmijët tanë dhe nipërit e mbesat tona duhet të kujtojnë, është se Kisha do të qëndrojë e pandryshueshme, [është ende këtu; sidoqoftë] bota do të vazhdojë të ecë – ai hendek po [bëhet] gjithmonë e më i gjerë. . . . Prandaj, jini shumë të kujdesshëm. Nëse i gjykoni veprimet tuaja dhe standardet e Kishës mbi bazën e vendit ku ndodhet bota dhe ku po shkon ajo, do të zbuloni se nuk jeni atje ku duhet të jini."⁴

Në atë kohë nuk mund ta kisha imagjinuar se sa larg dhe sa shpejt bota do të largohej nga Perëndia; ishte e pamundur ta kuptoja atë, duke pasur parasysh doktrinën, parimet dhe urdhërimet. Dhe akoma standardet e Krishtit dhe Kisha e Tij nuk kanë lëvizur. Sikurse Ai tha: "E vërteta qëndron gjithmonë e përgjithmonë"⁵. Kur e kuptojmë dhe e pranojmë këtë, ne jemi të përgatitur t'i bëjmë ballë



presionit shoqëror, talljes dhe madje diskriminimit që do të vijë nga bota dhe disa që e quajnë veten miq.

Shumë prej nesh njohin dikë që do të thoshte: "Nëse do që të jesh miku im, do të duhet t'i pranosh vlerat e mia". Një mik i vërtetë nuk na kërkon që të zgjedhim midis ungjillit dhe miqësisë së tij apo të saj. Duke përdorur fjalët e Palit përgjigjem: "Nga këta largohu"⁶. Një mik i vërtetë na forcon që të qëndrojmë në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar.

Të qëndruarit në shtegun e besëlidhjeve, urdhërimeve dhe ordiancave të ungjillit na mbron dhe na përgatit për të bërë punën e Perëndisë në këtë botë. Kur i bindemi Fjalës së Urtësisë, liria jonë e zgjedhjes mbrohet nga varësitë ndaj substancave të tilla si: alkooli, drogat dhe duhani. Kur paguajmë të dhjetën, i studiojmë shkrimet e shenjta, marrim pagëzimin

dhe konfirmimin, jetojmë për shoqërimin e vazhdueshëm të Frymës së Shenjtë, marrim sakramentin denjësisht, mbajmë ligjin e dëlirësisë, përgatitemi për Priftërinë Melkizedeke dhe e marrim atë, dhe bëjmë besëlidhje të shenjta të tempullit, atëherë ne përgatitemi të shërbejmë.

Në tempull, ne përgatitemi dhe premtojmë ta jetojmë ligjin e përkushtimit. Të rinjtë e aftë fillojnë ta jetojnë këtë ligj duke kërkuar një thirrje për mision – duke dhënë të dhjetën e viteve të para të jetës së tyre në shërbimin kohëplotë të Zotit. Kjo sakrificë i forcon ata që të ecin përpara drejt besëlidhjes më të lartë në jetë – për shumë njerëz, kjo ka të bëjë me vulosjen në tempull dhe fillimin e një familjeje të përjetshme.

Ndërsa ecim përpara, përgjatë shtegut të ngushtë dhe të ngushtuar, ne krijojmë forcë shpirtërore rritëse

– forcë në përdorimin e lirisë sonë të zgjedhjes për të vepruar për veten. Si për të rinjtë edhe të rejtat, kjo rritje ndihmohet kur ata mësojnë doktrinën dhe ndajnë dëshmitë e tyre përmes programit të ri mësimor në internet, *Come, Follow Me [Ejani, Më Ndiqni]*.

Përveç kësaj, përdoreni lirinë tuaj të zgjedhjes për t’u zhvilluar personalisht. Ndërsa i zbuloni dhuratat dhe talentet tuaja, kujtoni se prindërit dhe mësuesit mund t’ju ndihmojnë, por ju duhet ta lejoni Shpirtin t’ju udhëheqë. Zgjidhni dhe veproni për veten. Gjeneroni nxitje brenda vetes. Bëni një plan për jetën tuaj, përfshirë arsimin ose trajnimin profesional. Zbuloni interesa dhe aftësi. Punoni dhe bëhuni të mbështetur te vetja. Caktoni qëllime, mposhtini gabimet, fitoni përvojë dhe përfundojeni atë që filloni.

Përgjatë rrugës, sigurohuni që të merrni pjesë në aktivitetet e familjes,

të kuorumit, të orëve mësimore dhe ato të përbashkëta me Të Rejat. Gëzohuni së bashku në argëtime të shëndosha. Përmes këtyre përvojave, ju do të arrini t’i respektoni e vlerësoni dhuratat shpirtërore të njëri-tjetrit dhe karakteret e përjetshme dhe plotësuese të bijve e bijave të Perëndisë.

Mbi të gjitha, kini besim te Shpëtimtari! Mos druani! Ndërsa e jetojmë ungjillin me zell, ne forcohemi në Zotin. Me forcën e Tij, ne jemi në gjendje të refuzojmë anti-Krishtin që thotë: “Hani, pini dhe dëfrohuni”, pasi Perëndia “do [t’]ju justifikojë në bërjen e një mëkati të vogël; . . . nuk ka gjë të keqe në këtë . . . , pasi nesër ne vdesim.”⁷ Me forcën e Zotit ne jemi në gjendje të qëndrojmë kundër çdo filozofie apo kredoje që mohon Shpëtimtarin dhe kundërshton planin e madh dhe të përjetshëm të lumturisë për të gjithë fëmijët e Perëndisë.



Ne nuk autorizohemi t’i diskutojmë kushtet e atij plani të përjetshëm. Kujtoni Nehemian, i cili u ngarkua me detyrën për të ndërtuar një mur për mbrojtjen e Jerusalemit. Disa donin që ai të zbriste e të bënte kompromis për qëndrimin e tij, por Nehemia nuk pranoi. Ai nuk ishte mospranues ndaj të tjerëve; ai thjesht shpjegoi: “Jam duke bërë një punë të madhe dhe nuk mund të zbres. Pse duhet ta ndërprisim punën . . . ?”⁸

Ndonjëherë ne bëhemi rrufepritisja dhe duhet “ta durojmë nxehtësinë” e të mbajturit fort te standardet e Perëndisë dhe të bërjes së punës së Tij. Dëshmoj se nuk kemi përse të kemi frikë nëse ngulemi fort në doktrinën e Tij. Ne mund të provojmë keqkuptime, kritika dhe madje akuza të rreme, por nuk jemi asnjëherë të vetëm. Shpëtimtari ynë ishte “i përbuzur dhe i braktisur nga njerëzit”⁹. Është privilegji ynë i shenjtë të qëndrojmë me Të!

Si për ironi, të qëndrosh i paepur ndonjëherë do të thotë t’i shmangesh botës dhe madje të largohesh nga ajo. Shpëtimtari shpalli: “Largohu prej meje, Satana”¹⁰. Jozefi i Egjiptit u largua nga tundimet e gruas së Potifarit¹¹, dhe Lehi la pas Jerusalemin dhe e çoi familjen e tij në vendin e shkretët¹².

Të jini të sigurt se të gjithë profetët para nesh qëndruan të paepur në kohën e tyre:

Nefi e kreu punën e rrallë të Zotit, pavarësisht nga goditjet e Satanit dhe përndjekjet e Lamanit dhe Lemuelit, vëllezërve të tij.¹³

Abinadi dëshmoi për Krishtin kur u ndodh përballë mosbesimit, poshtërimet dhe vdekjes së sigurt.¹⁴

2.000 luftëtarët e rinj i mbrojtën familjet e tyre ndaj atyre që i përçmuan vlerat e ungjillit.¹⁵

Moroni ngriti titullin e lirisë për t’i ruajtur familjet e popullit të tij dhe lirinë fetare.¹⁶

Samueli qëndroi mbi një mur dhe profetizoi për ardhjen e Krishtit, edhe kur gurë e shigjeta po e sulmonin atë.¹⁷

Profeti Jozef Smith e rivendosi ungjillin e Shpëtimtarit, duke e vulosur dëshminë e tij me gjakun e vet.¹⁸

Dhe pionierët mormonë qëndruan të paepur përballë kundërshtimit dhe vuajtjeve përçmuese, duke ndjekur një profet në udhëtimin e tyre të gjatë dhe në vendosjen në perëndim.

Këta shërbëtorë të mëdhenj dhe shenjtorë të Perëndisë qenë në gjendje të qëndronin të paepur, sepse qëndruan me Shpëtimtarin. Merrni parasysh se si Shpëtimtari qëndroi i paepur:

Si djalë i ri, Jezusi me besnikëri u mor me punët e Atit të Tij, duke u predikuar ungjillin dijetarëve në tempull.¹⁹ Gjatë gjithë shërbesës së Tij, Ai përmbushi punën e priftërisë – duke dhënë mësim, duke shëruar, duke shërbyer dhe duke bekuar e lartësuar të tjerët. Kur qe e përshtatshme, Ai qëndroi me guxim përballë së ligës, madje duke pastruar tempullin.²⁰ Dhe gjithashtu qëndroi për të vërtetën – qoftë me fjalë ose me heshtje dinjitoze. Kur krerët e priftërinjve e akuzuan përpara Kajafës, Jezusi me urtësi dhe me guxim refuzoi t'i përgjigjej gënjeshtres dhe ruajti paqen e Tij.²¹

Në Kopshtin e Gjetsemanit, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë nuk u mpak kur piu kupën e hidhur të Shlyerjes.²² Dhe në kryq vuajti sërish për të bërë vullnetin e Atit të Tij, derisa më në fund mund të thoshte: “U krye!”²³ Ai duroi deri në fund. Si përgjigje ndaj bindjes së përsosur të Shpëtimtarit për të qëndruar i paepur, Ati ynë Qiellor shpalli: “Vini re Birin tim të Dashur, në të cilin unë jam shumë i kënaqur, në të cilin unë kam lartësuar emrin tim”²⁴.



Vëllezërit e mi të dashur të priftërisë, të rinj dhe të moshuar, le ta përlëvdojmë emrin e Perëndisë duke qëndruar të paepur me Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Jap dëshminë time të veçantë se Ai jeton dhe se ne “thirr[emi] me një thirrje të shenjtë”²⁵ për të marrë pjesë në punën e Tij. “Prandaj, qëndroni në vende të shenjta dhe mos lëvizni.”²⁶ Duke qëndruar të bindur dhe të paepur në doktrinën e Perëndisë tonë, ne qëndrojmë në vende të shenjta, pasi doktrina e Tij është e shenjtë dhe nuk do të ndryshojë për shkak të erërave shoqërore e politike të kohës sonë. Unë shpall, sikurse shpalli Apostulli Pal: “Rrini zgjuar, qëndroni të palëkundshëm në besim, silluni si burrat, [dhe] jini të fortë”²⁷. Kjo është lutja ime e zjarrtë për ju, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 2 Timoteut 3:1.

2. Efesianëve 6:13–17; theksimi i shtuar.

3. Moisiu 5:23.

4. Robert D. Hales, “This Is the Way; and There Is None Other Way”, në *Brigham Young University 1981–1982 Speeches* (1982), f. 3–4; të disponueshme në speeches.byu.edu.

5. Doktrina e Besëlidhje 1:39; theksimi i shtuar.

6. 2 Timoteut 3:5.

7. 2 Nefi 28:8.

8. Nehemia 6:3.

9. Isaia 53:3; Mosia 14:3.

10. Lluca 4:8.

11. Shih Zanafilla 39:7–12.

12. Shih 1 Nefi 2.

13. Shih, për shembull, 1 Nefi 18.

14. Shih Mosia 11–17.

15. Shih Alma 53, 56–58.

16. Shih Alma 46:11–13.

17. Shih Helamani 13–16.

18. Shih Doktrina e Besëlidhje 135.

19. Shih Lluca 2:46–49.

20. Shih Mateu 21:12–13.

21. Shih Mateu 26:57, 59–63.

22. Shih Doktrina e Besëlidhje 19:16–19.

23. Gjoni 19:30.

24. 3 Nefi 11:7.

25. Alma 13:3; shih edhe 2 Timoteut 1:9.

26. Doktrina e Besëlidhje 87:8.

27. 1 Korintasve 16:13.



Nga Plaku Ted R. Kelister,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Fuqia e Priftërisë te një Djalë

Priftëria te djali është po aq e fuqishme sa edhe priftëria te burri, kur ushtrohet me drejtësi.


Në vitin 1878 stërgjyshi im, Xhorxh F. Riçards ishte 17 vjeç. Sikurse ishte ndonjëherë rasti në ato kohë, ai ishte shuguruar tashmë një plak. Një të diel, nëna e tij po rënkonte nga dhembja e shumë. Ngaqë babai i tij nuk ishte i prani-shëm, peshkopi dhe disa të tjerë u ftuan t'i jepnin asaj një bekim, por nuk i erdhi asnjë lehtësim. Si rrjedhim, ajo iu drejtua të birit, Xhorxhit, dhe i kërkoi atij t'ia vinte duart mbi kokë. Ai shkroi në ditarin e tij: "Ndërmjet lotëve për vuajtjen e nënës sime dhe detyrës për të kryer një administrim të tillë që nuk e kisha bërë kurrë më parë, unë shkova në një dhomë tjetër ku vajtova dhe u luta".

Kur e mblodhi veten, i vuri duart mbi të dhe i dha asaj një bekim shumë të thjeshtë. Më vonë ai shkroi: "Nëna ime pushoi së rënkuari dhe mori lehtësim nga dhembja, ndërkohë që duart e mia ishin ende mbi kokën e saj". Më pasi ai shënoi në ditarin e tij këtë vëzhgim tepër kuptimplotë. Ai tha se gjithmonë kishte ndier që, arsyjeja përse nëna e tij nuk pati lehtësim nga bekimi i peshkopit, nuk ishte ngaqë Zoti nuk e kishte nderuar bekimin e peshkopit, por ngaqë Zoti e

kishte ruajtur këtë bekim për një djalë, për t'i dhënë atij një mësim se priftëria e djalit është po aq e fuqishme sa edhe priftëria e burrit, kur ushtrohet me drejtësi.

Sonte do të doja të flisja për atë fuqi. Edhe pse do t'ju drejtohem presidentëve të kuorumeve të dhjakëve, parimet e diskutuara zbatohen për të gjithë të rinjtë e Priftërisë Aarone dhe udhëheqësit përkatës të tyre, duke përfshirë presidentët e kuorumeve të mësuesve dhe ndihmësit e presidentëve të kuorumeve të priftërinjve.

Ndërsa shërbeja si president misioni, vëzhgova se pati një rritje befasuese në shpirtmërinë dhe aftësitë udhëheqëse të të rinjve gjatë viteve të tyre të misionit. Nëse, në një farë mënyre, mund t'i rrisim këto aftësi gjatë viteve të Priftërisë Aarone dhe të misioneve të



Shpirtshmëria dhe Udhëheqja

tyre, ndoshta ajo llogaritje do të duken diçka si kjo vijë blu që që shihni në këtë grafik. Mendoj se ka të paktën tre faktorë kyç që luajnë rol në një rritje të tillë befasuese në vitet e misionit: 1) ne u mirëbesojmë këtyre të rinjve si kurrë më parë, 2) ne presim shumë më tepër prej tyre, por edhe i duam më shumë, dhe 3) ne i mësojmë ata vazhdimisht, që ta përmbushin çfarë pritet prej tyre në mënyrë të shkëlqyer.

Dikush mund të pyesë me vend: "Përse nuk mund të zbatohen këto parime të njëjta me presidentët e kuorumeve të dhjakëve?" Nëse do të bëhej ajo, ndoshta rritja do të fillonte shumë më parë dhe do të dukej më shumë si 'vija e gjelbër në grafik'. Për një çast, më lejoni të flas për mënyrën se si këto parime mund të vihen në jetë për një president të kuorunit të dhjakëve.

Së pari – mirëbesimi. Ne mund t'iu mirëbesojmë përgjegjësi të madhe presidentëve tanë të kuorumeve të dhjakëve. Zoti sigurisht që u beson – siç tregohet prej gatishmërisë së Tij për t'u dhënë atyre çelësa, domethënë të drejtën për të kryesuar mbi kuorumin e tyre dhe për ta drejtuar punën në kuorum. Si provë e këtij mirëbesimi, ne i thërrasim presidentët e kuorumeve të dhjakëve me anë të zbulesës, jo thjesht duke u bazuar në kohëzgjatjen e të qenit në kuorum apo ndonjë faktor tjetër të ngjashëm. Çdo udhëheqës në këtë Kishë, duke përfshirë presidentët e kuorumeve të dhjakëve, ka të drejtën ta dijë, dhe duhet ta dijë, se ai është thirrur me anë të zbulesës. Kjo siguri e ndihmon atë të dijë se Perëndia ka mirëbesim tek ai dhe po ashtu e mbështet atë.

Aftësia e dytë dhe e tretë ndërthuren – gjërat e mëdha që priten prej tyre dhe trajnimi përkatës për t'i përmbushur ato. Mësova një mësim të rëndësishëm në fushën e misionit:

misionarët në përgjithësi ngrihen ose bien në nivelin që pret presidenti i misionit dhe po kështu është me presidentët e kuorumeve të dhjakëve. Nëse prej tyre pritet vetëm të kryesojnë mbledhje kuorumesh dhe të marrin pjesë në mbledhjet e komitetit të rinisë me peshkopatën, atëherë ajo është gjithçka që do të bëjnë. Por ju udhëheqës mund t'iu jepni një largpamësi më të madhe – largpamësinë e Zotit. Dhe përse është largpamësia kaq vendimtare? Sepse nëpërmjet rritjes së largpamësisë rritet edhe nxitja.

E pandarë nga çdo thirrje në këtë Kishë është e drejta për të marrë zbuluesë. Prandaj, këta presidentë të kuorumeve të dhjakëve kanë nevojë të dinë se kanë të drejtën të marrin zbuluesë për t'i rekomanduar këshilltarët e tyre, të drejtën për të marrë zbuluesë për të shpëtuar të humburit dhe të drejtën për të marrë zbuluesë që t'i trajtojnë anëtarët e kuorumit në detyrat e tyre.

Një udhëheqës i urtë do t'ia mësojë presidentit të kuorumit të dhjakëve ato parime që do të jenë të dobishme për marrjen e zbuluesës. Ai mund t'ia mësojë atij premtimin tërësisht të qartë të Zotit: “Në qoftë se do të kërkosh, ti do të marrësh zbuluesë pas zbuluese” (DeB 42:61). Zoti është tepër zemërgjerë në dhënien e zbuluesës. A nuk ua kujtoi Ai Jozefit dhe Oliverit: “Sa shpesh që ti ke




kërkuar, ke marrë udhëzim nga Shpirti im” (DeB 6:14)? Dhe kështu mund të jetë me ju presidentë të kuorumeve të dhjakëve. Zoti ju do dhe dëshiron t'ju zbulojë mendjen dhe vullnetin e Tij. A mund ta përfytyronit ndonjëherë Zotin të kishte një problem që Ai nuk mund ta zgjidhte? Unë s'mundem. Ngaqë ju autorizoheni për të marrë zbuluesë, Ai mund t'ju ndihmojë të zgjidhni çdo shqetësim që keni si president i kuorumit tuaj, nëse ju thjesht do ta kërkoni ndihmën e Tij.

Ju udhëheqës të mrekullueshëm mund t'ia mësoni këtij presidenti të kuorumit të dhjakëve se zbuluesia nuk është një zëvendësues i punës së zellshme dhe i përpjekjes vetjake. Presidenti Henri B. Ajring njëherë e pyeti Presidentin Harold B. Li: “Si e marr unë zbuluesën?” Presidenti Li u përgjigj: “Nëse dëshiron të marrësh zbuluesë, bëj përpjekjen tënde vetjake”¹. Udhëheqësi i urtë mund t'ia diskutojë me presidentin e tij të kuorumit të dhjakëve disa nga përpjekjet shpirtërore vetjake që ai mund të bëjë gjatë përgatitjes për t'ia rekomanduar këshilltarët e tij. Atij mund t'ia duhet të bëjë dhe t'ua përgjigjet pyetjeve të tilla si: Kush do të ishte një shembull i mirë që mund t'ia frymëzonte djemtë e tjerë? Ose kush mund të ishte i ndjeshëm ndaj nevojave të atyre që hasin sfida të veçanta?

Dhe së fundi, ky udhëheqës i urtë mund t'ia mësojë atij se si ta dallojë

zbuluesën dhe të veprojë sipas saj, kur vjen ajo. Ne jetojmë në një botë të mbushur me veprim të shpejtë, plot emocion, ku dritat e shkëlqyeshme dhe altoparantët me zë të lartë janë të zakonshëm. Por ky i ri ka nevojë të dijë se kjo është mënyra e botës, jo mënyra e Zotit. Shpëtimtari u lind në një vend të panjohur pothuajse nga askush, në një grazhd; Ai e kreu veprimin më të madhërishtë dhe më të pashoq të të gjithë kohës në qetësinë e një kopshti; dhe Jozefi e mori Vegimin e tij të Parë në fshehtësinë e një korijeje. Përgjigjet e Perëndisë vijnë me anë të zërit të qetë, të vogël – ndjenjave të paqes ose ngushëllimit, nxitjeve për të bërë mirë, ndriçimit të mendjes – nganjëherë në formën e farave të vogla të mendimeve që, nëse nderohen dhe ushqehen, mund të rriten në lisa gjigandë shpirtërore. Nganjëherë këto nxitje ose mendime edhe mund t'ju bëjnë ju, presidentë të kuorumeve të dhjakëve, të rekomandoni si këshilltar një të ri që tani për tani është më pak aktiv ose t'ia jepni një detyrë atij.

Vite më parë kur shërbeja në një presidencë kunji, ne patëm mbresën të thërrisim një burrë të mirë në detyrën e nëpunësit të kunjit. Në atë kohë, ai përkohësisht po haste vështirësi me ardhjen e rregullt në Kishë. Ne e dinim, megjithatë, se po ta pranonte thirrjen, ai do të bënte një punë të mrekullueshme.





Ne ia parashtruam thirrjen, por ai u përgjigj: “Jo, nuk mendoj se mund ta bëj”.

Atëherë më erdhi një mbresë.

Thashë: “Pra, mendoj, kunji i Glendejllit nuk do të ketë një nëpunës kunji atëherë”.

I habitur, ai u përgjigj: “Çfarë po thoni? Ju duhet të keni një nëpunës kunji”.

Unë u përgjigja: “A dëshiron që ne tani të thërrasim dikë tjetër për të shërbyer si nëpunës i kunjit, ndëkohë që Zoti na nxiti të të thërrasim ty?”

“Në rregull”, tha ai, “do ta bëj”.

Dhe vërtet e bëri. Nuk ka vetëm shumë burra, por edhe shumë djem, të cilët do t’i përgjigjen një thirrjeje kur e dinë se Zoti po i thërret ata dhe se Zoti ka nevojë për ta.

Më pas, ju mund t’i mësoni këtë presidenti të kuorumit të dhjakëve se një nga gjërat që Zoti pret prej tij, është të shpëtojë ata që kanë humbur, si anëtarët më pak aktivë edhe joanëtarët. Zoti e shpalli misionin e Tij qendror me këto fjalë: “Sepse Biri i njeriut erdhi për të shpëtuar atë që qe humbur” (Mateu 18:11). Nëse është përparësi për Shpëtimtarin që ta shpëtojë atë që qe humbur, nëse është përparësi për Presidentin Tomas S. Monson që ta bëjë këtë, sikurse vihet në dukje nga tërë jeta e tij, a nuk duhet të jetë përparësi për çdo udhëheqës, për çdo president të kuorumit të dhjakëve në këtë Kishë që të bëjnë të njëjtën gjë? Në thelb të udhëheqjes sonë, si pjesë qendrore e shërbesës sonë, duhet të jetë vendosmëria e zellshme, nxitëse, e vazhdueshme

për të shkuar tek ata që kanë humbur dhe për t’i kthyer mes nesh.

Një i ri, që u vizitua prej anëtarëve të kuorumit të tij, tha: “Ishte habi sot kur . . . 30 vetë më erdhën në shtëpi. . . . Më bënë të kem dëshirë të shkoj në kishë tani.” Si mund ta kundërshtojë një i ri një dashuri dhe vëmendje të tillë?

Emocionohem kur dëgjoj shumë tregime për presidentë të kuorumeve të dhjakëve, të cilët e kanë fituar largpamësinë dhe sipas rastit po japin mësim të plota ose të pjesshme në mbledhjet e kuorumeve të tyre. Disa javë më parë, mora pjesë në një klasë të kuorumit të dhjakëve. Një djalë 12-vjeçar zhvilloi për 25 minuta një mësim lidhur me Shlyerjen. Ai filloi duke i pyetur dhjakët e tjerë se çfarë mendonin që ishte Shlyerja. Më pas lexoi disa shkrime të shenja domethënëse dhe bëri pyetje kuptimplota, të cilave ata iu dhanë përgjigje. Megjithatë, duke vërejtur se kishte më shumë kohë se sa pjesa e mbetur e materialit të mësimin, ai pati mjaft urtësi dhe ndoshta një farë udhëzimi nga babai i tij, që t’u kërkonte udhëheqësve që ishin të pranishëm, se çfarë pyetjesh u ishin bërë rreth Shlyerjes kur ishin në misione dhe si u ishin përgjigjur atyre. Ai më pas e përfundoi me dëshminë e tij. Dëgjova plot habi. Mendova: “Nuk më kujtohet ndonjëherë të kisha dhënë mësim për një pjesë të rëndësishme të mësimin, kur isha një i ri i Priftërisë Aarone”. Ne mund ta rrisim atë që presim nga këta të rinj dhe largpamësinë e tyre, dhe ata do të përgjigjen.

Ju udhëheqës i nxisni më mirë këta presidentë të kuorumeve të dhjakëve kur i lejon të drejtojnë dhe ju bëni një hap prapa nga qendra e vëmendjes. Ju e lartësoni thirrjen tuaj më mirë, jo kur jepni një mësim të mrekullueshëm, por kur i ndihmoni ata të japin një mësim të mrekullueshëm, jo kur shpëtoni dikë, por kur i ndihmoni ata ta shpëtojnë atë.

Ekziston një thënie e vjetër: mos vdis me peng në shpirt. Në mënyrë të ngjashme, do t’ju thoja juve, udhëheqës të rritur, mos u lironi nga një detyrë pa i përdorur tërësisht aftësitë tuaja udhëheqëse. I jepni mësim rinisë sonë në çdo rast të mundshëm; u mësoni atyre se si të përgatisin një plan për mbledhjen, se si t’i drejtojnë mbledhjet me dinjitet dhe dashamirësi, se si ta shpëtojnë dikë, se si të përgatiten e të japim një mësim frymëzues dhe se si të marrin zbulësë. Kjo do të jetë mënyra e matjes së suksesit tuaj – trashëgimia e udhëheqjes dhe e shpirtmërisë që i lini të rrënosura në zemrën dhe mendjen e këtyre të rinjve.

Nëse ju presidentë të kuorumeve të dhjakëve do ta lartësoni thirrjen tuaj, ju do të jeni mjete në duart e Perëndisë që tani, pasi priftëria te djali është po aq e fuqishme sa edhe priftëria te burri, kur ajo ushtrohet me drejtësi. Dhe atëherë, kur të bëni besëlidhje tempulli dhe të bëheni misionarë dhe udhëheqës të ardhshëm të kësaj Kise, ju do të dini se si të merrni zbulësë, se si ta shpëtoni dikë dhe se si të jepni mësim për doktrinën e mbretërisë me fuqi dhe autoritet. Atëherë, ju do të jeni bërë rinia e lindjes fisnike. Për këtë unë kështu dëshmoj në emrin e Jezu Krishtit, që është Shpëtimtari dhe Shëlbuesi i botës, amen. ■

SHËNIM

1. Në Henry B. Eyring, “Waiting upon the Lord”, në *Brigham Young University 1990–1991 Devotional and Fireside Speeches* (1991), f. 17.



Nga Dejvid L. Bek,
President i Përgjithshëm i Të Rinjve

Detyra Juaj e Shenjtë për të Shërbyer

Ju e morët fuqinë, autoritetin dhe detyrën e shenjtë për të shërbyer në çastin që u shuguruar në priftëri.

Gëzimi i Shërbesës

Të rinj të Priftërisë Aarone, ju jeni bij të dashur të Perëndisë dhe Ai ka një punë të madhërishtme për ju që ta kryeni. Për ta përmbushur këtë punë, ju duhet të plotësoni detyrën tuaj të shenjtë për t'u shërbyer të tjerëve.¹

A e dini se çfarë do të thotë të shërbesh? Mendoni rreth kësaj pyetjeje ndërsa ju tregoj rreth një vajze të quajtur Shai Xhonson.

Vitin e kaluar, kur Shai filloi shkollën e mesme, ajo qe viktimë e një kërcënimi mizor e të pamend. Ajo u keqtrajtua, u shty dhe u përqesh kur ecte për në klasë – disa studentë madje i hodhën plehra. Ndoshta edhe ju keni parë njerëz të keqtrajtohen kështu në shkollën tuaj.

Për një numër të madh njerëzish, vitet e adoleshencës janë kohë vetmie dhe frike. Nuk ka pse të jetë kështu. Fatmirësisht për Shain, kishte të rinj në shkollën e saj që e kuptuan se çfarë do të thotë të shërbesh.

Nëna e Shait u kishte kërkuar mësuesve në shkollë që të ndihmonin në ndalimin e kërcënimit, por ai vazhdoi. Atëherë ajo u lidh me Karson Xhonsin, një mbajtës të Priftërisë Aarone dhe organizatorin e lojës në skuadrën e

futbollit amerikan. Ajo i kërkoi atij ta ndihmonte që të gjente se kush po i bënte kërcënimet.

Karsoni pranoi ta ndihmonte, por në zemrën e tij ndjeu se mund të bënte shumë më tepër sesa thjesht të gjente kërcënuesit. Shpirti i pëshpëriti që ai duhej ta ndihmonte Shain të ndiente se e donin.

Karsoni u kërkoi disa prej shokëve të tij të skuadrës të bashkoheshin me të për t'i shërbyer Shait. Ata e ftuan që të ulej me ta gjatë drekës. Ata ecën me të

drejt klasës për t'u siguruar që ishte e sigurt. Nuk është çudi që, me lojtarët e futbollit amerikan si miqtë e saj të ngushtë, asnjë nuk e kërcënoi më Shain.


Ky qe një sezon emocionues për skuadrën e futbollit. Por edhe me ethet e një sezoni pa asnjë humbje, këta të rinj nuk e harruan Shain. Ata e ftuan që, pas lojërave, të bashkohej me skuadrën në fushë. Shai ndiente se e donin dhe e vlerësonin. Ajo ndihej e sigurt. Ajo ishte e gëzuar.

Skuadra e futbollit arriti të fitonte kampionatin shtetëror. Por diçka më e rëndësishme se një kampionat futbollit amerikan ndodhi në shkollën e tyre. Shembulli i këtyre të rinjve kishte motivuar studentë të tjerë që të ishin më pranues, më miqësorë. Tani ata e trajtojnë njëri-tjetrin me më shumë dashamirësi dhe respekt.

Mediat e lajmeve kombëtare zbuluan se çfarë kishin bërë këta të rinj dhe e treguan historinë e tyre anembanë vendit. Ajo që filloi si përpjekje për t'i shërbyer një njeriu, po frymëzon mijëra të tjerë që të bëjnë të njëjtën gjë.

Nëna e Shait i quan këta të rinj “engjëj të maskuar”. Karsoni dhe





miqtë e tij nxitojnë të thonë se Shai e ka bekuar jetën e tyre shumë më tepër se e bekuan ata jetën e t'i. Kjo është ajo që ndodh kur e humbisni veten në shërbesën ndaj të tjerëve – ju e gjeni vetveten.² Ju ndryshoni dhe rriteni në mënyra që në të kundërt do të ishin të pamundura. Këta të rinj kanë përjetuar gëzimin e të shërbyerit të tjerëve dhe vazhdojnë të kërkojnë mundësi për t'i bekuar të tjerët. Ata mezi presin ta shtojnë shërbesën e tyre në muajt e ardhshëm kur të shërbejnë si misionarë kohëplotë.³

Një Nevojë dhe Detyrë

Ka mijëra si Shai Xhonson kudo nëpër botë – njerëz që kanë nevojë të ndiejnë dashurinë e Atit Qiellor. Ata janë në shkollat tuaja, në kuorumet tuaja dhe madje në familjen tuaj. Disa njerëz ju vijnë në mendje shpejt. Të tjerë kanë nevoja që janë më pak të dukshme. Praktikisht, çdokush që njihni, mund të bekohet në ndonjë

mënyrë nga shërbesa juaj. Zoti pret nga ju që t'u afroheni atyre.

Nuk duhet të jeni një yll i atletikës për t'u shërbyer të tjerëve. Ju e morët fuqinë, autoritetin dhe detyrën e shenjtë për të shërbyer në çastin që u shuguruan në priftëri. Presidenti Xhejms E. Faust dha mësim: “Priftëria është autoriteti i deleguar njeriut për të shërbyer në emër të Perëndisë”⁴. Priftëria Aarone mban çelësat e shërbesës së engjëjve.⁵

Ndërsa i doni fëmijët e Tij, Ati Qiellor do t'ju drejtojë dhe engjëjt do t'ju ndihmojnë.⁶ Do t'ju jepet fuqi për të bekuar jetë dhe për të shpëtuar shpirta.

Jezu Krishti është shembulli juaj. Ai “nuk erdhi që t'i shërbejnë, por për të shërbyer”⁷. Të shërbesh do të thotë t'i duash të tjerët e të kujdesesh për ta. Do të thotë t'u përgjigjesh nevojave të tyre fizike dhe shpirtërore. E thënë thjesht, do të thotë të bësh atë që Shpëtimtari do të bënte po të ishte këtu.

Familja Juaj

Filloni në vetë shtëpinë tuaj. Ai është vendi ku mund të bëni shërbesën tuaj më të rëndësishme.⁸

A dëshironi të provoni një eksperiment interesant? Herën tjetër që mamaja do t'ju kërkojë ndihmë nëpër shtëpi, thoni diçka të tillë si: “Faleminderit që kërrove [ndihmë] nga unë, Mami. Do të më pëlqente shumë të ndihmoja.” Pastaj vështroni reagimin e saj. Disave prej jush mund t'ju duhet t'i rifreskoni aftësitë tuaja të dhënies së ndihmës së shpejtë përpara se ta provoni këtë. Mund ta çoni në gjendje shoku mamanë. Pasi ta sillni në vete, do të vini re një përmirësim të dukshëm të marrëdhënies suaj me të dhe një shtim të Shpirtit në shtëpinë tuaj.

Kjo është vetëm një mënyrë për t'i shërbyer familjes suaj; ka shumë të tjera. Ju shërbeni, ndërsa u shprehni fjalë të dashura anëtarëve të familjes. Ju shërbeni, kur i trajtoni vëllezërit e motrat tuaja si miqtë tuaj më të mirë.

Ndoshta më e rëndësishmja, ju shërbeni ndërsa e ndihmoni babanë tuaj në detyrat e tij si udhëheqësi shpirtëror në shtëpinë tuaj. Jepni mbështetjen dhe inkurajimin tuaj të plotë ndaj mbrëmjes familjare, lutjes familjare dhe studimit familjar të shkrimeve të shenjta. Përmbusheni rolin tuaj për të siguruar që Shpirti është i pranishëm në shtëpinë tuaj. Kjo do ta forcojë babanë tuaj në rolin e tij dhe do t'ju përgatisë që të jeni baba një ditë. Nëse nuk keni baba në shtëpinë tuaj, përgjegjësia juaj për t'i shërbyer familjes suaj është edhe më e nevojshme.

Kuorumi Juaj

Ju gjithashtu keni detyrë të shërbeni në kuorumin tuaj.

Priftëria po përhapet anembanë botës. Shumë prej jush po i binden thirrjes së Presidentit Monson për të shpëtuar [të tjerët]. Ka më shumë

mbajtës aktivë të Priftërisë Aarone sot, sesa ndonjëherë më parë në historinë e Kishës. Prapëseprapë, ka ende nga ata që nuk janë aktivë dhe që kanë nevojë për ju.

Qershorin e kaluar, kur u krijua një degë e re në Bangalor të Indisë, i vetmi i ri në mbledhjen e priftërisë që një dhjak i shuguruar së fundmi, i quajtur Gleduin.

Gleduini, së bashku me presidentin e Të Rinjve dhe presidentin e degës, filloi t'u telefononte të rinjve më pak aktivë dhe t'u shkonte për vizitë në shtëpi. Shpejt, një i ri i dytë, Samueli, filloi të vinte përsëri në kishë.

Çdo javë, Gleduini dhe Samueli u telefononin atyre që nuk e kishin ndjekur mbledhjen e kuorumit dhe u tregonin se çfarë kishin mësuar. Ata gjithashtu u telefononin ose i vizitonin në ditën e tyre të ditëlindjes. Një nga një, të rinjtë më pak aktivë u bënë miqtë e tyre dhe filluan të pranonin ftesa për të ardhur në aktivitetet e kuorumit, për të ndjekur mbledhjet e kuorumit dhe së fundmi për të bërë shërbesë vetjake. Sot, të gjithë të rinjtë në degë janë aktivë në Kishë.

Shkrimet e shenjta na mësojnë se kuorumet e Priftërisë Aarone duhet të ulen në këshill dhe ta lartësojnë – ose ta ndërtojnë e forcojnë – njëri-tjetrin.⁹ Ju lartësoheni ndërsa jepni mësim të vërtetë e ungjillit, tregoni përvoja shpirtërore dhe jepni dëshmi. Programi mësimor për rininë i nxit këto lloj ndërveprimesh në mbledhjet e kuorumit, por kjo mund të ndodhë vetëm kur çdo anëtar i kuorumit ndien se e duan dhe e respektojnë. Tallja dhe ngacmimi nuk kanë vend në një mbledhje të kuorumit – veçanërisht kur ndjenjat shprehen haptazi. Presidentat e kuorumeve duhet të udhëheqin për të siguruar që mbledhjet e kuorumit janë vend i sigurt për këdo për të marrë pjesë.

Apostulli Pal paralajmëroi: “Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por ajo që është e mirë për ndërtimin, sipas nevojës, që t'u japë hir atyre që dëgjojnë”¹⁰.

Mbajtësit e priftërisë kurrë nuk përdorin gjuhë vulgare apo të pistë. Ata kurrë nuk i poshtërojnë apo i lëndojnë të tjerët. Ata gjithmonë i ndërtojnë dhe i forcojnë të tjerët. Kjo është një mënyrë e thjeshtë, por e fuqishme për të shërbyer.

Në të Gjitha Kohërat

Puna e shërbimit nuk kufizohet te ordinancat apo vizitat e mësimit të shtëpisë ose projektet e herëpashërshme të shërbimit. Ne jemi gjithmonë burra të priftërisë – jo vetëm të dielën dhe jo vetëm kur veshim këmisha të bardha e kravata. Ne kemi për detyrë që të shërbejmë kudo ku gjendemi. Shërbimi nuk është thjesht diçka që bëjmë – ai përcakton se cilët jemi.

Shërbeni çdo ditë. Mundësitë janë kudo rreth jush. Kërkojini ato.



Kërkojini Zotit t'ju ndihmojë që t'i dalloni ato. Do të zbuloni se shumica [e tyre] janë veprime të vogla, të singërta që i ndihmojnë të tjerët të bëhen pasues të Jezu Krishtit.¹¹

Ndërsa përpiqeni të jeni i denjë për Shpirtin, ju do të dalloni mendime e ndjenja që ju nxisin të shërbeni. Ndërsa veproni sipas këtyre nxitjeve, ju do të merrni edhe më shumë prej tyre dhe mundësitë tuaja dhe aftësia juaj për të shërbyer do të rritet e do të zhvillohet.

Vëllezërit e mi të rinj, unë dëshmoj se ju është dhënë autoriteti dhe fuqia e Priftërisë së mrekullueshme Aarone për të shërbyer në emrin e Perëndisë.

Dëshmoj se ndërsa veproni kështu, ju do të jeni një mjet në duart e Perëndisë në ndihmë të të tjerëve. Jeta juaj do të jetë më e pasur dhe më kuptimplote. Ju do të gjeni një forcë më të madhe për t'i bërë ballë së ligës. Ju do të gjeni lumturi të vërtetë – atë lloj lumturie që njihet vetëm nga pasuesit e vërtetë të Jezu Krishtit.

Provofshi gëzimin e plotësimin të detyrës suaj të shenjtë për të shërbyer, lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:111.
2. Shih Marku 8:35.
3. Shih Trent Toone, “Kindness of Arizona High School QB Carson Jones and Teammates Has Gone Viral”, *Deseret News*, 9 nëntor 2012, deseretnews.com/article/865566351/Kindness-of-Arizona-high-school-QB-Carson-Jones-and-teammates-has-gone-viral.html.
4. James E. Faust, “Message to My Grandsons”, *Liahona*, maj 2007, f. 54; emphasis added; [Xhejms E. Faust, “Mesazh drejtuar Nipërve të mi”, Konferenca e Përgjithshme (nr. artikullit 02368 101), prill 2007, f. 66].
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 13:1.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:88.
7. Shih Mateu 20:27–28.
8. Shih *Handbook 2: Administering the Church* (2010), 2.4.5.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 107:85.
10. Efesianëve 4:29.
11. Shih *Handbook 2*, 3.2.3.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Katër Tituj

Do të doja të sugjeroja katër tituj . . . që mund të na ndihmojnë t'i njohim rolet tona vetjake në planin e përjetshëm të Perëndisë dhe potencialin tonë si mbajtës të prifërisë

Të dashur vëllezër dhe miq të mi të dashur, më mbushet zemra me mirënjohje dhe gëzim që jam me ju. Unë ju lavdëroj ju baballarë dhe gjyshër që keni sjellë bijtë dhe nipërit tuaj. Unë ju përgëzoj ju të rinj që keni zgjedhur të jeni këtu sot. Ky është vendi ku duhet të jini. Shpresoj se mund ta ndieni vëllazërinë që na bashkon, dhe lutem që këtu, midis vëllezërve tuaj, ju do të gjeni përkatësi, mbështetje dhe miqësi.

Ne burrat ndonjëherë e përcaktojmë veten nëpërmjet titujsh. Shumë prej nesh kanë tituj të shumëfishtë dhe secili thotë diçka të rëndësishme rreth identitetit tonë. Për shembull, disa tituj përshkruajnë rolet tona në familje, të tillë si *bir, vëlla, bashkëshort* dhe *baba*. Tituj të tjerë përshkruajnë punët që ne bëjmë në botë, të tilla si *mjek, ushtar* apo *artizan*. Dhe disa përshkruajnë thirrjet tona në Kishë.

Sot do të doja të sugjeroja katër tituj që unë besoj se u përshtaten të gjithë mbajtësve të pritërisë nëpër botë – tituj që mund të na ndihmojnë t'i njohim rolet tona vetjake në planin e përjetshëm të Perëndisë dhe potencialin tonë si mbajtës të prifërisë në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Bir i Atit Qiellor

Një titull që na përcakton të gjithë ne, në mënyrën më themelore, është *bir i Atit Qiellor*. Pavarësisht nga çfarë tjetër jemi apo bëjmë në jetë, nuk duhet të harrojmë kurrë se ne jemi fëmijë shpirtërorë të mirëfilltë të Perëndisë. Ne ishim fëmijë të Tij para se të vinim në këtë botë dhe do të jemi fëmijët e Tij përgjithmonë. Kjo e vërtetë bazë ndryshon mënyrën se si e shohim veten, vëllezërit dhe motrat tona dhe vetë jetën.

Fatkeqësisht, asnjë prej nesh nuk jeton plotësisht sipas gjithçkaje që përfshin ky titull, “sepse të gjithë mëkatuan dhe u privuan nga lavdia e Perëndisë”¹.

Mund të jetë shkurajuese nganjëherë kur e di se çfarë do të thotë të jesh bir i Perëndisë dhe përsëri të dështosh në përmbushjen e potencialit tënd si i tillë. Kundërshtari dëshiron t'i shfrytëzojë këto ndjenja. Satani do të donte që ju ta përcaktonit veten sipas mëkateve tuaja dhe jo sipas potencialit tuaj hyjnor. Vëllezër, mos ia vini veshin atij.

Ne të gjithë e kemi parë një foshnjë që mëson të ecë. Ai bën një hap të vogël dhe lëkundet. Ai bie. A e qortojmë një përpjekje të tillë? Natyrisht që jo. Cili baba do ta ndëshkonte një foshnjë

sepse pengohet? Ne nxisim, ne duartrokasim dhe ne lavdërojmë, sepse me çdo hap të vogël, fëmija po bëhet më shumë si prindërit e tij.

Tani, vëllezër, krahasuar me përsosmërinë e Perëndisë, ne të vdekshmit zor se jemi më shumë se foshnja të ngathëta, ngurruese. Por Ati ynë i dashur Qiellor na do të bëhemi më shumë si Ai dhe, vëllezër të dashur, ky duhet të jetë qëllimi ynë i përjetshëm gjithashtu. Perëndia e kupton se ne nuk arrijmë atje brenda një çasti, por duke i bërë hapat një e nga një.

Unë nuk besoj në një Perëndi i cili do të vendoste rregulla dhe urdhërime me qëllimin e vetëm për të na pritur të dështonim, që Ai të mund të na ndëshkonte. Unë besoj në një Atë Qiellor që është i dashur dhe i përkujdesur dhe që gëzohet për çdo përpjekje tonën për të qëndruar kryelartë dhe për të ecur drejt Tij. Dhe, edhe kur pengohemi, Ai na nxit të mos shkurajohemi – kurrë të mos dorëzohemi apo t'i shmangemi pjesës sonë të caktuar të shërbimit – por të marrim kurajë, ta gjejmë besimin tonë dhe të vazhdojmë të përpiqemi.

Ati ynë në Qiell i mëson fëmijët e Tij dhe shpesh u dërgon ndihmë qiellore të padukshme atyre që dëshirojnë ta ndjekin Shpëtimtarin.

Dishepull i Jezu Krishtit


Dhe kjo na çon te titulli tjetër që ne të gjithë e kemi të përbashkët: Të gjithë ata që përpiqen seriozisht të ndjekin Krishtin, quhen *dishepuj* të Tij. Edhe pse e dimë se askush prej nesh nuk është i përsosur, ne nuk e përdorim atë fakt si justifikim për t'i ulur pritshmëritë tona, për të jetuar nën nivelin e privilegjeve tona, për ta shtyrë ditën e pendimit tonë, apo për të mos pranuar të bëhemi pasues më të mirë, më të përsosur, më të përpunuar të Mësuesit dhe Mbretit tonë.

Kujtoni që Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme nuk është ngritur për burra dhe gra që janë të përsosur apo të paprekur nga tundimet e vdekshmërisë, por më tepër, ajo është ngritur për njerëz që janë saktësisht si ju dhe unë. Dhe ajo është ngritur mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë, Zotit Jezu Krisht², nëpërmjet Shlyerjes së të Cilit ne mund të pastrohemi dhe të bëhemi “bashkëqytetarë . . . të familjes së Perëndisë”³.

Pa Shlyerjen e Jezu Krishtit, jeta do të ishte një udhë pa krye, pa shpresë apo të ardhme. Me Shlyerjen, jeta është një udhëtim fisnikërues e frymëzues, rritjeje e zhvillimi që çon në jetë të përjetshme në praninë e Atit tonë Qiellor.

Por edhe pse Shlyerja ka për qëllim të na ndihmojë ne të gjithë të bëhemi më shumë si Krishti, ajo nuk ka për qëllim të na bëjë të gjithë njësoj. Ndonjëherë ne i ngatërrojmë ndryshimet në personalitet me mëkat. Ne madje mund të mendojmë gabimisht se, ngaqë dikush është i ndryshëm nga ne, kjo duhet të nënkuptojë që ai nuk e kënaq Perëndinë. Mendime si këto i bëjnë disa njerëz të besojnë se Kisha dëshiron ta krijojë çdo anëtar sipas një kallëpi të vetëm – që çdo anëtar duhet të duket, të ndiejë, të mendojë dhe të sillet si çdo anëtar tjetër. Kjo do të binte në kundërshtim me gjeninë e Perëndisë, i Cili e krijoi çdo njeri të ndryshëm nga vëllai i tij, çdo bir të ndryshëm nga babai i tij. Madje binjakët identikë nuk janë identikë në personalitetin dhe veçoritë shpirtërore të tyre.

Ajo gjithashtu bie në kundërshtim me synimin dhe qëllimin e Kishës së Jezu Krishtit, që njeh dhe mbron lirinë morale të zgjedhjes – me të gjitha pasojat e saj të rënda – për secilin dhe këdo nga fëmijët e Perëndisë. Si dishepuj të Jezu Krishtit, ne bashkohemi në



dëshminë tonë për ungjillin e rivendosi dhe në zotimin tonë për të mbajtur udhërimet e Perëndisë. Por ne jemi të ndryshëm në parapëlqimet tona kulturore, shoqërore dhe politike.

Kisha fuqizohet kur ne përfitojmë nga kjo shumëllojshmëri dhe e nxisim njëri-tjetrin t'i zhvillojmë dhe t'i përdorim talentet tona për të nxitur dhe forcuar bashkëdishepujt tanë.

Vëllezër, të qenit dishepull është një udhëtim i përjetshëm për ta ndjekur Shpëtimtarin tonë. Përgjatë udhëtimit tonë metaforik nga Bethlehemi për në Golgotë, ne vërtet do të kemi shumë mundësi për ta braktisur udhëtimin tonë. Ndonjëherë do të

duket sikur udha kërkon më shumë se sa do të kishim dëshiruar. Por si burra të priftërisë, ne duhet të kemi kurajën ta ndjekim Shëlbuesin tonë, edhe kur kryqi ynë duket tepër i rëndë për ta mbajtur.

Me çdo hap që bëjmë duke ndjekur Birin e Perëndisë, ne mund të na kujtohet se ende nuk jemi të përsosur. Por ne duhet të jemi dishepuj të patundur dhe të qëndrueshëm. Ne nuk duhet të dorëzohemi. Ne duhet t'i mbajmë besnikërisht besëlidhjet tona. Ne duhet të shohim kurdoherë drejt Mbrojtësit dhe Shëlbuesit tonë, ndërsa ecim drejt Tij, me hapa të papërsosur njëri pas tjetrit.

Shërues i Shpirtave

Vëllezër, nëse vërtet ndjekim Zotin Jezu Krisht, ne duhet të përvetësojmë një titull të tretë: *shërues i shpirtave*. Ne që jemi shuguruar në priftërinë e Perëndisë, thirrëmi për të shëruar të tjerët⁴.

Është detyra jonë që të formojmë, ndreqim, forcojmë, ngremë moralisht dhe të shërojmë. Detyra jonë është të ndjekim shembullin e Shpëtimtarit dhe të ndihmojmë ata që vuajnë. Ne “vajtolojmë” me ata që vajtojnë . . . dhe ngushëllojmë ata që kanë nevojë të ngushëllohen”⁵. Ne u lidhim plagët të pikëlluarve. Ne “ndihmojmë” të dobët, ngr[emë] duart që varen poshtë dhe forcojmë] gjunjët e këputur”⁶.

Si mësues të shtëpisë, ne jemi shërues. Si udhëheqës të priftërisë, ne jemi shërues. Si baballarë, bij, vëllezër dhe bashkëshortë, ne duhet të jemi shërues të zotuar dhe të përkushtuar. Ne mbajmë në një dorë një shishe të vogël me vaj të përkushtuar për bekimin e të sëmurëve; në tjetrën, ne mbajmë një bukë për të ushqyer të uriturit; dhe në zemrat tona, ne mbajmë fjalën e paqes së Perëndisë, “që shëron shpirtin e plagosur”⁷.

Kjo është përgjegjësia jonë e parë dhe kryesore si mbajtës të priftërisë – dhe kjo i përket si mbajtësve të Priftërisë Aarone, ashtu edhe të asaj Melkizedeke. Ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit i bekon jetët, jo vetëm kur e besojmë atë – por edhe më shumë kur e jetojmë atë. Është në zbatimin e parimeve të ungjillit që individët ngrihen moralisht dhe familjet forcohen. Është privilegj dhe përgjegjësia jonë jo thjesht t’i themi gjërat e drejta, por gjithashtu t’i bëjmë gjërat e drejta.

Shpëtimtari është bërësi i mrekullive. Ai është Shëruesi i madh. Ai është shembulli ynë, drita jonë, madje në çastet më të errëta, dhe Ai na tregon udhën e drejtë.

Ne duhet ta ndjekim Atë. Ne duhet ta përmbushim rolin tonë dhe të bëhemi shërues duke i shërbyer Perëndisë dhe bashkënjerezve tanë.

Trashëgimtar i Jetës së Përjetshme

Titulli i katërt që ndajmë ne të gjithë, na kthen te titulli i parë në listën tonë. Si bij të Atit tonë Qiellor, ne jemi *trashëgimtarë* të gjithçkaje që Ai ka.

“Vetë Fryma i dëshmon frymës sonë se ne jemi bij të Perëndisë.

Dhe nëse jemi bij, jemi dhe trashëgimtarë, trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë të Krishtit, nëse vuajmë me të dhe lavdohemi me të.”⁸

Mendoni për këtë, vëllezërit e mi të dashur. Ne jemi bashkëtrashëgimtarë me Krishtin!

Pra, a ka ndonjë kuptim që shumë prej nesh shpenzojnë aq tepër nga koha, mendimet, financat dhe energjitë tona të çmuara duke u dhënë pas prestigjit apo pasurisë, apo për t’u

argëtuar me pajisjet elektronike më të reja dhe më të shkëlqyera?

Zoti ka vendosur përpara nesh premtimin hyjnor se, “cilëtdo që janë besnikë në marrjen e këtyre dy priftërive, . . . [në] lartësimin e thirrjes së tyre, . . . [do të] më pranojnë mua, thotë Zoti; . . . Dhe ai që më pranon mua, pranon Atin tim; si rrjedhim, gjithçka që Ati im ka, do t’i jepet atij”⁹.

Është përtej fuqisë sime që të përfytyroj gjithçka që përcjell ky premtim. Por unë vërtet e di se ai është i mrekullueshëm, ai është hyjnor, ai është i përjetshëm dhe i meriton të gjitha përpjekjet tona në jetë.

Duke e ditur këtë, si është e mundur që të mos përfshihemi me vullnet dhe me gëzim në shërbim të Zotit e të bashkënjerezve tanë dhe për të jetuar sipas përgjegjësive tona në priftërinë e Perëndisë?

Kjo është një punë shumë fisnike që do të na sfidojë me çdo mënyrë dhe do të na kërkojë t’i përdorim të gjitha



aftësitë tona. A dëshirojmë t'i shohim qiejt të hapen dhe të dëshmojmë nxitjet e Frymës së Shenjtë që na tregon udhën? Atëherë le ta marrim draprin dhe të bëjmë përpjekjet tona në këtë vepër të madhe – një kauzë shumë më e madhe se vetja jonë!

Shërbimi ndaj Perëndisë dhe bashkënjerezve tanë do të na krijojë sfida dhe do të na shndërrojë në diçka më të madhe nga sa mund ta kemi menduar ndonjëherë të mundshme.

Ndoshta ju mund të mendoni se nuk jeni të nevojshëm, që ju kanë anashkaluar apo nuk ju duan, që jeni i parëndësishëm.

Më vjen sinqerisht keq nëse ndonjë mbajtës priftërie ndihet kështu. Sigurisht ju nuk jeni të anashkaluar apo të padëshiruar nga Ati juaj Qiellor. Ai ju do. Dhe unë ju them me siguri se ju i nevojiteni Kishës suaj.

A nuk e dini se “Perëndia ka zgjedhur gjërat e marra të botës për të turpëruar të urtët; dhe Perëndia ka zgjedhur gjërat e dobëta të botës për të turpëruar të fortët”¹⁰?

Ndoshta është e vërtetë që ne jemi të dobët. Ndoshta ne nuk jemi të urtë apo të fuqishëm. Por kur Perëndia punon nëpërmjet nesh, askush dhe asgjë nuk mund të na kundërshtojë.¹¹

Kjo është arsya përse jeni të nevojshëm. Ju keni për të dhënë ndihmesën tuaj të veçantë dhe Perëndia mund ta lartësojë në mënyrë të fuqishme atë ndihmesë. Aftësia juaj për të ndihmuar nuk varet nga thirrja juaj në Kishë. Ju keni mundësi të pafundme për të shërbyer. Në qoftë se jeni në pritje jashtë vijave të fushës, ju nxis që të hyjni në lojë.

Mos prisni për një thirrje të posaçme para se të angazhoheni plotësisht në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë. Si mbajtës i priftërisë, ju jeni thirrur tashmë në punë. Studiojeni fjalën e Perëndisë çdo ditë, lutiu Ati Qiellor çdo ditë, bëjini parimet e ungjillit të



rivendosur pjesë të qenies tuaj, jepini falënderime Perëndisë dhe kërkoni drejtimin e Tij. Pastaj jetojeni atë që mësoni, së pari në familjen tuaj, por edhe në çdo situatë të jetës suaj.

Në simfoninë e Kompozitorit të madh, ju keni pjesën tuaj të veçantë për të luajtur – notat tuaja për të kënduar. Edhe nëse dështoni t'i ekzekutoni ato, simfonia me siguri do të vazhdojë. Por nëse ngriheni dhe i bashkoheni korit, dhe e lejoni fuqinë e Perëndisë të veprojë nëpërmjet jush, ju do të shihni “pragjet e qiellit” të hapen, dhe Ai do të “derdhë mbi ju aq shumë bekim, sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini”¹². Plotësoni potencialin tuaj të vërtetë si bir i Perëndisë dhe ju mund të jeni një forcë për të mirën në familjen tuaj, shtëpinë tuaj, komunitetin tuaj, kombin tuaj dhe vërtet në botë.

Dhe në këtë proces, ndërsa “humb[isni] jetën [tuaj]” në shërbim të të tjerëve¹³, ju do të rriteni dhe zhvilloheni gjersa të arrini “masën e shtatit të plotësisë së Krishtit”¹⁴. Atëherë ju do të përgatiteni për të trashëguar, me Krishtin, gjithçka që ka Ati juaj.

Ju Jeni të Rëndësishëm për Perëndinë

Vëllezërit e mi të dashur, ju jeni të rëndësishëm. Juve ju duan. Ju jeni të nevojshëm. Kjo punë është e vërtetë. Priftëria që keni privilegjin të mbani, është vërtet prej Perëndisë.

Unë lutem që, ndërsa meditonit mbi titujt e shumtë të një mbajtësi të denjë të priftërisë, ju do të zbuloni se keni një ndihmë hyjnore, që gjithmonë ju ndihmon të përparoni drejt trashëgimisë madhështore që Ati juaj Qiellor ka ruajtur për ju. Ju lë këtë bekim dhe dëshminë time në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Romakëve 3:23.
2. Shih Helamani 5:12.
3. Efesianëve 2:19.
4. “Lord, I Would Follow Thee”, *Hymns*, nr. 220.
5. Mosia 18:9.
6. Doktrina e Besëlidhje 81:5.
7. Jakobi [LiM] 2:8.
8. Romakëve 8:16–17.
9. Doktrina e Besëlidhje 84:33, 35, 37–38.
10. 1 Korintasve 1:27.
11. Shih Romakëve 8:31.
12. Malakia 3:10.
13. Mateu 16:25.
14. Efesianëve 4:13.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Jemi të Bashkuar

Lutem që kudo që të jemi dhe cilatdo të jenë detyrat që kemi në priftërinë e Perëndisë, ne vërtet do të jemi të bashkuar në kauzën e sjelljes së ungjillit tek e gjithë bota.

Zoti e bëri të qartë vërtet që nga fillimi i kësaj periudhe të fundit ungjillore, se ne duhej t'ia çonim ungjillin të gjithë botës. Atë që Ai ua tha disa mbajtësve të priftërisë në vitin 1831, Ai ua thotë shumë të tjerëve tani. Pavarësisht nga mosha, aftësia, thirrja në Kishë ose vendndodhja jonë, ne të bashkuar thirrmi për punën që ta ndihmojmë Atë për mbledhjen e shpirtrave derisa Ai të vijë përsëri. Ai u tha atyre punëtorëve të parë në vresht: “Dhe përsëri, unë ju them, unë ju jap një urdhërim që çdo burrë qoftë plak, prift, mësues dhe gjithashtu anëtar, të fillojë me fuqinë e tij, me punën e duarve të tij, të përgatitet dhe të plotësojë gjërat që unë kam urdhëruar.

Dhe predikimi juaj le të jetë zëri paralajmërues, çdo njeri të afërmit të tij, me qetësi dhe butësi.

Dhe largohuni nga të ligjtë. Shpëtoni vetveten. Jini të pastër që të mbani enët e Zotit.”¹

Tani, ju anëtarë të Priftërisë Aarone mund ta kuptoni se urdhri i Zotit ju përfshin ju. Përderisa e dini se Zoti gjithmonë e përgatit një udhë për t'i zbatuar urdhërimet e Tij, ju mund të prisni që Ai do ta bëjë atë për secilin prej jush.

Më lejoni t'ju tregoj se si Ai e bëri atë për një djalë, i cili tani mban

detyrën e priftit në Priftërinë Aarone. Ai është 16 vjeç. Jeton në një vend ku misionarët mbërritën fillimisht vetëm një vit më parë. Ata u caktuan në dy qytete, por jo në qytetin ku jeton djali.

Kur ishte shumë i vogël, prindërit e tij e sollën në Jutë për siguri. Familja e tij i mori mësimet dhe u pagëzua nga misionarët. Ai nuk u pagëzua në Kishë, sepse nuk ishte ende tetë vjeç.

Prindërit e tij humbën jetën në një aksident. Kështu, gjyshja e bëri atë të kthehej në shtëpinë e tij, përtej oqeanit, përsëri në qytetin ku ishte lindur.

Vetëm një vit më parë në mars, ai po ecte në rrugë, kur ndjeu se duhej të fliste me një grua të cilin nuk e njohte. Ai foli me të me anglishten që ende i kujtohej. Ajo ishte një infermiere e dërguar nga presidenti i misionit në qytetin e tij për të parë për shtëpi dhe kujdes mjekësor për misionarët, të cilët do të caktoheshin atje së shpejti. Djali dhe gruaja u bënë miq, teksa po flisnin. Kur u kthye në zyrat qendrore të misionit, ajo u tregoi misionarëve rreth tij.

Dy misionarët e parë mbërritën në shtator të 2012–ës. Djali jetim ishte pagëzimi i parë i tyre në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Në mars të këtij viti ai kishte qenë anëtar për katër muaj. Ai ishte

shuguruar prift në Priftërinë Aarone dhe kështu mundi të pagëzonte në Kishë të kthyerin e dytë në besim. Ai ishte pionieri i parë i priftërisë që do të mblidhte me vete fëmijë të tjerë të Atit Qiellor për të ngritur Kishën në një qytet me afërsisht 130.000 njerëz.

Të dielën e Pashkës, më 31 mars 2013, anëtarësia e Kishës atje ishte rritur në numrin e madh të gjashtë anëtarëve në atë qytet. Ai ishte i vetmi anëtar vendor që mori pjesë në mbledhje atë të diel. Kishte vrarë gjurin një ditë më parë, por që i vendosur të ishte atje. Ishte lutur që të ishte në gjendje për të ecur deri në kishë. Dhe kështu ai ishte atje. Ai e ndau sakramentin me katër misionarë të rinj dhe një çift misionarësh – i tërë grumbullimi.

Kjo ngjarje nuk duket mbresëlënëse, në qoftë se nuk dalloni në të modelin e dorës së Perëndisë në ndërtime dhe mbretërisë së Tij. E kam parë atë shumë herë.

E pashë në Nju-Meksiko kur isha i ri. Gjatë brezave profetët na kanë thënë se ne duhet t'i ndihmojmë misionarët të gjejnë dhe t'i mësojnë të ndershmërit në zemër dhe më pas t'i duam ata që vijjnë në mbretëri.

E kam parë vetë atë që mund të bëjnë udhëheqës dhe anëtarë besnikë të priftërisë. Në vitin 1955 u bëra oficer në Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Peshkopi im në lagjen ku jetoja, më dha një bekim pikërisht përpara se të largohesha për caktimin tim të parë, që ishte në Albakërki, Nju-Meksiko.

Në bekimin e tij ai tha se koha ime në forcat ajrore do të ishte shërbim misionar. Arrita në kishë të dielën time të parë në Degën e Parë të Albakërkit. M'u afrua një burrë, u prezantua si presidenti i distriktit dhe më tha se do të më thërriste të shërbeja si misionar distrikti.

I thashë atij se do të isha atje për trajnim për vetëm pak javë dhe më pas do të caktohesha diku tjetër nëpër botë. Ai tha: “Nuk di gjë për këtë, por ne duhet të të thërrasim ty të shërbesh”. Në mes të trajnimit tim ushtarak, nëpërmjet asaj që u duk si e rastit, unë u zgjodha mes qindra oficerëve që po trajnoheshin, të zija vendin në shtabin qendror të një oficeri që kishte vdekur papritur.

Kështu që, për dy vitet që isha atje, punova në thirrjen time. Në shumicën e mbrëmjeve dhe çdo fundjavë, u mësova ungjillin e Jezu Krishtit njerëzve që na sillnin anëtarët.

Shokët e mi dhe unë bëmë mesatarisht më shumë se 40 orë në muaj në shërbimin tonë misionar, pa patur asnjëherë nevojë të trokisnim në dyer që të gjenim dikë për ta mësuar. Anëtarët na e mbushën kaq shumë kohën, sa shpesh në një mbrëmje u jepnim mësim dy familjeve. E pashë vetë fuqinë dhe bekimin në thirrjen e përsëritur të profetëve që çdo anëtar të jetë një misionar.

Të dielën e fundit përpara se të largohesha nga Albakërki, u organizua kunji i parë në atë qytet. Tashmë atje gjendet një tempull i shenjtë, një shtëpi e Zotit, në një qytet ku dikur

ne u takuam në një kishë të vetme me shenjtorë të cilët na sollën miq për t'i mësuar dhe për të ndier dëshminë e Shpirtit. Ata miq gjetën një shtëpi mikpritëse në Kishën e vërtetë të Zotit.

E pashë më pas ndikimin e tyre në Nju-Ingland kur shkova në shkollë. U thirra si këshilltari i një presidenti të shkëlqyer distrikti, i cili ishte ndryshuar nga mungesa e interesit për Kishën në një burrë me fuqi shpirtërore të madhërishtme. Mësuesi i tij i shtëpisë e donte atë aq shumë sa të mos i kushtonte vëmendje puros së tij dhe të shihte atë që Perëndia mund të shihte tek ai. Presidenti i distriktit dhe unë shkuam me makinë përgjatë kodrave dhe bregdetit për të vizituar degët e vogla që mbushnin Masaçusetin dhe Rod-Ajllëndin, për të ngritur dhe bekuar mbretërinë e Perëndisë.

Në vitet që shërbeva me atë udhëheqës të mrekullueshëm, ne i pamë njerëzit të afrojnë miq te Kisha me anë të shembullit të tyre dhe me anë të ftesës së tyre për t'i dëgjuar misionarët. Rritja e atyre degëve mua më dukej e ngadaltë dhe ngurruese. Por të dielën që u largova, pesë vjet më vonë, dy Apostuj erdhën për ta organizuar distriktin tonë në një kunj në godinën e kishës në Parkun Longfellow në Kembrixh.

Vite më pas u ktheva atje për të drejtuar një konferencë kunj. Presidenti i kunjit më çoi të shihja një kodër shkëmbore në Belmont. Më tha se do të ishte vend i përsosur për një tempull të Perëndisë. Një tempull qëndron atje tani. Kur ia hedh vështrimin, kujtoj anëtarët e përlurur me të cilët u ula në degë të vogla, fqinjët që ata ftuan dhe misionarët që po i mësonin.

Ka një dhjak të ri në këtë mbledhje këtu sonte. Unë isha me të në të njëjtën të diel Pashke që prifti, për të cilin fola më parë, hyri në mbledhjen e tij me një anëtar. Dhjaku u mbush plot





Los Anxhelos, Kaliforni, SHBA

gëzim kur babai i tha se ai do të ishte sonte në këtë mbledhje të priftërisë me të. Ky baba ishte një misionar i shkëlqyer në të njëjtin mision ku gjyshi i tij kishte qenë presidenti. E kam parë *Manualin për Misionarë* të vitit 1937 të stërgjyshit të tij. Trashëgimia e tij për të sjellë njerëz në Kishë ka rrënjë të thella.

Kështu që fola me peshkopin e atij dhjaku për të mësuar çfarë përvojash mund të presë djali që të plotësojë përgjegjësinë e priftërisë për të punuar në mbledhjen e shpirtave për Zotin. Peshkopi ishte entuziast kur përshkroi se si udhëheqësi i misionit të lagjes e ndiqte përparimin e kërkuesve. Ai e merr atë informacion nga kontakti i vazhdueshëm me misionarët.

Peshkopi dhe këshilli i tij i lagjes diskutojnë për çdo kërkues që po përparon. Ata vendosin atë që mund të bëjnë për çdo njeri dhe për familjet e tyre për t'i ndihmuar ata të bëhen miq përpara pagëzimit, për t'i përfshirë ata në aktivitete dhe për t'i ushqyer shpirtërisht ata që pagëzohen. Ai tha se misionarët me raste kanë mjaft takime për të mësuar sa ata marrin si shoqërues mbajtës të Priftërisë Aarone.

Plani i misionit të lagjes përfshin qëllimet e kuorumeve për t'i ftuar të takohen me misionarët njerëzit që ata i njohin. Madje presidenca e kuoromit të dhjakëve ftohet që të caktojë qëllime dhe të planifikojë për anëtarët e kuoromit të tyre për t'i ndihmuar ata të sjellin kë njohin në mbretërinë e Perëndisë.

Tani, dhjaku në lagjen e fortë dhe prifti i ri – i kthyeri në besim – në grupin e vogël të anëtarëve mund të duken se kanë pak gjëra të përbashkëta me njëri-tjetrin ose me ju. Dhe ju mund të mos shihni shumë ngjashmëri midis përvojës suaj për të ngritur Kishën me atë që pashë unë si mrekulli në Nju-Meksiko dhe në Nju-England.

Por ka një mënyrë sipas së cilës ne bashkohemi në përgjegjësinë tonë në priftëri. Ne e shenjtërojmë veten tonë dhe i përmbushim detyrat tona individuale ndaj urdhërimit për ta çuar ungjillin te të gjithë fëmijët e Atit tonë Qiellor.

Ne tregojmë për përvoja në mënyrën se si Zoti ndërton mbretërinë e Tij në tokë. Në Kishën e Tij, me të gjitha mjetet dhe organizimin e mrekullueshëm që na është dhënë, ende gjendet

një e vërtetë themelore, e mësuar nga profetët, lidhur me mënyrën se si ne duhet ta përmbushim urdhrin tonë të priftërisë për punë misionare.

Në konferencën e përgjithshme të prillit të vitit 1959, Presidenti Dejvid O. Mek-Kei na mësoi këtë parim, siç na e kanë mësuar profetët që nga ajo kohë, duke përfshirë Presidentin Tomas S. Monson. Presidenti Mek-Kei tregoi në fjalët e tij të mbylljes se në vitin 1923 në Misionin Britanik, një udhëzim i përgjithshëm iu dërgua anëtarëve të Kishës. Atyre iu tha të mos harxhonin para që të bënin reklama për të ndryshuar ndjenjat e këqija që njerëzit e zonës kishin ndaj Kishës. Presidenti Mek-Kei tha se vendimi ishte: “Ja jepni përgjegjësinë çdo anëtar të Kishës që në vitin pasues të 1923–shit, çdo anëtar do të jetë një misionar. Çdo anëtar një misionar! Ju mund të sillni nënën tuaj në Kishë, ose mund të jetë babai juaj; ndoshta shoku me të cilin punoni bashkë. Dikush do ta dëgjojë lajmin e mirë të së vërtetës nëpërmjet jush.”

Dhe Presidenti Mek-Kei vazhdoi: “Dhe ky është mesazhi sot. *Çdo anëtar – një milion e gjysmë – një misionar!*”²

Kur u shpall në vitin 2002 se puna misionare do të bëhej përgjegjësia e peshkopëve, vrava mendjen se si do të arrihej kjo. Unë kisha qenë një peshkop. Më dukej se ngarkesa që tashmë po mbanin në shërbimin ndaj anëtarëve dhe në drejtimin e organizatave në lagje, ishte pothuajse gjithë çka mund të bënin.

Një peshkop që e njihja, nuk e pa atë si një detyrë të shtuar, por si mundësi për ta afruar lagjen më pranë një kauze të madhe ku çdo anëtar të bëhej një misionar. Ai thirri një udhëheqës misioni të lagjes. Ai u takua vetë me misionarët çdo të shtunë për të mësuar rreth punës së tyre, për t'i inkurajuar ata dhe për të mësuar rreth përparimit të kërkuesve të tyre. Këshilli i lagjes gjeti mënyra që organizatat dhe kuorumet t'i përdornin përvojat e shërbimit si përgatitje misionare. Si gjykatës në Izrael, ai i ndihmoi të rinjtë t'i ndienin bekimet e Shlyerjes për ta mbajtur veten të dëlirë.

Kohët e fundit e pyeta atë se si e shpjegonte rritjen e shpejtë të pagëzimeve të të kthyerve në besim në

lagjen e tij dhe rritjen në numër të të rinjve të gatshëm dhe të zellshëm për t'ia çuar botës ungjillin e Jezu Krishtit. Ai tha se mendonte se nuk ishte për shkak të detyrës që kreu secili, por ishte mënyra se si ata u bashkuan me entuziazëm për të sjellë njerëz në komunitetin e shenjtorëve që ua kishte sjellë atyre këtë lumturi.

Për disa, rritja ishte më shumë se entuziazëm. Si bijtë e Mosias, ata i kishin ndier pasojat e mëkatit në jetën e tyre personale dhe shërimin e mrekullueshëm të Shlyerjes brenda Kishës së Perëndisë. Për shkak të dashurisë dhe mirënjohjes për dhuratën e Shpëtimtarit për ta, ata donin ta ndihmonin këdo që mundeshin, për t'iu larguar trishtimit të mëkatit, për ta ndier gëzimin e faljes dhe për t'i mbledhur ata të sigurt në mbretërinë e Perëndisë.

Ishte dashuria e Perëndisë dhe dashuria për miqtë dhe fqinjët e tyre që i bashkuan ata për t'u shërbyer njerëzve. Ata dëshiruan t'ia çonin ungjillin çdo njeriu në pjesën e tyre të botës. Dhe i përgatitën fëmijët e tyre që të ishin të denjë për t'u thirrur nga Zoti

për të dhënë mësim, për të dëshmuar dhe për të shërbyer në pjesë të tjera të vreshtit të Tij.

Qoftë në lagjen e madhe ku dhjaku i ri do të kryejë detyrën e tij për ta ndarë ungjillin dhe për ta ngritur mbretërinë, apo në grupin e vogël shumë larg ku prifti i ri shërben, ata do të jenë të bashkuar në qëllim. Dhjaku do të frymëzohet nëpërmjet dashurisë së Perëndisë për t'u drejtuar te një shok që s'është ende anëtar. Ai do ta përfshijë shokun e tij në një shërbim ose veprimtari në Kishë dhe më pas do ta ftojë atë dhe familjen e tij për të marrë mësimet nga misionarët. Për ata që pagëzohen, ai do të jetë shoku për të cilin kanë nevojë.

Prifti do të ftojë të tjerë të bashkohën me të në grupin e vogël të shenjtorëve, ku ai e ka ndier dashurinë e Perëndisë dhe paqen e bekuar të Shlyerjes.

Nëse vazhdon me besnikëri në detyrën e tij të priftërisë, ai do ta shohë grupin të bëhet degë dhe më pas një kunj i Sionit do të vijë në qytetin e tij. Do të ketë një lagje me një peshkop dashamirës. Mund të jetë një prej bijve ose nipërve të tij që një ditë do ta çojë një shërbëtor të Perëndisë te një kodër pranë dhe do të thotë: "Ky do të ishte një vend i mrekullueshëm për një tempull".

Lutem që kudo që të jemi dhe cilatdo të jenë detyrat që kemi në priftërinë e Perëndisë, ne vërtet do të jemi të bashkuar në kauzën e sjelljes së ungjillit tek e gjithë bota dhe që ne do t'i nxisim njerëzit që i duam të pastrohen nga mëkati dhe të jenë të lumtur me ne në mbretërinë e Perëndisë. Në emrin e Jezu Krishtit, Kisha e të cilit është kjo, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 38:40–42.
2. David O. McKay, në Conference Report, prill 1959, f. 122.





Nga Presidenti Tomas S. Monson

Ejani, Bij t'Per'ndis'

I kërkofte me zell secili prej nesh shkrimet e shenjta, e planifikofte jetën e vet me pikësynim, e dhëntë mësim të vërtetën me dëshmi dhe i shërbeftë Zotit me dashuri.

Dy herë në vit, kjo Qendër e mrekullueshme e Konferencave duket se na thotë me zërin e saj nxitës: “Ejani, bij t'Per'ndis' që keni marr' prift'rinë”¹. Ka një shpirt të veçantë që e përshkon mbledhjen e përgjithshme të priftërisë së Kishës.

Sonte ka mijëra e mijëra nga mbaj-tësit tanë të priftërisë nëpër botë, që po i shërbejnë Zotit si misionarët e Tij. Siç e përmenda në mesazhin tim këtë mëngjes, ne aktualisht kemi mbi 65.000 misionarë në fushën e misionit, me mijëra të tjerë që po presin të hyjnë në qendrën e trajnimit të misionarëve ose aplikimet e të cilëve aktualisht janë duke u shqyrtuar. Ne i duam dhe i lëvdojmë ata që janë të gatshëm dhe plot dëshirë për të shërbyer.

Shkrimet e shenjta nuk kanë asnjë shpallje më të përshtatshme, asnjë përgjegjësi më detyruese dhe asnjë udhëzim më të drejtpërdrejtë sesa urdhërimi i dhënë nga Zoti i ringjallur kur iu shfaq në Galile të njëmbëdhjetë dishepujve. Ai tha:

“Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë,

dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar.

Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës.”²

Ky urdhër hyjnor, i bashkuar me premtimin e lavdishëm që e shoqëron, është motoja jonë sot, sikurse që në meridianin e kohës. Puna misionare është një tipar dallues i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Përherë ka qenë kështu; gjithmonë do të jetë kështu. Sikurse shpalli Profeti Jozef Smith: “Pas gjithçkaje që është thënë, detyra më e madhe dhe më e rëndësishme është të predikojmë Ungjillin”³.

Brenda dy vitesh të shkurtra, të gjithë misionarët me kohë të plotë që shërbejnë aktualisht në këtë ushtri mbretërore të Perëndisë, do t'i kenë përfunduar punët e tyre dhe do të jenë kthyer në shtëpitë e tyre dhe tek të dashurit e tyre. Për pleqtë [eldrat], zëvendësuesit e tyre gjenden sonë në radhët e Priftërisë Aarone të Kishës. Të rinj, a jeni gati të përgjigjeni? A jeni të gatshëm të punoni? A jeni të përgatitur të shërbeni?

Në rastin më të mirë, puna misionare ka nevojë për një përshtatje të rreptë të stilit të jetesës së njeriut. Ajo kërkon orë të gjata dhe përkushtim të madh, sakrificë vetëmohuese dhe lutje me gjithë shpirt. Për pasojë, shërbimi i përkushtuar misionar sjell shpërblimin

e lumturisë së përjetshme, që shtrihet përgjatë vdekshmërisë dhe në përjetësi.

Sfida është që të jemi shërbëtorë më të dobishëm në vreshtin e Zotit. Kjo gjen zbatim për të gjithë ne, cilado qoftë mosha jonë dhe jo vetëm për ata që po përgatiten për të shërbyer si misionarë me kohë të plotë, pasi secilit prej nesh i vjen urdhri për të shpërndarë ungjillin e Krishtit.

A mund të sugjeroj një formulë që do të na sigurojë sukses: së pari, **kërkojini me zell shkrimet e shenjta**; së dyti, **planifikojini jetën tuaj me pikësynim** (dhe, mund të shtoj, planifikojini jetën tuaj pavarësisht moshës suaj); së treti, **jepeni mësim të vërtetën me dëshmi**; dhe së katërti, **shërbejini Zotit me dashuri**.

Le ta shqyrtojmë secilën nga katër pjesët e formulës.

Së pari, **kërkojini me zell shkrimet e shenjta**.

Shkrimet e shenjta dëshmojnë për Perëndinë dhe përmbajnë fjalët e jetës së përjetshme. Ato bëhen themeli i mesazhit tonë.

Theksi i programit mësimor të Kishës janë shkrimet e shenjta, organizuar dhe bashkërenduar përmes përpjekjes për [të krijuar] lidhje reciproke. Ne gjithashtu nxitemi që t'i studiojmë shkrimet e shenjta çdo ditë, si individualisht edhe me familjet tona.

Unë do t'ju jap vetëm një referencë që gjen zbatim të drejtpërdrejtë në jetën tonë. Në Librin e Mormonit, kapitulli i 17-të i Almës, lexojmë rrëfimin për gëzimin e Almës kur takoi përsëri bijtë e Mosias dhe vuri re qëndrueshmërinë e tyre në kauzën e të vërtetës. Anali na tregon: “Ata ishin përforcuar në njohurinë e së vërtetës; pasi ata ishin njerëz me kuptim të saktë dhe kishin kërkuar me zell shkrimet e shenjta, që ata të mund të dinin fjalën e Perëndisë.

Por kjo nuk është e gjitha; ata ishin dhënë pas lutjeve të shumta dhe agjërimit; prandaj ata kishin shpirtin e profecisë dhe shpirtin e zbulësës dhe kur i mësuan të tjerët, ata i mësuan me fuqinë dhe autoritetin e Perëndisë.”⁴

Vëllezër, **kërkojini me zell shkri-
met e shenjtja.**

Së dyti në formulën tonë: **planifi-
kojeni jetën tuaj me pikësynim.**

Ndoshta asnjë brez të rinjsh nuk ka përballuar vendime me ndikim kaq të gjerë sa rinia e sotme. Duhet të merren masat për shkollë, mision dhe martesë. Për disa, do të përfshihet shërbimi ushtarak.

Përgatitja për mision fillon herët. Përveç përgatitjes shpirtërore, një prind i urtë do të sigurojë mjetet përmes të cilave i biri në moshë të re të mund të fillojë fondin e tij personal misionar. Ndërsa vitet kalojnë, ai mjaft mirë mund të nxitet për të studiuar një gjuhë të huaj kështu që, nëse është e nevojshme, aftësitë e tij gjuhësore të mund të përdoren. Përfundimisht vjen ajo ditë e lavdishme kur peshkopi dhe presidenti i kунjit e ftojnë të riun për një bisedë. Vlerësohet denjësia; plotësohet një rekomandim misionari.

Gjatë asnjë kohe tjetër një familje e tërë nuk vëzhgon dhe pret me aq ankth postierin dhe letërën që përmban adresën e dërguesit *47 East South Temple, Salt Lake City, Utah*. Letra vjen; ndjenja e ankthit është dërrmuese; thirrja lexohet. Shpesh fusha e caktuar për punë është shumë larg shtëpisë. Megjithatë, pavarësisht vendit, përgjigjja e misionarit të përgatitur e të bindur është e njëjtë: “Unë do të shërbej”.

Fillojnë përgatitjet për nisje. Të rinj, shpresoj që i vlerësoni sakrificat që prindërit tuaj i bëjnë me aq gatishmëri në mënyrë që ju të shërbeni. Punët e tyre do t’ju mbështesin, besimi i tyre do t’ju nxisë, lutjet e tyre do t’ju



përkrahin. Misioni është një çështje familjare. Zemrat janë një, edhe pse sipërfaqja e gjerë e kontinenteve apo oqeanëve mund t'i ndajë.

Vëllezër, ndërsa e planifikoni me pikësynim jetën tuaj, kujtoni se mundësitë tuaja misionare nuk kufizohen te periudha e thirrjes zyrtare. Për ata prej jush që shërbejnë në ushtri, një kohë e tillë mund dhe duhet të jetë dobiprurëse. Çdo vit, të rinjtë tanë me uniformë sjellin shumë shpirtira në mbretërinë e Perëndisë duke nderuar priftërinë e tyre, duke jetuar urdhërimet e Perëndisë dhe duke u mësuar të tjerëve fjalën hyjnore të Zotit.

Mos e nënvlerësoni privilegjin tuaj për të qenë misionarë ndërsa ndiqni arsimimin tuaj zyrtar. Shembulli juaj si shenjtor i ditëve të mëvonshme do të

vihet re, do të peshohet dhe shpesh do të pasohet.

Vëllezër, pavarësisht moshës suaj, pavarësisht rrethanave tuaja, unë ju nxit që ta **planifikoni jetën tuaj me pikësynim.**

Tani te pika e tretë në formulën tonë: **jepeni mësim të vërtetën me dëshmi.**

Binduni këshillës së Apostullit Pjetër, i cili nxiti: “Jini gjithnjë gati për t’u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që ju kërkon shpjegime për shpresën që është në ju”⁵. Ngrijeni zërin tuaj dhe dëshmoni për natyrën e vërtetë të Kreut–Perëndi. Shpalleni dëshminë tuaj në lidhje me Librin e Mormonit. Përçojini të vërtetat e lavdishme dhe të bukura që përmban plani i shpëtimit.



Kur shërbeva si president misioni në Kanada mbi 50 vjet më parë, një misionar i ri që vinte nga një komunitet i vogël rural mahnitej nga madhësia e Torontos. Ai që i vogël nga shtati, por me dëshmi të madhe. Jo shumë pas mbërritjes së tij, bashkë me shokun e vet misionar, ai vizitoi shtëpinë e Elmer Pollardit në Oshaua të Ontarios në Kanada. Nga keqardhja për të rinjtë që, gjatë një stuhie verbuese dëbore, po shkonin shtëpi më shtëpi, z. Pollard i ftoi misionarët brenda në shtëpinë e tij. Ata i paraqitën mesazhin e tyre. Ai nuk u frymëzua nga shpirti [i mesazhit]. Kur erdhi çasti, u kërkoi që të largoheshin e të mos vinin përsëri. Fjalët e tij të fundit drejtuar pleqve, ndërsa kalonin hyrjen e tij të përparme, u thanë me tallje: “Mos më thoni se e besoni me të vërtetë që Jozef Smithi qe profet i Perëndisë!”

Dera u mbyll. Pleqtë ecën tatë-pjetë rrugës. Djali ynë nga fshati i tha shokut të vet misionar: “Eldër, nuk iu përgjigjëm z. Pollard. Ai tha se ne

nuk besonim se Jozef Smithi qe profet i vërtetë. Le të kthehemi dhe t'i shprehim dëshmitë tona.” Në fillim, misionari më me përvojë ngurroi por më në fund ra dakord ta shoqëronte shokun e tij. Frika mbërtheu zemrat e tyre ndërsa i afroheshin derës nga e cila sapo qenë dëbuar. Ata trokitën, u përballën me z. Pollard, kaluan një çast pikëllimi dhe pastaj me fuqi nga Shpirti, misionari ynë i papërvojë tha: “Z. Pollard, ju thatë se ne nuk e besonim vërtet se Jozef Smithi qe profet i Perëndisë. Unë ju dëshmoj se Jozefi ishte profet. Ai e përktheu vërtet Librin e Mormonit. Ai pa Perëndinë, Atin dhe Jezusin, Birin. Unë e di këtë.”

Jo shumë kohë më vonë, z. Pollard, tani Vëllai Pollard, u ngrit në një mbledhje të priftërisë dhe tha: “Atë natë nuk munda të flija. Dëgjoja të kumbonin në veshët e mi fjalët: ‘Jozef Smithi ishte profet i Perëndisë. Unë e di këtë. Unë e di këtë.’ Ditën tjetër u telefonova misionarëve dhe u kërkova që të ktheheshin. Mesazhi i

tyre, i ndërthurur me dëshmitë e tyre, ndryshoi jetën time dhe jetën e familjes sime.” Vëllezër, **jepeni mësim të vërtetën me dëshmi.**

Pika e fundit në formulën tonë është që t'i **shërbejmë Zotit me dashuri**. Nuk ka asnjë zëvendësues për dashurinë. Misionarët e suksesshëm i duan shokët e tyre misionarë, udhëheqësit e tyre të misionit dhe njerëzit e çmuar të cilëve u japin mësim. Në sesionin e katërt të Doktrinës e Besëlidhjeve, Zoti vendosi cilësimet [kualifikueset] për punët e shërbesës. Le të shqyrtojmë vetëm disa vargje:

“Prandaj, O ju që hyni në shërbim të Perëndisë, kujdesuni që t'i shërbeni atij me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tuaj, që ju të qëndroni të pafaj përpara Perëndisë në ditën e fundit. . . .

Dhe besimi, shpresa, dashuria hyjnore dhe dashuria, me syrin drejtuar vetëm te lavdia e Perëndisë, e cilësojnë atë për veprën.

Kujtoni besimin, virtytin, diturinë, maturinë, durimin, mirësinë

vëllazërore, perëndishmërinë, dashurinë hyjnore, përvulësinë, zellin.”⁶

Secili prej jush, tek i cili arrin zëri im, mjaft mirë mund t'i bëjë vetes pyetjen: “Sot, a jam rritur në besim, në virtyt, në njohuri, në perëndishmëri, në dashuri?”

Përmes përkushtimit tuaj të devotshëm në shtëpi ose jashtë saj, ata shpirta që ju i ndihmoni të shpëtojnë, mjaft mirë mund të jenë ata që i doni më shumë.

Shumë vite më parë, miqtë e mi të dashur, Krejg Sudbëri dhe e ëma, Perla, erdhën në zyrën time para nisjes së Krejgut për në Misionin e Australisë – Melburn. Fred Sudbëri, i ati i Krejgut, dukej që mungonte. Njëzet e pesë vjet më parë, e ëma e Krejgut qe martuar me Fredin, që nuk kishte po të njëjtën dashuri si ajo për Kishën dhe në të vërtetë nuk qe anëtar.

Krejgu më tregoi në mirëbesim dashurinë e tij të thellë e të qëndrueshme për prindërit dhe shpresën e tij se disi, në ndonjë mënyrë, i ati do të prekej nga Shpirti dhe do ta hapte zemrën ndaj ungjillit të Jezu Krishtit. U luta për frymëzim lidhur me mënyrën se si mund të përmbushej një dëshirë

e tillë. Frymëzimi erdhi dhe unë i thashë Krejgut: “Shërbeji Zotit me të gjithë zemrën tënde. Ji i bindur ndaj thirrjes tënde të shenjtë. Çdo javë, shkruaj letër prindërve të tu dhe, me raste, shkruaj Babait veçmas e bëji të ditur se sa shumë e do dhe tregoji se përse je mirënjohës që je biri i tij.” Ai më falënderoi dhe me të ëmën u larguan nga zyra.

Nuk e kisha parë nënën e Krejgut për afro 18 muaj, kur erdhi në zyrën time dhe me fjali të ndërprera nga lot më tha: “Kanë kaluar pothuaj dy vjet që kur Krejgu u largua për në misionin e tij. Ai kurrë nuk ka harruar të na shkruajë letër çdo javë. Kohët e fundit, im shoq, Fredi, u ngrit për herë të parë në një mbledhje dëshmie dhe më befasoi mua dhe e habiti së tepërmi këdo që ishte atje duke shpallur se kishte marrë vendim të bëhej anëtar i Kishës. Ai tregoi se unë dhe ai do të shkonim në Australi për të takuar Krejgun në fund të misionit të tij në mënyrë që Fredi të mund të ishte pagëzimi i fundit i Krejgut si misionar kohëplotë.”

Asnjë misionar nuk kishte qenë më ballëlart sesa Krejg Sudbëri kur, në

Australinë e largët, ndihmoi të atin të futej në ujë gjer në mes dhe duke ngritur krahun e djathtë në kënd të drejtë, përsëriti ato fjalë të shenjta: “Frederik Çarls Sudbëri, duke qenë i autorizuar nga Jezu Krishti, unë të pagëzoj ty në emër të Atit dhe të Birit dhe të Frymës së Shenjtë”.

Dashuria kishte arritur fitoren e saj. **Shërbejini Zotit me dashuri.**

Vëllezër, secili prej nesh i **kërkofhtë me zell shkrimet e shenjta, e planifikofhtë jetën e vet me pikësnyim, e dhëntë mësim të vërtetën me dëshmi dhe i shërbeftë Zotit me dashuri.**

Bariu i përsosur i shpirtave tanë, misionari që shëlbeu njerëzimin, na dha sigurimin e Tij hyjnor:

“Dhe nëse është që ju duhet të punoni gjithë ditët tuaja për t'u shpallur pendim këtyre njerëzve dhe sillni qoftë edhe një shpirt tek unë, sa i madh do të jetë gëzimi juaj me të në mbretërinë e Atit tim!

Dhe tani, nëse gëzimi juaj do të jetë i madh me një shpirt që keni sjellë tek unë në mbretërinë e Atit tim, sa i madh do të jetë gëzimi juaj nëse do të më sillni shumë shpirta!”⁷

Unë shpall dëshminë time për Atë që i tha këto fjalë: “Ai është biri i Perëndisë, Shëlbuesi ynë dhe Shpëtimtari ynë”.

Unë lutem që të mund t'i përgjigjemi përherë ftesës së Tij të dashur: “Ti ndiqmë”⁸. Në emrin e Tij të shenjtë – madje të Jezu Krishtit, Zotit – amen. ■

SHËNIAME

1. “Come, All Ye Sons of God [Ejani Bij t'Per'ndis’]”, *Hymns*, nr. 322.
2. Mateu 28:19–20.
3. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith (2007)*, f. 349.
4. Alma 17:2–3.
5. 1 Pjetrit 3:15.
6. Doktrina e Besëlidhje 4:2, 5–6.
7. Doktrina e Besëlidhje 18:15–16.
8. Gjoni 21:22.





Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Shpresa e Dritës së Perëndisë

Teksa kërkojmë ta shtojmë dashurinë për Perëndinë dhe të përpiqemi ta duam të afërmin tonë, drita e ungjillit do të na rrethojë e ngrejë moralisht.

Hyrja për te Ndrichimi i Mendjes

Më pëlqen së tepërmi një pikturë në zyrën time që titullohet *Hyrja për te Ndrichimi i Mendjes*. U krijua nga një mik i imi, artisti danez Johan Benthin, i cili ishte presidenti i parë i kunjtit në Kopenhagë të Danimarkës.

Piktura tregon një dhomë të errët me një derë të hapur nga e cila po shkëlqen drita. Është interesante për mua që drita që vjen nga dera nuk e ndriçon të gjithë dhomën – vetëm hapësirën pikërisht përballë derës.

Për mua, errësira dhe drita në këtë pikturë janë një metaforë për jetën. Është pjesë e gjendjes sonë si qenie të vdekshme që ndonjëherë të ndihemi sikur jemi rrethuar nga errësira. Mund të kemi humbur një njeri të dashur; një fëmijë mund të ketë dalë nga udha; mund të kemi marrë një diagnozë mjekësore shqetësuese; mund të kemi sfida punësimi dhe të jemi rënduar me dyshime apo frikë; ose mund të ndihemi të vetmuar apo pa dashuri.

Por edhe pse mund të ndihemi të humbur në mes të rrethanave tona të

tanishme, Perëndia premton shpresën e dritës së Tij – Ai premton të na e ndriçojë udhën përpara nesh dhe të na tregojë udhën për të dalë nga errësira.

Një Dhomë e Mbushur me Errësirë

Do të doja t'ju tregoja rreth një gruaje që u rrit në një dhomë të mbushur me errësirë – do ta quaj Xhejni.

Nga koha kur Xhejni ishte tri vjeçe, ajo u rrah, u poshtërua dhe u dhunua në mënyrë të përsëritur. Ajo u kërcënua dhe u përqesh. Ajo zgjohej çdo mëngjes duke mos e ditur nëse do të mbijetonte deri të nesërmen. Njerëzit që duhet ta kishin mbrojtur, ishin ata që e torturonin apo e lejonin dhunën të vazhdonte.

Në mënyrë që të vetëmbrohej, Xhejni mësoi të pushonte së ndieri. Ajo nuk kishte shpresë për shpëtim, ndaj e ngurtësoi veten para tmerrit të realitetit. Nuk kishte dritë në botën e saj, ndaj ajo iu dorëzua errësirës. Me një mpirje që mund të vijë vetëm nga kontakti i vazhdueshëm e i pandërprerë me të keqen, ajo e pranoi

faktin se çdo çast mund të ishte i fundit për të.

Më pas, në moshën 18-vjeçare, Xhejni zbuloi Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Gëzimi dhe shpresa e ungjillit të rivendosur ia depërtuan zemrën dhe ajo e pranoi ftesën për t'u pagëzuar. Për herë të parë, drita hyri në jetën e saj dhe ajo pa një shteg të shndritshëm përpara. U largua nga errësira e botës së saj dhe vendosi të shkonte në një shkollë shumë larg dhunuesit të saj. Më në fund, ajo u ndje e çliruar nga një mjedis errësire dhe ligësie – e lirë për të gëzuar paqen e ëmbël dhe shërimin mrekullibërës të Shpëtimtarit.

Sidoqoftë, vite më vonë, pasi dhunuesi i saj kishte vdekur, Xhejni qe sërish e shqetësuar nga ndodhitë e tmerrshme të rinisë së saj. Trishtimi dhe zemërimi i thellë rrezikonin ta shkatërronin dritën e mrekullueshme që ajo kishte gjetur tek ungjilli. Ajo e kuptoi se nëse do ta lejonte errësirën ta gërryente, torturuesi i saj do të merrte fitore përfundimtare.

Ajo kërkoi këshillim e ndihmë mjekësore dhe filloi ta kuptonte se, për të, mënyra më e mirë për t'u shëruar ishte të kuptonte dhe të pranonte se errësira ekziston – por nuk duhet jetuar atje. Sepse, sikurse e dinte ajo tanimë, edhe drita ekziston – dhe ai është vendi ku zgjodhi të jetojë.

Për shkak të së kaluarës së saj të errët, Xhejni mund të ishte bërë me lehtësi hakmarrëse, e vrerosur ose madje e dhunshme. Por nuk u bë. Ajo i bëri qëndresë tundimit për të shpërndarë errësirën duke shpërthyer në zemërim, lëndim apo cinizëm. Përkundrazi, ajo u kap fort pas shpresës se me ndihmën e Perëndisë mund të shërohej. Ajo zgjodhi të rrezatonte dritë dhe t'ia përkushtonte jetën ndihmës ndaj të tjerëve. Ky vendim i dha asaj mundësi ta linte pas të shkuarën



Autoritetet e Përgjithshme të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

PRESIDENCA E PARË



Henri B. Ajring
Këshilltar i Parë



Tomas S. Monson
President



Dieter F. Uchtdorf
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMËDHJETË APOSTUJVE



Boyd K. Packer



L. Tom Perry



Russell M. Nelson



Dallin H. Oaks



M. Russell Ballard



Riçard G. Skot



Robert D. Hejls



Xhefiri R. Holland



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen

PRESIDENCA E TË SHTATËDHJETËVE



Ronald A. Rasband



L. Ulmi Klejton



Donald L. Hallstrom



Ted R. Kelister



Riçard J. Meinis



Kreig C. Kristensen



Ulises Soaresh

KUORUMI I PARË I TË SHITATËDHJETËVE

(sipas rendit alfabetik)



Markos A. Adjakakis



Hoze L. Alonso




Karlos H. Amado



Jan S. Aldern



Mervin B. Arnold



Dejvis S. Balsler



Shein M. Bowen



Keig A. Cardon



Jun Huo Çoi



Don R. Clark



Karl B. Kuk



Lorens E. Kobrich



Klaudio R. M. Kosta



LeGrand R. Kurris i Riu



Benjamin De Hojps



Xhon B. Dikson



Eduard Dobri



Kevin R. Dankan



Leni J. Eko Houk



Stefil G. Elis



Dejvid E. Evans



Enrike R. Falabala



Eduardo Gavaret



Robert C. Gai



Karlos A. Gadoi




Kristofel Golden i Riu



Geit W. Gong



Uolter F. Gonzales



C. Skot Grou



Xhejms J. Hamula



Daniel L. Xhanson




Poi V. Xhanson



Patrik Kijanon



Poi E. Kalliker



Erik W. Kopshke



Markus B. Nash



S. Giford Nilsen



Brent H. Nilson



Alan F. Paber



Kevin W. Prason



Entoni D. Peckins



Poi B. Pajper



Rafael E. Pino




Brus D. Porter



Dej G. Renlund



Mjajkell T. Ringud



Lin G. Robins



Xhozef W. Shtari



Shteni E. Snou



Mjajkell Xhon U. Teh



Uilford W. Andersen



Koçij Aojogij



Rendall K. Benet



Bus A. Karlson



J. Devn Kornish



Timothi J. Dajks



Bredli D. Foster



Rend D. Frank



O. Vinsent Hatak



Kevin S. Hamilton



Leni R. Lorens



Per G. Malm



Xhejms B. Marriho



Jaro Maccagardi



Adhian Oçoa



Kent F. Rigards



Gregora A. Shwicer



Terens M. Vinson



Kent D. Utason



Leni Y. Ulison



Don R. Clark



Kevin R. Dankan



Alan F. Paber



Shteni E. Snou



Mjajkell Xhon U. Teh



Horge F. Zebalao



Uolter F. Gonzales



Skot D. Uajing



F. Mjajkell Utason



Uiljam R. Uolker



W. Kristofer Uajali



Francisco J. Vmijos



Amulfo Valenaralo



Huan A. Ueredo



W. Keig Zulk



Dejvid E. Evans



Enrike R. Falabala



Eduardo Gavaret



Robert C. Gai



Karlos A. Gadoi



Kristofel Golden i Riu



Geit W. Gong



Uolter F. Gonzales



C. Skot Grou



Xhejms J. Hamula



Kevin W. Prason



Mjajkell Xhon U. Teh



Horge F. Zebalao



Uolter F. Gonzales



Skot D. Uajing



F. Mjajkell Utason



Uiljam R. Uolker



W. Kristofer Uajali



Francisco J. Vmijos



Amulfo Valenaralo



Huan A. Ueredo



W. Keig Zulk

PESHKOPATA KRYESEUE



Zherard Kocë
Këshilltar i Pate



Geri E. Swenson
Peshkopari Kryesues



Din M. Dejvis
Këshilltar i Dytë



Shenjtoret e ditëve të mëvonshme anekënd botës mbliidhen për Konferencën e Përgjithshme Vjetore të 183-të. Te fotografitë sipas drejtimit të akrepave të orës nga e majta lart janë anëtarë të Kishës dhe misionarë në Guajakil, Ekuador; Pretoria, Afrika e Jugut; Santiago, Kili; Kopenhagë, Danimarkë; Nju-Jork-Siti, Nju-Jork, SHBA; Brazilia, Brazil; dhe Edinburg, Skoci.

dhe të ecte drejt një të ardhme të lavdishme.

Ajo u bë mësuese shkollë dhe sot, disa dhjetëvjeçarë më vonë, dashuria e saj ka ndikuar në jetën e qindra fëmijëve, duke i ndihmuar ata të dinë se kanë vlerë, se janë të rëndësishëm. Ajo është bërë mbrojtëse e palodhur e të dobtëve, viktimave dhe të shkurajuarve. Ajo ndërton, forcon dhe frymëzon çdokënd rreth saj.

Xhejni mësoi se shërimi vjen kur largohemi nga errësira dhe ecim drejt shpresës për një dritë më të shkëlqyeshme. Ishte në zbatimin praktik të besimit, shpresës dhe dashurisë hyjnore që ajo jo vetëm e shndërroi jetën e saj, por ua bekoi jetën përgjithnjë shumë e shumë të tjerëve.

Drita Kapet Pas Dritës

Mund të ketë disa mes jush që ndiejnë errësirën t'i rrethojë gjithnjë e më shumë. Ju mund të ndiheni të rënduar me shqetësim, frikë apo dyshim. Juve dhe të gjithëve ne, ju përsëris një të vërtetë të mrekullueshme e të sigurt: Drita e Perëndisë është e vërtetë. Është e disponueshme për të gjithë! Ajo i jep jetë gjithçkaje.¹ Ajo ka fuqinë ta zbusë dhembjen e plagës më të thellë. Mund të jetë një balsam shërues për vetminë dhe sëmundjen e shpirtrave tanë. Në brazdat e dëshpërimit, ajo mund të mbjellë farat e një shprese më të shndritshme. Ajo mund të ndriçojë luginat më të thella të hidhërimit. Mund të ndriçojë shtegun para nesh dhe të na udhëheqë përmes natës më të errët drejt premtimit për një agim të ri.

Ky është "Shpirti i Jezu Krishtit", që i jep "dritë çdo njeriu që vjen në botë".²

Megjithatë, drita shpirtërore rralleherë u vjen atyre që thjesht ulen në errësirë duke pritur që dikush të shtypë çelësin e dritës. Duhet një gjest besimi që të na i hapë sytë për Dritën



e Krishtit. Drita shpirtërore nuk mund të shquhet nga sytë e mishit. Vetë Jezu Krishti dha mësim: "Unë jam drita që shkëlqen në errësirë dhe errësira nuk e kupton atë".³ Sepse "njeriu natyror nuk i rrok gjërat që janë të Frymës së Shenjtë; sepse për të janë marrëzi dhe nuk mund t'i njohë; sepse ato gjykojnë frymërisht".⁴

Pra, si i hapim ne sytë për shpresën e dritës së Perëndisë?

Së pari, fillojeni aty ku jeni.

A nuk është e mrekullueshme të dini se nuk na duhet të jemi të përsosur për të përjetuar bekimet dhe dhuratat e Atit tonë Qiellor? Neve nuk na duhet të presim derisa të përsosemi për të marrë bekimet e Perëndisë. Në fakt, qiejt fillojnë të hapen dhe bekimet e qiellit fillojnë të pikojnë sipër nesh që prej hapave të parë që hedhim drejt dritës.

Vendi i përsosur për të filluar është pikërisht aty ku jeni tani. Nuk ka rëndësi sa të kualifikuar mund të mendoni se jeni apo sa prapa të tjerëve mund të ndiheni. Vetë çasti kur filloni të kërkonte Atin tuaj Qiellor, në atë çast, shpresa e dritës së Tij do të nisë ta zgjojë, ta gjallërojë dhe ta fisnikërojë shpirtin tuaj.⁵ Errësira mund të mos shpërbëhet e gjitha menjëherë, por me aq siguri sa nata i lë vendin agimit, drita do të vijë.


Së dyti, drejtojeni zemrën tuaj nga Zoti.

Derdhëni shpirtin tuaj në lutje dhe shpjegojani Atit tuaj Qiellor atë që po ndieni. Pranojini të metat tuaja. Hapeni zemrën tuaj dhe shprehni mirënjohjen tuaj. Bëjani Atij të ditur sprovat që po hasni. Lutjuni Atij në emrin e Krishtit për forcë dhe mbështetje. Kërkoni që t'ju hapen veshët, që të mund ta dëgjoni zërin e Tij. Kërkoni që t'ju hapen sytë, që të mund ta shihni dritën e Tij.

Së treti, ecni në dritë.

Ati juaj Qiellor e di se do të bëni gabime. Ai e di se ju do të ngecni – ndoshta shumë herë. Kjo e trishton Atë, por Ai ju do. Ai nuk dëshiron që të shkurajoheni. Përkundrazi, Ai dëshiron që të ngriheni dhe të bëheni njeriu që jeni paracaktuar të bëheni.

Për atë qëllim, Ai e dërgoi Birin e Tij për të ndriçuar udhën dhe për të na treguar se si t'i kapërcejmë me siguri blloqet penguese të vendosura në shtegun tonë. Ai na ka dhënë ungjillin, që jep mësim udhën e dishepullit. Ai na mëson gjërat që duhet të dimë, të bëjmë dhe të jemi për të ecur në dritën e Tij duke ndjekur gjurmët e hapave të Birit të Tij të Dashur, Shpëtimtarit tonë.



Drita e Mposht Errësirën

Po, ne do të bëjmë gabime.

Po, do të çalojmë.

Por teksa kërkojmë ta shtojmë dashurinë për Perëndinë dhe të përpiqemi ta duam të afërmin tonë, drita e ungjillit do të na rrethojë e ngrejë moralisht. Errësira do të tretet me siguri, sepse nuk mund të ekzistojë në prani të dritës. Teksa afrohem me shumë me Perëndinë, Ai do të afrohet me ne.⁶ Dhe, ditë pas dite, shpresa e dritës së Perëndisë do të shkëlqejë brenda nesh “gjithnjë e më shumë, derisa dita është e plotë”⁷.

Të gjithë ju që ndieni se ecni në errësirë, ju ftoj të mbështeteni te ky premtim i sigurt i shprehur nga Shpëtimtari i njerëzimit: “Unë jam drita e botës; kush më ndjek nuk do të ecë në errësirë, por do të ketë dritën e jetës”⁸.

Një Dritë në Afrikë

Disa vite më parë, gruaja ime, Herieta dhe unë, patëm një përvojë të paharrueshme tek e cila e pamë këtë premtim të përmbushej. Ne ishim

në Afrikën Perëndimore, një pjesë e bukur e botës ku Kisha po rritet dhe shenjtorët e ditëve të mëvonshme janë plot hir. Sidoqoftë, Afrika Perëndimore ka edhe shumë sfida. Në veçanti, u hidhërova nga varfëria që pashë. Në qytete ka papunësi të madhe dhe familjet shpesh heqin shumë për të siguruar të ardhura për nevojat ditore dhe për sigurinë e tyre. Më këputi zemrën të merrja vesh se shumë prej anëtarëve tanë të çmuar të Kishës jetojnë në një varfëri të tillë. Por mësova edhe se këta anëtarë të shkëlqyer e ndihmojnë njëri-tjetrin për t'i lehtësuar barrat e tyre të rënda.

Ne përfundimisht mbërritëm te një prej shtëpive të mbledhjeve pranë një qyteti të madh. Por në vend që të gjenim një popull të rënduar dhe të gëlltitur nga errësira, ne zbuluam një popull të gëzuar që rrezatonte me dritë! Lumturia që ndienin për ungjillin ishte ngjithëse dhe na ngriti shpirtërisht. Dashuria që shprehën për ne, ishte përulëse. Buzëqeshjet e tyre ishin të çiltra e infektuese.

Më kujtohet se pyesja veten në atë kohë nëse mund të kishte një popull më të lumtur në faqen e dheut. Edhe pse këta shenjtorë të dashur u rrethuan nga vështirësitë dhe sprovat, ata u mbushën me dritë!

Mbledhja filloi dhe unë fillova të flisja. Por shpejt, iku energjia elektrike në ndërtesë dhe mbetëm në errësirë të plotë.

Për pak kohë, nuk mund të shihja asnjë në bashkësi, por mund t'i shihja e t'i ndieja buzëqeshjet e shkëlqyeshme e të bukura të shenjtorëve tanë. O, sa më pëlqente të rrija me këta njerëz të mrekullueshëm!

Errësira në godinën kishtarë vazhdoi dhe kështu unë u ula pranë sime shoqeje dhe prita që të rikthehej energjia elektrike. Teksa prisnim, ndodhi diçka e mahnitshme.

Disa zëra filluan të këndonin një nga himnet e Rivendosjes. Dhe pastaj të tjerë u bashkuan me ta. Dhe pastaj më shumë të tjerë. Shpejt, një kor i ëmbël dhe pushtues zërash e mbushi godinën kishtarë.

Këtyre anëtarëve të Kishës nuk iu duheshin librat e himneve; ata e dinin çdo fjalë të çdo himni që kënduan. Dhe pastaj kënduan këngë njëra pas tjetres me një energji dhe ndjenjë që ma prekën shpirtin.

Përfundimisht, drita shkëlqeu sërish dhe e mbushi dhomën me dritë. Herieta dhe unë, pamë nga njëri-tjetri, faqet tona qenë të lagura me lotë.

Në mes të errësirës së madhe, këta shenjtorë të bukur e të mrekullueshëm i kishin mbushur ndërtesën e Kishës dhe shpirtrat tanë me dritë.

Ishte një çast thellësisht prekës për ne – një çast që unë dhe Herieta nuk do ta harrojmë kurrë.

Ejani në Dritë

Po, herë pas here, jeta jonë mund të duket e prekur ose madje e

mbështjellë nga errësira. Nganjëherë, nata që na rrethon, do të na duket shtypëse, shkurajuese dhe frikësuese.

Zemra ime vajton për shumë hidhërimi që disa prej jush hasni, për vetminë e dhembshme dhe frikën këputëse që mund të jeni duke përjetuar.

Megjithatë, unë jap dëshmi se shpresa jonë e gjallë është te Jezu Krishti! Ai është porta e vërtetë, e pastër dhe e fuqishme për te ndriçimi hyjnor.

Dëshmoj se me Krishtin, errësira nuk mund t'ia dalë mbanë. Errësira nuk do të marrë fitore mbi dritën e Krishtit.

Jap dëshmi se errësira nuk mund të qëndrojë përpara dritës shkëlqyese të Birit të Perëndisë së gjallë!

E ftoj secilin prej jush t'ia hapë zemrën Atij. Kërkojeni Atë përmes studimit dhe lutjes. Kjo është Kisha e Tij, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ejani në Kishën e Tij, mësoni rreth Tij dhe ungjillit të Tij, merrni pjesë aktivisht, ndihmoheni njëri-tjetrin dhe shërbejini me gëzim Perëndisë tonë.

Vëllezër e motra, edhe pas natës më të errët, Shpëtimtari i botës do t'ju udhëheqë drejt një agimi shkallë-shkallë, të ëmbël e të shndritshëm që do të zbardhë me siguri brenda jush.

Teksa ecni drejt shpresës së dritës së Perëndisë, do të zbuloni mëshirën, dashurinë dhe mirësinë e një Ati të dashur Qiellor “në [të cilin] nuk ka kurrfarë errësirë”⁹. Për këtë dëshmoj në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:11–13.
2. Doktrina e Besëlidhje 84:45–46
3. Doktrina e Besëlidhje 6:21
4. 1 Korintasve 2:14
5. Shih Alma 34:31.
6. Shih Jakobi [Bibla] 4:8; Doktrina e Besëlidhje 88:63.
7. Doktrina e Besëlidhje 50:24
8. Gjoni 8:12
9. 1 Gjoni 1:5



Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Është një Mrekulli

Nëse nuk jeni një misionar kohëplotë me një etiketë misionari të kapur në pallton tuaj, tani është koha që ta pikturoni një [të tillë] në zemrën tuaj – të ngjyrosur, siç tha Pali “jo me bojë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë”.

Jeta në vdekshmëri e Jezu Krishtit ishte e mbushur me mrekulli: një nënë e virgjër, një yll i ri, engjëjt që iu shfaqën barinjve, i verbri që pa, i çali që eci, engjëjt në Gjetseman e në varr dhe, mrekullia më e madhe e të gjithave, – Ringjallja e Tij e lavdishme.

A mund ta përfytyroni skenën e njëmbëdhjetë Apostujve në malin pranë Galilesë, kur Zoti i ringjallur erdhi tek ata dhe tha: “Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë”¹? “Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin çdo krijese.”²

“Të gjithë popujt”? “Mbarë botën”? “Çdo krijese”? A qe e mundur kjo? Megjithëse Jezusi i siguroi, ata duhet ta kenë pyetur veten nëse mrekullitë me të vërtetë do t'i shoqëronin ata në përhapjen e ungjillit.³

Besimi e mposhti dyshimin dhe Pjetri foli me zë të lartë, duke thënë:

“Ju të gjithë që banoni në Jeruzalem, . . . dëgjoni me vëmendje fjalët e mia. . . .

. . . Jezusi Nazareas, . . . [të cilin] ju e zutë dhe, me duart e të padrejtëve, e gozhduat në kryq dhe e vratë. . . .

Këtë Jezus . . . Perëndia e ka

ringjallur; dhe . . . të gjithë ne jemi dëshmitarë!”⁴

Pati manifestime shpirtërore të pamohueshme atë ditë dhe 3.000 shpirtra u pagëzuan. Sikurse premtoi Jezusi, shenjat dhe mrekullitë po ndiqnin besimin e besimtarëve.

Ndërsa Kisha e Jezu Krishtit u rivendos në tokë 183 vjet më parë, detyra e Zotit për grupin e Tij të vogël të dishepujve i bëri jehonë fjalëve të Tij të thëna shekuj më parë: “Zëri i paralajmërimit do të shkojë te gjithë njerëzit”⁵. “Sepse, në të vërtetë, tingulli duhet të shkojë . . . në të gjithë botën dhe në skajet më të largëta të tokës.”⁶

“Gjithë njerëzit”? “Gjithë botën”? “Skajet më të largëta të tokës”? A qe e mundur kjo?

Shpëtimtari i siguroi sërish shenjtorët e Tij të ditëve të mëvonshme⁷, por a mund ta parashikonin ata shtrirjen dhe fatin e kësaj vepre të mrekullueshme? Ata duhet ta kenë pyetur veten nëse mrekullitë me të vërtetë do t'i shoqëronin ata në përhapjen e ungjillit.

Sërish, besimi e mposhti dyshimin dhe mijëra u pagëzuan. Në Angli, Plaku Uillford Udraf zbuloi një komunitet të tërë duke pritur ardhjen e tij. Shpirti i Zotit ra mbi ta dhe ai

pagëzoi 45 predikues dhe disa qindra anëtarë gjatë muajit të parë në fermën “Benbou”⁸.

Koha jonë nuk është e ndryshme. Kur Plaku Dejvid A. Bednar dhe unë ishim misionarë, afro 40 vjet më parë (dhe mund t’ju siguroj se nuk jemi misionarët e kthyer më të moshuar të ulur në karriget e kuqe), kishte 16.000 misionarë. Siç njoftoi dje Presidenti Tomas S. Monson, tani kemi 65.000 – më shumë se kurrë më parë. Atëherë kishte 562 kunje. Sot ka më shumë se 3.000. Në atë kohë, lagjet dhe degët tona qenë në 59 vende. Sot kemi organizuar kongregacione në 189 nga 224 vende dhe territore të botës. Ne jemi të paktë në numër, tamam siç parashikoi Nefi.⁹ Por në të njëjtën kohë, unë dhe ju jemi dëshmitarë të fjalëve profetike të Danielit: “Gur[i] . . . shkëput[et] . . . jo nga dora e njeriut . . . [duke mbushur] tërë tokën”¹⁰.

Koha jonë është një kohë e shquar mrekullish. Gjashtë muaj më parë, kur Presidenti Monson njoftoi ndryshimin e moshës së të rinjve dhe të rejave që dëshirojnë të shërbejnë në mision, pati manifestime shpirtërore të pamohueshme. Besimi e mposhti dyshimin dhe të rinjtë e të rejtat shkuan përpara. Të enjten pas konferencës, unë u caktova t’i rekomandoja Presidencës së Parë thirrjet për mision. U mahnita të shihja kërkesat e meshkujve 18–vjeçarë dhe vajzave 19–vjeçare, që tanimë i kishin rregulluar planet e tyre, i kishin vizituar doktorët e tyre, ishin intervistuar nga peshkopët dhe presidentët e kunjeve të tyre dhe i kishin dërguar kërkesat e tyre për punë misionare – të gjitha në vetëm pesë ditë. Mijëra më shumë tani i janë bashkuar atyre. Është një mrekulli.

Jemi mirënjohës për besimin që rrezaton energji të motrave tona misionare, numrin në rritje të misionarëve nga vende anekënd botës dhe numrin

në rritje të çifteve të gatshëm për të shërbyer. Pesëdhjetë e tetë misione të reja janë njoftuar dhe qendra jonë e mbipopulluar e trajnimit të misionarëve në Provo ka gjetur mrekullisht një simotër të re në Meksiko–Siti.

Presidenti Tomas S. Monson ka thënë: “Ne e konsiderojmë me seriozitetin maksimal urdhrin e Shpëtimtarit . . . : ‘Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë’.”¹¹ “Kjo kauzë . . . do të vazhdojë të shkojë përpara, duke ndryshuar dhe bekuar jetë. . . . Asnjë forcë në të gjithë botën nuk mund ta ndalojë punën e Perëndisë.”¹²

Ne po dëshmojmë mrekullitë e Zotit ndërsa ungjilli i Tij po përhapet nëpër botë.

Vëllezër e motra, me aq siguri sa Zoti ka frymëzuar më shumë misionarë për të shërbyer, Ai gjithashtu po zgjon mendjet dhe po hap zemrat e më shumë njerëzve të mirë e të ndershëm për të pranuar misionarët e Tij. Ju tashmë i njihni apo do t’i njihni ata. Ata janë në familjen tuaj dhe jetojnë në lagjen tuaj. Ata ecin duke u shkëmbyer me ju në rrugë, ulen pranë jush në shkollë dhe lidhen me ju në internet. Edhe ju jeni një pjesë e rëndësishme e kësaj mrekullie që po shpaloset.

Nëse nuk jeni një misionar kohëplotë me një etiketë misionari të kapur në pallton tuaj, tani është koha që ta pikturoni një [të tillë] në zemrën tuaj – të ngjyrosur, siç tha Pali “jo me bojë, por me Frymën e Perëndisë së gjallë”¹³. Dhe [ju] misionarë të kthyer, gjejeni etiketën tuaj të vjetër misionare. Mos e vini, por lëreni atje ku mund ta shihni. Zoti ka nevojë për ju tani më shumë se asnjëherë që të jeni një mjet në duart e Tij. Të gjithë ne kemi një kontribut për të bërë për këtë mrekulli.

Çdo anëtar i drejtë i Kishës ka menduar rreth mënyrës se si ta ndajë ungjillin. Disa e ndajnë atë natyrshëm dhe mund të mësojmë shumë prej tyre.¹⁴ Disa luftojnë dhe pyesin veten si ta ndajnë më mirë, duke uruar që ndjenja e fajit që ndiejmë ndonjëherë, do të gjejë një vend tjetër për të shkuar.

Dëshira jonë për të ndarë ungjillin na bën të gjithëve ne të gjuhëzohemi dhe duhet të na bëjë të gjuhëzohemi, sepse kemi nevojë për ndihmën e Zotit.

Presidenti Monson ka kërkuar që të lutemi për “[ato] zona ku ndikimi ynë është i kufizuar dhe ku ne nuk lejohejmë ta ndajmë ungjillin lirisht”¹⁵. Ndërsa i kërkojmë me zell dhe të bashkuar Atit tonë në Qiell, Zoti do të vazhdojë të hapë dyer të rëndësishme për ne.

Ne gjithashtu lutemi për mundësitë tona vetjake për të ndarë ungjillin. Apostulli Pjetër tha: “Jini gjithnjë gati për t’u përgjigjur në mbrojtjen tuaj kujtdo që . . . kërkon shpjegime për shpresën që është në ju”¹⁶.

Me përshtjellimin¹⁷ dhe rrëmujën¹⁸ e botës së sotme, nuk është çudi që më pak njerëz po i frekuentojnë vendet e tyre të adhurimit. Edhe pse shumë njerëz dëshirojnë të jenë më afër Perëndisë dhe ta kuptojnë më mirë qëllimin e jetës, ata kanë pyetje pa përgjigje. Shumë vetë kanë zemra të hapura ndaj të vërtetës, por siç e përshkroi profeti Amosi: “ata . . . [po] rendin sa andej dhe këtej në kërkim të fjalës [së] Zotit, por nuk [mund] ta gjejnë”¹⁹. Ju mund të ndihmoni për t’iu përgjigjur pyetjeve të tyre. Në bisadat tuaja të përditshme ju mund ta rrisni besimin e tyre në Krisht.²⁰

Shpëtimtari tha: “Mbani lart dritën tuaj që të ndriçojë tërë botën. Vini re, unë jam drita që ju duhet të mbani lart.”²¹



Të martuar të premtën dhe të pagëzuar me fëmijët e tyre më të rritur të shtunën, këto çifte nga Mozambiku zgjedhën të ndiqnin Shpëtimtarin, Jezu Krishtin.

Ju premtoj se, ndërsa luteni për të ditur me kë të flisni, emrat dhe fytyrat do t'ju shfaqen në mendjen tuaj. Fjalët që duhet të flisni, do t'ju jepen pikërisht në çastin që keni nevojë për to.²² Do t'ju hapen mundësitë. Besimi do të mposhtë dyshimin dhe Zoti do t'ju bekojë pikërisht me mrekullitë tuaja vetjake.

Shpëtimtari na mësoi se si ta ndajmë ungjillin. Më pëlqen historia e Andreas, i cili pyeti: “Rabbi, ku banon?”²³ Jezusi mund t'i qe përgjigjur me vendin ku jetonte. Por, përkundrazi, Ai i tha Andreas: “Ejani e shikoni”²⁴. Më pëlqen të mendoj se Shpëtimtari po thoshte: “Ejani e shikoni jo vetëm ku jetoj por si jetoj. Ejani e shikoni kush jam. Ejani e ndieni Shpirtin.” Ne nuk dimë gjithçka rreth asaj dite, por vërtet dimë se kur Andrea e gjeti të vëllanë, Simonin, i shpalli: “E gjetëm . . . Krishti[n]”²⁵.

Ndaj atyre që tregojnë interes për bisedimet tona, ne mund të ndjekim shembullin e Shpëtimtarit duke i ftuar ata të “[vijjnë] e shikojnë”. Disa do ta pranojnë ftesën tonë dhe të tjerë jo. Ne të gjithë njohim dikë që është ftuar

disa herë përpara pranimit të një ftese për të “[ardhur] e shik[uar]”. Le të mendojmë edhe për ata që dikur ishin me ne por që tani i shohim rrallë, duke i ftuar të rikthehen dhe të shikojnë edhe një herë.

Ne e respektojmë zgjedhjen dhe kohën e secilit person. Zoti tha: “Le të zgjedhë çdokush vetë”²⁶. Mungesa e interesit të një personi nuk duhet të zvogëlojë lidhjet tona të miqësisë dhe dashurisë. Qoftë nëse pranohet ose jo ftesa ndërsa i ftoni të tjerët të “[vijjnë] e shikojnë”, ju do ta ndieni miratimin e Zotit dhe, bashkë me atë miratim, një masë të shtuar besimi për të ndarë vazhdimisht bindjet tuaja.

Për ata të cilët përdorin internetin dhe telefonat celularë, ka mënyra të reja për t'i ftuar të tjerët që të “[vijjnë] dhe shikojnë”. Le ta bëjmë më shumë pjesë të jetës sonë të përditshme ndarjen e besimit tonë në internet. LDS.org, Mormon.org, Facebook, Twitter – të gjitha ofrojnë mundësi.

Të rinjtë anëtarë në Boston, për të ndarë ungjillin, krijuan disa faqe diskutimesh.²⁷ Ata të cilët u bashkuan me Kishën, e filluan mësimin e tyre

në internet, të pasuar nga diskutimet me misionarët. Kjo përvojë gjithashtu e ndihmoi rininë të ketë besim më të madh për të folur personalisht rreth ungjillit. Njëri nga ata tha: “Kjo nuk është punë misionare. Ky është një argëtim misionar.”²⁸

Ne jemi të gjithë së bashku në këtë gjë. Me bashkëpunuesit dhe misionarët e lagjes, planifikojmë, lutemi dhe ndihmojmë njëri-tjetrin. Ju lutem, mbajini në mendimet e lutjet tuaja misionarët kohëplotë. Mirëbesojuni atyre familjen dhe miqtë tuaj. Zoti i mirëbeson ata dhe i ka thirrur të japin mësim dhe të bekojnë ata që e kërkojnë Atë.

Presidenti Paulo Kretli, i Misionit të Mozambikut, Maputo, ndau këtë përvojë: “Në Mozambik është e zakonshme [për] çiftet që të jetojnë bashkë [pa qenë të martuar për shkak se] tradita afrikane kërko[n] një prikë të shtrenjtë për t'u martuar, një prikë që shumë çifte nuk mund ta përballojnë”²⁹.

Anëtarët dhe misionarët menduan dhe u lutën se si të ndihmonin.

Përgjigjja ndaj lutjeve të tyre ishte se ata do të theksonin ligjin e dëlirësisë



dhe rëndësinë e martesës dhe familjeve të përjetshme. Dhe teksa ndihmonin çiftet të pendoheshin dhe të martoheshin ligjërisht, ata do të jepnin mësim për lumturinë që vjen vetëm përmes ndjekjes së Jezu Krishtit.

Kjo është një fotografi e çifteve nga dy qytete të ndryshme në Mozambik. Të martuar të premtën, u pagëzuan me fëmijët e tyre më të rritur të shtunën.³⁰ Miqtë dhe familja u ftuan që të "[vinin] dhe shikonin", dhe qindra vërtet "[erdhën] dhe [panë]".

Pas pagëzimit, një motër tha: "Ne duhej të zgjidhnim ose të ndiqnim traditat e etërve tanë ose të ndiqnim Jezu Krishtin. Zgjedhëm të ndiqnim Krishtin."³¹

Ju mund të mos jetoni në Mozambik, por në vetë mënyrën tuaj, në vetë kulturën tuaj, ju mund të ndani ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit.

Lutjuni Atit tuaj Qiellor. Kjo është puna e Tij e shenjtë. Ai do t'ju udhëheqë në atë që duhet të bëni. Ai do të hapë dyer, do të heq barrikada dhe do t'ju ndihmojë të mposhtni pengesa. Zoti shpalli: "Zëri i paralajmërimit do

të shkojë te gjithë njerëzit prej gojës së dishepujve të mi, . . . dhe askush s'do t'i ndalojë"³².

Dëshmoj se "zëri i Zotit [do të shkojë] te fundet e dheut që, gjithkush që do të dëgjojë le të dëgjojë"³³. Është një mrekulli. Është një mrekulli. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 28:19.
2. Marku 16:15.
3. Shih Mateu 28:20; Marku 16:17-18.
4. Veprat e Apostujve 2:14, 22-23, 32.
5. Doktrina e Besëlidhje 1:4.
6. Doktrina e Besëlidhje 58:64.
7. Shih Doktrina e Besëlidhje 1:5.
8. Shih *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f. 89-92.
9. Shih 1 Nefi 14:12.
10. Danieli 2:34-35.
11. Tomas S. Monson, "Mirësevini në Konferencë", *Liahona*, maj 2009, f. 5.
12. Tomas S. Monson, "Ndërsa Mbledhemi Përsëri", *Liahona*, maj 2012, f. 4.
13. 2 Korintasve 3:3.
14. Shih Clayton M. Christensen, *The Power of Everyday Missionaries: The What and How of Sharing the Gospel* (2013).
15. Tomas S. Monson, "Mirësevini në Konferencë", *Liahona*, nëntor 2009, f. 6.
16. 1 Pjetrit 3:15.
17. Ata vërejnë se idetë ose parimet e konsideruara të vërteta prej shumë kohësh, po

ripërkufizohen apo refuzohen; shih Doktrina e Besëlidhje 1:16; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 132:8.

18. Shih Doktrina e Besëlidhje 45:26; 88:91.

19. Amosi 8:12.

20. Profeti Jozef Smith tha: "A kanë presbiterianët ndonjë të vërtetë? Po. A kanë baptistët, metodistët etj., ndonjë të vërtetë? Po. . . . Ne duhet t'i mbledhim të gjitha parimet e sakta e të vërteta në botë dhe t'i përhapim" (*History of the Church*, 5:517). "Ne nuk i kërkojmë askujt të hedhë poshtë ndonjë të mirë që kanë; ne vetëm u kërkojmë atyre të vijnë dhe të marrin edhe më. Po sikur e gjithë bota të përqafojë Ungjillin? Ata atëherë do të shihnin sy më sy dhe bekimet e Perëndisë do të derdheshin mbi njerëzit, gjë që është dëshira e gjithë shpirtit tim" (*Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2009], f. 161). Presidenti Gordon B. Hinkli tha: "Më lejoni të them se e vlerësojmë të vërtetën te të gjitha kishat dhe të mirën që ata bëjnë. Ne u themi njerëzve, parimisht, sillni me vete gjithë të mirën që keni, dhe më pas na lejoni të shohim nëse mund ta rrisim atë. Ky është shpirti i kësaj vepre. Ky është thelbi i shërbimit tonë misionar" ("Words of the Living Prophet", *Liahona*, prill 1999, f. 19). "Ne duhet të jemi një popull miqësor. Ne duhet ta dallojmë të mirën te të gjithë njerëzit. Ne nuk shkojmë andej-këtej të kritikojmë kishat e tjera. Ne predikojmë dhe japim mësim në një mënyrë pozitive dhe pohuese. Ne u themi njerëzve të besimeve të tjera, 'sillni me vete gjithë të mirën që keni, dhe na lejoni të shohim nëse mund ta rrisim atë'. Ky është parimisht thelbi i programit tonë të mrekullueshëm misionar dhe ai jep rezultate" ("Messages of Inspiration from President Hinkley", *Church News*, 7 nëntor 1998, f. 2; shih ldschurchnews.com).

21. 3 Nefi 18:24.

22. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:85; 100:6.

23. Gjoni 1:38.

24. Gjoni 1:39.

25. Gjoni 1:41.

26. Doktrina e Besëlidhje 37:4.

27. Shih, për shembull, youngandmormon.com.

28. Bisedë telefonike me Jackson Haight-in më 22 mars 2013.

29. Mesazh elektronik personal nga Presidenti Paulo V. Kretly, 6 mars 2013.

30. Foto të siguruar nga Presidenti Paulo V. Kretly. Grupi i parë ishte nga Maputo; ata u martuan më 30 nëntor 2012 dhe u pagëzuan më 1 dhjetor 2012. Grupi i dytë ishte nga Beira; ata u martuan më 1 mars 2013 dhe u pagëzuan më 2 mars 2013.

31. Mesazh elektronik personal nga Presidenti Paulo V. Kretly, 6 mars 2013.

32. Doktrina e Besëlidhje 1:4-5.

33. Doktrina e Besëlidhje 1:11.



Nga Rozmari M. Uiksom,
Presidente e Përgjithshme e Fillores

Fjalët që Themi

Mënyra si u flasim fëmijëve tanë dhe fjalët që përdorim, mund t'i inkurajojnë dhe t'i ngrenë moralisht ata dhe ta forcojnë besimin e tyre që të qëndrojnë në shtegun e kthimit për tek Ati Qiellor.

Një baba i ri, së fundi mësoi se mësuesja e tij e jashtëzakonshme e klasës së dytë kishte ndërruar jetë. Në përkujtim të saj, ai shkroi: “Nga të gjitha ndjenjat dhe përvojat që kujtoj, ndjenja më mbi-zotëruese në mendjen time është ‘ngushëllimi’. Ajo mund të më ketë mësuar germëzimin, gramatikën dhe matematikën, por më me rëndësi, ajo më mësoi ta pëlqoja të qenit fëmijë. Në klasën e saj nuk ishte problem po të germëzoje keq një fjalë me raste: ‘Mirë, do të punojmë me të’, thoshte ajo. Nuk ishte problem të derdhje, shkulte apo grisje diçka: ‘Do ta rregullojmë dhe do ta pastrojmë’, përgjigjej ajo. Ishte mirë të përpiqeshe, të sfidoje veten, të ëndërroje dhe t'i shijojë ato kënaqësi që vijnë nga gjëra të parëndësishme që vetëm fëmijëve u duken emocionuese.”

Një prej ndikimeve më të mëdha që një njeri mund të ketë në botë, është ndikimi ndaj një fëmije. Bindjet e fëmijëve dhe vetëvlerësimi kriohen herët në jetën e tyre. Çdokush që më dëgjon të flas, ka fuqinë ta shtojë besimin e një fëmije te vetja dhe ta shtojë besimin e një fëmije tek Ati Qiellor dhe Jezu Krishti përmes fjalëve që thotë.

Te Helamani kapitulli 5 lexojmë: “Dhe tani bijtë e mi, mbani mend, mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj”¹.

Këto qenë *fjalët* që Helamani ua mësoi bijve të tij. Dhe vazhdojmë të lexojmë: Dhe ne vazhdojmë të lexojmë: “Dhe ata i mbajtën mend *fjalët* e tij; dhe . . . u nisën, . . . për t’u mësuar fjalën e Perëndisë të gjithë njerëzve”².

Edhe pse bijtë e Helamanit u përndoqën dhe u burgosën, ato fjalë që



kishin dëgjuar, nuk i lanë kurrë në baltë. Ata u mbrojtën dhe u rrethuan nga një shtyllë zjarri. Më pas erdhi një zë, që u thoshte robëruesve të tyre:

“Pendohuni, pendohuni dhe mos kërkonini më të shkatërroni shërbëtorët e mi. . . .

. . . Nuk ishte një zë bubullime, as nuk ishte zëri i zhurmës së një trazire të madhe, por vini re, ishte një zë i qetë i një butësie të përsosur, sikur të ishte një pëshpëritje dhe depërtoi deri në thellësinë e shpirtit.”³

Ne mund të mësojmë prej atij zëri nga qielli. Nuk qe i lartë, qortues apo poshtërues; ishte një zë i qetë me butësi të përsosur, duke dhënë udhëzime të vendosur ndërkohë që jep shpresë.

Mënyra si u flasim fëmijëve tanë dhe fjalët që përdorim, mund t'i inkurajojnë dhe t'i ngrenë moralisht ata dhe ta forcojnë besimin e tyre që të qëndrojnë në shtegun e kthimit për tek Ati Qiellor. Ata vijnë në këtë botë të gatshëm për të dëgjuar.

Një shembull i një fëmije duke dëgjuar ndodhi në një dyqan cohërash. Dyqani qe mbushur me blerës kur u bë e qartë për të gjithë se një nënë ishte tmerruar sepse kishte humbur të birin vocërrak. Së pari, ajo po e thërriste në emër. “Konër”, thoshte ajo teksa ecte me shpejtësi nëpër dyqan. Teksa koha kalonte, zëri i saj u bë më i lartë dhe i furishëm. Shpejt, rojet e sigurisë së dyqanit u njoftuan dhe çdokush në dyqan u përfshi në kërkimin e fëmijës. Disa minuta kaluan pa mundur ta gjenin. Në mënyrë të kuptueshme nëna e Konërit, po shqetësohej më shumë me kalimin me kohës dhe po e thërriste me shpejtësi emrin e tij pa pushim.

Një kliente, pasi bëri një lutje në heshtje, pati mendimin se Konëri ndoshta qe brenda dyqanit dhe mund të frikësohej teksa e dëgjonte të ëmën



të klithte emrin e tij. Ajo ia përmendi këtë një gruaje tjetër të përfshirë në kërkim dhe ato bënë një plan shpejt e shpejt. Së bashku filluan të ecnin mes tryezave të cohërave duke i përsëritur qetësisht fjalët: “Konër, nëse ma dëgjon zërin, thuaj: ‘Jam këtu.’” Teksa ecnin ngadalë drejt anës së prapme të dyqanit duke e përsëritur atë frazë, pa dyshim që dëgjuan një zë të druajtur, të butë të thoshte: “Jam këtu”. Konëri po fshihej mes rrotullave të një cohe nën tryezë. Ishte një zë me butësi të përsosur që e nxiti Konërin të përgjigjej.

Të Lutemi që t’i Dimë Nevojat e një Fëmije

Për t’i folur zemrës së një fëmije, ne duhet të lutemi që të dimë nevojat e tij. Nëse lutemi që t’i dimë ato nevoja, vetë fjalët që themi mund të kenë fuqinë t’iu futen në zemër. Përpjekjet tona lartësohen kur kërkojmë udhëzimin e Frymës së Shenjtë. Zoti tha:

“Flisni mendimet që unë do të vë në zemrat tuaja, . . .

Sepse do t’ju jepet në orën e duhur, po, në çastin e duhur, se çfarë duhet të thoni.⁴

Të Shkëputemi dhe të Dëgjojmë me Dashuri

Fatkeqësisht, hutimet e kësaj bote u mohojnë shumë fëmijëve dëgjimin e fjalëve inkurajuese që mund të ndikojnë te mënyra se si ata e shohin veten.

Dr. Nill Hallfon, një mjek që drejton qendrën UCLA për Fëmijë, Familje dhe Komunitete më të Shëndetshme, flet për “shpërfilljen e mirë prindërore”. Një shembull përfshiu një 18-muajsh dhe prindërit e tij:

“Djali i tyre dukej i lumtur, aktiv dhe i përfshirë, duke e shijuar dukshëm kohën dhe picën me prindërit e tij. . . . Në fund të darkës, mami shkoi të merrej me një punë, duke ia lënë në dorë kujdesin babait.”

Babi . . . filloi të lexonte mesazhe në telefon teksa vogëlushi përpiqej t’ia tërhiqte vëmendjen duke i hedhur copëza nga korja e picës. Më pas, babi u angazhua sërish, duke u kthyer me fytyrë nga fëmija dhe duke luajtur me të. Megjithatë, shpejt, ai e zëvendësoi lojën me të parit e një videoje në telefon me vogëlushin derisa u kthye gruaa.

Në të dyja raste [Dr.] Hallfoni vëzhgoi një zbehje të dritës së

brendshme të fëmijës, një dobësim të lidhjes mes prindit dhe fëmijës.”⁵

Përgjigjja e lutjes sonë për mënyrën se si të përmbushim nevojat e fëmijëve tanë mund të jetë shkëputja më shpesh nga teknologjia. Çaste të çmura mundësisht për të ndërvepruar dhe biseduar me fëmijët tanë zhduken kur ne jemi të zënë me gjëra që na tërheqin vëmendjen. Përse të mos zgjedhim një kohë çdo ditë për t’u shkëputur nga teknologjia dhe për t’u rilidhur me njëri-tjetrin? Thjesht fikini të gjitha. Kur e bëni këtë, shtëpia juaj mund të duket e qetë në fillim; madje mund të ndiheni sikur nuk dini ç’të bëni apo thoni. Pastaj, kur u jepni vëmendje të plotë fëmijëve tuaj, do të nisë një bisedë dhe ju mund të kënaqeni duke dëgjuar njëri-tjetrin.

Të Shkruajmë për t’i Bindur Fëmijët Tanë

Ne mund të ndikojmë te fëmijët tanë edhe përmes fjalëve që u shkruajmë. Nefi shkruan: “Ne punojmë me zell që të shkruajmë, të bindim fëmijët tanë . . . të besojnë në Krisht dhe të pajtohen me Perëndinë”⁶.

Presidenti Tomas S. Monson tregoi përvojën e Xhej Hesit, një piloti ushtarak që iu qëllua dhe rrëzua avioni në Vietnamin Verior në vitet 1960: “Për dy vjet familja e tij nuk kishte asnjë ide nëse ai ishte i vdekur apo i gjallë. Robëruesit e tij në Hanoi, përfundimisht e lejuan t’i shkruante shtëpisë, por e kufizuan mesazhin e tij në më pak se 25 fjalë.” Presidenti Monson pyet: “Çfarë do t’i thoshim unë dhe ju familjeve tona nëse do të ndodheshim në të njëjtën situatë – pa i parë ata për më shumë se dy vjet dhe pa e ditur nëse do t’i shihnim më ndonjëherë? Duke dashur të jepte diçka që familja e tij ta kuptonte që vinte nga ai dhe duke dashur gjithashtu t’u jepte këshillë të vlefshme, vëllai Hes shkroi [fjalët në vijim]: ‘Këto gjëra janë të rëndësishme: Martesa në

tempull, misioni, kolegji. Ecni përpara, vendosni qëllime, shkruani histori, bëni fotografi familjare dy herë në vit.”⁷

Çfarë fjalësh do t’u shkruanit fëmijëve tuaj nëse do të kishit 25 fjalë ose më pak?

Babai i ri për të cilin fola më herët, që shkroi rreth kujtimeve për mësuën e tij të klasës së dytë, po rrit tani një vogëlushe të bukur. Ai ndien se mbi të është vendosur mirëbesim hyjnor. Teksa rritet, cila do të jetë e ardhmja e saj? Çfarë do t’i thotë ai asaj që t’i ngulitet thellë në zemër? Çfarë fjalësh do ta inkurajojnë, ta ngrenë moralisht dhe ta ndihmojnë të qëndrojnë në shteg? A do të sjellë ndryshim nëse ai gjen kohë për t’i pëshpëritur: “Ti je fëmijë i Perëndisë”? A do ta kujtojë ajo një ditë që i ati shpesh thoshte fjalët: “E dua gjithçka tënden”?

A nuk është kjo ajo që po i thoshte Ati Qiellor Birit të Tij dhe të gjithëve ne kur tha: “Ky është Biri im i dashur” dhe më pas shtoi: “në të cilin jam kënaqur”?⁸

E pasqyrofshin fjalët që u themi dhe u shkruajmë fëmijëve tanë, dashurinë që Ati ynë Qiellor ka për Birin e Tij, Jezu Krishtin dhe për ne. Dhe pastaj ndalofshim për të dëgjuar, sepse një fëmijë është tepër i aftë për të thënë gjëra të mëdha e të mrekullueshme në këmbim. E them këtë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Helamani 5:12.
2. Helamani 5:14; kursivet shtuar.
3. Helamani 5:29–30.
4. Doktrina e Besëlidhje 100:5–6
5. Lois M. Collins, “Baby’s Development Potentially Harmed by Parents Texting,” *Deseret News*, 4 qershor, 2012, deseretnews.com/article/print/865556895/Babys-development-potentially-harmed-by-parents-texting.html.
6. 2 Nefi 25:23.
7. Tomas S. Monson, “Të Gjejmë Gëzim në Udhëtim”, *Liahona*, nëntor 2008, f. 86.
8. Mateu 3:17.



Nga Plaku L. Uimi Klejton,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Martesa: Shikoni dhe Mësoni

Premtimet e Zotit shtrihen ndaj të gjithë atyre që ndjekin modelin e jetës që ndërton marrëdhënie martesore të lumtura e të shenjta.

Një mbrëmje, disa vite më parë, unë dhe bashkëshortja ime po shkonim për darkë në shtëpinë e njërit prej djemve tanë dhe të bashkëshortes e fëmijëve të tij. Ishte një ngjarje e zakonshme për një familje me fëmijë të vegjël: kishte shumë zhurmë dhe akoma më shumë argëtim. Pak pas darke, mbresa jonë katër vjeçare, Ana, dhe unë ishim akoma të ulur në tryezë. Duke e kuptuar se kishte vëmendjen time të plotë, ajo u ngrit menjëherë mbi një stol dhe m’i nguli sytë. Kur u sigurua se po e shihja, me seriozitet më urdhëroi ta “shikoja e të mësoja”. Më pas kërcëu dhe më këndoi një këngë.

Mësimi i Anës për të “parë dhe mësuar” qe urtësi nga goja e një foshnjëje. Ne *mund* të mësojmë kaq shumë duke parë dhe më pas duke marrë parasysh atë që kemi parë dhe ndier. Me këtë në mendje, më lejoni të ndaj me ju disa parime që kam vërejtur duke parë dhe mësuar nga martesa të mrekullueshme e besnike. Këto parime ndërtojnë martesa të forta e të kënaqshme, që janë të pajtueshme me parimet qiellore. Ju ftoj të shikoni dhe të mësoni me mua.

Së pari, kam vërejtur se në martesat më të lumtura, si bashkëshorti edhe bashkëshortja e konsiderojnë marrëdhënien e tyre të jetë një margaritar me vlerë të madhe, një thesar me vlerë të pafundme. Të dy ata i lënë etërit dhe nënat e tyre dhe, së bashku, fillojnë të ndërtojnë një martesë që do të përparojë përjetësisht. Ata e kuptojnë se ecin në një shteg të shuguruar hyjnisht. Ata e dinë se asnjë marrëdhënie tjetër e çfarëdo lloji nuk mund të sjellë kaq shumë gëzim, të ofrojë kaq shumë të mira ose të prodhojë kaq shumë përmirësim vetjak. Shikoni dhe mësoni: partnerët më të mirë në martesë i konsiderojnë martesat e tyre si të paçmueshme.

Tjetri, besimi. Martesat e suksesshme përjetësisht ndërtohen mbi themelin e besimit në Zotin Jezu Krisht dhe bindjen ndaj mësimave të Tij.¹ Kam vërejtur se çiftet që i kanë bërë martesat e tyre tepër të çmuara, ushtrojnë modelet e besimit: ata marrin pjesë çdo javë në mbledhjet e sakramentit dhe mbledhjet e tjera, mbajnë mbrëmje familjare, luten dhe i studiojnë shkrimet e shenjta bashkërisht dhe veçan, si dhe paguajnë një



të dhjetë të ndershme. Synimi i tyre i përbashkët është të jenë të bindur e të mirë. Ata nuk i konsiderojnë urdhërimet të jenë një banak, nga i cili mund të marrin e zgjedhin vetëm ofertat më tërheqëse.

Besimi është themeli i çdo virtyti që forcon martesën. Forcimi i besimit e forcon martesën. Besimi rritet ndërsa ne i mbajmë urdhërimet, dhe kështu rritet edhe harmonia dhe gëzimi në martesë. Pra, mbajtja e urdhërimeve është themelore për krijimin e martesave të forta përjetësisht. Shikoni dhe mësoni: besimi në Zotin Jezu Krisht është themeli i martesave të lumtura përjetësisht.

Së treti, pendimi. Kam mësuar se martesat e lumtura mbështeten te dhurata e pendimit. Ai është një element thelbësor në çdo marrëdhënie të mirë martesore. Bashkëshortët dhe bashkëshortet të cilët rregullisht bëjnë vetanalizim të ndershëm dhe sakaq ndërmarrin hapat e nevojshëm për t'u penduar dhe përmirësuar, përjetojnë një balsam shërues në martesat e tyre. Pendimi ndihmon të kthehet dhe ruhet harmonia e paqja.

Përlësia është thelbi i pendimit. Përlësia është vetëmohuese, jo egoiste. Ajo nuk kërkon mënyrën e vet apo flet me epërsi morale. Përkundrazi, përlësia përgjigjet me

ëmbëlsi² dhe dëgjon me mirësi për të kuptuar, jo për të përligjur. Përlësia pranon se askush nuk mund ta ndryshojë dikë tjetër, por me besim, përpjekje dhe ndihmën e Perëndisë, *ne* mund t'i nënshtrohemi *vetë* ndryshimit tonë të madh të zemrës.³ Përjetimi i ndryshimit të madh të zemrës na bën t'i trajtojmë të tjerët, sidomos bashkëshortët tanë, me butësi.⁴ Përlësi do të thotë që si bashkëshortët edhe bashkëshortet kërkojnë ta bekojnë, ta ndihmojnë dhe ta lartësojnë njëri-tjetrin, duke e vendosur tjetrin të parin në çdo vendim. Shikoni dhe mësoni: pendimi dhe përlësia ndërtojnë martesat e lumtura.

Së katërti, respekti. Kam vërejtur se te martesat e mrekullueshme e të lumtura, bashkëshortët e bashkëshortet e trajtojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë. Praktikrat nga çdo vend apo çdo kohë në të cilat bashkëshortët kanë sunduar mbi bashkëshortet apo i kanë trajtuar ato në çfarëdo mënyre si partnere inferiore në martesë, nuk janë në harmoni me ligjin hyjnor dhe duhet të zëvendësohen nga parime e modele të drejta sjelljeje.

Bashkëshortët dhe bashkëshortet në martesat e mrekullueshme i marrin vendimet njëzëri, ku secili prej tyre vepron si pjesëmarrës i plotë dhe me të drejta të barabarta në të shprehur

dhe votë.⁵ Ata përqendrohen fillimisht te shtëpia dhe te të ndihmuarit e njëri-tjetrit me përgjegjësitë e tyre të përbashkëta.⁶ Martesat e tyre bazohen në bashkëpunim, jo negociata. Koha e ngrënies së darkës dhe koha familjare që pason, bëhen qendra e ditës së tyre dhe synimi i përpjekjeve të tyre më të mira. Ata i fikin aparatet elektronike dhe heqin dorë nga argëtimet vetjake me qëllim që të ndihmojnë me detyrat e familjes. Brenda mundësive, ata lexojnë çdo natë me fëmijët e tyre dhe të dy marrin pjesë në vënien e të vegjëlve në shtrat. Shkojnë në shtratin e tyre bashkë. Si t'ia lejojnë detyrat dhe rrethanat, bashkëshortët dhe bashkëshortet punojnë krah për krah në bërjen e punës më të rëndësishme që kanë – punën që bëjmë në vetë shtëpitë tona.

Ku ka respekt, ka edhe sinqeritet të plotë, i cili është një element kyç i martesave të lumtura. Nuk ka sekrete për çështje përkatëse në martesat e bazuara te respekti dhe sinqeriteti i plotë i përbashkët. Bashkëshortët dhe bashkëshortet i marrin së bashku të gjitha vendimet për të ardhurat dhe të dy kanë qasje ndaj të gjitha informacioneve.

Besnikëria bashkëshortore është një formë respekti. Profetët japin mësim se partnerët e suksesshëm në martesë janë "fortësisht besnikë" ndaj njëri-tjetrit.⁷ Ata sigurohen që të qëndrojnë të denjë në çfarëdo mënyre ndërsa përdorin mediat sociale. Nuk i lejojnë vetes asnjë përvojë të fshehtë interneti. Ndajnë lirisht me njëri-tjetrin fjalëkalimet e rrjeteve të tyre sociale. Nuk shohin profilet virtuale të ndokujt në ndonjë mënyrë që mund të tradhtojë mirëbesimin e shenjtë të bashkëshortit apo bashkëshortes së tyre. Kurrë nuk bëjnë ose thonë ndonjë gjë që i afrohet dukjes së sjelljes së pahijshme, gojarrishtë ose fizikisht. Shikoni dhe mësoni:

martesat e jashtëzakonshme janë tërësisht plot respekt, sinqeritet dhe besnikëri.

Së pesti, dashuria. Martesat më të lumtura që kam parë, rrezatojnë bindje ndaj njërit prej urdhërimeve më të lumtura – që ne “jetojmë] së bashku në dashuri”⁸. Duke iu drejtuar bashkëshortëve, Zoti urdhëroi: “Duaje bashkëshorten tënde me gjithë zemër dhe do të kapesh pas saj e pas askujt tjetër”⁹. Një manual i Kishës jep mësim: “Fjalët të kapesh pas duan të thonë të jesh plotësisht i përkushtuar dhe besnik ndaj dikujt. Çiftet e martuar kapen pas Perëndisë dhe njëri-tjetrit duke i shërbyer e duke e dashur njëri-tjetrin dhe duke mbajtur besëlidhjet në besnikëri të plotë ndaj njëri-tjetrit dhe ndaj Perëndisë.” Si bashkëshorti edhe bashkëshortja “lënë pas jetën e tyre si beqarë/e dhe [e] vendosin martesën si përparësinë e [tyre të] parë. . . . Ata nuk lejojnë asnjë njeri ose interes tjetër që të ketë përparësi më të madhe . . . sesa mbajtja e besëlidhjeve që kanë bërë me Perëndinë dhe njëri-tjetrin”¹⁰. Shikoni dhe mësoni: çiftet e suksesshme e duan njëri-tjetrin me përkushtim të plotë.

Ka nga ata, martesat e të cilëve nuk janë aq të lumtura sa do të donin të ishin, si dhe nga ata që nuk janë martuar ndonjëherë, janë divorcuar, janë prindër të vetëm apo për arsye të ndryshme nuk janë në gjendje të martohen. Këto rrethana mund të jenë plot sfida dhe lëndime, por nuk duhet të jenë të përjetshme. Atyre prej jush që janë në situata të tilla e që prapë-seprapë i “bë[ni] me gëzim të gjitha gjërat që janë në fuqinë [tuaj]”¹¹ për të ngulmuar, qielli ju bekoftë me bollëk. Reshtni pas idealit të krijimit të një martese të përjetshme, duke përfshirë orvatjen ose përgatitjen për të qenë një bashkëshort apo bashkëshorte e



denjë. Mbani urdhërimet, dhe mirëbesojini Zotit dhe dashurisë së Tij të përsosur për ju. Një ditë çdo bekim i premtuar në lidhje me martesën do të jetë i juaji.¹²

Një nga vargjet më të këndshme në Librin e Mormonit shpreh me thjeshtësi: “Dhe ata u martuan dhe martuan, dhe qenë të bekuar sipas premtimeve të shumta që u kishte bërë Zoti”¹³. Premtimet e Zotit shtrihen ndaj të gjithë atyre që ndjekin modelin e jetës që ndërton marrëdhënie martesore të lumtura e të shenjta. Të tilla bekime vijnë si pasoja të hirshme e të parashikueshme të të jetuarit me besnikëri të ungjillit të Jezu Krishtit.

Jam mirënjohës për bashkëshorten time të mrekullueshme, Kethin, që është dashuria e jetës sime.

Martesa është një dhuratë nga Perëndia për ne; cilësia e martesave

tona është një dhuratë e jona për Të. Jap dëshmi për planin e mahnitshëm të Atit tonë të dashur Qiellor, i cili jep mundësinë për martesë të përjetshme e të mrekullueshme. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
2. Shih Fjalët e Urta 15:1.
3. Shih Alma 5:11–12, 26–31.
4. Shih Moroni 7:43–48; 8:25–26.
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 107:27–31.
6. Shih “Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës”, f. 129.
7. Shih Tomas S. Monson, “Fuqia e Priftërisë”, *Liahona*, maj 2011, f. 68; Gordon B. Hinckley, “Life’s Obligations”, *Liahona*, maj 1999, f. 4.
8. Doktrina e Besëlidhje 42:45.
9. Doktrina e Besëlidhje 42:22.
10. *Manuali 2: Administrimi i Kishës* (2010), 1.3.1.
11. Doktrina e Besëlidhje 123:17.
12. Shih *Manuali 2*, 1.3.3.
13. 4 Nefi 1:11.



Nga Plaku L. Tom Peri,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Bindja ndaj Ligjit Është Liri

Burrat dhe gratë e marrin lirinë e tyre të zgjedhjes si një dhuratë nga Perëndia, por liria e tyre dhe, si rrjedhim, lumturia e tyre e përhershme vjen nga bindja ndaj ligjeve të Tij.

Krishtlindjen e fundit mora një dhuratë të veçantë që më solli shumë kujtime. Ma dha mbesa ime. Kishte qenë ndër gjërat që pata lënë në shtëpinë e vjetër të familjes sonë kur u largova pasi qeshë martuar. Dhurata që ky libër i vogël bojëkafë që mbaj në dorë. Është një libër që u që dhënë ushtarakëve SHDM që hynë në forcat e armatosura gjatë Luftës II Botërore. Unë personalisht e konsiderova librin si një dhuratë nga Presidenti Hiber J. Grant dhe këshilltarët e tij, J. Ruben Klark i Riu dhe Dejvid O. Mek-Kei.

Në krye të librit, këta tre profetë të Perëndisë shkruanin: “Ngjarjet në shërbimin e armatosur nuk lejojnë që ne të jemi në kontakt personal të vazhdueshëm me ju, qoftë drejtpërdrejt apo me anë të një përfaqësimi personal. Mënyra tjetër më e mirë që kemi, është që t’ju japim juve që shërbeni në ushtri, pjesë të tilla të zbulesës bashkëkohore dhe të shpjegimeve të parimeve të Ungjillit, që do të sjellin te ju, kudo që mund të jeni, shpresë dhe besim të ripërtërirë si edhe qetësim, ngushëllim dhe paqe në shpirt.”¹

Sot ne e gjejmë veten në një luftë tjetër. Kjo nuk është një luftë me armatime. Është një luftë me mendime, fjalë dhe vepra. Është një luftë me mëkatit dhe më shumë se kurrë ne kemi nevojë të na kujtojnë për urdhërimet. Laicizmi po bëhet norma dhe shumë nga besimet dhe praktikatat e tij janë në luftë të drejtpërdrejtë me ato që qenë krijuar nga Vetë Zoti për të mirën e fëmijëve të Tij.

Në librin e vogël bojëkafë, menjëherë pas letrës nga Presidenca e Parë, është një “Shënim Hyrës drejtuar Njerëzve në Shërbim Ushtarak”, i titulluar *Bindja ndaj Ligjit Është Liri*. Shënimi bën krahasim midis ligjeve ushtarake, që “janë për të mirën e të gjithë atyre që janë në shërbimin ushtarak” dhe ligjit hyjnor.

Ai deklaroi: “Në univers, gjithashtu, ku Perëndia është në komandë, ka një ligj – ligj . . . universal, të përjetshëm – me disa bekime dhe ndëshkime të pandryshueshme”.

Fjalët e fundit të shënimit përqendrohen te bindja ndaj ligjit të Perëndisë: “Nëse doni të ktheheni tek të dashurit tuaj me kokën lart, . . . nëse do të jeni burrë dhe të jetoni i lumtur

– atëherë zbatoni ligjin e Perëndisë. Duke vepruar kështu ju mund t’u shtoni atyre lirive të paçmueshme që po përpigjeni të mbronin, një tjetër liri tek e cila të tjerët mund të mbështeten mirë, lirinë prej mëkatit; sepse vërtet ‘bindja ndaj ligjit është liri.’”²

Përse fraza “bindja ndaj ligjit është liri” më tingëllonte aq e vërtetë në atë kohë? Përse ajo na tingëllon e vërtetë të gjithë neve sot?

Ndoshta sepse ne kemi njohuri të zbuluar për historinë tonë para lindjes. Ne e dimë se kur Perëndia, Ati Qiellor, na paraqiti planin e Tij në fillim të kohës, Satani donte ta ndryshonte planin. Ai tha se ai do ta shëlbente gjithë njerëzimin. Asnjë shpirt nuk do të humbiste dhe Satani që i sigurt se mund ta përhapte propozimin e tij. Por ishte një kosto e papranueshme – shkatërrimi i lirisë së zgjedhjes së njeriut, që ishte dhe është një dhuratë e dhënë nga Perëndia (shih Moisiu 4:1–3). Lidhur me këtë dhuratë, Presidenti Harold B. Li tha: “Pas vetë jetës, liria e zgjedhjes është dhurata më e madhe e Perëndisë për njerëzimin”³. Atëherë nuk ishte një gjë e vogël që Satani të shpërfillte lirinë e zgjedhjes së njeriut. Në fakt, ajo u bë çështja kryesore rreth së cilës u zhvillua Lufta në Qiell. Fitortja e Luftës në Qiell që një fitore për lirinë e zgjedhjes së njeriut.

Satani, gjithsesi, nuk kishte mbarruar. Plani i tij rezervë – plani që po zbatonte që nga koha e Adamit dhe Evës – ishte që të tundonte burrat dhe gratë, në thelb të provonte se ne nuk e meritojmë dhuratën e dhënë nga Perëndia për lirinë e zgjedhjes. Satani ka shumë arsye për të bërë atë që bën. Ndoshta më e fuqishmja është shtysa e hakmarrjes, por ai gjithashtu do që t’i bëjë burrat dhe gratë të mjerë ashtu siç është ai i mjerë. Askush prej nesh nuk duhet ta nënvlerësojë kurrë motivin e Satanit për të pasur sukses. Roli i

tij në planin e përjetshëm të Perëndisë krijon “kundërshtim në të gjitha gjërat” (2 Nefi 2:11) dhe provon lirinë tonë të zgjedhjes. Çdo zgjedhje që bëjmë ju dhe unë, është një provë e lirisë sonë të zgjedhjes – nëse zgjedhim të jemi të bindur apo të pabindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë është në të vërtetë një zgjedhje midis “liri[s]ë dhe jetë[s] [së] përjetshme” dhe “robëri[s]ë dhe vdekje[s]”.

Kjo doktrinë themelore jepet mësim qartazi te 2 Nefi, kapitulli i dytë: “Kështu që, njerëzit janë të lirë sipas mi-shtit; dhe të gjitha gjërat u janë dhënë atyre të cilat janë të nevojshme për njeriun. Dhe ata janë të lirë të zgjedhin lirinë dhe jetën e përjetshme, nëpërmjet Ndërmjetësit të madh të të gjithë njerëzve, ose të zgjedhin robërinë dhe vdekjen, sipas robërisë dhe fuqisë së djallit; pasi ai kërkon që të gjithë njerëzit të jenë të mjeruar sikurse është ai vetë” (2 Nefi 2:27).

Në shumë mënyra, kjo botë ka qenë gjithmonë në luftë. Unë besoj se kur Presidenca e Parë më dërgoi librin e vogël bojëkafe, ata qenë më të shqetësuar rreth një lufte më të madhe sesa Lufta II Botërore. Unë gjithashtu besoj që ata shpresonin se libri do të ishte një mburojë e besimit kundër Satanit dhe ushtrive të tij në këtë luftë më të madhe – lufta kundër mëkatit – dhe do të shërbente si kujtesë për mua që t’i jetoja urdhërimet e Perëndisë.

Një mënyrë për ta vlerësuar veten dhe për t’u krahasuar me brezat e mëparshëm është nëpërmjet njerit prej standardeve më të vjetra që njeh njeriu – Dhjetë Urdhërimet. Për shumicën e botës së qytetëruar, sidomos botës hebreo-kristiane, Dhjetë Urdhërimet kanë qenë vija ndarëse më e pranuar dhe më e qëndrueshme midis së mirës dhe së keqes.

Sipas gjykimit tim, katër nga Dhjetë Urdhërimet janë marrë aq seriozisht



sot sa kurrë më parë. Si kulturë, ne e përbuzim dhe e dënojmë vrasjen, vjedhjen e gënjeshtrenë, dhe ne ende besojmë te përgjegjësia e fëmijëve ndaj prindërve të tyre.

Por si një shoqëri më e madhe, ne zakonisht i fshijmë gjashtë udhërimet e tjera:

- Nëse përparësitë tokësore janë njëfarë treguesi, ne sigurisht kemi “perëndi të tjerë” që i vendosim përpara Perëndisë së vërtetë.
- Ne krijojmë idhuj njerëzish të famshëm, stilesh jetese, pasurie, dhe po, ndonjëherë shëmbëlltyrash apo skulpturash.
- Ne e përdorim emrin e Perëndisë në të gjitha mënyrat përdhosëse, përfshirë pasthirrat tona dhe betimet tona.
- Ne e përdorim ditën e Shabatit për ndeshjet tona më të mëdha, argëtimet tona më të rëndësishme, pazaret tona më të mëdha dhe praktikisht për çdo gjë tjetër përveç adhurimit.
- Ne i trajtojmë marrëdhëniet seksuale jashtë martesë si çlodhje dhe dëfrim.

- Dhe makutëria është bërë një mënyrë jetese tejet e zakonshme. (Shih Eksodi 20:3–17.)

Profetët nga të gjitha periudhat unguilllore kanë paralajmëruar vazhdimisht lidhur me dy urdhërimet më serioze – ato që lidhen me vrasjen dhe tradhtinë bashkëshortore. Unë shoh një bazë të përbashkët për këto dy urdhërimet vendimtare – besimin se vetë jeta është e drejta e posaçme e Perëndisë dhe se trupat tanë fizikë, tempujt e jetës së vdekshme, duhet të krijohen brenda kufijve që Perëndia ka vendosur. Që njeriu të zëvendësojë me rregullat e tij ligjet e Perëndisë lidhur me krijimin dhe marrjen e një jete, është kulmi i arrogancës dhe i thellësisë së mëkatit.

Ndikimet kryesore të këtyre qëndrimeve zhvlerësuese rreth shenjtërisë së martesës janë pasojat te familjet – forca e familjeve po përkeqësohet me një ritëm alarmues. Ky përkeqësim po i shkakton shoqërisë një dëm me përhapje të gjerë. Unë shoh një shkak dhe pasojë të drejtpërdrejtë. Kur shpërfillim zotimin dhe besnikërinë ndaj partnerit/es sonë të martesës, ne



heqim ngjitësin që e mban shoqërinë tonë të bashkuar.

Një mënyrë e dobishme për të menduar rreth urdhërimeve është se ato janë këshilla të dashura nga një Atë QIELLOR i urtë dhe i gjithëdijshëm. Qëllimi i Tij është lumturia jonë e përjetshme dhe urdhërimet e Tij janë harta rrugore që na ka dhënë për t'u kthyer tek Ai, e cila është e vetmja udhë që ne të jemi përjetësisht të lumtur. Sa të rëndësishme janë shtëpia dhe familja për lumturinë tonë të përjetshme? Në faqen 141 të librit tim të vogël bojëkafe thuhet: “Vërtet qielli ynë është pak më tepër sesa një përfaqësim i shtëpive tona në përjetësi”⁴.

Doktrina e familjes dhe e shtëpisë që përsëritur më së fundi me qartësi e forcë të madhe të “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”. Ajo shpalli natyrën e përjetshme të familjeve dhe pastaj shpjegoi lidhjen me adhurimin në tempull. Proklamata shpalli gjithashtu ligjin mbi të cilin bazohet lumturia e përjetshme e familjeve, domethënë: “Fuqitë e shenjta të krijimit të jetës duhet të përdoren vetëm midis burrit dhe gruas, ligjërisht të martuar si

bashkëshort dhe bashkëshorte”⁵.

Perëndia u zbulon profetëve të Tij se ka të vërteta morale absolute. Mëkati do të jetë gjithmonë mëkat. Mosbindja ndaj urdhërimeve të Zotit gjithmonë do të na heqë bekimet e Tij. Bota ndryshon vazhdimisht dhe befasisht, por Perëndia, urdhërimet e Tij dhe bekimet e premtuara nuk ndryshojnë. Ato janë të përhershme dhe të pandryshueshme. Burrat dhe gratë e marrin lirinë e tyre të zgjedhjes si një dhuratë nga Perëndia, por liria e tyre dhe, si rrjedhim, lumturia e tyre e përhershme vjen nga bindja ndaj ligjeve të Tij. Siç e këshilloi Alma birin e tij të çoroditur Koriantonin: “Ligësia kurrë nuk ka qenë lumturi” (Alma 41:10).

Në këtë ditë të Rivendosjes së plotësisë së ungjillit, Zoti na ka zbuluar përsëri bekimet që na ka premtuar për faktin e të qenit të bindur ndaj urdhërimeve të Tij:

Te Doktrina e Besëlidhje 130, lexojmë:

“Ka një ligj, të shpallur në mënyrë të pakthyeshme në qiell, përpara krijimit të kësaj bote, mbi të cilin të gjitha bekimet bazohen—

Dhe kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet” (DeB 130:20–21).

Sigurisht nuk mund të ketë ndonjë doktrinë të shprehur më fort në shkrimet e shenjta sesa urdhërimet e pandryshueshme të Zotit dhe lidhja e tyre me lumturinë e me mirëqenien tonë si individë, familje dhe si shoqëri. Ka parime morale absolute. Mosbindja ndaj urdhërimeve të Zotit gjithmonë do të na heqë bekimet e Tij. Këto gjëra nuk ndryshojnë.

Në një botë ku busulla e parimeve morale të shoqërisë po luhetet, ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit nuk luhetet kurrë dhe nuk duhet ta bëjnë as kunjet dhe lagjet e tij, familjet e tij, as anëtarët e tij të veçantë. Ne nuk duhet të përzgjedhim se cilat urdhërime mendojmë se janë të rëndësishme për t'u mbajtur, por t'i pranojmë të gjitha urdhërimet e Perëndisë. Ne duhet të qëndrojmë të vendosur dhe të patundur, duke pasur besim të plotë te palëkundshmëria e Zotit dhe me besim të përsosur në premtimet e Tij.

Qofshim përherë një dritë në majë të malit, një shembull në mbajtjen e urdhërimeve që kurrë nuk kanë ndryshuar dhe kurrë nuk do të ndryshojnë. Ashtu si ky libër i vogël i nxit ushtarakët SHDM të qëndrojnë të vendosur moralisht në kohë lufte, qofshim ne, në këtë luftë të ditëve të fundit, një fener për të gjithë tokën dhe veçanërisht për fëmijët e Perëndisë që po kërkojnë bekimet e Zotit. Për këtë unë dëshmoj, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. First Presidency, në *Principles of the Gospel* (1943), i.
2. *Principles of the Gospel*, v, vii, viii.
3. *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* (2000), f. 4.
4. Stephen L Richards, në *Principles of the Gospel*, f. 141.
5. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Bindja Sjell Bekime

Një dituri për të vërtetën dhe përgjigjet për pyetjet tona më të mëdha na vijnë kur jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë.

Të dashur vëllezërit dhe motrat e mia, sa mirënjohës jam të jem me ju këtë mëngjes. Unë kërkoj besimin dhe lutjet tuaja teksa i përgjigjem privilegjit për t'ju drejtuar juve.

Gjatë gjithë epokave, burrat dhe gratë kanë kërkuar njohuri dhe kuptueshmëri lidhur me këtë ekzistencë në vdekshmëri dhe vendin e qëllimit të tyre në të, si dhe për udhën drejt paqes e lumturisë. Një kërkim i tillë ndërmerret nga secili prej nesh.

Kjo dituri dhe kuptueshmëri është në dispozicion të të gjithë njerëzimit. Ato përmbahen në të vërteta që janë të përjetshme. Te Doktrina e Besëlidhje, seksioni 1, vargu 39, lexojmë: "Pasi vini re dhe shihni, Zoti është Perëndia dhe Shpirti jep dëshmi, dhe dëshmia është e vërtetë, dhe e vërteta qëndron gjithmonë e përgjithmonë".

Poeti shkroi:

*Edhe qiejt të çahen, burimet të shpërthejn',
E vërteta mbi të gjitha këto do ngadhënjej',
Përjet', e njëjtë gjithmon'.¹*

Disa do të pyesnin: "Ku mund ta gjejmë këtë të vërtetë dhe si duhet ta njohim atë?" Në një zbulësë dhënë përmes Profetit Jozef Smith në

Kirtland të Ohajos, në majin e 1833-it, Zoti shpalli:

"Dhe e vërteta është dituri për gjërat siç janë dhe siç ishin, dhe siç do të jenë; . . .

Shpirti i së vërtetës është nga Perëndia. . . .

Dhe askush nuk e merr plotësinë, në qoftë se ai nuk i zbaton urdhërimet e tij.

Ai që i mban urdhërimet e [Perëndisë], merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat."²

Çfarë premtimi i lavdishëm. "Ai që i mban urdhërimet e [Perëndisë], merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat."

Nuk ka nevojë që ju ose unë, në këtë periudhë të ndriçuar, kur plotësia e ungjillit është rivendosur, të lundrojmë detra të paeksploruar apo të udhëtojmë në rrugë të panjohura, në kërkim të së vërtetës. Një Atë i dashur Qiellor na e ka shënuar rrugën dhe na ka siguruar një hartë të pagabueshme – madje *bindjen*. Një dituri për të vërtetën dhe përgjigjet për pyetjet tona më të mëdha na vijnë kur jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë.

Ne e mësojmë bindjen gjatë gjithë jetës sonë. Duke filluar që kur jemi shumë të rinj, ata që janë përgjegjës

për kujdesin ndaj nesh, caktojnë orientime dhe rregulla për të garantuar sigurinë tonë. Jeta do të ishte më e thjeshtë për të gjithë ne, nëse do t'u bindeshim këtyre rregullave plotësisht. Megjithatë, shumë prej nesh e mësojnë përmes përvojës urtësinë e të qenit të bindur.

Teksa rritesha, çdo verë nga fillimi i korrikut deri në fillim të shtatorit, familja ime qëndronte në një shtëpizë verimi në parkun Vivian te Kanioni i Provos në Juta.

Një nga shokët e mi më të mirë gjatë atyre ditëve të shkujdesura në kanion, ishte Deni Larsen, familja e të cilit zotëronte gjithashtu një shtëpizë në parkun Vivian. Çdo ditë, ai dhe unë endeshim në këtë parajsë djemsh, duke peshkuar në përrua dhe lumë, duke mbledhur gurë dhe thesare të tjera, duke marshuar, duke u ngjitur në mal dhe thjesht duke shijuar çdo minutë të çdo ore të çdo dite.

Një mëngjes, Deni dhe unë, vendosëm se dëshironim të bënim një kampim rreth zjarrit me të gjithë miqtë tanë të kanionit. Thjesht na duhej të pastronim një zonë në një fushë aty pranë ku mund të mblidheshim të gjithë. Bari i qershorit që e mbulonte fushën, ishte bërë i thatë dhe gjembaç, duke e bërë fushën të papërshtatshme për qëllimet tona. Ne filluam ta shkullnim barin e lartë, duke planifikuar të pastronim një zonë të gjerë rrethore. Ne e shkullnim dhe e tërhiqim me të gjithë fuqinë tonë, por gjithçka mundëm të arrinim ishin disa duar të vogla barërash të këqija e kokëforta. Ne e dinim se kjo detyrë do të na merrte gjithë ditën dhe tashmë energjia dhe entuziazmi ynë po shteronin.

Dhe atëherë, ajo që mendova se ishte zgjidhja e përsosur, erdhi në mendjen time tetëvjeçare. I thashë Denit: "Gjithçka na duhet është t'u vëmë zjarrin këtyre barërave të këqija.

Ne thjesht do të *djegim* një sipërfaqe rrethore me barëra të këqija!" Ai ra dakord me shpejtësi dhe unë vrapova në shtëpizën e verimit për të marrë disa shkrepëse.

Që asnjëri prej jush të mos mendojë se në një moshë delikate si ajo tetëvjeçare na lejohej të përdornim shkrepëse, dua ta bëj të qartë se edhe mua edhe Denit na ndalohej t'i përdornim ato pa mbikëqyrje nga të rriturit. Të dy ne ishim paralajmëruar në mënyrë të përsëritur për rreziqet e zjarrit. Sidoqoftë, e dija se ku i mbante shkrepëset familja ime dhe na duhej ta pastronim atë fushë. Pa u menduar dy herë, vrapova për të shtëpiza jonë dhe mora disa fije shkrepësesh, duke u siguruar që nuk po më shihte njeri. I fsheha shpejt në një nga xhepat e mi.

U ktheva me vrap te Deni, i emocionuar që në xhepin tim kisha zgjidhjen për problemin tonë. Më kujtohet se mendoja që zjarri do të digjej vetëm deri atje ku dëshironim dhe pastaj si me magji do të fikej.

Përplasa një shkrepëse në një shkëmb dhe i vura flakën barit të përcëlluar të qershorit. U ndez sikur të ishte spërkatur me benzinë. Në fillim, Deni dhe unë u ngazëllyem teksa i shikonim barërat e këqija të zhdukshin, por shpejt, u bë e dukshme se zjarri nuk do të fikej vetë. Na zuri paniku kur e kuptuam se nuk mund të bënim asgjë për ta ndalur. Flakët kërcënuese filluan ta përpinin barin e egër deri anës së malit, duke vënë në rrezik pemët e pishës dhe gjithçka tjetër në shtegun e tyre.

Në fund, nuk kishim asnjë mundësi përveçse të vraponim për ndihmë. Shpejt të gjithë burrat dhe gratë që gjendeshin në parkun Vivian, po turrehin para-prapa me trasta lecke me ujë, duke u ndeshur me flakët në orvatje për t'i fikur ato. Pas disa orësh, thëngjijtë e fundit të mbetur u fikën.

Pemët shumëvjeçare ishin shpëtuar, sikurse shtëpitë që flakët do t'i kishin arritur në fund.

Deni dhe unë morëm disa mësimë të vështira, por të rëndësishme atë ditë – një pjesë e rëndësishme prej të cilëve ishte rëndësia e bindjes.

Këto janë rregulla dhe ligje që ndihmojnë për të na siguruar mbrojtjen tonë fizike. Po njësoj, Zoti ka siguruar orientime dhe urdhërime që të ndihmojnë për të na siguruar mbrojtjen tonë shpirtërore, me qëllim që të mund të lundrojmë me sukses në këtë ekzistencë shpesh të pabesë në vdekshmëri dhe të kthehemi përfundimisht tek Ati ynë Qiellor.

Shekuj më parë, një brezi të zhytur në traditën e flijimeve të kafshëve, Samueli u shpalli me guxim: "Bindja është më e mirë se flijimi; dhe të dëgjosh me kujdes është më mirë se dhjami i deshve."³

Në këtë periudhë ungujillore, Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith se Ai kërkoi "zemrën dhe një mendje të gatshme; dhe të gatshmit dhe të bindurit do të hanë të mirat e tokës së Sionit në këto ditë të fundit"⁴.

Të gjithë profetët, të lashtë dhe modernë, e kanë ditur se bindja është thelbësore për shpëtimin tonë. Nefi deklaroi: "Unë do të shkoj dhe do të bëj gjërat që Zoti ka urdhëruar"⁵. Edhe pse të tjerët ngurronin në besimin dhe bindjen e tyre, asnjëherë Nefi nuk dështoi në bërjen e asaj që Zoti kërkonte prej tij. Breza të panumërt janë bekuar falë tij.

Një tregim për bindjen, i cili të trondit shpirtin, është ai për Abrahamin dhe Isakun. Sa e vështirë dhe e dhembshme duhet të ketë qenë për Abrahamin, në bindje ndaj urdhrit të Perëndisë, ta çonte Isakun e tij të dashur në vendin e Moriahve për ta ofruar si flijim. A mund ta përfytyrojmë brengën e zemrës së Abrahamit

teksa udhëtonte për në vendin e caktuar? Me siguri, vuajtja duhet t'ia ketë mbështjellë trupin dhe t'ia ketë torturuar mendjen teksa e lidhi Isakun, e shtriu mbi altar dhe mori thikën për ta therur. Me një besim të palëkundur dhe mirëbesim të plotë te Zoti, ai iu përgjigj urdhrit të Zotit. Sa i lavdishëm qe shqiptimi dhe me sa mirëpritje të gëzueshme erdhi: "Mos e zgjat dorën kundër djalit dhe mos i bëj asnjë të keqe. Tani e di mirë që ti i trembesh Perëndisë, se nuk më ke refuzuar birin tënd, të vetmin bir që ke."⁶

Abrahami ishte sprovuar e vënë në provë dhe për besnikërinë e bindjen e tij, Zoti i dha atij këtë premtim të lavdishëm: "Dhe tërë kombet e tokës do të bekohen te pasardhësit e tu, sepse ti iu binde zërit tim"⁷.


Edhe pse nuk na kërkohet ta vërtetojmë bindjen tonë në një mënyrë kaq dramatike dhe zemërkëputëse, bindja kërkohet edhe prej nesh.

Presidenti Jozef F. Smith në tetor të vitit 1873 shpalli: "Bindja është ligji i parë i qiellit"⁸.

Presidenti Gordon B. Hinkli tha: "Shenjtore të ditëve të mëvonshme, përparimi i shenjtoreve të ditëve të mëvonshme, begatia e shenjtoreve të ditëve të mëvonshme, si dhe shpëtimi i përjetshëm dhe ekzaltimi i këtij populli, qëndrojnë tek ecja me bindje ndaj këshillave të . . . Perëndisë"⁹.

Bindja është shenja dalluese e profetëve; ajo u ka siguruar atyre forcë dhe dituri përgjatë epokave. Është thelbësore që ta kuptojmë se ne, gjithashtu, kemi të drejtën për këtë burim force dhe diturie. Ajo është lehtësisht e gjindshme për secilin prej nesh sot teksa u bindemi urdhërimeve të Perëndisë.

Përgjatë viteve, kam njohur individë të panumërt që kanë qenë veçanërisht besnikë dhe të bindur. Unë jam bekuar dhe frymëzuar prej tyre. Do



të doja t'ju tregoja një histori për dy individë të tillë.

Valter Krauze ishte një anëtar i patundur i Kishës, i cili, me familjen e tij, jetoi në atë që u bë e njohur si Gjermania Lindore, pas Luftës II Botërore. Pavarësisht mundimeve që hasi për shkak të mungesës së lirisë në atë zonë të botës në atë kohë, vëllai Krauze ishte një burrë që e donte Zotin dhe i shërbente Atij. Ai e përmbushi me besnikëri dhe me ndërgjegje çdo detyrë që iu dha.

Burri tjetër, Johan Dendorfer, një hungarez, u kthye në besim në Kishë në Gjermani dhe u pagëzua atje në vitin 1911 në moshën 17-vjeçare. Jo

shumë kohë pas kësaj, ai u kthye në Hungari. Pas Luftës II Botërore, ai e gjeti veten praktikisht të burgosur në tokën e tij të lindjes, në qytetin e Debreçenit. Liria i ishte hequr edhe popullit në Hungari.

Vëllai Valter Krauze, që nuk e njihte vëllanë Dendorfer, mori detyrën të ishte mësuesi i tij i shtëpisë dhe ta vizitonte atë rregullisht. Vëllai Krauze i telefonoi shokut të tij të mësimit të shtëpisë dhe i tha: “Kemi marrë një detyrë për të vizituar vëllanë Johan Dendorfer. A do të ishe i disponueshëm të vije me mua këtë javë për ta parë atë dhe për t'i dhënë atij një mesazh nga ungjilli?” Dhe më

pas ai shtoi: “Vëllai Dendorfer jeton në Hungari”.


Shoku i tij i trembur e pyeti: “Kur do të nisemi?”

“Nesër”, erdhi përgjigja nga vëllai Krauze.

“Kur do të kthehemi në shtëpi?” pyeti shoku.

Vëllai Krauze iu përgjigj: “O, pas pothuaj një jave – nëse kthehemi”.

U nisën dy shokët e mësimit të shtëpisë për të vizituar vëllanë Dendorfer, duke udhëtuar me tren dhe autobus nga zona verilindore e Gjermanisë për në Debreçen të Hungarisë – një udhëtim i gjatë. Vëllai Dendorfer nuk kishte pasur mësues



shtëpie që përpara luftës. Tani, kur i pa këta shërbëtorë të Zotit, ai u mbush me mirënjohje për ardhjen e tyre. Në fillim ai nuk pranoi t'ua shtrëngonte duart. Në vend të kësaj, ai shkoi në dhomën e tij të gjumit dhe nxori një kuti nga një dollap i vogël që kishte të dhjetën të cilën ai e kishte ruajtur për vite. Ai u dha të dhjetën mësuesve të tij të shtëpisë dhe tha: “Tani jam në rregull me Zotin. *Tani* ndihem i denjë për të tokur duart me shërbëtorët e Zotit!” Vëllai Krauze më tregoi më vonë se ishte prekur përtej aftësisë për ta përshkruar prej mendimit se ky vëllai besnik, që nuk kishte pasur kontakt me Kishën për shumë vite, kishte hequr me bindje dhe në mënyrë të qëndrueshme 10 përqind të të ardhurave të tij të pakta me të cilat pagoi të dhjetën. Ai e kishte ruajtur atë, pa e ditur se kur ose nëse do të mund të kishte privilegjin ta paguante atë.

Vëllai Krauze ndërroi jetë nëntë vjet më parë në moshën 94-vjeçare. Ai shërbeu me besnikëri dhe bindje gjatë gjithë jetës së tij dhe ishte një frymëzim për mua dhe të gjithë ata që e njohën. Kur i kërkohej të përmbushte detyra, ai kurrë nuk e vinte në dyshim, kurrë nuk mëmëriste dhe kurrë nuk gjente justifikime.

Vëllezërit dhe motrat e mia, prova e madhe e kësaj jete është bindja. “Dhe

ne do t'i provojmë me këtë”, tha Zoti, “për të parë nëse ata do t'i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t'i urdhërojë.”¹⁰

E tillë qe barra e mesazhit të Shpëtimtarit tonë kur shpalli: “Sepse të gjithë ata që dëshirojnë të kenë bekim nga dora ime, duhet t'i binden ligjit që u caktua për atë bekim dhe kushteve të tij, siç u ngritën që përpara krijimit të botës.”¹¹

Nuk ekziston shembull më i shkëlqyer për bindjen se ai i Shpëtimtarit tonë: Për të Pali vërejt:

“Edhe pse ishte Bir, mësoi të jetë i bindur nga ato që pësoi,

dhe, si u bë i përkryer, u bë vepëronjësi i shpëtimit të amshuar për të gjithë ata që i binden.”¹²

Shpëtimtari tregoi dashuri të sinqertë për Perëndinë duke jetuar jetë të përsosur, duke e nderuar misionin e shenjtë që ishte i Tij. Kurrë nuk ishte Ai arrogant. Kurrë nuk ishte Ai i fryrë me krenari. Kurrë nuk qe ishte Ai i pabesë. Gjithmonë ishte Ai i përlulur. Gjithmonë ishte Ai i sinqertë. Gjithmonë ishte Ai i bindur.

Edhe pse Atë e tundoi ai mjeshër i mashtrimit, madje djalli; edhe pse fizikisht qe i dobësuar nga agjërimit për 40 ditë e 40 netë dhe “në fund e mori uria”; përsëri kur i ligu i bëri Jezusit propozimet më joshëse e tunduese,

Ai na dha një shembull hyjnor të bindjes duke mos pranuar të shmangej nga ajo që e dinte se ishte e drejtë.¹³

Kur u përball me agoninë e Gjetsemanit, kur Ai duroi dhembje të tillë që “djersa iu bë sikur të ishte pika të mëdha gjaku që binin në tokë”,¹⁴ Ai dha shembullin e Birit të bindur duke thënë: “O Atë, po të duash, largoje këtë kupë nga unë! Megjithatë mos u bëftë vullneti im, por yti”¹⁵.

Sikurse Shpëtimtari i udhëzoi Apostujt e Tij të hershëm, kështu ju udhëzoi Ai ju dhe mua: “Ti ndiqmë!”¹⁶ A jemi të gatshëm të bindemi?

Dituria që kërkojmë, përgjigjet për të cilat jemi të dëshiruar dhe forca që dëshirojmë sot për të përballuar sfidat e një bote të ndërlikuar dhe në ndryshim, mund të jenë tonat kur u bindemi me gatishmëri urdhërimeve të Zotit. Po i citoj edhe njëherë fjalët e Zotit: “Ai që i mban urdhërimet e tij, merr të vërtetë e dritë, derisa të përlëvdohet në të vërtetë dhe i di të gjitha gjërat.”¹⁷

Është lutja ime e përlulur që të mund të bekohemi me shpërblimet e bollshme që u premtohen të bindurve. Në emrin e Jezus Krishtit, Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. “E Vërteta Çfar’ Është?” *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 31.
2. Doktrina e Besëlidhje 93:24, 26–28.
3. 1 Samuelit 15:22.
4. Doktrina e Besëlidhje 64:34
5. 1 Nefi 3:7.
6. Zanafilla 22:12.
7. Zanafilla 22:18.
8. Joseph F. Smith, “Discourse,” *Deseret News*, 12 nëntor 1873, f. 644.
9. Gordon B. Hinckley, “If Ye Be Willing and Obedient,” *Ensign*, dhjetor 1971, f. 125.
10. Abraham 3:25
11. Doktrina e Besëlidhje 132:5
12. Hebrejve 5:8–9.
13. Shih Mateu 4:1–11.
14. Lluca 22:44
15. Lluca 22:42
16. Gjoni 21:22
17. Doktrina e Besëlidhje 93:28



Nga Plaku Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“Unë Besoj, o Zot”

Me ndershmëri i bëni të njohura pyetjet dhe shqetësimet tuaja, por më parë dhe përgjithmonë i fryni flakës së besimit tuaj, sepse të gjitha gjërat janë të mundshme për ata që besojnë.

Në një rast, Jezusi u afrua te një grup që po grindeshin vullshëm me dishepujt e Tij. Kur Shpëtimtari pyeti lidhur me arsyen e kësaj grindjeje, babai i një fëmije të munduar doli nga turma, duke thënë se ai u ishte drejtuar dishepujve të Jezusit për një bekim për birin e tij, por ata nuk ishin në gjendje t’ia jepnin. Me djalin ende duke kërcëllirë dhëmbët, duke i dalë shkumë nga goja dhe duke u përplasar përtokë përpara tyre, babai i kërkoi Jezusit me atë që duhej të kishte qenë dëshpërimi i mundësisë së fundit në zërin e tij:

“Nëse mund të bësh diçka”, tha ai, “ki mëshirë për ne dhe na ndihmo!”

Dhe Jezusi i tha: ‘Nëse ti mund të besosh, çdo gjë është e mundshme për atë që beson.’

Menjëherë babai i fëmijës, duke bërë titur me lot, tha: ‘Unë besoj, o Zot, ndihmo mosbesimin tim!’¹

Bindja fillestare e këtij burri, sipas vetë pohimit të tij, është e kufizuar. Por ai ka një dëshirë ngulmuese, tepër të dukshme, në emër të fëmijës së tij të vetëm. Na thuhet se kjo është e mjaftueshme si fillim. “Edhe në qoftë se ju nuk mund të bëni më shumë sesa të *dëshironi të besoni*”, shpall

Alma, “lëreni këtë dëshirë të veprorë në ju, madje derisa të besoni”². Pa asnjë shpresë tjetër të mbetur, ky baba e pohon atë besim që ka dhe i përgjehet Shpëtimtarit të botës: “Nëse [ti] mund të bësh diçka, ki mëshirë për ne dhe na ndihmo!”³ Mezi mund t’i lexoj këto fjalë pa u përlotur. Përemri në shumës *ne* përdoret qartësisht me qëllim. Në fakt, ky burrë po thotë: “E tërë familja jonë po përgjehet. Ndeshja jonë nuk ndalon kurrë. Jemi të dërrmuar. Djali ynë bie në ujë. Bie në zjarr. Ai është vazhdimisht në rrezik dhe ne kemi vazhdimisht frikë për të. Nuk dimë se kujt tjetër t’i drejtohemi.

A mund të na ndihmosh *ti*? Do të të jemi vërtet mirënjohës për *gjithçka* – një bekim të pjesshëm, veç një grimcë shprese, një lehtësim të paktë të barrës që mbahet nga nëna e këtij djali çdo ditë të jetës së saj.

Fjalët “nëse [ti] mund të bësh diçka”, të thëna nga ky baba, i kthehet atij përsëri “nëse *ti* mund të *besosh*”, të thëna nga Mësuesi.⁴

“Menjëherë”, thotë shkrimi i shenjtë – jo me ngadalësi, as me dyshim, as me përbuzje, por “menjëherë” – babai bërtet përmes dhembjes së tij të pashtirur prindërore: “Unë besoj, o Zot, ndihmo mosbesimin tim”. Në përgjigje të besimit të ri dhe ende të pjesshëm, Jezusi e shëron djalin, pothuajse duke e ngritur atë drejtpërsëdrejti nga vdekja, sikurse e përshkruan ngjarjen Marku.⁵

Me këtë tregim të dhembshur nga shkrimi i shenjtë si sfond, dëshiroj t’u flas drejtpërsëdrejti njerëzve të rinj të Kishës – të rinj në vite moshe, ose të rinj në vite anëtarësie, ose të rinj në vite besimi. Në një mënyrë ose një tjetër, kjo duhet të na përfshijë pothuajse të gjithëve.

Gjëja e parë për t’u vënë në dukje lidhur me këtë tregim është se, kur ndodhet përballë sfidës së besimit, babai fillimisht vë në pah forcën e tij dhe



vetëm më pas e pranon kufizimin e tij. Deklarimi i tij fillestar është pohues dhe pa ngurrim: “Unë besoj, o Zot”. Do t’iu thoja të gjithë atyre që dëshirojnë më shumë besim, kujtojeni këtë burrë! Në çaste frike apo dyshimi, ose kohë shqetësimi, mos u largoni nga besimi që keni fituar tashmë, edhe pse ai mund të jetë i kufizuar. Gjatë rritjes që ne të gjithë duhet të përjetojmë në vdekshmëri, gjëra të ngjashme shpirtërore me mundimin e këtij djali apo dëshpërimin e këtij prindi do të na ndodhin të gjithëve. Kur ato çaste vijnë dhe shqetësimet shfaqen, zgjidhja e të cilave nuk po afrohet menjëherë, *mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të paepur derisa vjen dija e mëtejshme*. Ishte pikërisht për këtë ngjarje, këtë mrekulli të veçantë, që Jezusi tha: “Po të keni besim sa një kokërr sinapi, do t’i thoni këtij mali: ‘Zhvendosuni nga këtu atje’, dhe ai do të zhvendoset; dhe asgjë nuk do të jetë e pamundshme për ju”⁶. Problemi nuk është përmasa e besimit tuaj apo shkalla e njohurisë suaj – ai është integriteti që tregoni ndaj besimit që keni vërtet dhe ndaj së vërtetës që tashmë e dini.

Gjëja e dytë për t’u vënë në dukje është një variant i së parës. Kur problemet vijnë dhe pyetjet dalin, mos e filloni kërkimin tuaj për besim duke thënë sa shumë *nuk* keni, duke u udhëhequr nga “mosbesimi” juaj. Është si të përpiqeshit ta mbushnit një pulë nga sqepi! Më lejoni të jem i qartë në këtë pikë: nuk po ju kërkoj të shtireni për besimin që nuk e keni. Unë *po* ju kërkoj të jeni të vërtetë ndaj besimit që vërtet e keni. Nganjëherë ne veprojmë sikur një shprehje e ndershme e dyshimit është një shfaqje më e lartë e kurajës morale sesa është një shpallje e ndershme e besimit. Nuk është! Kështu le të kujtojmë të gjithë mesazhin e qartë të këtij tregimi të shkrimit të shenjtë: Jini aq i sinqertë



me pyetjet tuaja sa është e nevojshme të jini; jeta është plot me pyetje për një temë apo një tjetër. Por nëse ju dhe familja juaj dëshironi të shëroheni, mos i lejoni ato pyetje t’i zënë udhën besimit për të mos e kryer mrekullinë e tij.

Për më tepër, ju keni më shumë besim sesa mendoni se keni, për shkak të asaj që Libri i Mormonit e quan “prova të mëdha”⁷. “Ju do t’i njihni nga frytet e tyre”, tha Jezusi⁸, dhe frutet e korijeve, pemishteve dhe vreshtave të ungjillit janë të dukshme në jetën e shenjtorëve të ditëve të mëvonshme kudo. Ashtu siç iu thanë publikut të lashtë Pjetri dhe Gjoni, unë them sot: “Sepse ne nuk mund të mos flasim për ato që kemi parë dhe dëgjuar” dhe ajo që ne kemi parë e dëgjuar është që “është bërë një mrekulli e dukshme” në jetën e miliona anëtarëve të kësaj Kishe. Kjo s’mund të mohohet.⁹

Vëllezër dhe motra, kjo është një punë hyjnore në vazhdim, me shfaqjet dhe bekimet e shumta të saj duke u shtuar në çdo drejtim, prandaj mos u merakosni nëse, herë pas here, dalin shqetësime të cilat kanë nevojë të shqyrtohen, kuptohen dhe zgjidhen. Ato dalin dhe do të dalin. *Në këtë Kishë, ajo që dimë gjithmonë do ta kapërcejë atë që nuk e dimë. Dhe kujtoni, në këtë botë, çdo njeri duhet të ecë me anë të besimit.*

Prandaj jini dashamirës lidhur me dobësinë e karakterit njerëzor – tuajit, si edhe të atyre që shërbejnë me ju në një Kishë të udhëhequr nga burra dhe gra vullnetare, të vdekshme. Me përjashtim të rastit të Birit të Tij të

përsosur, të Vetëmlindur, njerëz të papërsosur janë gjithë çka Perëndia ka pasur si veprues përherë. Kjo duhet të jetë tmerrësisht irrituese për Të, por Ai ia gjen anën asaj. Kështu duhet t’ia gjejmë edhe ne. Dhe kur shihni papërsosmëri, mbani mend që kufizimi *nuk* është në hyjninë e kësaj pune. Siç ka sugjeruar një shkrimtar i talentuar, kur plotësia e pakufishme derdhet, nuk është faji i vajit nëse ka ca humbje, sepse enët e kufizuara nuk mund ta përmbajnë atë plotësisht.¹⁰ Këto enë të kufizuara përfshijnë ju dhe mua, prandaj jini të duruar, dashamirës dhe zemërgjerë.

Gjëja e fundit për të vënë në dukje: kur afrohet dyshimi ose vështirësia, mos kini frikë të kërkoni ndihmë. Nëse e dëshirojmë ndihmën me po aq përlulesi e ndershmëri, sa e deshi ky baba, ne mund ta gjejmë atë. Shkrimet e shenjta e quajnë një dëshirë të tillë të zellshme si të qenit me “bindje të vërtetë”, e ndjekur “me qëllim të plotë të zemrës, pa bërë hipokrizi dhe mashtrim para Perëndisë”¹¹. Unë dëshmoj në përgjigje të *atij* lloj kërkimi të ngutshëm, Perëndia do të dërgojë gjithmonë ndihmë nga të dy anët e velit për ta forcuar besimin tonë.

Thashë se po u flisja atyre që janë të rinj. Unë ende jam. Një djalë 14-vjeçar kohët e fundit më tha me pak ngurrim: “Vëllai Holland, nuk mund të them ende se e di që Kisha është e vërtetë, por unë besoj se është”. E përqafova atë djalë derisa i gufuan sytë. I thashë me gjithë zjarrin e shpirtit tim se *të besuarit* është një fjalë e çmuar, një veprim akoma më i çmuar dhe ai kurrë nuk kishte pse të kërkonte falje ngaqë “vetëm besonte”. I thashë atij se Krishti Vetë tha: “Mos ki frikë, vetëm ki besim”¹², një frazë që e mbështeti të riun Gordon B. Hinkli në fushën e misionit.¹³ I thashë këtij djali se të besuarit ishte gjithmonë hapi i parë

drejt bindjes dhe se secili nga nenet përcaktuese të besimit tonë të përba-shkët thekson me forcë frazën “Ne besojmë”¹⁴. Dhe i thashë atij se sa shumë krenar isha për të, për ndershmërinë e kërkit të tij.

Tani, me përparësinë që më japin rreth 60 vjet që nga koha kur isha një 14-vjeçar që kishte filluar të besonte, unë shpall disa gjëra që tani i di. Unë e di se Perëndia është në të gjitha kohët dhe në të gjitha mënyrat dhe në të gjitha rrethanat Ati ynë i dashur, falës, në Qiell. Unë e di se Jezusi ishte i vetmi fëmijë i Tij i përsosur, jeta e të cilit u dha me dashuri nëpërmjet vullnetit të Atit, si edhe të Birit, për

shëlbimin e gjithë ne të tjerëve që nuk jemi të përsosur. Unë e di se Ai u ngrit nga vdekja për të jetuar përsëri dhe, ngaqë Ai e bëri këtë, ju dhe unë do të jetojmë përsëri. Unë e di se Jozef Smithi, i cili e pranoi se nuk ishte i përsosur¹⁵, ishte, pavarësisht prej kësaj, mjeti i zgjedhur në dorën e Perëndisë për të rivendosur ungjillin e përjetshëm në tokë. Unë gjithashtu e di se, duke e bërë këtë – veçanërisht nëpërmjet përkthimit të Librit të Mormonit – ai më ka mësuar më shumë për dashurinë e Perëndisë, për hyjninë e Krishtit dhe për fuqinë e priftërisë, sesa ndonjë profet tjetër për të cilin kam lexuar, ditur ose dëgjuar

gjatë një jete të tërë kërkitimi. Unë e di se Presidenti Tomas S. Monson, i cili po i afrohet me përkushtim dhe gjallëri 50-vjetorit të shugurimit të tij si Apostull, është pasuesi i duhur për atë mantel profetik sot. Ne e kemi parë atë mantel përsëri mbi të në këtë konferencë. Unë e di se 14 burra të tjerë, të cilët ju i mbështesni si profetë, shikues dhe zbulues, e mbështesin atë me duart e tyre, me zemrat e tyre dhe me vetë çelësat e tyre apostolikë.

Këto gjëra jua shpall me bindjen që Pjetri e quajti “më të vërtetuar[ën] fjalë profetike”¹⁶. Ajo që ishte dikur një farë e vogël e besimit për mua, është rritur në pemën e jetës, prandaj, në qoftë se besimi juaj po vihet sadopak në provë në këtë stinë apo ndonjë stinë tjetër, ju ftoj të mbështeteni te besimi im. E di se kjo punë është pikërisht e vërtata e Perëndisë dhe e di se vetëm për rrezikun tonë, ne do ta lejojmë dyshimin ose djajtë të na largojnë nga shtegu i saj. Shpresoni. Udhëtoni. Me ndershmëri i bëni të njohura pyetjet dhe shqetësimet tuaja, por më parë dhe përgjithmonë i fryni flakës së besimit tuaj, sepse të gjitha gjërat janë të mundshme për ata që besojnë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Marku 9:22–24; shih edhe vargjet 14–21.
2. Alma 32:27; theksimi i shtuar.
3. Marku 9:22; theksimi i shtuar.
4. Marku 9:22, 23; theksimi i shtuar.
5. Shih Mark 9:24–27.
6. Mateu 17:20.
7. Helamani 5:50.
8. Mateu 7:16.
9. Shih Veprat e Apostujve 4:16, 20.
10. Përshtatur nga Alfred Edersheim, *The Life and Times of Jesus the Messiah*, 2 vëll. (1883), 2:108.
11. 2 Nefi 31:13.
12. Marku 5:36.
13. Shih Gordon B. Hinckley, në Conference Report, tetor 1969, f. 114.
14. Shih Nenet e Besimit 1:1–13.
15. Shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2009), f. 556.
16. 2 Pjetrit 1:19.





Nga Plaku Dallin H. Oaks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Pasues të Krishtit

Ndjekja e Krishtit nuk është një praktikë e zakonshme apo e rastit, por një zotim i vazhdueshëm dhe një mënyrë jete që zbatohet në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet.

Një nga himnet tona më të dashura, i kënduar këtë mëngjes nga Kori i Tabernakullit, fillon me këto fjalë:

*“Eja, më ndiq”, Shpëtu’si tha.
Në gjurm’t e Tij le t’ecim pra,
Ne veç ashtu mund t’jemi një
Me t’lindurin Bir’ q’Ati do.¹*

Këto fjalë, të frymëzuara nga ftesa më e hershme e Shpëtimtarit drejtuar dishepujve të Tij (shih Mateu 4:19), u shkruan nga Xhon Nikolson, një skocez i kthyer në besim. Si shumë prej udhëheqësve tanë të hershëm, ai kishte pak shkollim zyrtar, por një dashuri të thellë për Shpëtimtarin tonë dhe për planin e shpëtimt.²

Të gjitha mesazhet e kësaj konference na kanë ndihmuar të ecim në gjurmët e Shpëtimtarit tonë, shembulli dhe mësimet e të cilit përcaktojnë shtegun për çdo pasues të Jezu Krishtit.

Sikurse gjithë të krishterët e tjerë, anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme e studiojnë jetën e Shpëtimtarit tonë, siç paraqitet në librat e Dhiatës së Re nga Mateu, Marku, Lluka dhe Gjoni. Unë vërtet do të rishikoj shembuj dhe mësimet që gjenden në këta katër libra

të Biblës së Shenjtë dhe e ftoj secilin prej nesh të marrë parasysh se si kjo Kisha e rivendosur dhe secili prej nesh kualifikohen si pasues të Krishtit.

Jezusi na mësoi se pagëzimi ishte i domosdoshëm për të hyrë në mbretërinë e Perëndisë (shih Gjoni 3:5). Ai e filloi shërbesën e Tij duke u pagëzuar (shih Marku 1:9) dhe Ai dhe pasuesit e Tij pagëzuan të tjerë (shih Gjoni 3:22–26). Ne bëjmë po të njëjtën gjë.

Jezusi e filloi predikimin e Tij duke i ftuar dëgjuesit e Tij për t’u penduar (shih Mateu 4:17). Ky ende është mesazhi i shërbëtorëve të Tij ndaj botës.

Gjatë gjithë shërbesës së Tij, Jezusi dha urdhërime. Dhe Ai na mësoi: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia” (Gjoni 14:15; shih edhe vargjet 21, 23). Ai pohoi se zbatimi

i urdhërimeve të Tij do të kërkonte që pasuesit e Tij të linin atë që Ai e quajti “ajo që vlerësohet shumë ndër njerëzit” (Lluka 16:15) dhe “traditë [e] njerëzve” (Marku 7:8; shih edhe vargun 13). Ai gjithashtu paralajmëroi: “Po të ishit nga bota, bota do të donte të vetët; por sepse nuk jeni nga bota, por unë ju kam zgjedhur nga bota, prandaj bota ju urren” (Gjoni 15:19). Siç deklaroi më pas Apostulli Pjetër, pasuesit e Jezusit duhej të ishin “një popull i fituar” (1 Pjetrit 2:9).

Shenjtorët e ditëve të mëvonshme kuptojnë se ne nuk duhet të jemi “nga bota” ose të lidhur pas “traditës së njerëzve”, por si pasues të tjerë të Krishtit, ne nganjëherë e shohim të vështirë ndarjen e vetvetes nga bota dhe traditat e saj. Disa vetë jetojnë sipas mënyrave të botës ngaqë, sikurse Jezusi tha për disa, të cilëve Ai u dha mësim, ata e “donin lavdinë e njerëzve më tepër, se lavdinë e Perëndisë” (Gjoni 12:43). Këto dështime për ta ndjekur Krishtin janë tepër të shumta dhe tepër të ndjeshme për t’i renditur këtu. Ato përfshijnë gjithçka, nga praktikat e botës, të tilla si saktësia politike dhe veprimet e skajshme në veshje dhe pamje të jashtme, deri te shmangiet nga vlerat bazë të tilla si natyra dhe funksioni i përjetshëm i familjes.

Mësimet e Jezusit nuk kishin si qëllim të ishin teorike. Gjithmonë me to



duhej të veprohej. Jezusi na mësoi: “Ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar” (Mateu 7:24; shih edhe Lluka 11:28) dhe “Lum ai shërbëtor që, kur kthehet zotëria e tij, e gjen duke bërë kështu” (Mateu 24:46). Në një himn tjetër të dashur ne këndojmë:

*Shpëtimtar, mësom' të t'dua,
N'shtegun që m'tregon të shkoj, . . .
Shpëtimtar, mësom' të t'dua –
Zot, un' do të të ndjek.*³

Siç na mësoi Jezusi, ata që e duan Atë, do t'i zbatojnë urdhërimet e Tij. Ata do të jenë të bindur, siç na mësoi këtë mëngjes Presidenti Tomas S. Monson. Ndjekja e Krishtit nuk është një praktikë e zakonshme apo e rastit, por një zotim i vazhdueshëm dhe një mënyrë jete që zbatohet në të gjitha kohët dhe në të gjitha vendet. Shpëtimtari na e mësoi këtë parim dhe se si duhet të kujtoheshim dhe forcoheshim për ta ndjekur atë, kur Ai filloi ordnancën e sakramentit (kungimin, siç e quajnë të tjerët atë). E dimë nga zbulesa moderne se Ai i urdhëroi pasuesit e Tij t'i marrin simbolet në kujtim të Tij (shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, Përkthimi prej Jozef Smithit, Mateu 26:22 [në Mateu 26:26, shënim në fund c], 24 [në shtesën e Biblës]; Përzgjedhje nga Përkthimi i Biblës prej Joseph Smith-it, Marku 14:21–24 [në shtesën e Biblës]). Anëtarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme e ndjekin atë urdhërim çdo javë duke marrë pjesë në një shërbim adhurimi, në të cilin na marrim nga buka e uji dhe besëlidhim që vërtet do ta kujtojmë gjithmonë Atë dhe do t'i zbatojmë urdhërimet e Tij.

Jezusi na mësoi se “[njerëzit] duhet të lute[n] vazhdimisht” (Lluka 18:1). Ai gjithashtu e dha atë shembull, të tillë si kur Ai “e kaloi natën duke iu lutur



Perëndisë” (Lluka 6:12) përpara se të thërriste Dymbëdhjetë Apostujt e Tij. Si të krishterët e tjerë, ne lutemi në të gjitha shërbesat tona të adhurimit. Ne gjithashtu lutemi për udhëzim dhe japim mësim se duhet të kemi lutje vetjake të shpeshta dhe lutje të përditshme në gjunjë si familje. Sikurse Jezusi, ne i lutemi Atit tonë në Qiell dhe e bëjmë këtë në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit.

Shpëtimtari thirri Dymbëdhjetë Apostuj për të ndihmuar në Kishën e Tij dhe u dha atyre çelësat dhe autoritetin për të vazhduar pas vdekjes së Tij (shih Mateu 16:18–19; Marku 3:14–15; 6:7; Lluka 6:13). Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, si Kisha e rivendosur e Jezu Krishtit, e ndjek këtë shembull në organizimin e saj dhe në dhënien nga ana e saj të çelësave dhe të autoritetit mbi Apostujt.

Disa njerëz që Jezusi i thirri për ta ndjekur Atë, nuk u përgjigjën menjëherë, por kërkuan një vonim që të kujdeseshin për detyrimet e duhura familjare. Jezusi u përgjigj: “Asnjëri që ka vënë dorë në parmendë dhe kthehet e shikon prapa, nuk është i përshtatshëm për mbretërinë e Perëndisë” (Lluka 9:62). Shumë shenjtorë të ditëve të mëvonshme e praktikojnë përparësinë që Jezusi na mësoi. Kjo përfshin shembullin e mrekullueshëm të mijëra misionarëve në moshë dhe të të tjerëve që i kanë lënë fëmijët dhe nipërit e mbesat për të kryer detyrat misionare në të cilat janë thirrur.

Jezusi na mësoi se Perëndia krijoi mashkullin e femrën dhe se një *burrë* duhet t'i lërë prindërit e tij dhe të bashkohet me *gruan* e tij (shih Marku 10:6–8). Zotimi ynë ndaj këtij mësimi njihet mirë.

Në shëmbëlltyrën e njohur të deles së humbur, Jezusi na mësoi se ne duhet të bëjmë gjithçka mundemi për ta kërkuar këdo nga tufa që ka humbur udhën (shih Mateu 18:11–14; Lluka 15:3–7). Siç e dimë, Presidenti Tomas S. Monson ka vënë theksim të madh për këtë drejtim në shembullin dhe mësimet e tij të paharrueshme rreth shpëtimit të burrave dhe të grave.⁴

Në përpjekjet tona për të shpëtuar dhe shërbyer, ne ndjekim shembullin e pashoq dhe mësimet e dhembshura të Shpëtimtarit tonë rreth dashurisë: “Duaje të afërmin tënd porsi vetveten” (Mateu 22:39). Ai madje na urdhëroi t'i duam armiqtë tanë (shih Lluka 6:27–28). Dhe, në mësimet e Tij të madhërishtme në fund të shërbesës së Tij në vdekshmëri, Ai tha:

“Po ju jap një urdhërim të ri: ta doni njëri-tjetrin; sikurse unë ju kam dashur, ashtu edhe ju ta doni njëri-tjetrin.

Prej kësaj do t'ju njohin të gjithë që jeni dishepujt e mi, nëse keni dashuri për njëri-tjetrin” (Gjoni 13:34–35).

Si pjesë e dashurisë për njëri-tjetrin, Jezusi na mësoi se kur trajtohemi padrejtësisht nga njerëzit, ne duhet t'i falim ata (shih Mateu 18:21–35; Marku 11:25–26; Lluka 6:37). Ndërsa



shumë shqetësohen nga ky urdhërim i vështirë, ne të gjithë i njohim shembujt frymëzues të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme, të cilët kanë dhënë falje plot dashuri, edhe për trajtimet më të rënda, të padrejta. Për shembull, Kris Uilliams u mbështet te besimi i tij në Jezu Krishtin për ta falur shoferin e dehur që shkaktoi vdekjen e gruas së tij dhe dy prej fëmijëve të tyre. Vetëm dy ditë pas tragedisë dhe ende thellësisht i shqetësuar, ky burrë falës, që në atë kohë shërbente si një nga peshkopët tanë, tha: “Si dishepull i Krishtit, nuk kisha asnjë zgjedhje tjetër”⁵.

Shumica e të krishterëve u japin të varfërve dhe nevojtarëve, siç na mësoi Jezusi (shih Mateu 25:31–46; Marku 14:7). Në ndjekjen e këtij mësimi të Shpëtimtarit tonë, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme dhe anëtarët e saj shquhen. Anëtarët tanë bëjnë kontribute bujare ndaj organizatave bamirëse dhe japin shërbim vetjak dhe dhurata të tjera për të varfrit dhe nevojtarët. Përveç kësaj, anëtarët tanë agjërojnë për dy vakte çdo muaj dhe dhurojnë të paktën vlerën e katyre vakteve si ofertë agjërimi, të cilën e përdorin peshkopët dhe presidentët tanë të degëve për të ndihmuar anëtarët tanë nevojtarë. Agjërimi ynë për të ndihmuar të uriturit, është një veprim dashurie hyjnore dhe, kur bëhet me qëllim të dëlirë, është një festë shpirtërore.

Akoma më pak i njohur është shërbimi humanitar mbarëbotëror i Kishës sonë. Duke përdorur fonde të

dhuruara nga anëtarë bujarë, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme dërgon ushqime, veshje dhe gjëra të tjera të domosdoshme për të lehtësuar vuajtjen e të rriturve dhe të fëmijëve në të gjithë botën. Këto dhurime humanitare, në shumën e qindra miliona dollarësh në dekadën e fundit, bëhen pa marrë parasysh fenë, racën ose kombësinë.

Përpyekja jonë masive e ndihmës pas tërmetit dhe cunamit japonez të 2011–tës siguroi 13 milionë dollarë në para dhe furnizime ndihme. Përveç kësaj, më shumë se 31.000 vullnetarë të sponsorizuar nga Kisha dhanë më shumë se 600.000 orë shërbimi. Ndihma jonë humanitare për viktimat e uraganit Sendi, në pjesën lindore të Shteteve të Bashkuara, përfshiu dhurime të mëdha nga burime të ndryshme, plus thuhajse 300.000 orë shërbimi në përpjekjet për pastrim nga rreth 28.000 anëtarë të Kishës. Mes shumë shembujve të tjerë të vitit të kaluar, ne siguroam rreth 300,000 paund (136,000 kg) veshje dhe këpucë për refugjatët në shtetin afrikan të Çadit. Gjatë 25 viteve të fundit, ne kemi ndihmuar rreth 30 milionë njerëz në 179 vende.⁶ Me të vërtetë, njerëzit e quajtur “mormonë” dinë se si t’u japin të varfërve dhe nevojtarëve.

Në mësimin e Tij të fundit biblik, Shpëtimtari ynë i udhëzoi pasuesit e Tij t’i çonin mësimet e Tij te çdo komb dhe te çdo krijesë. Që nga fillimi i Rivendosjes, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtoreve të Ditëve të Mëvonshme

është përpjekur ta ndjekë atë mësim. Edhe kur ishim një kishë e re, e varfër dhe në vështirësi, me vetëm disa mijëra anëtarë, udhëheqësit tanë të hershëm dërguan misionarë përtej oqeanëve, në lindje dhe perëndim. Si popull, ne kemi vazhduar të japim mësim për mesazhin e krishterë derisa sot programi ynë i pa-shoq misionar ka më shumë se 60.000 misionarë kohëplotë, plus mijëra të tjerë që shërbejnë me kohë të pjesshme. Ne kemi misionarë në mbi 150 shtete dhe territore në mbarë botën.

Si pjesë të Predikimit të Tij të madhërishtë në Mal, Jezusi na mësoi: “Jini, pra, të përkryer, ashtu siç është i përsosur Ati juaj, që është në qiej” (Mateu 5:48). Qëllimi i këtij mësimi dhe qëllimi i ndjekjes së Shpëtimtarit tonë është të vijmë tek Ati, të cilit Shpëtimtari ynë iu drejtua si “Ati im dhe Ati juaj, [dhe] . . . Perëndia im dhe Perëndia juaj” (Gjoni 20:17).

Nga zbulesa moderne, që gjendet vetëm në ungjillin e rivendosur, ne dimë se urdhërimi për të kërkuar përsosmërinë është pjesë e planit të Perëndisë, Atit, për shpëtimin e fëmijëve të Tij. Sipas atij plani, ne të gjithë jemi *trashëgimtarë* të prindërve tanë qiellorë. “Ne jemi bij të Perëndisë”, na mësoi Apostulli Pal, “dhe nëse jemi bij, jemi dhe trashëgimtarë, trashëgimtarë të Perëndisë dhe bashkëtrashëgimtarë të Krishtit” (Romakëve 8:16–17). Kjo do të thotë, siç na thuhet në Dhiatën e Re, se ne jemi “trashëgimtarë të jetës së përjetshme” (Titit 3:7) dhe që, nëse vijmë tek Ati, ne do t’i “trashëgojmë” të gjitha gjërat (Zbulesa 21:7) – gjithçka që ka Ai – një koncept që mendjet tona të vdekshme mund ta kuptojnë me vështirësi. Por së paku ne mund të kuptojmë se arritja e këtij fati përfundimtar në përjetësi është e mundur vetëm nëse e ndjekim Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin, i cili na mësoi se “askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet

meje” (Gjoni 14:6). Ne kërkojmë ta ndjekim Atë dhe të bëhemi më shumë si Ai, këtu dhe pas kësaj jete. Prandaj është që në vargjet e fundit të himnit tonë “Eja, Më Ndiq”, ne këndojmë:

*Ne dim' se duhet në k'të jet',
Që luginës së lot've zbret,
Pas Tij të shkojm'. Por a është' mjaft?
Jo, kjo vazhdon në bot' më lart. . . .*

*Frone, sundim, mbret'ri, pushtet,
Lavdi, parajs' për ne do t'jen',
Po t'u bindemi përjet'sisht
Fjal've të Tij “Eja, më ndiq”.*

Unë dëshmoj për Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin, mësimet dhe shembullin e të cilit ne kërkojmë të ndjekim. Ai i fton të gjithë, që janë të rënduar, të vijmë tek Ai, të mësojmë prej Tij, ta ndjekim Atë dhe në këtë mënyrë të gjejmë prehje për shpirtat tanë (shih Mateu 4:19; 11:28). Unë dëshmoj për të vërtetën e mesazhit të Tij dhe për misionin dhe autoritetin hyjnor të Kishës së Tij të rivendosur, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “Come, Follow Me”, *Hymns*, nr. 116.
2. Shih Karen Lynn Davidson, *Our Latter-day Hymns: The Stories and the Messages* (1988), f. 142–143, 419.
3. “Lord, I Would Follow Thee”, *Hymns*, nr. 220.
4. Shih, për shembull, Heidi S. Swinton, *To the Rescue: The Biography of Thomas S. Monson* (2010), f. 149–161; Thomas S. Monson, “To the Rescue”, *Liahona*, korrik 2001, f. 57–60.
5. Chris Williams, në Jessica Henrie, “Father Relies on Faith to Forgive Intoxicated Teen Driver”, *Deseret News*, 1 gusht 2012, deseretnews.com/article/865559847/Let-It-Go-Chris-Williams-shares-his-story-of-tragedy-and-forgiveness.html; shih edhe Chris Williams, *Let It Go: A True Story of Tragedy and Forgiveness* (2012).
6. Shih “Emergency Response: Church Assists Worldwide”, *Church News*, 9 mars 2013, f. 9; Welfare Services Emergency Response, “2012 Year in Review”, f. 8.
7. *Hymns*, nr. 116.



Nga Plaku Kristofel Golden i Riu,
i Të Shtatëdhjetëve

Ati dhe Biri

Në zemër të ungjillit të Jezu Krishtit dhe të fuqisë së tij për të shpëtuar, është një kuptim i saktë i Atit dhe i Birit.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, jam mirënjohës t’ju drejtohem juve këtë pasdite në mjedisin e kësaj konference të përgjithshme frymëzuese!

Duke trajtuar një temë që në mendjen time është shumë e shenjtë, së pari, dëshiroj të pranoj me mirënjohje përkushtimin e kaq shumë të krishterëve gjatë gjithë historisë, përfshirë të parët e mi protestantë francezë dhe katolikë irlandezë. Për shkak të besimit të tyre dhe të

adhurimit të Perëndisë, shumë prej tyre sakrifkuan poste, zotërieme, madje dhe jetën në mbrojtje të Perëndisë së tyre dhe të besimit të tyre.¹

Si shenjtore të ditëve të mëvonshme dhe si të krishterë, edhe ne kemi një besim të fortë dhe të thellë në Perëndinë, Atin e Përrjetshëm, dhe Birin e Tij, Jezu Krishtin. Përkushtimi ndaj Perëndisë mbetet gjithmonë një çështje e shenjtë dhe vetjake midis secilit prej nesh dhe Krijuesit tonë.



Kërkimi ynë për jetë të përjetshme nuk është asgjë tjetër përveç një kërkimi për të kuptuar se kush është Perëndia dhe për t'u kthyer që të jetojmë me Të. Shpëtimtari iu lut Atit të Tij: “Dhe kjo është jeta e përjetshme, të të njohin ty, të vetmin Perëndi të vërtetë, dhe Jezu Krishtin që ti ke dërguar”².

Madje edhe në dritën e kësaj deklaratë nga Vetë Shpëtimtari ynë, pikëpamja mbizotëruese për natyrën e Atit dhe të Birit përgjatë shumë shekujve dhe midis shumicës së njerëzimit, është qartësisht kontradiktore me mësimet e shkrimeve të shenjta.

Me respekt ne parashtrijmë se, në zemër të ungjillit të Jezu Krishtit dhe të fuqisë së tij për të shpëtuar, është një kuptim i saktë i Atit dhe i Birit.³

Rëndësia e këtij parimi shumë themelor të ungjillit të Jezu Krishtit vërtetohet nga Vegimi i Parë i Profetit Jozef Smith, në 1820–ën. Profeti shkroi: “Unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcejnë të gjitha përkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin – *Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!*”⁴

Kjo përvojë e djaloshit Jozef, e pasuar nga shumë vegime dhe zbulesa të tjera, tregon se Perëndia në të vërtetë ekziston; se Ati dhe Biri i Tij, Jezu Krishti, janë dy qenie të ndara dhe të ndryshme; se njeriu është krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; se Ati ynë Qiellor është vërtet Ati i Jezu Krishtit; se Perëndia vazhdon t'ia zbulojë Veten njeriut; se Perëndia është gjithmonë afër dhe i interesuar për ne; dhe se Ai u përgjigjet lutjeve tona.

Megjithëse shfaqje të ngjashme të Atit dhe të Birit në shkrimin e shenjtë janë relativisht të rralla, e vërteta e mrekullueshme e Vegimit të Parë është se përputhet kaq mirë me ngjarje të tjera të shënuara në shkrimet e shenjta.


Në Dhiatën e Re, për shembull, ne lexojmë për dëshminë përfundimtare të Stefanit gjatë martirizimit të tij. Ai tha: “Ja, unë po shoh qiejt e hapur dhe Birin e njeriut që rri në këmbë në të djathtën e Perëndisë”⁵.

Ndërsa ishte në vegimin e fuqishëm në ishullin e Patmosit, Apostulli Gjon sheh “Zoti[n] Perëndi, [të] Plotfuqishmi[n]”⁶ si edhe Qengjin e Perëndisë, i cili “me gjakun [e Tij] na ble[uj]”⁷.

Në Librin e Mormonit, doktrina e Atit dhe e Birit qëndron në dëshmi madhështore përkrah Biblës së Shenjtë. Libri i Mormonit shënon vizitën e Shpëtimtarit tonë te nefitët, në të cilën zëri i Atit, në praninë e rreth 2.500 nefitëve, prezanton Krishtin e ringjallur: “Vini re Birin tim të Dashur, në të cilin unë jam shumë i kënaqur, në të cilin unë kam lartësuar emrin tim – dëgjojeni atë”⁸.

Në të katër Ungjijtë, Vetë Krishti i drejtohet Atit të Tij në Qiell 160 herë, ndërsa gjatë shërbesës së Tij të shkurtër treditore midis nefitëve, siç shënohet në Librin e Mormonit, Ai e përmend Atin e Tij 122 herë.

Për shembull, te Mateu, Jezusi thotë: “Jo çdo njeri që më thotë: ‘Zot, Zot’ do të hyjë në mbretërinë e qiejve; por do të hyjë ai që kryen vullnetin e *Atit tim* që është në qiej”⁹.



Te Gjoni, Ai dëshmon: “Biri nuk mund të bëjë asgjë prej vetvetes, përveç asaj që sheh se bën *Ati*”¹⁰.

Dhe te Lluka, Ai thërret: “*O Atë*, në duart e tua po e dorëzoj frymën tim”¹¹!

Çdo herë që Zoti ynë i drejtohet Atit të Tij Qiellor, Ai e bën këtë me nderimin dhe nënshtrimin më të madh.

Duke thënë këtë, shpresoj se nuk do të ketë keqkuptim. Jezu Krishti është Jehova i madhërishtëm, Perëndia i Izraelit, Mesia i premtuar dhe, për shkak të Shlyerjes së Tij të pafundme, Ai është Shpëtimtari ynë dhe Shëlbuesi i botës. Për Të, Apostulli Pal shpalli: “Pastaj do të vijë fundi, kur [Krishti] t’ia dorëzojë mbretërinë Perëndisë Atë, pasi [Krishti] të ketë asgjësuar çfarëdo sundimi, çdo pushtet e fuqi”¹².

Në prag të Shlyerjes së Shpëtimtarit, Ai i ofroi Atit Lutjen e Tij të madhe Ndërmjetësuese. Ai u lut:

“Tani unë nuk lutem vetëm për ta [me fjalë të tjera, Apostujt e Tij], por edhe për ata që do të besojnë në mua me anë të fjalës së tyre,

që të gjithë të jenë *një*, ashtu si ti, o Atë, je në mua dhe unë në ty; edhe ata të jenë *një në ne*, që bota të besojë se ti më ke dërguar.

Dhe unë u kam dhënë lavdinë që më ke dhënë, që ata të jenë një, ashtu si ne jemi një.”¹³

Ati dhe Biri janë qenie qartësisht të ndara, por Ata janë përsosmërisht të bashkuar dhe një në fuqi e qëllim. Uniteti i tyre nuk është ruajtur vetëm për Ta; përkundrazi, Ata dëshirojnë po këtë unitet tek të gjithë ata që, me përkushtim, do t’i ndjekin dhe do t’u binden urdhërimeve të Tyre.

Si mundet të njihet me Atin dhe Birin kërkuesi i zellshëm i Perëndisë? Shpëtimtari ynë premtoi: “Por Ngu-shëlluesi, Fryma e Shenjtë, . . . do t’ju mësojë çdo gjë”¹⁴.

Në Librin e Mormonit, Nefi, kur po fliste për doktrinën e Krishtit, deklaroi



se Fryma e Shenjtë “dëshmon për Atin dhe Birin”¹⁵.

Është e vërtetë që fuqia apo ndikimi i Frymës së Shenjtë mund të ndihet me raste nga çdo njeri, sipas vullnetit të Zotit, pavarësisht bindjes fetare të atij njeriu. Por masa e plotë, ose dhurata, e Frymës së Shenjtë vjen vetëm pasi një njeri ka marrë, me “një zemër të thyer dhe shpirt të penduar”¹⁶, ordinancat e pagëzimit dhe të dhuratës së Frymës së Shenjtë¹⁷ me anë të vënies së duarve. Këto dhe ordinanca të tjera të shenjta mund të kryhen vetëm nën drejtimin dhe fuqinë e priftërisë së Perëndisë. Në lidhje me këtë, na është mësuar:

“Dhe kjo priftëri më e madhe administron ungjillin dhe mban çelësin e mistereve të mbretërisë, madje çelësin e daturisë së Perëndisë.

Si rrjedhim, në ordinancat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet.”¹⁸

E parë në dritën e saj të vërtetë, doktrina e Atit dhe e Birit është doktrina e familjes së përjetshme. Çdo qenie

njerëzore ka ekzistuar më parë si një fëmijë shpirtëror me prindër qiellorë¹⁹, me Krishtin duke qenë i Parëlinduri i Atit në këtë familje qiellore.²⁰

Kështu është me të gjithë ne. Ne jemi fëmijë të Atit tonë Qiellor.

Presidenti Ezra Taft Benson me mprehtësi profetike tha: “Asgjë nuk do të na befasojë më tepër kur të kalojmë përmes velit në anën tjetër, sesa të kuptojmë se sa mirë e njohim Atin tonë [në Qiell] dhe se sa familjare është fytyra e tij për ne”²¹.

Kam mësuar se nuk është e mundur të përçohen në gjuhën e njeriut ato gjëra që janë bërë të njohura vetëm nga Fryma e Shenjtë dhe fuqia e Perëndisë. Është në këtë frymë që unë jap dëshminë time solemne për realitetin, afërsinë dhe mirësinë e Atit tonë të Përjetshëm dhe të Birit të Tij të shenjtë, Jezu Krishtit. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Kenneth Scott Latourette, *A History of Christianity, Vëllimi 1: Beginnings to 1500*,

bot. i rish. (1975) dhe *A History of Christianity, Vëllimi 2: Reformation to the Present*, bot. i rish. (1975); shih edhe Diarmaid MacCulloch, *The Reformation* (2003).

2. Gjoni 17:3.

3. Shih *Lectures on Faith* (1985), f. 38–44.

4. Joseph Smith – Historia 1:17.

5. Veprat e Apostujve 7:56.

6. Zbulesa 4:8.

7. Zbulesa 5:9.

8. 3 Nefi 11:7.

9. Mateu 7:21; theksimi i shtuar.

10. Gjoni 5:19; theksimi i shtuar.

11. Lluca 23:46; theksimi i shtuar.

12. 1 Korintasve 15:24. Me qëllim që të kuptoni më tepër për Shpëtimtarin dhe misionin e Tij, shihni “The Living Christ: The Testimony of the Apostles”, *Liahona*, prill 2000, f. 2–3.

13. Gjoni 17:20–22; theksimi i shtuar.

14. Gjoni 14:26.

15. 2 Nefi 31:18.

16. 3 Nefi 9:20; Moroni 6:2.

17. Shih Gjoni 3:5; 3 Nefi 11:31–38.

18. Doktrina e Besëlidhje 84:19–20.

19. Shih “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.

20. Shih Kolosianëve 1:15; Doktrina e Besëlidhje 93:21.

21. Ezra Taft Benson, “Jesus Christ – Gifts and Expectations”, në *Speeches of the Year, 1974* (1975), f. 313; shih edhe “Jesus Christ – Gifts and Expectations”, *Tambuli*, maj 1977, f. 24.



Nga Plaku Enrike R. Falabela,
i Të Shtatëdhjetëve

Shtëpia: Shkolla e Jetës

Mësimet mësohen në shtëpi – vendi që mund të bëhet një copë qiell këtu në tokë.

Disa prindër shfajësohen për gabimet që kanë bërë në shtëpi, duke pohuar se arsyeja e kësaj është se nuk ka një shkollë prindërimi.

Në të vërtetë, një shkollë e tillë vërtet që ekziston dhe mund të jetë më e mira nga të gjitha. Kjo shkollë quhet *shtëpi*.

Ndërsa shkoj pas në krahët e kujtesës sime, kujtoj çaste të dashura që kam përjetuar me bashkëshorten time. Ndërsa i ndaj këto kujtime me ju, ju mund të kujtoni përvojat tuaja – si të lumtura edhe të trishtuara; ne mësojmë nga të gjitha ato.

1. Tempulli Është Vendi

Kur u ktheva nga misioni im, takova një të re të bukur, me flokë të zinj e të gjatë, që i zbrisnin deri në mes. Ajo kishte sy të mëdhenj e të bukur ngjyrë mjalti dhe një buzëqeshje ngjitesë. Ajo më robëroi që nga çasti i parë që e pashë.

Bashkëshortja ime kishte vënë synimin që të martohej në tempull edhe pse, në atë kohë, tempulli më i afërt kërkonte një udhëtim prej më shumë se 6.400 km.

Ceremonia e martesës sonë civile ishte edhe e lumtur edhe e trishtuar, sepse u martuam me një datë skandence. Punonjësi shqiptoi fjalët: “Dhe

tani ju deklaroj burrë e grua”, por menjëherë pas kësaj, ai tha: “derisa vdekja t’ju ndajë”.

Kështu që, me sakrificë, kursyem sa për të blerë një biletë vetëm vajtjeje deri në Tempullin e Mesës në Arizonë.

Në tempull, ndërsa ishim të gjuhëzuar tek altari, një shërbëtar i autorizuar shqiptoi fjalët që doja shumë të dëgjoja, të cilat na shpallën burrë e grua për këtë kohë dhe për të gjithë përjetësinë.

Një mik na çoi te Shkolla e së Dielës. Gjatë mbledhjes ai u ngrit në këmbë dhe na paraqiti tek të pranishmit. Kur mbledhja mbaroi, një vëlla m’u afrua dhe më toku dorën, duke më lënë një kartmonedhë 20–dollarëshe. Menjëherë pas kësaj, edhe një tjetër vëlla m’u afrua dhe, për habinë time, edhe ai më lënë dorë një kartmonedhë. Menjëherë kërkova me sy bashkëshorten time, që ishte nga ana tjetër e dhomës, dhe i thirra: “Blanki, toki duart me të gjithë!”

Shpejt ne mblodhëm mjaftueshëm para sa të ktheheshim në Guatemalë.

“Në lavdinë çelestiale ka tre qiej ose shkallë;

Dhe me qëllim që të fitojë më të lartën, një njeri duhet të hyjë në këtë rend të priftërisë.”¹

2. Që të Grindesh, të Duhet Dy Njerëz

Një nga motot e bashkëshortes sime ka qenë: “Me qëllim që të grindesh, të duhen dy njerëz dhe unë nuk do të jem kurrë njëri prej tyre”.

Zoti i ka përshkruar qartë veçoritë që duhet të na udhëheqin në marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë. Këto janë bindja, durimi, mirësjellja, zemërbutesia dhe dashuria e pashtirur.²

Abuzimi fizik në familje është një praktikë që po ndodh më rrallë në disa shoqëri, dhe ne gëzohemi për këtë. Megjithatë, jemi shumë larg nga përjashtimi i abuzimit emocional. Dëmi i shkaktuar nga kjo formë abuzimi na mbetet në kujtesë, na lëndon personalitetin, na mbjell urrejtje në zemra, na zvogëlon vlerësimin për veten dhe na mbush me frikë.

Pjesëmarrja në ceremoninë e martesës çelestiale nuk mjafton. Ne gjithashtu duhet të jetojmë një jetë çelestiale.

3. Një Fëmijë që Këndon, Është një Fëmijë i Lumtur

Kjo është një moto tjetër që bashkëshortja ime e përmend shpesh.

Shpëtimtari e kuptonte rëndësinë e muzikës së shenjtë. Pasi mbajti Pashkën me dishepujt e Tij, shkriimet e shenjta tregojnë: “Dhe, mbasi kënduan një himn, dolën dhe u drejtuan nga mali i Ullinjve”³.

Dhe duke folur me anë të Profetit Jozef, Ai tha: “Sepse shpirti im kënaqet në këngën e zemrës; po, kënga e të drejtëve është një lutje për mua dhe ajo do të marrë përgjigje me një bekim mbi kokat e tyre”⁴.

Sa prekëse është të dëgjosh këngën e një vogëlushi, të cilit prindërit i kanë mësuar të këndojë: “Fëmi i Per’ndis’ Jam”⁵.

4. Unë Kam Nevojë të më Përqafosh

Fjalët “Të dua”, “Faleminderit shumë” dhe “Më fal” janë si një balsam



për shpirtin. Ato i shndërrojnë lotët në lumturi. Ato i sjellin ngushëllim shpirtit të shqetësuar dhe i vërtetojnë ndjenjat e dashura të zemrës sonë. Ashtu si bimët vyshken nga mungesa e ujit të çmuar, dashuria jonë dobësohet dhe vdes kur ne nuk përdorim fjalë dhe veprime dashurie.

Më kujtohen kohët kur e kishim zakon të dërgonim letra dashurie me anë të postës së zakonshme ose se si mblihdhnim pak monedha për të marrë në telefon njerëzit tanë të dashur nga një kabinë telefonike, apo se si do të skiconim e shkruanim vjersha dashurie në letër të zakonshme.

Sot të gjitha këto duken si objekte muzeu!

Teknologjia në këtë kohë dhe epokë na lejon të bëjmë çudira. Sa e lehtë është të dërgojmë me celular një mesazh dashurie dhe mirënjohjeje! Rinia e bën këtë gjatë gjithë kohës. Vras mendjen nëse kjo dhe praktika të tjera të bukura vazhdojnë pasi ngremë shtëpinë. Një nga mesazhet e fundit me celular që mora nga bashkëshortja ime, është ky: “Një

përqaftim sa qielli, një puthje si dielli dhe një mbrëmje si hëna. Ditë të lumtur, unë të dua.”

Nuk mund të mos ndihem si të jem në qiell kur marr një mesazh si ky.

Ati ynë në Qiell është një shembull i përkryer për shprehjen e dashurisë. Kur paraqiti Birin e Tij, Ai përdori fjalët: “Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur”⁶.

5. Unë e Dua Librin e Mormonit dhe Shpëtimtarin Tim, Jezu Krishtin

Mbushem me emocion kur e shoh bashkëshorten time të lexojë Librin e Mormonit çdo ditë. Kur ajo e bën këtë, mund ta ndiej dëshminë e saj, thjesht duke parë gëzimin në pamjen e saj kur ajo lexon pjesët që dëshmojnë për misionin e Shpëtimtarit.

Sa të mençura janë fjalët e Shpëtimtarit tonë: “Ju hetoni Shkrimet sepse mendoni të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme; dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua”⁷.

Frymëzuar nga kjo, i kërkova mbesës sime, Raketës, që ka mësuar të lexojë së fundmi: “Çfarë do të thoshje

po të vëmë si synim që të lexojmë Librin e Mormonit?”

Përgjigjja e saj qe: “Por, Gjyshi, është kaq e vështirë. Është një libër i madh.”

Pastaj i kërkova të më lexonte një faqe. Mora një kronometër dhe mata kohën. I thashë: “Tu deshën vetëm tri minuta dhe varianti spanjisht i Librit të Mormonit ka 642 faqe, kështu që ty të duhen 1.926 minuta”.

Kjo do të mund ta kishte frikësuar atë edhe më shumë, kështu që e pjesëtova atë numër me 60-minutëshja dhe i thashë se do t’i duheshin vetëm 32 orë për ta lexuar atë – më pak se një ditë e gjysmë!

Atëherë ajo më tha: “Kjo është kaq e lehtë, Gjyshi”.

Më në fund Rakela, vëllai i saj, Estebani, dhe nipërit e mbesat tanë të tjerë shpenzuan më shumë kohë se kaq, sepse ai është një libër që duhet të lexohet me një shpirt lutjeje dhe meditimi.

Me kalimin e kohës, ndërsa mësojmë të kënaqemi pa masë në shkrimet e shenjta, do të thërrasim si Psalmisti: “Sa të ëmbla janë fjalët e tua në gojën time! Janë më të ëmbla se mjalti në gojën time!”⁸

6. Nuk Mjafton t’i Dimë Shkrimet e Shenjta; Ne Duhet t’i Jetojmë Ato

Më kujtohet kur isha misionar i kthyer dhe, pasi i kisha hetuar shkrimet e shenjta me zell, mendoja se i dija të gjitha. Gjatë periudhës sonë të njohjes, Blanki dhe unë do t’i studionim shkrimet e shenjta së bashku. Përdora shumë prej shënimeve dhe referencave të mia për të ndarë me të njohurinë time të ungjillit. Pasi u martuam arrita në një kuptim të rëndësishëm ndërsa mësova një mësim të madh prej saj: Unë mund të isha përpjekur t’ia mësoja asaj ungjillin, por ajo më mësoi se si ta jetojë atë.

Kur Shpëtimtari mbaroi Predikimin në Mal, Ai dha këtë këshillë të mençur: “Prandaj, ai që i dëgjon këto fjalë të mia dhe i vë në praktikë, mund të krahasohet prej meje me një njeri të zgjuar, që e ka ndërtuar shtëpinë e tij mbi shkëmb”⁹.

Ata që jetojnë parimet çelestiale, të cilat gjenden në shkrimet e shenjta, u japin ngushëllim atyre që vuajnë. Ata u sjellin gëzim atyre që janë të brengosur, drejtim atyre që kanë humbur, paqe atyre që janë të shqetësuar, dhe një drejtim të sigurt atyre që kërkojnë të vërtetën.

Përmbledhtas:

1. Tempulli është vendi.
2. Që të grindesh, të duhen dy njerëz dhe unë nuk do të jem kurrë njëri prej tyre.
3. Një fëmijë që këndon, është një fëmijë i lumtur.
4. Unë kam nevojë të më përqafosh.
5. Unë e dua Librin e Mormonit dhe Shpëtimtarin tim, Jezu Krishtin.
6. Nuk mjafton t'i dimë shkrimet e shenjta; ne duhet t'i jetojmë ato.

Këto dhe shumë mësim të tjera, mësohen në shtëpi – vendi që mund të bëhet një copë qiell këtu në tokë.¹⁰ Unë dëshmoj se ungjilli i Jezu Krishtit dhe plani i Atit tonë Qiellor japin një drejtim të sigurt në këtë jetë dhe premtimin e jetës së përjetshme, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 131:1–2.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:41.
3. Marku 14:26.
4. Doktrina e Besëlidhje 25:12.
5. “Fëmi” i Per’ndis’ Jam”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58.
6. Mateu 3:17; shih edhe Marku 1:11; 3 Nefi 11:7.
7. Gjoni 5:39.
8. Psalmeve 119:103.
9. Mateu 7:24.
10. Shih *Teachings of Presidents of the Church: David O. McKay* (2003), f. 43, 150.



Nga Plaku Erik W. Kopishke,
i Të Shtatëdhjetëve

Të Pranoresh nga Zoti

Kërkimi dhe marrja e pranimit prej Zotit do të na bëjnë të dimë se jemi të zgjedhur e të bekuar prej Tij.

Kur isha djalosh, më kujtohet që babai im ndonjëherë më merrte me vete për të punuar në projekte. Ne kishim një kopsht të vogël disa kilometra nga vendi ku jetonim dhe përherë kishte shumë punë për t’u bërë që ta përgatisnim kopshtin për secilën stinë. Ne merreshim me tendën e drunjte apo ndërtonim ose riparanim gardhe. Në kujtimet e mia, kjo punë gjithmonë u bë në të ftohtë të acartë, në borë të ashpër ose në shi të madh. Por më pëlqente shumë. Babai më mësonte se si t’i bëja gjërat me durim dhe pranim.

Një ditë, ai më kërkoi të shtrëngoja një vidë dhe më paralajmëroi: “Mbaj mend, nëse e shtrëngon tepër, do të këputet”. Me krenari, dëshiroja t’i tregoja se çfarë mund të bëja. E shtrëngova me gjithë forcën që kisha dhe, sigurisht, e këputa vidën. Ai bëri një vërejtje komike dhe ia nisëm nga e para. Edhe kur “i katranosja gjërat”, gjithmonë e ndieja dashurinë dhe mirëbesimin e tij në mua. Ai ndërroi jetë mbi 10 vjet më parë, por ende mund ta dëgjoj zërin e tij, mund ta ndiej dashurinë e tij, mund të kem inkurajimin e tij e ta ndiej pranimin e tij.

Ndjenja e të qenit i pranuar nga dikush që e duam, është nevojë themelore njerëzore. Të qenit i pranuar nga njerëz të mirë na nxit. E rrit ndjenjën

tonë të vetëvlerësimit dhe të vetëbesimit. Ata që nuk mund të gjejnë pranim nga burime të dëshirueshme, shpesh e kërkojnë atë gjetkë. Mund të drejtohen te njerëz të cilëve nuk u intereson mirëqenia e tyre. Mund të bashkohen me miq të rremë dhe të bëjnë gjëra të dyshimta në përpjekje për të marrë miratimin që po kërkojnë. Mund të kërkojnë pranim duke veshur një markë të veçantë veshjeje për të nxitur një ndjenjë të përkatësisë ose të pozitës. Për disa, përpjekja për një rol apo pozicion me rëndësi mund të jetë gjithashtu një mënyrë për të kërkuar pranim. Ata mund ta përcaktojnë vlerën e tyre nga pozicioni që mbajnë ose pozita që fitojnë.

Madje edhe në Kishë, ne nuk jemi gjithnjë të lirë nga ky lloj mendimi. Kërkimi i pranimit nga burime të gabuara ose për arsye jokorrekte na vë në një shteg të rrezikshëm – një shteg që ka mundësi të na çojë në udhë të gabuar dhe madje drejt shkatërrimit. Në vend që të ndiejmë se na duan dhe të ndihemi të sigurt në vetvete, ne përfundimisht do të ndihemi të braktisur dhe të pavlerë.

Alma e këshilloi të birin, Helamanin: “Vër re të shikosh te Perëndia dhe jeto”¹. Burimi themelor për forcë dhe pranim të përhershëm është Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti.

Ata na njohin. Ata na duan. Ata nuk na pranojnë prej titullit apo pozicionit tonë. Ata nuk e vërejnë pozitën që kemi. Ata shohin brenda zemrës sonë. Ata na pranojnë për njeriun që jemi dhe për atë që po përpiqemi të bëhemi. Synimi për pranim prej Tyre dhe marrja e tij, do të na lartësojë dhe inkurajojë përherë.

Do t'ju tregoj një model të thjeshtë, i cili, nëse zbatohet, mund ta ndihmojë gjithsecilin prej nesh të marrë pranim të përhershëm. Ky model u dha nga Zoti përmes Profetit Jozef Smith: “Në të vërtetë unë ju them, të gjithë mes atyre që e dinë se zemrat e tyre janë të pastra e të thyera dhe shpirtrat e tyre të penduar, dhe janë të gatshëm t'i ruajnë besëlidhjet e tyre me anë të sakrificës – po, çdo sakrificë që unë, Zoti, do të urdhëroj – ata pranohen nga unë”².

Ky model përbëhet nga tre hapa të thjeshtë:

1. Të dimë që zemrat tona janë të pastra dhe të thyera,
2. Të dimë që shpirtrat tanë janë të penduar, dhe
3. Të jemi të gatshëm t'i ruajmë [e mbajmë] besëlidhjet tona me anë të sakrificës, siç urdhërohemi nga Zoti.

Së pari, duhet të dimë që zemrat tona janë të pastra dhe të thyera. Si e dimë këtë? Ne fillojmë duke u përfshirë në vetanalizim të sinqertë. Zemra është qendra e ndjenjave tona. Teksa shohim brenda zemrës sonë, ne bëjmë një vlerësim të vetvetes. Atë që askush nuk e di rreth nesh, ne e dimë me siguri. Ne i njohim motivet dhe dëshirat tona. Kur përfshihemi në reflektim të sinqertë e të ndershëm, ne nuk e justifikojmë apo e mashtrojmë veten.

Ka gjithashtu një mënyrë për të gjykuar nëse zemrat tona janë të thyera. Një zemër e thyer është një zemër e



butë, e hapur dhe pranuese. Kur e dëgjoj Shpëtimtarin të thotë: “Ja, unë qëndroj te dera dhe trokas”³, e dëgjoj Atë të trokasë në derën e zemrës sime. Nëse ia hap këtë derë Atij, unë jam më veprues ndaj ftesave të Shpirtit dhe më pranues ndaj vullnetit të Perëndisë.

Kur meditojmë me sinqeritet dhe me lutje mbi atë sesa të pastra dhe të thyera janë zemrat tona, ne do të marrim mësim nga Fryma e Shenjtë. Ne do të marrim një konfirmim të ëmbël ose korrigjim të butë, që na fton të veprojmë.

Së dyti, ne duhet të dimë që shpirti ynë është i penduar. Te fjalori i Oksfordit, fjala *i penduar* përkufizohet si “ndjenjë ose shprehje e keqardhjes kur një njeri pranon se ka vepruar gabim”⁴. Nëse kemi shpirt të penduar, ne i pranojmë mëkatet dhe të metat tona. Ne jemi të aftë të marrim mësim “në lidhje me [të gjitha] gjërat që k[anë] të bëjnë me drejtësinë”⁵. Ne ndiejmë keqardhje hyjnore dhe jemi të gatshëm të pendohemi. Një shpirt i penduar është i gatshëm të dëgjojë “thirrjet e Frymës së Shenjtë”⁶.

Një shpirt i penduar del në pah përmes gatishmërisë dhe vendosmërisë sonë për të vepruar. Ne jemi të gatshëm të përulemi përpara Perëndisë, të gatshëm të pendohemi, të gatshëm të mësojmë dhe të gatshëm të ndryshojmë. Ne jemi të gatshëm të lutemi: “Mos u bëftë vullneti im, por yt”⁷.

Hapi i tretë që të pranohesh nga Zoti, është një vendim i ndërgjegjshëm për të ruajtur besëlidhjet tona me anë të sakrificës, “po, çdo sakrificë që unë, Zoti, do të urdhëroj”⁸. Tepër shpesh ne mendojmë se fjala *sakrificë* i referohet diçkaje të madhe ose të vështirë për t'u bërë nga ne. Në situata të caktuara kjo mund të jetë e vërtetë, por përgjithësisht i referohet të jetuarit dita-ditës si dishepull i vërtetë i Krishtit.

Një mënyrë se si i ruajmë besëlidhjet tona me anë të sakrificës është duke e marrë sakramentin denjësisht çdo javë. Ne e përgatisim veten me ndërgjegje për ordinancën e shenjtë. Ne rinovojmë premtimet tona të shenjta me Zotin dhe ia pohojmë ato Atij. Në këtë mënyrë, ne e ndiejmë



pranimin e Tij dhe marrim miratim nga Ai që përpjekjet tona vihen re dhe mëkatet na falen përmes Shlyerjes së Jezu Krishtit. Gjatë kësaj ordina- nce, Zoti na premtan se kur jemi të gatshëm të marrim mbi vete emrin e Birit të Tij dhe gjithmonë ta kujtojmë Atë dhe të zbatojmë urdhërimet e Tij, ne do të kemi gjithmonë Shpirtin e Tij me ne. Të pasurit e Frymës së Shenjtë si shoqëruesin tonë të vazhdueshëm është treguesi themelor se pranohemi nga Perëndia.

Mënyra të tjera për të ruajtur besëlidhjet tona me anë të sakrificës janë po aq të thjeshta sikurse pranimi i një thirrjeje në Kishë dhe shërbimi besnikërisht në atë thirrje, apo ndjekja e ftesës së profetit tonë, Tomas S. Monson, për t'iu afruar atyre që ndo- dhen buzë rrugës dhe kanë nevojë të shpëtohen shpirtërisht. Ne i ruajmë besëlidhjet tona me anë të sakrificës duke bërë shërbim pa u vënë re në la- gjen ose komunitetin tonë, apo duke gjetur emrat e paraardhësve tanë dhe duke bërë punën në tempull për ta. Ne i ruajmë besëlidhjet tona me anë të sakrificës thjesht duke u përpje- kur për drejtësi, duke qenë të hapur dhe duke ua vënë veshin nxitjeve të Shpirtit, ndërsa jetojmë jetën tonë të përditshme. Ndonjëherë mbajtja e

besëlidhjeve të bëra, nuk do të thotë asgjë më shumë sesa të qëndrosh i fortë dhe besnik kur stuhitë e jetës tërbohen kudo rreth nesh.

Pasi shpjegon modelin se si të pranohemi prej Tij, Zoti përdor një ilu- strim të mrekullueshëm për të treguar se si përfitojmë ne si individë e familje ndërsa kërkojmë të na pranojë Ai. Ai tha: “Sepse unë, Zoti, do t'i bëj ata të lulëzojnë si një pemë shumë fryt- dhënëse, e cila mbillet në një tokë të mirë, pranë një rrekeje të pastër, e cila prodhon shumë fruta të çmuar”⁹.

Kur jemi vetë në harmoni me Shpirtin e Zotit dhe ndiejmë pranimin e Tij, ne do të bekohemi përtej aftësisë sonë për të kuptuar dhe do të sjellim shumë fryte drejtësie. Ne do të jemi mes atyre, të cilëve Ai u ka thënë: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; ti u tregove besnik në gjëra të vogla, unë do të të vë mbi shumë gjëra; hyr në gëzimin e zotit tënd”¹⁰.

Kërkimi dhe marrja e pranimin prej Zotit do të na bëjnë të dimë se jemi të zgjedhur e të bekuar prej Tij. Ne do të fitojmë besim më të madh se Ai do të na drejtojë e do të na udhëheqë për mirë. Mëshirat e Tij të dhembshura do të bëhen të dukshme në zemrat tona, në jetën tonë dhe në familjet tona.

Ju ftoj me gjithë zemër që të

kërkoni pranimin e Zotit dhe të gëzoni bekimet e Tij të premtuara. Ndërsa ndjekim modelin e thjeshtë që ka treguar Zoti, ne do të arrijmë ta dimë se jemi pranuar prej Tij, pavarësisht nga pozicioni, gjendja apo kufizimet tona tokësore. Pranimi i Tij i dashur do të na motivojë, do ta rrisë besimin tonë dhe do të na ndihmojë të përballojmë çdo gjë që hasim në jetë. Pavarë- sisht nga sfidat tona, ne do të jemi të suksesshëm, do të përparojmë¹¹ dhe do të ndiejmë paqe¹². Do të jemi mes atyre të cilëve Zoti u tha:

“Mos kini frikë, fëmijë të vegjël, sepse ju jeni të mitë dhe unë e kam mundur botën e ju jeni prej atyre që Ati im m'i ka dhënë;

Dhe asnjë prej atyre që Ati im m'i ka dhënë, nuk do të humbasë”¹³.

Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Alma 37:47.
2. Doktrina e Besëlidhje 97:8.
3. Zbulesa 3:20.
4. *Oxford Dictionaries Online*, “contribute”, oxforddictionaries.com.
5. Alma 21:23.
6. Mosia 3:19.
7. Lluca 22:42.
8. Doktrina e Besëlidhje 97:8.
9. Doktrina e Besëlidhje 97:9.
10. Mateu 25:21.
11. Shih Mosia 2:22.
12. Shih Mosia 2:41.
13. Doktrina e Besëlidhje 50:41–42.



Nga Plaku Brus D. Porter,
I të Shtatëdhjetëve

Mëngjese të Bukura

Vëllezër e motra, nuk duhet t'i druheni së ardhmes, as të ligështohemi në shpresë dhe në marrjen zemër, sepse Perëndia është me ne.

Në një mbrëmje të diele në Jerusalem, Jezusi dhe dishepujt u mblodhën në një dhomë të sipërme që të festonin Pashkën. Burrat që shkuan pas Tij, nuk e dinin që, ky vakt, një ditë do të quhej Darka e Fundit. Po ta kishin ditur këtë dhe kuptimin e saj, do të kishin lotuar.

Mësuesi i tyre, sidoqoftë, e kuptonte fare mirë se prova e rëndë e Gjetsemanit dhe e Golgotës do të fillonte pas pak. Orët më të errëta në historinë e botës qenë të pashmangshme; megjithatë, Jezusi u tha atyre: “Në botë do të keni mundime, por merrni zemër; unë e munda botën” (Gjoni 16:33).

Ne jetojmë sot në një epokë trazirash dhe pasigurie, një kohë për të cilën Zoti i profetizoi Enokut se do të shënohej si “ditët e ligësisë dhe të hakmarrjes” (Moisiu 7:60). Trazira dhe kohë të vështira mund të na presin, prapëseprapë edhe ne kemi shkak të marrim zemër e të gëzohemi sepse ne jetojmë në periudhën e fundit ungjillore, kur Perëndia ka rivendosur Kishën dhe mbretërinë e Tij në tokë në përgatitje për kthimin e Birit të Tij.

Presidenti Bojd K. Paker foli dikur rreth nipërve e mbesave të tij dhe botën gjithnjë e më të trazuar në të cilën ata jetojnë. Ai tha: “Ato do të shohin shumë ngjarje që do të ndodhin gjatë

rrjedhës së jetës së tyre. Disa prej tyre do të sfidohen në guximin e tyre dhe do ta tendosin besimin e tyre. Por nëse kërkojnë ndihmë dhe udhëzim plot lutje, do t'u jepet fuqi mbi kundërshtitë.”

Dhe më vonë ai shtoi: “Vlerat morale nga të cilat vetë qytetërimi duhet të mbështetet, po shkatërrohen me një ritëm gjithnjë e në rritje. Megjithatë, nuk i druheni së ardhmes” (“Do Not Fear”, *Liahona*, maj 2004, f. 77, 78).

Vëllezër e motra, nuk duhet t'i druheni së ardhmes, as të ligështohemi në shpresë dhe në marrjen zemër, sepse Perëndia është me ne. Mes fjalëve të para të shënuara nga këshilla që Jezusi u dha dishepujve të Tij të sapothirrur në Galile, ishte paralajmërimi trifjalësh: “Mos ki frikë” (Luka 5:10). Ai e përsëriti atë këshillë shumë

herë gjatë shërbesës së Tij. Shenjtorëve të Tij në kohën tonë, Shpëtimtari u ka thënë: “Merrni zemër dhe mos u frikësoni, sepse unë, Zoti, jam me ju dhe do t'ju qëndroj përkrah” (DeB 68:6).

Zoti do të qëndrojë përkrah Kishës dhe popullit të Tij dhe do t'i mbajë ata në mbrojtje deri në ardhjen e Tij. Do të ketë paqe në Sion dhe në kunjet e Tij, sepse Ai ka shpallur “që mbledhja së bashku mbi tokën e Sionit dhe në kunjat e tij të mund të jetë për mbrojtje e për strehim nga stuhia dhe nga zemërimi, kur të derdhen pa u zvogëluar mbi tërë dheun” (DeB 115:6).

Kisha qëndron si mburojë mbrojtjeje për anëtarët e saj. Megjithëse kushtet në botë mund të jenë shumë të pafavorshme ndonjëherë, shenjtorët besnikë të ditëve të mëvonshme do ta gjejnë shenjtëroren në kunjet e Sionit. Zoti e ka dekretuar se guri i shkëputur nga mali, jo nga dora e njeriut, do të rrotullohet poshtë derisa ta mbushë të gjithë tokën (see Danieli 2:31–45; DeB 65:2). Asnjë fuqi njerëzore s'mund t'ia presë rrugën, sepse Perëndia është autori i kësaj pune dhe Jezu Krishti është guri kryesor i qoshes.

Nefi pa në vegim se në ditët e fundit fuqia e Qengjit të Perëndisë do të zbriste “mbi njerëzit e besëlidhjes së Zotit” dhe ata do të ishin të “armatosur me drejtësi dhe me fuqinë e Perëndisë në lavdi të madhe” (1 Nefi 14:14).



Çdonjëri prej nesh dhe familjet tona, mund të armatosen me fuqinë e Perëndisë si një mbrojtje, nëse do të mbetemi të vërtetë ndaj Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme dhe ta lëmë Shpirtin e Shenjtë të jetë udhërrëfyesi ynë. Sprovat mund të vijnë dhe ne mund të mos e kuptojmë gjithçka që na ndodh neve ose përreth nesh. Por nëse ne mirëbesojmë te Zoti përrulësisht, qetësisht, Ai do të na japë forcë dhe udhërrëfim në çdo sfidë të jetës. Kur dëshira jonë e vetme është ta kënaqim Atë, ne do të bekohemi me një paqe të thellë së brendshmi.

Në ditët e hershme të Rivendosjes, anëtarët e Kishës u përballën me sprova të rënda. Presidenti Brigam Jang tha sa vijon rreth asaj kohe: “Kur u rrethova nga turmat, me vdekjen dhe shkatërrimin që më kërcënonte nga çdo anë, me sa mbaj mend, ndihesha aq i gëzuar [dhe] mirë në shpirtin tim sa edhe tani. E ardhmja dukej e plogësht dhe shumë e errët, por nuk kam parë kurrë një rast në këtë Ungjill në të cilën nuk e dija se rezultatet do t’i sillnin dobi çështjes së të vërtetës” (*Teachings of Presidents of the Church: Brigham Young* [1997], f. 357).

Shoku im i misionit, Poli, ishte dikush që gjithmonë rrezatonte humor të mirë. Kur ishte baba i ri, ai u prek nga skleroza e shumëfishhtë. Prapëseprapë, pavarësisht fatkeqësisë së vijoi, ai vazhdoi t’u shërbente të tjerëve me gëzim dhe humor të mirë. Një herë ai hyri në zyrën time i ulur në karrigen e tij të parë me rrota dhe deklaroi: “Jeta fillon me një karrige me rrota me motor!” Do ta kujtoj gjithnjë atë, pak vite përpara se të vdiste, duke mbajtur lart flakën olimpikë teksa levizte në karrigen e tij me rrota nën brohoritjet e qindra vetave. Si ajo flakë përherë e ndezur, besimi i Polit nuk u zbeh kurrë me kohën.



Kur isha student në universitetin “Brigam Jang”, jetoja në një shtëpi me disa të rinj. Shoku im i dhomës, Brusi, ishte ndoshta njeriu më optimist që kam njohur ndonjëherë. Ne kurrë nuk e dëgjonim atë të thoshte ndonjë gjë negative për ndonjë njeri apo rrethanë dhe ishte e pamundur të mos ndiheshe i inkurajuar në praninë e tij. Humori i tij i mirë vinte nga një mirëbesim i qëndrueshëm te Shpëtimtari dhe te ungjilli.

Një ditë të ftohtë dimri, një tjetër mik i imi, Tomi, po ecte drejt kampit të universitetit. Ora ishte vetëm 7:00 e mëngjesit dhe kampi ishte i shkretë dhe i errët. Binte borë e dendur, me një erë të akullt. “Çfarë moti i keq”, mendoi Tomi. Ai eci më përpara, dhe jashtë në errësirë dhe borë, ai dëgjo dikë duke kënduar.

Pa dyshim, përmes borës së furishme u duk miku ynë përherë optimist, Brusi. Me duart e shtrira nga qielli, ai po këndonte një numër nga komedia muzikore e Broduejit *Oklahoma*: “O ç’mëngjes i bukur! O ç’ditë e bukur! Kam një ndjenjë të bukur, çdo gjë po shkon siç dua”, (shih Richard Rodgers and Oscar

Hammerstein II, “Oh, What a Beautiful Mornin’” [1943]).

Në vitet pasuese, ai zë që këndonte në një stuhi të errët, është bërë për mua një simbol për kuptimin që ka besimi dhe shpresa. Edhe në një botë të errët, ne si shenjtorë të ditëve të mëvonshme mund të këndojmë me gëzim, duke e ditur se fuqitë e qiellit janë me Kishën dhe popullin e Perëndisë. Ne mund të gëzohemi prej dijes se na pret një mëngjes i bukur – agimi i ditës së mijëvjeçarit, kur Biri i Perëndisë do të ngrihet në Lindje dhe do të mbretërojë sërish mbi tokë.

Mendoj edhe për dy mëngjese të tjera të bukura në historinë e botës. Në pranverë të 1820–ës, në mëngjesin e një dite të bukur e të kthjellët në Palmira, Nju-Jork, një djalosh i quajtur Jozef Smith shkoi në një korije pemësh dhe u gjunjëzua në lutje. Përgjigja e asaj lutjeje, shfaqja e Atit dhe Birit, erdhi në periudhën ungujlore të plotësisë së kohëve dhe gjatë Rivendosjes së Kishës së Jezu Krishtit në tokë.

Sërish një mëngjes tjetër i bukur agoi afro 2.000 vjet më parë pikërisht jashtë qytetit të vjetër me mure të Jerusalemit. Dielli pa dyshim që ndriçoi me rrezatim të veçantë atë mëngjes Pashke. Një grup i vogël grash kishte ardhur të vizitonte një varr në kopsht, duke shpresuar të vajosnin trupin e Zotit të tyre të kryqëzuar. Dy engjëj iu shfaqën dhe shpallën: “Pse e kërkoni të gjallin midis të vdekurve? Ai nuk është këtu, por është ringjallur” (Lluka 24:5–6).

Unë jap dëshmi për ngadhënjimin e Jezu Krishtit mbi mëkatën dhe vdekjen. Unë dëshmoj për planin e mëshirshëm të Atit të Përjetshëm dhe të dashurisë së Tij të përherëshme. Kur ngrihem çdo mëngjes, shikofshim drejt qiellit me besim dhe thëncim: “O ç’mëngjes i bukur”, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Shëlbimi

Në atë shkallë që ndjekim Krishtin, ne kërkojmë të marrim pjesë në punën e Tij shëlbuese dhe ta çojmë më tej atë.

Në kohët e kolonizimit, kishte nevojë të madhe për krahë pune në Amerikë. Gjatë shekullit të 18-të dhe fillimit të atij të 19-të, punëtorë të mundshëm emigrantë u rekrutuan në Britaninë e Madhe, Gjermani dhe vende të tjera europiane, por shumë njerëz që ishin të gatshëm të shkonin, nuk mund t'i mbulonin shpenzimet e udhëtimit. Nuk ishte e pazakontë për ta që të udhëtonin sipas një marrëveshjeje apo kontrate, duke premtuar të punonin pas mbërritjes së tyre për një periudhë të caktuar kohe pa rrogë, si pagesë për udhëtimin e tyre. Të tjerë erdhën me premtimin se pjesëtarë të familjes që ishin tashmë në Amerikë, do ta paguanin shpenzimin e udhëtimit të tyre kur të mbërrinin por, nëse kjo nuk ndodhte, të sapoardhurit ishin të detyruar t'i paguanin shpenzimet e veta nëpërmjet shërbimit kontraktual pa pagesë. Termi i përdorur për t'i përshkruar këta imigrantë nën kontratë ishte “të shëlbuar”. Ata duhej të shëlbënin çmimin e udhëtimit të tyre – në njëfarë mënyre ta blinin lirinë – me anë të punës së tyre.¹

Një nga titujt më kuptimplotë që e përshkruajnë Jezu Krishtin, është Shëlbues. Siç u tregua në rrëfimin tim të shkurtër për “të shëlbuarit” imigrantë, fjala *shëlboj* do të thotë të shlyesh një

detyrim ose borxh. *Shëlboj* mund të ketë gjithashtu kuptimin të shpëtosh ose të çliroh me anë të pagimit të një shpërblese. Nëse dikush bën gabim dhe më pas e korrigjon ose e rregullon, ne themi se ai e ka shëlbuar veten. Secili prej këtyre kuptimeve shfaq aspekte të ndryshme të Shëlbimit të madhërishtë, të kryer nga Jezu Krishti me anë të Shlyerjes së Tij, që përfshin, sipas fjalëve të fjalorit, “të çliroh nga mëkati dhe ndëshkimet e tij, me anë të një sakrifice të bërë për mëkatarin”².

Shëlbimi i Shpëtimtarit ka dy pjesë. Së pari, shëlbimi shlyen për shkeljen e Adamit dhe Rënien rezultuese të njeriut duke i kapërcyer ato që mund të quhen pasojat e drejtpërdrejta të Rënies – vdekja fizike dhe vdekja shpirtërore. Vdekja fizike kuptohet mirë; vdekja shpirtërore është ndarja e njeriut nga Perëndia. Me fjalët e Palit: “Sepse, ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin” (1 Korintasve 15:22). Ky shëlbim nga vdekja fizike dhe shpirtërore është si universal, ashtu edhe pa kushte.³

Aspekti i dytë i Shlyerjes së Shpëtimtarit është shëlbimi nga ajo që mund të quhet pasojat jo të drejtpërdrejta të Rënies – vetë mëkati tona kundrejt shkeljes së Adamit. Për shkak të Rënies, ne kemi lindur në një botë vdekshmërie ku mëkati – që domethënë mosbindja ndaj ligjit të krijuar hyjnisht – është i përgjithshëm. Duke folur për të gjithë ne, Zoti thotë:

“Po kështu, kur fillojnë të rriten, mëkati zë vend në zemrat e tyre dhe





ata provojnë hidhësinë, që të mund të dinë ta çmojnë të mirën.

Dhe u është dhënë atyre ta njohin të mirën nga e liga; si rrjedhim, ata janë vetëveprues” (Moisiu 6:55–56).

Për shkak se jemi të përgjegjshëm dhe i bëjmë zgjedhjet, shëlbimi nga vetë mëkatet tona është me kusht – i kushtëzuar nga rrëfimi e braktisja e mëkatit dhe kthimi te një jetë e perëndishme ose, me fjalë të tjera, i kushtëzuar nga pendimi (shih DeB 58:43). “Si rrjedhim”, urdhëron Zoti, “mësojuani fëmijëve tuaj se të gjithë njerëzit, kudo, duhet të pendohen ose ata nuk mund të trashëgojnë në asnjë mënyrë mbretërinë e Perëndisë, sepse asgjë e papastër nuk mund të banojë atje, ose të banojë në prani të tij” (Moisiu 6:57).

Vuajtja e Shpëtimtarit në Gjetseman dhe agonia e Tij në kryq na shëlbajnë nga mëkati duke kënaqur kërkesat që drejtësia ka mbi ne. Ai shtrin mëshirë dhe fal ata që pendohen. Shlyerja gjithashtu kënaq borxhin që drejtësia zotëron mbi ne, duke na shëruar dhe dëmshpërblyer për çfarëdo vuajtje që durojmë pafajësisht. “Pasi vini re, ai vuan dhembjet e të gjithë njerëzve, po, vuajtjet e çdo krijese të gjallë, si burra, gra ashtu edhe fëmijë, që bëjnë pjesë

në familjen e Adamit” (2 Nefi 9:21; shih edhe Alma 7:11–12).⁴

Në atë shkallë që ndjekim Krishtin, ne kërkojmë të marrim pjesë në punën e Tij shëlbuese dhe ta çojmë më tej atë. Shërbimi më i madh që mund t’u bëjmë të tjerëve në këtë jetë, duke filluar me njerëzit e vetë familjes sonë, është që t’i sjellim ata te Krishti nëpërmjet besimit dhe pendimit, që ata të mund ta përjetojnë Shëlbimin e Tij – paqe e gëzim tani dhe pavdekësi e jetë të përjetshme në botën që do të vijë. Puna e misionarëve tanë është një shfaqje e mrekullueshme e dashurisë shëlbuese të Zotit. Si lajmëtarët e Tij të autorizuar, ata ofrojnë bekimet e pakrahasueshme të besimit te Jezu Krishti, pendimit, pagëzimit dhe të dhuratës së Frymës së Shenjtë, duke hapur udhën për rilindje shpirtërore dhe shëlbim.

Ne gjithashtu mund të ndihmojmë në shëlbimin prej Zotit të atyre që kanë ndërruar jetë. “Pleqtë besnikë të kësaj periudhe, kur largohen nga jeta e vdekshme, i vazhdojnë punët e tyre për predikimin e ungjillit të pendimit dhe të shëlbimit, nëpërmjet sakrificës së Birit të Vetëmlindur të Perëndisë, mes atyre që janë në errësirë dhe nën robërinë e mëkatit në botën e madhe të shpirtave të të vdekurve” (DeB 138:57). Për

shkak të përfitimit prej riteve mëkëmbëse që u ofrojmë në tempujt e Perëndisë, edhe ata që vdiqën në robërinë e mëkatit, mund të çlirohen.⁵

Ndërkohë që aspektet më të rëndësishme të shëlbimit kanë të bëjnë me pendimin dhe faljen, ka gjithashtu një aspekt shumë kuptimplotë fizik. Thuhet se Jezusi e përshkoi vendin duke bërë mirë (shih Veprat e Apostujve 10:38), që përfshiu shërimin e të sëmurit dhe të pafuqishmit, sigurimin e ushqimit turmave të uritura dhe mësimdhënien për një udhë shumë më të lartë. “Biri i njeriut nuk erdhi që t’i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetëve” (Mateu 20:28). Po kështu mundemi ne, nën ndikimin e Shpirtit të Shenjtë, të shkojmë duke bërë mirë sipas modelit shëlbues të Mësuesit.

Ky lloj i punës shëlbuese do të thotë t’i ndihmosh njerëzit për problemet e tyre. Do të thotë të bëhesh shok me të varfrin dhe të dobtin, duke lehtësuar vuajtjen, duke ndrequr fyerjet, duke mbrojtur të vërtetën, duke forcuar brezin e ri dhe duke arritur siguri e lumturi në shtëpi. Shumë prej punës sonë shëlbuese në tokë është t’i ndihmojmë të tjerët të rriten dhe të arrijnë shpresat dhe aspiratat e tyre të drejta.

Një shembull, nga romani i Viktor Hygoit, *Të Mjerët*, edhe pse nga letërsia, gjithmonë më ka prekur dhe frymëzuar. Nga fillimi i historisë, peshkopi Bienvënyi i jep ushqim dhe strehim për natën të pastrehut Zhan Valzhan, të cilin sapo e kanë liruar nga 19 vite burgimi, sepse kishte vjedhur një bukë për të ushqyer fëmijët e uritur të së motrës. I ashpërsuar dhe plot mllef, Valzhani e shpërblen mirësinë e peshkopit Bienvënyi duke i vjedhur takëmet e tij të argjendta. Më vonë, i ndalur nga xhandarë dyshues, Valzhani pretendon, duke gënjer, se

argjendin ia kishin dhuruar. Kur xhandarët e kthyen forcërisht në shtëpinë e peshkopit, për habinë e madhe të Valzhanit, peshkopi Bienvënyi ia pohon historinë dhe, për përshtypje të mirë, thotë: “‘More, por unë ju kisha dhënë edhe shandanët, që janë prej argjendi si ato të tjerat dhe me të cilat mund të bënit fare mirë dyqind franga. Pse nuk i paskeni marrë tok me takëmet?’ . . .

Peshkopi iu afrua dhe i tha me zë të ulët:

‘Mos harroni, mos harroni kurrë se më keni dhënë fjalën që do ta përdorni këtë argjend për t’u bërë njeri i ndershëm’.

Zhan Valzhani, të cilit s’i binte hiç ndër mend të kishte premtuar gjë, shtangu në vend. Peshkopi . . . vazhdoi me njëfarë solemniteti:

‘Zhan Valzhan, vëllai im, tani ju nuk jeni më rob i së keqes, por i takoni së mirës. Unë po jua blej shpirtin me këto; Unë po e largoj shpirtin tuaj nga mendimet e errëta dhe nga [shpirti i humbjes, dhe po ia jap atë Perëndisë!].’

Zhan Valzhani vërtet u bë një njeri i ri, një njeri i ndershëm dhe mirëbërës për shumë njerëz. Gjatë gjithë jetës së tij, ai i mbajti ato dy shandane, që t’i kujtonin se shpirti i tij ishte shëlbuar për t’i shërbyer Perëndisë.⁶

Disa forma të shëlbimit fizik vijnë nga përpjekja bashkëpunuese. Është një nga arsytet pse Shpëtimtari krijoi një kishë. Duke qenë të organizuar në kuorume e organizata ndihmëse dhe në kunje, lagje e degë, ne jo vetëm që mund t’i japim mësim dhe ta nxisim njëri-tjetrin në ungjill; ne gjithashtu mund të kërkojmë ndihmën e njerëzve dhe të burimeve për t’u marrë me nevojat e jetesës. Njerëzit që veprojnë vetëm, ose në grupe të posaçme, nuk mund të sigurojnë gjithmonë mjete në shkallën e duhur që të trajtojnë sfida më të mëdha. Si pasues të Jezu Krishtit,



ne jemi një komunitet shenjtorësh të organizuar për të ndihmuar që të shëlbehen nevojat e bashkëshenjtoreve tanë dhe të aq shumë të tjerëve sa mund të ndihmojmë në mbarë globin.

Për shkak të përpjekjeve tona humanitare, përmendur nga Plaku Dallin H. Ouks, pikërisht në vitin e kaluar, 890.000 njerëz në 36 vende kanë ujë të pastër, 70.000 njerëz në 57 vende kanë karrige invalidësh, 75.000 njerëz në 25 vende kanë shikim të përmirësuar dhe njerëz në 52 vende kanë marrë ndihmë në vijim të fatkeqësive natyrore. Duke vepruar bashkë me të tjerë, Kisha ka ndihmuar për vaksinimin e rreth 8 milionë fëmijëve dhe ka ndihmuar njerëz nga Siria në kampe refugjatësh në Turqi, Liban dhe Jordani me mjete të domosdoshme për jetesë. Në të njëjtën kohë, anëtarë të Kishës në nevojë morën miliona dollarë në oferta agjërimit dhe ndihmë tjetër për mirëqenie gjatë vitit 2012. Ju falënderoj për bujarinë tuaj.

E gjitha kjo, nuk fillon të llogarisë veprimet individuale të mirësisë dhe mbështetjes – dhurimin e ushqimeve, veshjeve, të hollave, kujdesit dhe mijëra forma të tjera të ngushëllimit e dhembshurisë – me anë të së cilave mund të marrim pjesë në punën si të Krishtit për shëlbimin. Kur isha djalosh, qeshë dëshmitar i vetë veprimeve të nënës sime për të shëlbuar një grua në nevojë. Shumë vite më parë, kur

i kishte fëmijët të vegjël, nëna ime iu nënshtrua një operacioni të rëndë që gati i mori jetën dhe e bëri të zinte shtratin shumicën e kohës për thujt një vit. Gjatë kësaj kohe, anëtarë të familjes dhe të lagjes e ndihmuan nënën dhe familjen tonë. Për të ndihmuar më tej, presidentja e Shoqatës së Ndihmës të lagjes, motra Abraham, këshilloi që prindërit e mi të punësonin një grua në lagje, që kishte nevojë të skajshme për punë. Ndërsa e tregoj këtë ngjarje, do të përdor emrat e trilluar Sara dhe Eni për këtë grua dhe bijën e saj. Ky është rrëfimi i nënës sime:

“Mund ta kujtoj aq qartë sikur të kishte ndodhur veçse dje. Unë dergjesha në shtrat dhe motra Abraham solli Sarën te dera e dhomës së gjumit. M’u ndrydh zemra. Atje qëndronte njeriu më pak tërheqës që kisha takuar ndonjëherë – kaq e dobët, e çrregullt, me flokë të pakrehur, e kërrusur, me kokën ulur duke parë dyshtemenë. Kishte veshur një fustan shtëpie të vjetër shumë të madh për masën e saj. Ajo nuk i ngriti sytë dhe foli kaq dobët sa që unë nuk munda ta dëgjoja. Fshehur pas saj, ishte një vajzë e vogël rreth tri vjeçe. E çfarë të bëja unë me këtë krijesë? Pasi ato u larguan nga dhoma, qava shumë. Kisha nevojë për ndihmë, jo për probleme të tjera. Motra Abraham qëndroi pak me të dhe shpejt e rregulluan shtëpinë dhe përgatitën disa vakte të mira. Motra



Abraham më kërkoi ta provoja për disa ditë, [duke thënë] se kjo vajzë po kalonte një periudhë vërtet të vështirë dhe i duhej ndihmë.

Mëngjesin tjetër, kur erdhi Sara, së fundi e bëra të vinte pranë shtratit ku mund ta dëgjoja. Më pyeti se çfarë doja që të bënte ajo. Ia tregova dhe pastaj i thashë: 'Por gjëja më e rëndësishme janë djemtë e mi; rri me ta, lexoju atyre – ata janë më të rëndësishëm se shtëpia'. Ajo ishte kuzhinieri e mirë dhe e mbajti shtëpinë të pastër, rrobat të lara dhe ishte e mirë me djemtë.

Gjatë javëve, mësova historinë e Sarës. [Ngaqë kishte vështirësi dëgjimi, ajo nuk shkoi mirë me mësim dhe së fundi e la shkollën. U martua në moshë të re me një burrë të shthurur. Eni lindi dhe u bë gëzimi i jetës së Sarës. Një natë dimri, i shoqi erdhi i dehur në shtëpi, i futi me forcë në makinë Sarën dhe Enin, të veshura me pizhame, dhe pastaj i la në buzë të autostradës. Nuk e panë më kurrë atë. Këmbëzbathura dhe duke ngrirë nga të ftohtit, Sara dhe Eni ecën disa kilometra deri në shtëpinë e nënës së Sarës.] Nëna e saj ra dakord t'i lejonte të rrinin në shkëmbim të kryerjes së gjithë punëve të shtëpisë dhe gatimit e kujdesjes për motrën e vëllanë që ishin në shkollë të mesme.

Ne e çuam Sarën te një mjek për veshët dhe ajo mori një pajisje për ta ndihmuar për dëgjimin. . . . Ne e çuam të ndiqte shkollimin për të rritur dhe ajo mori diplomën e saj të shkollës së

mesme. Ajo shkoi në shkollën e natës dhe më vonë mori diplomë universiteti dhe dha mësim për shkollimin e njerëzve me nevoja të veçanta. Bleu një shtëpi të vogël. Eni u martua në tempull dhe bëri dy fëmijë. Sara përfundimisht bëri disa operacione në veshë dhe së fundi ishte në gjendje të dëgjonte mirë. Vite më vonë, ajo doli në pension dhe shërbeu në një mision. . . . Sara na falënderoi shpesh dhe tha se mësoi kaq shumë prej meje, veçanërisht kur i thashë se bijtë e mi ishin më të rëndësishëm se shtëpia. Ajo tha se e mësoi që të sillej po ashtu me Enin. . . . Sara është një grua shumë e veçantë."

Si dishepuj të Jezu Krishtit, ne duhet të bëjmë gjithçka mundemi për t'i shëlbuar të tjerët nga vuajtja dhe barrat. Megjithatë, shërbimi ynë më i madh shëlbues do të jetë t'i udhëheqim ata te Krishti. Pa Shëlbimin e Tij nga vdekja dhe nga mëkati, ne kemi vetëm një ungjill të drejtësisë shoqërore. Ai mund të japë njëfarë ndihme dhe pajtimi në të tashmen, por nuk ka fuqi që të zbresë nga qielli drejtësinë e përkryer dhe mëshirën e pafundme. Shëlbimi përfundimtar është te Jezu Krishti dhe vetëm tek Ai. Unë përlulesisht dhe me mirënjohje e pranoj Atë si Shëlbuesin, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih *Merriam-Webster's Collegiate Dictionary*, bot. 10-të (1993), "redemptioner".
 2. *Webster's New World College Dictionary*, bot. 3-të (1988), "redeem".
 3. "Biri i Perëndisë ka shlyer për fajin origjinal, me anë të të cilit mëkatet e prindërve nuk mund të marrin përgjigje mbi kokat e fëmijëve, sepse ata janë të pacënuar që nga themelimi i botës" (Moisiu 6:54). Me anë të Shëlbimit të Krishtit, të gjithë e mposhtin varrin dhe ringjallen në pavdekësi. Përveç kësaj, të gjithë e kapërcejnë vdekjen shpirtërore duke u sjellë sërish në praninë e Perëndisë që të gjykohen. Jezusi tha: "Që ashtu si unë u ngrita [në kryq] nga njerëzit, ashtu dhe njerëzit të ngrihen nga Ati, që të qëndrojnë para meje për t'u gjykuar për veprat e tyre" (3 Nefi 27:14). Ata që
- pastrohen nga mëkati, do të mbeten me Perëndinë në mbretërinë qiellore, por ata që nuk janë penduar dhe janë të papastër, nuk mund të banojnë me një Perëndi të shenjtë dhe, pas Gjykimit, ata duhet të largohen dhe në këtë mënyrë, të pësojnë sërish vdekje shpirtërore. Nganjëherë kësaj i referohemi si një vdekje e dytë ose të vuash vdekje shpirtërore për herë të dytë. (Shih Helamani 14:15–18.)
4. Pikërisht në lidhje me vetë mëkatet tona, shkrimet e shenjta flasin për disa që nuk e marrin përfitimin e shëlbimit: "Të ligjtë mbeten sikurse të mos kishte patur shëlbim, me përjashtim se rripat e vdekjes do të jenë zgjidhur" (Alma 11:41). "Ai që nuk ushtron besim deri në pendim, qëndron i ekspozuar para tërë ligjit të kërkesave të drejtësisë; prandaj vetëm atij që ka besim deri në pendim do t'i realizohet plani i madh, i përjetshëm i shëlbimit" (Alma 34:16). Nëse një njeri nuk e pranon Shlyerjen e Shpëtimtarit, ai duhet ta shëlbtojë vetë borxhin e tij ndaj drejtësisë. Jezusi tha: "Pasi vër re, unë, Perëndia, i kam vuajtur këto gjëra për të gjithë, që ata të mos vuajnë nëse do të pendohen; Por nëse nuk do të pendohen, ata duhet të vuajnë po aq sa unë" (Doktrina e Besëlidhje 19:16–17). Vuajtja e pashëlbuar e individit për mëkatin njihet si ferr. Kjo do të thotë të jesh subjekt i djallit dhe përshkruhet në metafora të shkrimet të shenjtë si të jesh në zinxhirë ose në një liqen zjarri e squfuri. Lehi iu përgjërta bijve të tij që të zgjidhnin Shëlbimin e Krishtit "dhe [të] mos zgjidhni [n] vdekjen e përjetshme sipas dëshirës së mishit dhe ligësisë që është në të, e cila i jep shpirtit të djallit fuqi të robërojë, t'ju marrë poshtë në ferr, që ai të mund të sundojë mbi ju në mbretërinë e tij" (2 Nefi 2:29). Megjithatë, për shkak të Shlyerjes së Jezu Krishtit, ferri ka një fund dhe ata që janë të detyruar të kalojnë nëpër të, "do të shëlbohen nga djalli . . . në ringjalljen e parë" (Doktrina e Besëlidhje 76:85). Relativisht pak "bijtë e humbjes" janë "të vetmit mbi të cilët vdekja e dytë do të ketë ndonjë fuqi [të qëndrueshme]; Po, në të vërtetë, të vetmit që nuk do të shëlbohen në kohën e caktuar të Zotit, pas vuajtjeve të zemërimit të tij" (Doktrina e Besëlidhje 76:32, 37–38).
 5. Profeti Jozef Smith u ngazëllua: "Të vdekurit duhet t'i thonë këngë përlëvdimi të përjetshëm mbretit Emanuel, që ka shuguruar, përpara se bota të ishte, atë që do të na bëjë të aftë për t'i shëlbuar ata nga burgu i tyre; sepse të burgosurit do të lirohen" (Doktrina e Besëlidhje 128:22).
 6. Shih Victor Hugo, *Les Misérables*, (1992), f. 91–92; përkthimi shqip "Të Mjerët", (1983), f. 123–125.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Derisa Prapë të Takohemi

Lutem që Zoti t'ju bekojë dhe t'ju ruajë, vëllezërit dhe motrat e mia. Paqja e Tij e premtuar qoftë me ju tani dhe gjithmonë.

Vëllezërit dhe motrat e mia, ç'konferencë të lavdishme që kemi pasur! E di se ju jeni dakord me mua që mesazhet kanë qenë frymëzuese. Zemrat tona janë prekur dhe dëshmitë tona për këtë

punë hyjnore janë forcuar, ndërkohë që kemi ndier Shpirtin e Zotit. Le t'i kujtojmë për një kohë të gjatë ato që kemi dëgjuar në këto dy ditë që kaluan. Ju nxis t'i studioni mesazhet më tej kur ato të botohen në numrin

e ardhshëm të revistave *Ensign* dhe *Liahona*.

I shprehim mirënjohjen tonë secilit që na ka folur, si dhe atyre që kanë bërë lutjet. Përveç këtyre, muzika ka qenë lartësuese dhe frymëzuese. Ne e duam Korin tonë të mrekullueshëm të Tabernakullit dhe i falënderojmë edhe të gjithë të tjerët që na siguruan muzikën.

Bashkohemi të gjithë për t'u shprehur mirënjohjen tonë atyre të presidencës dhe bordit të përgjithshëm të Të Rejave që u liruan dje nga thirrja. Shërbimi i tyre ishte i jashtëzakonshëm dhe përkushtimi i tyre i plotë.

Ne kemi mbështetur, duke ngritur duart, vëllezër dhe motra që janë thirrur në detyra të reja gjatë kësaj konference. Ne dëshirojmë që ata të gjithë ta dinë se mezi po presim të shërbejmë me ta në kauzën e Mësuesit.





Ne jemi një Kishë mbarëbotërore, vëllezër e motra. Anëtarësia jonë gjendet në të gjithë globin. Unë ju këshilloj që të jeni qytetarë të mirë të kombeve ku jetoni dhe fqinjë të mirë në komunitetet tona, duke u afruar te njerëz të besimeve të tjera, si dhe tek ata të besimit tonë. Qofshim tolerantë, si edhe dashamirës dhe të dashur, me ata që nuk kanë bindjet tona dhe standardet tona. Shpëtimtari solli në këtë tokë një mesazh dashurie dhe vullneti të mirë për të gjithë burrat dhe gratë. Le ta ndjekim përgjithmonë shembullin e Tij.

Lutem që të mund të jemi të vëmendshëm ndaj nevojave të atyre që ndodhen përreth nesh. Ka disa, veçanërisht mes të rinjve, të cilët në mënyrë tragjike janë përfshirë me drogë, imoralitet, pornografi e kështu me radhë. Ka nga ata që janë të vetmuar, përfshirë të veja dhe të ve, që kanë mall për shoqërimin dhe interesimin e të tjerëve. Qofshim përherë të gatshëm për t'iu shtrirë atyre një dorë ndihme dhe një zemër të dashur.

Ne jetojmë në një kohë në historinë e botës kur ka shumë sfida të vështira, por edhe mundësi dhe arsye të mëdha për t'u gëzuar. Gjenden, sigurisht, ato kohë kur ne përjetojmë zhgënjime, dhembje dhe madje tragjedi në jetën tonë. Megjithatë, nëse vërtet do ta vendosim besimin tonë te Zoti, Ai do të na ndihmojë përmes vështirësive tona, cilatdo qofshin ato. Psalmisti e dha këtë siguri: "Të qarat mund të vazhdojnë një natë, por në mëngjes shpërthen një britmë gëzimi"¹.

Vëllezërit dhe motrat e mia, dëshiroj që ju ta dini sa mirënjohës jam për ungjillin e Jezu Krishtit, të rivendosi në këto ditë të fundit nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Ai është kyçi drejt lumturisë sonë. Qofshim të përlurur dhe plot lutje, duke pasur besimin se Ati ynë Qiellor mund të na udhëzojë dhe bekojë në jetën tonë.

Ju jap dëshminë time vetjake dhe ju dëshmoj se Perëndia jeton, se Ai i dëgjon lutjet e zemrave të përlurura. Biri i Tij, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, i flet secilit prej nesh: "Ja, unë qëndroj

te dera dhe trokas; nëse dikush dëgjon zërin tim dhe të hapë derën, unë do të hyj tek ai"². I besofshim këto fjalë dhe përfitofshim nga ky premtim.

Ndërsa e përfundojmë këtë konferencë tani, i kërkoj bekimet e qiellit mbi secilin prej jush. Shtëpitë tuaja qofshin të mbushura me paqe, harmoni, mirësjellje dhe dashuri. Le të jenë ato të mbushura me Shpirtin e Zotit. I ushqefshi dhe i rritshi dëshmitë tuaja të ungjillit, që ato të jenë një mbrojtje për ju kundër goditjeve të Satanit.

Derisa të takohemi përsëri pas gjashtë muajsh, lutem që Zoti t'ju bekojë dhe t'ju ruajë, vëllezërit dhe motrat e mia. Paqja e Tij e premtuar qoftë me ju tani dhe gjithmonë. Ju falënderoj për lutjet tuaja në të mirën time dhe në të mirë të të gjithë Autoriteteve të Përgjithshme. Ne jemi thellësisht mirënjohës për ju. Në emrin e Shpëtimtarit dhe Shëlbuesit tonë, të cilit i shërbejmë, madje Jezu Krishtit, Zotit, amen. ■

SHËNIME

1. Psalmi 30:5.
2. Zbulesa 3:20.



Nga En M. Dib,

Këshilltare e Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Vendet Tuaja të Shenjta

Pavarësisht nëse [vendet tuaja të shenjta] janë vende gjeografike apo çaste në kohë, ato janë po aq të shenjta dhe kanë fuqi forcuese të papërshkrueshme.



Tema jonë e Aktiviteteve të Përbashkëta për vitin 2013 vjen nga seksioni 87 i Doktrinës e Besëlidhjeve. Ky udhëzim gjendet në tri seksione të veçanta në Doktrina e Besëlidhje; në mënyrë të qartë këshilla është e rëndësishme. Ajo shpjegon se si mund të marrim mbrojtje, forcë dhe paqe në kohë të trazuar. Udhëzimi i frymëzuar është të “qëndroni në vende të shenjta dhe mos lëvizni”¹.

Ndërsa kam meditar për këtë temë, shtyhem të vras mendjen: “Cilat janë ‘vendet e shenjta’ të cilave iu drejtohet Ati Qiellor?” Presidenti Ezra Taft Benson këshilloi: “Vendet e shenjta përfshijnë tempujt tanë, kishat tona, shtëpitë tona dhe kunjet e Sionit, të cilat janë, . . . ‘për mbrojtje e për strehim’”². Përveç këtyre, besoj se secila prej nesh mund të gjejë shumë më tepër vende. Ne, së pari, mund ta mendojmë fjalën *vend* si mjedis fizik ose vendndodhje gjeografike. Megjithatë, një *vend* mund të jetë “një rrethanë, kusht apo gjendje e caktuar e mendjes”³. Kjo do të thotë që vendet e shenjta mund të përfshijnë edhe *çaste në kohë* – çaste kur Fryma e Shenjtë na dëshmon, çaste kur ndiejmë dashurinë e Atit Qiellor ose çaste kur marrim një përgjigje për lutjet tona. Për më tepër, besoj se çdo herë që keni kurajë të mbronit atë që është e drejtë, veçanërisht në rrethana ku askush tjetër nuk është i gatshëm të veprojë kështu, ju po krijoni një vend të shenjtë.

Gjatë gjithë jetës së shkurtër, por të madhërishtme të Jozef Smithit, ai me të vërtetë “[qëndroi] në vende të shenjta” dhe nuk lëvizti. Kur ishte i ri, u shqetësua nga trazira fetare në komunitetin e tij dhe dëshironte të dinte se cila nga të gjitha kishat ishte e vërtetë. Zona me drurë pranë shtëpisë së tij u bë një vend i shenjtë, kur ai u ul në gjunjë mes drurëve dhe ofroi lutjen e tij të

parë me zë. Lutja e tij mori përgjigje dhe sot shenjtoret e ditëve të mëvonshme iu drejtohen këtyre drurëve si Koriya e Shenjtë.

Të reja kudo nëpër botë kanë qëndruar gjithashtu në vende të shenjta në natyrë në kampin e Të Rejave. Një udhëheqëse më tregoi historinë e përvojës së një të reje. Kjo vajzë ishte më pak aktive dhe ishte paksa mosbesuese rreth të pasurit të një përvoje shpirtërore në pyll. Pas ditës së parë, ajo e njoftoi udhëheqësen: “Po ia kaloj shumë mirë, por, të lutem, a mund t’i japim fund tërë të folurës rreth Shpirtit? Jam këtu për kampim, të kënaqem me natyrën, të jem me shoqet dhe të bëj qejf!” Megjithatë, në mbrëmjen përfundimtare të dëshmimeve, e njëjta vajzë me lot në sy pohoi: “Nuk dua të shkoj në shtëpi. Si mund ta kem atë që po ndiej tamam tani, këtë Shpirt, me vete gjatë gjithë kohës?” Ajo kishte zbuluar një vend të shenjtë.

Një tjetër vend i shenjtë në jetën e Jozef Smithit ishte vetë dhoma e tij e gjumit. Kjo mund të jetë e vështirë të besohet, sepse si shumë prej jush, ai e ndau dhomën e tij të gjumit me vëllezër e motra. Ajo u bë një vend i shenjtë kur ai u lut me besim, përlësi dhe nevojshmeri të madhe. Ai shpjegoi: “Pasi isha shtrirë në shtrat për të fjetur, unë u përfshiva në lutje dhe përgjërëm ndaj Perëndisë së Plotfuqishëm për falje të të gjitha mëkateve dhe marrëzive të mia”⁴. Tre vitet që kishin kaluar që nga koha kur Jozefi pati vegimin në Korijen e Shenjtë, nuk kishin qenë të lehta. Jozefi shtatëmbëdhjetëvjeçar kishte duruar tallje, përqeshje dhe keqtrajtim të pafundëm. Por atë natë, në dhomën e gjumit të Jozefit, engjëlli Moroni u shfaq në përgjigje të përgjërimeve të tij. Jozefi mori dituri dhe ngushëllim. Atë natë, dhoma e tij e gjumit u bënë një vend i shenjtë.



Ndërsa shihja një Mesazh Mormon për Rininë, dëshmova një tjetër dhomë gjumi që ishte bërë një vend i shenjtë. Videoja tregon Ingrid Delgadon, një e re nga Salvadori, duke treguar rreth ndjenjave të saj për tempullin. Ajo thotë: “Është mirë të dimë që kemi një vend ku mund të largohemi nga gjërat e botës dhe të marrim ordianca të shenjta dhe të ndihmojmë ata që nuk mundën t’i merrnin ato në këtë jetë”. Ndërsa ajo flet, videoja e tregon Ingridin duke lexuar shkrimet e saj të shenjta, e rrethuar nga Reklama Mormone, citime, një libër të Përparimit Personal, fotografi të familjes së saj e të tempullit dhe po, lodrat e saj të preferuara të kafshëve me push.⁵ Ndoshta edhe pa e kuptuar, ajo ka krijuar vendin e saj të shenjtë, larg nga gjërat e botës. Vras mendjen se sa herë i ka lexuar Ingridi shkrimet e saj të shenjta, ka ndier Shpirtin dhe ka marrë përgjigje për lutjet e saj në vendin e saj të shenjtë.

Por një vend tjetër i shenjtë, i paparrashikuar, në jetën e Jozef Smithit ishte burgu i Libertisë. Plaku Xhefri R. Holland tha: “Nuk pati kohë më të mundimshme në jetën e Jozefit sesa ky burgim mizor, i paligjshëm dhe i paarsyeshëm”. Plaku Holland vazhdoi duke shpjeguar se burgu i Libertisë është quajtur si një “burg tempull” për shkak të përvojave të shenjta që Profeti Jozef Smith pati atje.⁶

Disa nga ju të reja mund të jeni duke përjetuar vetë burgun tuaj të Libertisë, një vend ku përballeni me poshtërim, një vend ku nuk ndieni dashuri të përzemërt, një vend ku

talleni, keqtrajtoheni ose edhe dëmtoheni fizikisht. Juve, të rejave, ju ofroj fjalët e Plakut Holland: “Ju mund të keni përvoja të shenjta, zbuluese, thellësisht udhëzuese me Zotin *gjatë përvojave më të mjerueshme të jetës suaj* . . . ndërsa duroni padrejtësitë më të dhimbshme, kur ndeshni vështirësitë dhe kundërshtimin më të pakapërcyeshëm që keni hasur ndonjëherë”⁷. Me fjalë të tjera, po ashtu si Profeti Jozef Smith, *ju* mund të krijoni dhe të qëndroni në vende të shenjta, edhe në kohët më të vështira që keni përjetuar ndonjëherë.

Një e re në moshë madhore, Kirsten, më tregoi përvojën e saj të dhimbshme. Shkolla e mesme kishte qenë burgu i saj i Libertisë. Për fat të mirë, dhoma e bandës muzikore siguroi lehtësim. Ajo tha: “Kur hyra në këtë dhomë, ishte sikur të hyja në një vend të sigurt. Nuk kishte vërejtje zhvlerësuese apo nënvleftësuese, as gjuhë përdhosëse. Përkundrazi, ne dëgjuaam fjalë nxitjeje dhe dashurie. Ne ushtruam mirësi. Ishte një vend i lumtur. Dhoma e bandës muzikore mbushej me Shpirtin, ndërsa praktikonim dhe luanim pjesë muzikore. Dhoma ishte e tillë kryesisht për shkak të ndikimit të drejtuesit të bandës. Ai ishte një burrë i mirë, i krishterë. Më kujtohet që shkolla e mesme ishte një vend përpunimi. Ishte e vështirë, por unë mësova qëndrueshmërinë. Do të jem përherë mirënjohëse për vendstrehimin tim, vendin tim të shenjtë, dhomën e bandës muzikore.”⁸

Sonte, a keni menduar për vendet tuaja të shenjta? U kam kërkuar qindra të rejave që të më tregojnë për vendet e tyre të shenjta. Pavarësisht nëse ato janë vende gjeografike apo çaste në kohë, ato janë po aq të shenjta dhe kanë fuqi forcuese të papërshkrueshme. Ja nëntë nga përgjigjet e tyre të ndjeshme:

- Një: “Isha në spital, duke mbajtur vëllanë tim të sapolindur”.
- Dy: “Çdo herë që lexoj bekimin tim patriarkal, e ndiej se Ati im Qiellor më njeh dhe më do”.
- Tre: “Ditën që mbusha 12 vjeç, vajzat e reja në lagjen time ma zbukuruan derën me zemra letre.⁹ U ndjeva e dashur, e pranuar dhe e lumtur!”
- Katër: “Një ditë, ndërsa po lexoja shkrimet e mia të shenjta, një frazë më ‘kërceu befas’. Unë kisha gjetur përgjigje për lutjet e mia.”
- Pesë: “Hyra në një mbrëmje argëtimi ku njerëzit po pinin alkool dhe merrnin pjesë në veprimtari të tjera të papranueshme. Shpirti më tha të kthehesha dhe të shkoja në shtëpi. E bëra atë dhe po, pati pasoja shoqërore. Megjithatë, ai çast më dha vetëbesimin që më nevojitej për të ditur se unë mund ta jetoja ungjillin.”
- Gjashtë: “Një të diel gjatë sakramentit, po mendoja për Shlyerjen. E kuptova se kisha nevojë të falja dikë me të cilin isha e zemëruar. Zgjedhja ime për të falur ishte një veprim i duhur që do ta sillte Shlyerjen në jetën time të përditshme.”
- Shtatë: “Pasi ndoqa Fillimet e Reja me nënën time, ajo më puthi në faqe dhe me zë më tha se më donte. Kjo ishte hera e parë për aq sa më kujtohet.”
- Tetë: “Me sigurimin e dhënë nga peshkopi im, e dija se premtimi në shkrimet e shenjta ishte i vërtetë: ‘Edhe sikur mëkatet tuaja të ishin të kuqe flakë, do të bëhen të bardha si bora’.¹⁰ Ndjeva shpresë dhe e dija se mund ta filloja procesin tim të gjatë të pendimit.”
- Së fundi: “Një mbrëmje, mora guximin t’i ndaja ndjenjat e mia për ungjillin me shoqen time më të mirë dhe t’i jepja një Libër të Mormonit. Më vonë, ishte privilegj të merrja

pjesë në pagëzimin e saj. Tani ne shkojmë në Kishë së bashku.”

A mund t’ju tregoj për një nga vendet e mia të shenjta? Dikur, unë ndihesha e tronditur, e frikësuar dhe tërësisht e vetmuar. Në heshtje, u luta: “Ati Qiellor, nuk e di se si ta bëj këtë. Të lutem, të lutem më ndihmo!” Shpejt, papritur dikush m’u afrua, e vuri dorën mbi supin tim dhe më foli në mënyrë të sqartë, inkurajuese. Në atë çast, ndjeva paqe. U ndjeva e pranuar. Gjithçka kishte ndryshuar. Fjalët e Presidentit Spenser W. Kimball më erdhën në mendje: “Perëndia na vë re dhe kujdeset për ne. Por zakonisht është nëpërmjet një personi tjetër që Ai i plotëson nevojat tona.”¹¹ Për mua, ai çast, ai vend ishte bërë i shenjtë.

Të dashura të reja, ka vende të tjera të shenjta, të panumërueshme, do të uroja, për të cilat mund t’i tregonim njëra-tjetrës. Kur të ktheheni në shtëpi sonte, ju nxis t’i shkruani në ditarin tuaj ato vende që po i dalloni dhe po i kujtoni. Është e qartë për mua që mijëra prej *jush* po qëndrojnë në vende të shenjta. Këto vende po ju sigurojnë mbrojtje, forcë dhe paqe në kohë të trazuara. Dëshmitë tuaja po bëhen më të forta, sepse ju po mbron

të vërtetën dhe drejtësinë në mënyra të lavdishme.

Ju, rinia fisnike e Kishës, jeni heronjtë e mi. Unë ju dua. Unë e ndiej dashurinë e papërshkrueshme të Atit Qiellor për ju dhe ju jap dëshminë time se ungjilli i Jezu Krishtit është i vërtetë. Ai po pret, gati për t’ju mbështetur kur ju “qëndroni . . . në vende të shenjta dhe nuk lëvizni”. Unë e dua dhe e mbështes Presidentin Tomas S. Monson, profetin tonë të vërtetë dhe inkurajues. I them këto gjëra në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 87:8; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 45:32; 101:22.
2. Ezra Taft Benson, “Prepare Yourself for the Great Day of the Lord”, *New Era*, maj 1982, f. 50; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 115:6.
3. Merriam-Webster Online, “place [vend]”, merriam-webster.com/dictionary/place.
4. Joseph Smith – *Historia* 1:29.
5. Shih “Practice, Celebration, Dedication: Temple Blessings in El Salvador”, lds.org/youth/video.
6. Jeffrey R. Holland, “Lessons from Liberty Jail”, *Ensign*, shtator 2009, f. 26, 28.
7. Jeffrey R. Holland, “Lessons from Liberty Jail”, f. 28.
8. Bashkëbisedim personal me autoren.
9. Nganjëherë e quajtur në Shtetet e Bashkuara si “sulm me zemra”.
10. Isaia 1:18.
11. Spencer W. Kimball, “The Abundant Life”, *Ensign*, korrik 1978, f. 4; *Tambuli*, qershor 1979, f. 3.



San-Salvador, El-Salvador



Nga Meri N. Kuk,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rejave

Kur Shpëtoni një Vajzë, Ju Shpëtoni Breza

Jeta juaj e virtytshme do të bekojë paraardhësit tuaj, familjet tuaja tani dhe pjesëtarët e familjeve që ende do të vijnë.

Është një nder për mua t'u drejtohem të rejave të guximshme të Kishës. Ne ju shohim të përparoni në shtegun e atyre që i nderojnë besëlidhjet e tyre, dhe e dimë se jeta juaj e virtytshme do të bekojë paraardhësit tuaj, familjet tuaja tani dhe pjesëtarët e familjeve që ende do të vijnë, sepse siç deklaroi Presidenti Gordon B. Hinkli: "Kur shpëtoni një vajzë, ju shpëtoni breza"¹.

Shtegu juaj i besëlidhjes filloi në kohën kur u pagëzuat dhe morët dhuratën e Frymës së Shenjtë. Ai vazhdon çdo javë në mbledhjen e sakramentit, një vend i shenjtë ku ju ripërtëri besëlidhjen tuaj të pagëzimit. Tani është koha që ju të përgatiteni për të bërë besëlidhjet e tempullit. "Ordinancat dhe besëlidhjet e shenjta që janë në dispozicion në tempullit e shenjtë, bëjnë të mundur që [ne] të kthehemi [mi] në praninë e Perëndisë dhe që familjet [tona] të bashkohen përjetësisht."²

Qëndroni në vende të shenjta për paraardhësit tuaj. "Çdo qenie njerëzore që vjen në këtë tokë është produkt i brezave të prindërve. Ne kemi një mall të natyrshëm që të lidhemi me paraardhësit tanë."³ Ndërsa merrni pjesë në historinë familjare dhe punën në

tempull, ju e gërshetoni jetën tuaj me atë të paraardhësve tuaj, duke siguruar ordinancat shpëtuese për ta.

Qëndroni në vende të shenjta për vete dhe për familjarët tuaj më të afërt. Shembulli juaj i drejtë do të jetë një burim gëzimi i madh, pavarësisht rrethanave tuaja familjare. Zgjedhjet tuaja të drejta do t'ju kualifikojnë të bëni dhe të mbani besëlidhjet e shenjta, që do ta lidhin përjetësisht së bashku familjen tuaj.

Qëndroni në vende të shenjta për familjen tuaj të ardhshme. Zotohuni të vuloseni në tempull me bashkëshortin tuaj nëpërmjet priftërisë së shenjtë ndërsa krijoni një njësi të përjetshme familjare. Fëmijët tuaj do të bekohen me të vërtetën, ndërsa bëni që shembulli juaj i virtytshëm dhe dëshmia juaj e patundur të bëhen pjesë e jetës së tyre dhe u tregoni udhën drejt shtegut të besëlidhjes.

I pashë këto parime të përjetshme të shfaqen në Konkursin e fundit Ndërkombëtar të Artit për Të Rinjtë. Megan Uorner Tejlori kompozoi në mënyrë dixhitale një vepër me fotografi, duke përdorur një qasje bashkëkohore ndaj shëmbëlltyrës së Krishtit me dhjetë virgjëreshat.⁴ E takova Meganin, dhe ajo

shpjegoi simbolikën e virgjëreshës së dhjetë, të cilën e përshkroi si një të re të virtytshme dhe besnike, të përgatitur për të bërë dhe për të mbajtur besëlidhjet e shenjta të tempullit. Sikurse me të gjitha virgjëreshat e mençura, përgatitja e saj vetjake ndodhi ndërsa i shtoi vaj llambës së saj, pikë pas pike, nëpërmjet të jetuarit të vazhdueshëm me drejtësi. Vura re gërshetin e bukur në flokët e saj. Megani shpjegoi se gërsheti përfaqësonte gërshetimin e jetës së kësaj të reje të virtytshme me [një mori] brezash të panumërt. Njëra tufë e flokut përfaqësonte gërshetimin e dashurisë dhe respektit të saj për paraardhësit e vet, e dyta gërshetimin e ndikimit të saj të drejtë te familja e saj e tanishme, dhe tufa e tretë, gërshetimin e jetës së saj të përgatitur në jetën e brezave që do të vijnë.

Takova një të re tjetër, përgatitja e hershme shpirtërore e së cilës kishte gërshetuar në shumë breza një jetë të drejtë.

Në një pasdite të bukur shtatori, unë dhe bashkëshorti im ishim në tempull duke pritur mundësinë për të marrë pjesë në ordinancat e tempullit. Krisi, një mik i yni, hyri në dhomë. Ishte e mrekullueshme ta shihje këtë të ri, i cili ishte kthyer së fundmi nga një mision në Rusi.

Ndërkohë që sesioni që gati të fillonte, një e re e hijshme u ul pranë meje. Ajo ishte rrezatuese, e qeshur dhe plot me dritë. Doja ta njihja, ndaj qetë u prezantova. Ajo pëshpëriti emrin e saj, Keiti, dhe e njoha mbiemrin e saj meqenëse si familje kishin jetuar në Miçigan, ku familja ime jetoi dikur. Keiti që vajza e tyre e rritur, e cila pesë javë më parë ishte kthyer nga misioni i saj në Gjermani.

Gjatë sesionit, mendimi "Prezantoje Keitin me Krisin", vazhdonte të vinte në mendjen time. E lashë mënjanë këtë nxitje, duke menduar: "Kur, ku



Kuin Krik, Arizona, SHBA

dhe si?” Kur po bëheshim gati për t’u larguar, Krisi erdhi për të na thënë mirupafshim dhe unë e shfrytëzova mundësinë. E tërhoqa Keitin përpara dhe pëshpërita: “Ju jeni dy të rinj të virtutshëm që duhet ta njihni njëri-tjetrin”. U largova nga tempulli e kënaqur që kisha vepruar sipas nxitjes.

Gjatë rrugës për në shtëpi, unë dhe bashkëshorti im diskutuam mbi kujtimet tona të sfidave që kishte kaluar familja e Keitit. Që atëherë fillova ta njihja Keitin më mirë, dhe ajo më ka ndihmuar të kuptoj arsyet për pamjen e gëzuar që vura re atë ditë në tempull.

Keiti gjithmonë është përpjekur të qëndrojë në shtegun e saj të besëlidhjes duke kërkuar vende të shenjta. Ajo u rrit në një shtëpi ku mbajtja e mbrëmjeve familjare, lutjet bashkërisht dhe studimi i shkrimeve të shenjta e bënë shtëpinë e saj një vend të shenjtë. Kur ishte fëmijë, ajo mësoi rreth tempullit, dhe kënga “I Love to See the Temple” [“Shumë Tempullin Dua t’Shoh”] që e preferuara e saj për

mbrëmjen familjare.⁵ Kur ishte vajzë e vogël, ajo pa prindërit e saj tek jepnin një shembull të kërkimit të një vendi të shenjtë ndërsa shkonin në tempull në një mbrëmje fundjave në vend që të shkonin në kinema ose të dilnin për darkë.

Ajo e donte shumë të atin, dhe ai e përdori autoritetin e tij të priftërisë për ta ndihmuar të bënte besëlidhjen e saj të parë të pagëzimit. Pastaj asaj iu vunë duart mbi kokë dhe mori Frymën e Shenjtë. Keiti tha: “Isha e emocionuar të merrja Frymën e Shenjtë, dhe e dija se do të më ndihmonte të qëndroja në shtegun drejt jetës së përjetshme”.

Për Keitin jeta vazhdoi në një mënyrë shumë të bekuar e të lumtur. Kur ishte 14 vjeçe, ajo filloi shkollën e mesme dhe e donte seminarin, një tjetër vend i shenjtë për të mësuar rreth ungjillit. Një ditë mësuesja e saj filloi të fliste rreth sprovave dhe siguroi se të gjithë ne do të përballeshim me to. Ajo i tha vetes: “Nuk i dua sprovat; nuk dua ta dëgjoj këtë”.

Ishte pikërisht pak javë më vonë që i ati i saj u zgjua të dielën e Pashkës shumë i sëmurë. Keiti tha: “Babai im ishte një person shumë i shëndetshëm; ishte një vrapues maratone. Mamaja ime ishte kaq e alarmuar që ishte aq i sëmurë saqë e çoi në spital. Brenda 36 orëve ai pati një infarkt të gjerë që ia paralizoi pjesën më të madhe të trupit. Ai mund t’i hapte e mbyllte sytë, por pjesa tjetër e trupit nuk po punonte. Më kujtohet tek e shihja dhe mendoja: ‘O jo, po ndodh! Mësuesja ime e seminarit kishte të drejtë. Unë po kaloj një sprovë.’” Brenda pak ditëve babai i Keitit ndërroi jetë.

Duke vazhduar Keiti, tha: “Ishte kaq e vështirë. Askush nuk dëshiron asnjëherë ta humbasë heroin e jetës së vet. E dija se mund ta lija këtë gjë të bëhej një pedanë kërcimi për rritje ose ta lejoja të bëhej një pengesë [për mua]. Nuk doja ta lejoja të më rrënoje jetën sepse isha vetëm 14 vjeçe. U përpoqa të isha sa më afër me Zotin që qe e mundur. I lexova shumë shkrimet e mia të shenjta. Alma kapitulli 40



më siguroi se ringjallja është e vërtetë dhe përmes Shlyerjes së Krishtit unë mund të isha sërish me tim atë. U luta shumë. Shkrova në ditarin tim aq shpesh sa mundesha. E mbajta të gjallë dëshminë time duke e hedhur në letër. Shkova në kishë dhe te klasa e Të Rejave çdo javë. E rrethova veten me miq të mirë. Qëndrova pranë të afërmeve dashamirës dhe sidomos pranë mamasë sime, e cila qe spiranca në familje. Kërkova bekime të priftërisë nga gjyshi dhe mbajtës të tjerë të priftërisë.”

Këto zgjedhje të qëndrueshme, sikurse ato të virgjërshës së mençur, i shtuan vaj llambës së Keitit. Ajo u nxit nga dëshira e saj për të qenë përsëri me të atin. Keiti e dinte se i ati ishte në dijeni të zgjedhjeve të saj dhe nuk dëshironte ta zhgënjente. Ajo dëshironte një marrëdhënie të përjetshme me të, dhe e kuptoi se të qëndruarit në shtegun e saj të besëlidhjes do ta mbante jetën e saj të gërshetuar ngushtë me të tijën.

Megjithatë, sprovat nuk mbaruan. Kur Keiti qe 21 vjeçe dhe po dërgonte letrat e saj të misionit, e ëma u diagnostikua me kancer. Keiti duhet të

mernte një vendim të rëndësishëm në jetën e saj. A duhet të qëndronte në shtëpi dhe të mbështeste të ëmën apo të shkante në mision? Të ëmës iu dha një bekim priftërie që i premtoi se do t'i mbijetonte sëmundjes. E siguruar nga ky bekim, Keiti shkoi përpara me besim dhe vazhdoi me planet e saj për të shërbyer një mision.

Keiti tha: “Po ndërmerrija një hap në errësirë, por ndërsa isha në mision, drita përfundimisht erdhi dhe mora lajmin se bekimi i nënës sime u përmbush. Isha kaq e lumtur që nuk e shtyva shërbimin ndaj Zotit. Kur vijnë gjëra të vështira, mendoj se është e lehtë të bëhesh i amullt dhe të mos dëshirosh vërtet të ecësh përpara, por nëse e vendos Zotin të parin, fatkeqësitë mund të çojnë në bekime të bukura. Mund ta ndiesh dorën e Tij dhe të dëshmosh mrekulli.” Keiti provoi realitetin e fjalëve të Presidentit Tomas S. Monson: “Mundësitë tona më domethënëse do të gjenden në kohët e vështirësive më të mëdha”⁶.

Keiti e pati këtë lloj besimi sepse e kuptoi planin e shpëtimit. Ajo e dinte se jetuam më parë, se toka është një kohë prove dhe se do të jetojmë

sërish. Ajo pati besim se e ëma do të bekohej, por nga përvoja me të atin, ajo e dinte se nëse e ëma do të largohej nga kjo jetë, çdo gjë do të ishte në rregull. Ajo tha: “Nuk i mbijetova thjesht vdekjes së babait; ajo u bë pjesë e identitetit tim për mirë, dhe sikur mamaja të largohej nga kjo jetë, vdekja do të kishte bërë të njëjtën gjë. Do të kishte gërshetuar një dëshmi më të madhe në jetën time.”⁷

Keiti po kërkonte një vend të shenjtë mbrëmjen që e takova në tempull. Duke dëshiruar të gërshetonte ngushtë marrëdhëniet e përjetshme që vijnë përmes shërbimit në tempull, ajo ndoqi modelin e vendosur nga prindërit e saj për pjesëmarrjen e rregullt në tempull.

Mbrëmjen që e prezantova Keitin me Krisin nuk ndodhi ndonjë gjë e madhe, por duke kërkuar një vend tjetër të shenjtë të dielën pasuese, Keiti e pa Krisin në mes të qindra të rinjve në moshë madhore beqarë në një takim shpirtëror të institutit. Atje ata zbuluan më shumë për njëri-tjetrin. Pak javë më vonë, Krisi e ftoi atë të shihnin konferencën e përgjithshme bashkë. Ata vazhduan të kërkonin vende që ftonin Shpirtin gjatë gjithë periudhës së tyre të njohjes, dhe përfundimisht u vulosën në tempull, vendin e shenjtë ku u njohën. Të dy tani janë duke përmbushur përgjegjësinë e shenjtë të të qenit prindër, duke gërshetuar dëshmitë e tyre për planin e shpëtimit në jetën e tre djemve të vegjël, duke u treguar atyre udhën drejt shtegut të besëlidhjes.

“Kur shpëtoni një vajzë, ju shpëtoni breza.” Vendimi i Keitit si një 14-vjeçare për të qëndruar në shteg, për t'i shtuar vazhdimisht vaj llambës së saj dhe për të qëndruar në vende të shenjta ka shpëtuar dhe do të shpëtojë breza. Kërkimi për paraardhësit e saj dhe shërbimi në

tempull kanë gërshetuar zemrën e saj me të tyren. Pjesëmarrja në historinë familjare dhe punën në tempull gjithashtu do të gërshetojnë zemrat tuaja së bashku dhe do t'ju ofrojnë paraardhësve tuaj mundësinë e jetës së përjetshme.

Të jetuarit e ungjillit në shtëpinë tuaj gjithashtu do t'i shtojë vaj llambës suaj dhe do të gërshetojë forcë shpirtërore në shtëpinë tuaj tani dhe do të bekojë familjen tuaj të ardhshme në mënyra të pafundme. Dhe veç këtyre, sikurse ka thënë Plaku Robert D.

Hejls: "Nëse shembulli që kemi marrë nga prindërit tanë nuk ka qenë i mirë, është përgjegjësia jonë ta thyejmë atë cikël . . . dhe të japim mësim tradita të drejta për brezat që pasojnë"⁸.

Vendosni tani që të bëni gjithçka mundeni për të mbushur llambat tuaja, që dëshmia dhe shembulli juaj i fortë të mund të gërshetohen në jetën e shumë brezave – të kaluar, të tanishëm dhe të ardhshëm. Dëshmoj se jeta juaj e virtutshme jo vetëm që do të shpëtojë breza, por gjithashtu do të shpëtojë *jetën tuaj* të përjetshme, sepse është e vetmja mënyrë për t'u kthyer tek Ati ynë në Qiell dhe për të gjetur gëzim të vërtetë tani dhe gjatë gjithë përjetësisë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gordon B. Hinckley, "Standing Strong and Immovable", *Mbledhje e Trajnimit Mbarëbotëror të Udhëheqjes*, 10 janar 2004, f. 20; shih edhe Gordon B. Hinckley, "Our Responsibility to Our Young Women", *Ensign*, shtator 1988, f. 10.
2. "Familja: Një Proklamata drejtuar Botës", *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
3. Rasëll M. Nelson, "Breza të Lidhur me Dashuri", *Liahona*, maj 2010, f. 92.
4. Shih Mateu 25:1-13.
5. Shih "I Love to See the Temple", *Children's Songbook*, f. 95.
6. Thomas S. Monson, "Meeting Your Goliath", *New Era*, qershor 2008, f. 7.
7. Intervistë personale me autoren, 2013.
8. Robert D. Hales, "How Will Our Children Remember Us?", *Ensign*, nëntor 1993, f. 10.



Nga Elen S. Dalton

Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Mos Lëvizni!

Qëndroni të paepura. Jini të qëndrueshme. Qëndroni për të vërtetën dhe drejtësinë. Qëndroni si dëshmitare. Jini një shembull për botën. Qëndroni në vende të shenjta.

Sonte unë qëndroj në një vend të shenjtë në këtë podium, në prani të profetëve, shikuesve e zbuluesve dhe bijave mbretërore të Perëndisë. Kjo është një periudhë e mrekullueshme për të qenë në tokë dhe për të qenë një e re. Ju jeni bijat e zgjedhura të Atit tonë në Qiell. Shpresoj që e kuptoni identitetin tuaj dhe se sa bija të dashura jeni për Atin tonë në Qiell. Ai e do secilën prej jush dhe unë ju dua gjithashtu.

Mbi tavolinën në zyrën time, kam një kopje në bronz të një skulpture të një të reje, emri i së cilës është Kristina. Skulptura origjinale në madhësinë normale të Kristinës qëndron në një mol në Kopenhage të Dani-markës, e vendosur në mënyrë të

atillë që shikon nga deti drejt Sionit. Vendimi i saj për t'u bashkuar me Kishën e për të lënë shtëpinë nuk qe i lehtë dhe mund ta shihni që erërat kundërshtare po fryjnë furishëm kundër saj. Ajo po qëndron e paepur, duke bërë një gjë tepër të vështirë por që e di se është e drejtë. Pasardhësit e saj e vendosën këtë skulpturë atje mbi atë mol në shenjë nderimi ndaj Kristinës, pasi vendimi i saj atë ditë pati rëndësi të përjetshme për brezat [pasardhës].

Për mua, kjo skulpturë e Kristinës përfaqëson secilën nga ju. Ashtu si Kristina, ju po qëndroni përballë shumë vendimeve të rëndësishme dhe po bëni zgjedhje çdo ditë, disa prej të cilave të vështira, që do të përcaktojnë jo vetëm të ardhmen tuaj por edhe fatin e brezave [pasardhës]. Edhe ju po përballeni me erërat si tufan të kundërshtimit, të vështirësisë, të presionit të bashkëmoshatarëve dhe të ndotjes morale. Dhe prapë, ju po qëndroni të palëvizura dhe po e jetoni ungjillin përballë këtyre stuhive të egra në shoqërinë tonë. Ashtu si Kristina, ju udhëhiqeni nga Fryma e Shenjtë. Ju po merrni vendime të drejta. Ju jeni besnike; dhe ju jeni mbretërore.

Nuk mund të mendoj ndonjë këshillë më të rëndësishme nga një Atë i dashur Qiellor sesa paralajmërimi



i Tij për secilën prej jush që të “qëndroni në vende të shenjta dhe [të] mos lëvizni”¹. Ai po thotë: “Qëndroni të paepura. Jini të qëndrueshme.² ‘Qëndro[ni] për të vërtetën dhe drejtësinë.’³ Qëndroni si dëshmitare.⁴ Jini një shembull për botën. Qëndroni në vende të shenjta. Dhe kështu që mesazhi im për secilën prej jush është një mesazh i thjeshtë: “Mos lëvizni”.

Së pari, mos lëvizni nga zgjedhja e të drejtës. Në këto ditë të mëvonshme, nuk ka vendime të vogla. Vendimet që po merrni pikërisht tani, janë me rëndësi kritike. Zgjedhja e lirë, ose

aftësia për të zgjedhur është një prej dhuratave më të mëdha të Perëndisë për fëmijët e Tij. Ajo është pjesë e planit të lumturisë që ju dhe unë e zgjodhëm dhe e mbrojtëm në ekzistencën tonë para lindjes. Vazhdoni të jetoni në mënyrë të atillë që të mund ta dëgjoni e t’ia vini veshin Frymës së Shenjtë dhe Ai do t’ju ndihmojë të merrni vendime të drejta. Në të vërtetë, Ai do t’ju tregojë “të gjitha gjërat që ju duhet të bëni”⁵.

Disa javë më parë, për herë të parë pas shumë vitesh, u ktheva tek ish-shkolla ime e mesme. Isha për vizitë

në një konferencë kunji që po mbahej në sallën e shkollës. Ndërsa eca nëpër korridore, një mori kujtimesh befas filluan të vërshonin në mendjen time. Kujtova saktësisht si u ndjeva kur e frekuentoja shkollën e mesme kur qeshë e re – plot mëdyshje, e pasigurt në vetvete, e ndrojtur dhe me kaq shumë dëshirë për t’u përshtatur. Shkova tek salla. Sërish mori kujtimesh më vërshuan në mendje. E njihja çdo element të asaj salle. Vetëm një gjë kishte ndryshuar – unë.

Atë ditë pata mundësinë të qëndroja në podium siç kisha qëndruar shumë herë gjatë shkollës së mesme si përfaqësuese studentore. Madje ndërmjet dëgjuesve pashë disa prej shokëve të mi të mëparshëm të klasës – me disa kisha dalë në takime! Por këtë herë, në vend që të drejtoja një asamble, unë pata privilegjin – aty, në sallën e shkollës sime të mesme – të “qëndro[ja] si dëshmitar[e]”⁶ dhe të jepja dëshminë time për Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin.

Të reja, sigurohuni që marrëdhëniet tuaja me të tjerët të jenë të atilla që, 40 vjet nga sot, të mos të viheni në siklet. Nuk ia vlen që të bësh kompromis përpara asnjë mase trysnie nga grupi, për asnjë miratim [nga të tjerët], për asnjë popullaritet. Ndikimi juaj mbi të rinjtë do t’i ndihmojë që të qëndrojnë të denjë për fuqinë e tyre të priftërisë, për besëlidhjet e tempullit dhe për të shërbyer një mision. Dhe kush e di? Dyzetë vjet nga sot, atje në sallën e shkollës suaj të mesme, një nga ata madje mund të ecë drejt jush dhe t’ju falënderojë që e ndihmuat të qëndronte i denjë në përmbushjen e detyrës së tij të priftërisë për të shërbyer një mision plot nder. Dhe kush e di? Mund të merrni një letër nga një bashkëshorte e një prej atyre të rinjve, duke ju falënderuar *ju* për ndikimin që patët te bashkëshorti i saj dhe familja



e tyre e ardhme që atëherë në ditët e shkollës suaj të mesme. Zgjedhjet tuaja kanë rëndësi. Zgjedhjet tuaja tani jo vetëm që ndikojnë te ju, por ndikojnë te të tjerët gjithashtu. Ato kanë rëndësi të përjetshme. Mos lëvizni!

Së dyti, mos lëvizni nga dëshira dhe zotimi juaj për të qëndruar të virtytshme dhe seksualisht të dëlira. Ta keni fort për zemër virtytin. Dëlirësia juaj vetjake është një prej burimeve tuaja më të mëdha të fuqisë. Kur erdhët në tokë, juve ju dha dhurata e çmuar e pasjes së një trupi. Trupi juaj është vegël e mendjes suaj dhe dhuratë hyjnore me anë të të cilit ushtroni lirinë tuaj të zgjedhjes. Kjo është një dhuratë që iu mohua Satanit, dhe kështu që ai i drejton pothuaj të gjitha sulmet e tij te trupi juaj. Ai dëshiron që ju ta nënçmoni, ta keqpërdorni dhe të abuzoni me trupin tuaj. Mungesa e modestisë, pornografia, imoraliteti, tatuazhet dhe shpimet e trupit, abuzimi me drogat dhe varësitë e të gjitha llojeve, janë që të gjitha përpjekje për të marrë nën kontroll këtë dhuratë të çmuar – trupin tuaj – dhe për t’jua bërë të vështirë ushtrimin e lirisë suaj të zgjedhjes. Pali pyet: “A nuk e dini ju se jeni tempulli i Perëndisë dhe se Fryma e Perëndisë banon në ju?”⁷

Trupi juaj është një tempull. Përse? Sepse ka aftësinë të strehojë jo vetëm shpirtin tuaj të përjetshëm, por edhe shpirtin e përjetshëm të të tjerëve që do të vijnë në tokë si pjesë e familjes suaj të përjetshme. Plaku Dallin H. Ouks dha mësim: “Fuqia për të krijuar jetë të vdekshme është [një] fuqi e ekzaltuar”⁸. Roli juaj është rol i ekzaltuar. Perëndia ju ka dhënë një detyrë të shenjtë! Ju po përgatiteni që të jeni nëna të ardhshme për brezat që do të vijnë. Mbajeni veten të pastër e të denjë dhe ruajeni atë që është “më e dashur dhe më e çmuarshme përmbi të gjitha gjërat” – virtytin dhe dëlirësinë



tuaj.⁹ Këshilla e urtë e Atit Qiellor për ju personalisht, bijat e Tij të zgjedhura, është që të “ecni] në shtigjet e virtytit”¹⁰.

Virtyti është çelësi i artë për në tempull. *Kështu që, së treti, mos lëvizni nga qenia të denja kur bëni dhe mbani besëlidhjet e shenjtë.* Besëlidhja që bëni në pagëzim, do t’ju mbajë në shtegun e virtytit dhe të lumturisë ndërsa e rinovoni atë besëlidhje çdo javë duke marrë sakramentin. Kur mbani besëlidhjen tuaj të pagëzimit, ju do të dukeni ndryshe, do të visheni ndryshe dhe do të veproni ndryshe nga bota. Mbajtja e kësaj besëlidhjeje do t’ju mundësojë që të udhëhiqeni nga Fryma e Shenjtë. Qëndroni në vende të shenjtë dhe as mos shkoni pranë atyre ambienteve ose asaj muzike, atyre mediave ose atyre shoqërive që mund t’ju bëjnë të humbisni shoqërinë e Frymës së Shenjtë.¹¹ Dhe ndërsa i mbani besëlidhjet tuaja, ju do të mbeteni të denja e të përgatitura që të hyni në tempujt e shenjtë të Zotit.

Së fundmi, mos lëvizni nga pranimiti i Shlyerjes së Shpëtimtarit. Shlyerja është për ju dhe për mua. Është një fuqi ndihmuese dhe shëlbuese. Nëse nuk po ndiheni të denja të qëndroni në vende të shenjtë, mos e mbani atë barrë të mëkatit as edhe një ditë më shumë. Në vdekshmëri në të gjithë do të bëjmë gabime. Jini të sigurt se Shpëtimtari ju do aq shumë

sa bëri të mundur për ju që të ndryshoni dhe të pendoheni nëse bëni një gabim. Satani nuk dëshiron që të mendoni se mund të ndryshoni.¹² Ai do të përpiqet t’ju bindë që çdo shpresë ka humbur. Kjo është gënjeshtëri. Ju mund të ktheheni. Ju mund të pendoheni. Ju mund të jeni të dëlira dhe të shenjtë për shkak të Shlyerjes së pafundme të Shpëtimtarit.

Tani më lejoni ta mbyll me një prej historive më të mrekullueshme të dashurisë të treguara ndonjëherë. Ju mund të pyesni: “Çfarë lidhje ka një histori dashurie me qëndrimin në vende të shenjtë?” Sigurisht që ka lidhje me qëndrimin në vende të shenjtë. Kjo është historia e një të reje me emrin Rebeka.¹³

Ndërsa kjo histori fillon të shpaloset, Abrahami e ngarkon shërbëtorin e tij të gjejë një të re të denjë që të jetë gruaja e të birit, Isakut. Ajo duhet të jetë një e re që kualifikohet për një martesë në besëlidhje – e virtytshme, e dëlirë dhe e denjë. Dhe kështu ai e dërgon shërbëtorin e tij në një udhëtim të gjatë e të rrezikshëm në një vend të quajtur Haran. Arsyeja përse duhet të shkojë atje është e qartë – burra të shenjtë kanë nevojë për gra të shenjtë që të qëndrojnë krahu tyre. Kur shërbëtori iu afrua qytetit të Nahorit, ai ndaloi në një burim për t’iu dhënë ujë deveve të tij dhe u lut që do të udhëhiqej tek e reja e duhur dhe që



Brazilia, Brazil

do ta dallonte atë nga oferta që ajo do të bënte për t'i dhënë ujë atij dhe 10 deveve të tij. Tani, unë kam hipur në deve dhe [të paktën] kaq e di – devetë pinë shumë ujë!

Te Zanafilla lexojmë se Rebeka jo vetëm që shkoi deri te burimi dhe mori ujë, por [shkoi] “me nxitim”¹⁴, apo shpejtoi, që ta përmbushte këtë detyrë. Shërbëtori pastaj i vendosi byzylykë e stoli Rebekës dhe e pyeti nëse kishte vend në shtëpinë e të atit për të që të qëndronte. Jam e sigurt se stolitë bënë punën e tyre! Shkrimi i shenjtë thotë: “Dhe vajza vrapoi për t'i treguar këto gjëra në shtëpinë e nënës së saj”¹⁵. Rebeka duhet të ketë qenë vrapuese e mirë!

Shërbëtori i tregoi familjes së Rebekës për qëllimin e udhëtimit të tij të gjatë; dhe Rebeka ra dakord që të bëhej gruaja e Isakut. Shërbëtori dëshironte të nisej me Rebekën që të nesërmen, por familja iu lut asaj që të qëndronte me ta të paktën edhe 10 ditë. Pastaj ata e pyetën Rebekën se çfarë dëshironte që të bënte dhe përgjigjja e saj qe thjesht: “Po, do të shkoj”¹⁶. A ju duket kjo përgjigje e njëjtë me përgjigjen e mijëra vetëve

të cilët u përgjigjen me vendosmëri: “Unë do të shkoj dhe do të bëj”¹⁷, kur profeti ynë, Presidenti Tomas S. Monson, njoftoi mundësinë që kishin të rinjtë dhe të rejat për të shërbyer në misione në moshë më të re?

Tani morali dhe fundi i kësaj historie dashurie: Rebeka qe e përgatitur dhe e denjë të bënte dhe të mbante besëlidhje të shenja dhe të bëhej një grua e besëlidhur e Isakut. Asaj nuk iu desh të priste e të përgatitej. Përpara largimit nga familja e saj, iu dha një bekim; dhe fjalët janë emocionuese për mua, pasi iu premtua se do të bëhej “nëna e mijëra mizëri njerëzish”¹⁸. Por pjesa më e bukur e kësaj historie dashurie është kur Rebeka pa për herë të parë Isakun dhe ai e pa për herë të parë atë. Në Bibël kjo nuk thuhet, por mendoj se që dashuri me shikim të parë! Pasi “virtyti e dashuron virytin; [dhe] drita kapet pas dritës”¹⁹. Kur Isaku doli të takonte karvanin, Rebeka “zbriti me të shpejtë nga deveja [e saj]”²⁰. Dhe pastaj thotë: “Dhe ai e dashuroi”²¹. Këtu unë filloj të marr frymë sërisht!

Për të dyja, si Kristinën edhe Rebekën, nuk qe e lehtë të qëndronin në vende të shenja. Të mos lëviznin nuk

qe e lehtë. Erërat frynë furishëm, uji i burimit qe i rëndë dhe largimi nga vatra e tyre familjare dhe jeta e mëparshme me siguri nuk qe i lehtë. Por ato bënë zgjedhje të drejta. Ato u udhëhoqën nga Fryma e Shenjtë. Ato qenë të virtytshme dhe u përgatitën për të bërë e për të mbajtur besëlidhje të shenja. Shpëtimtari qe me prejardhje nga Rebeka. A e dinte ajo atëherë se kjo do të ndodhte? Jo! A kanë rëndësi zgjedhjet tuaja? Po!

Të reja, brezat [pasardhës] mbështeten te zgjedhjet që bëni, te dëlirësia juaj dhe jeta juaj e denjë. Mos lëvizni. Ju keni një fat të mrekullueshëm përpara jush. Ky është çasti juaj! Unë vërtet besoj se një e re e virtytshme, e udhëhequr nga Shpirti, mund ta ndryshojë botën!

Unë dëshmoj se Shpëtimtari jeton! Ai do të jetë me ju. Ai do t'ju ndihmojë. Dhe në çaste të vështira, “engjëjt e [Tij do të jenë] përreth jush, për t'ju ngritur lart”²². Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 87:8.
2. Shih Mosia 5:15.
3. Motoja e Të Rejave, tek *Të Rejat Përparimi Personal* (broshurë, 2009), f. 2.
4. Shih Mosia 18:9.
5. 2 Nefi 32:5.
6. Shih Mosia 18:9.
7. 1 Korintasve 3:16.
8. Dallin H. Oaks, “The Great Plan of Happiness”, *Ensign*, nëntor 1993, f. 74.
9. Moroni 9:9.
10. Doktrina e Besëlidhje 25:2.
11. Shih 1 Korintasve 6:9; 1 Thesalonikasve 5:22; 2 Timoteut 2:22; Doktrina e Besëlidhje 9:13.
12. Shih *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 28–29.
13. Shih Zanafilla 24.
14. Zanafilla 24:20.
15. Zanafilla 24:28.
16. Zanafilla 24:58.
17. Shih 1 Nefi 3:7.
18. Zanafilla 24:60.
19. Doktrina e Besëlidhje 88:40.
20. Zanafilla 24:64.
21. Zanafilla 24:67.
22. Doktrina e Besëlidhje 84:88.



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Udhëtimi Juaj i Mrekullueshëm për në Shtëpi

Ndërsa e përdorni me gëzim hartën që Ati juaj i dashur ju ka dhënë për udhëtimin tuaj, ajo do t'ju çojë në vende të shenjta dhe ju do të ngriheni tek aftësia juaj hyjnore.

Jemi të nderuar këtë mbrëmje me praninë e Presidentit Tomas S. Monson, profetit tonë të dashur. President, ne gjithmonë lutemi për ju.

Motra të dashura, faleminderit për muzikën dhe fjalët e folura. Gjithçka ishte kaq frymëzuese dhe kaq e përshtatshme për Pashkën, stinën e shenjtë që festojmë këtë javë.

Është gëzim të jesh me ju motra të reja, të çmuara, bashkë me nënat tuaja dhe me udhëheqëset tuaja të mrekullueshme. Ju keni shpirtra rrezatues dhe buzëqeshje që i bëjnë të tjerët të buzëqeshin. Sigurisht Zoti tregon kujdes për ju dhe hedh vështrimin nga qielli me dashuri mbi ju.

Unë u rrita në Cvikau, në ish-Gjermaninë Lindore. Kur isha rreth 11 vjeç, babai im iu nënshtrua gjithnjë e më shumë hetimit si kundërshtar politik dhe prindërit e mi ndien se e vetmja zgjidhje e sigurt për familjen tonë do të ishte të arratiseshim në Gjermaninë Perëndimore. U vendos që plani më i sigurt do të ishte të

largoheshim në kohë të ndryshme dhe të ndiqnim udhë të ndryshme drejt Perëndimit, duke lënë pas të gjitha gjërat tona personale.

Ngaqë babai im ishte në rrezik më të madh, ai mori udhën më të shpejtë, përmes Berlinit. Vëllezërit e mi më të mëdhenj u nisën drejt veriut dhe secili e gjeti mënyrën e vet drejt perëndimit. Motra ime – që do të kishte qenë në

moshën e shumë prej jush sot këtu – së bashku me Helga Fasman, mësuesen e saj në Të Rejat, dhe disa të tjerë shkuan me një tren që kalonte për një kohë të shkurtër përmes Gjermanisë Perëndimore. Ato paguan një portier për të hapur një nga dyert për to dhe pasi treni kapërceu kufirin e Gjermanisë Perëndimore, u hodhën drejt lirisë nga treni në lëvizje. Sa e admirova motrën time për guximin e saj.

Unë isha fëmija më i vogël dhe nëna vendosi që ajo dhe unë do të ecnim përmes një vargmali që i ndante të dy vendet. Më kujtohet që ajo paketoi drekën, sikur të shkonim për një ngjitje dhe një piknik në male.

Morëm një tren sa më larg që mundëm dhe më pas ecëm për shumë orë, duke iu afruar më pranë kufirit të Gjermanisë Perëndimore. Kufijtë kontrolloheshin imtësisht, por ne kishim një hartë dhe dinim një kohë dhe një vend ku mund të ishte pa rrezik të kalonim. Mund ta ndieja shqetësimin e nënës sime. Ajo e vëzhgoi zonën me kujdes për të parë nëse po na ndiqnin. Me çdo hap, këmbët dhe gjunjët e saj dukej se po dobësoheshin. E ndihmova të mbante çantën e saj të rëndë, të mbushur me ushqime, dokumente jetike dhe fotografi të familjes,



Sobral, Brazil

ndërsa i ngjiteshim një kodre të fundit, të gjatë. Sigurisht, mendoi ajo, ne tashmë e kishim kaluar kufirin. Kur ajo më së fundi u ndie jashtë rrezikut, ne u ulëm dhe filluam të hanim drekën tonë të piknikut. Për herë të parë atë ditë, jam i sigurt, ajo mori frymë më me lehtësi.

Ishte vetëm atëherë që vumë re shenjën e kufirit. Ishte ende shumë përpara nesh! Po e bënim piknikun tonë në anën e gabuar të kufirit. Ishim ende në Gjermaninë Lindore!

Rojet e kufirit mund të shfaqeshin në çdo çast!

Nëna ime furishëm mblodhi drekën tonë dhe iu ngjitëm kodrës aq shpejt sa mundeshim. Këtë herë nuk guxuam të ndalonim derisa e dinim me siguri se kishim arritur në anën tjetër të kufirit.

Edhe pse secili anëtar i familjes sonë pati marrë rrugë tepër të ndryshme dhe përjetoj vështirësi shumë të ndryshme përgjatë udhës, më së fundi ne të gjithë arritëm të sigurt. Më së fundi u ribashkuam si një familje. Ç'ditë e lavdishme ishte ajo!

Tregime Udhëtimeësh

Ajo që sapo ju kam treguar, është një përvojë që është për mua një udhëtim shumë i çmuar. Tani mund ta hedh vështrimin pas tek jeta ime dhe të dalloj një numër “udhëtimeësh” të tilla, që i kam ndërmarë me kalimin e kohës. Jo të gjitha ato përfshinë kalimin e vargmaleve apo kufijve politikë; disa patën më shumë të bënin me kapërcimin e sprovave ose rritjen në shpirtmëri. Por ato ishin të gjitha udhëtime. Besoj se çdo jetë është një koleksion i “tregimeve të udhëtimeve” individuale.

Jam i sigurt që ju e dini se çdo traditë kulturore është plot me tregime udhëtimeësh. Për shembull, ju mund ta njihni udhëtimin e Doroteas dhe



qenit të saj, Toto, në librin *Magjistari i Ozit*. Dorotea dhe Toto përfshihen në një tufan dhe zhvendosen në Tokën e Ozit. Atje, Dorotea gjen një rrugë të dallueshme, me tulla të verdha, që shënon shtegun për një udhëtim që më së fundi e udhëheq drejt shtëpisë së saj.

Pastaj është Ebenizer SkruXH i Çarls Dikensit, udhëtimi i të cilit nuk e çon atë nga një vend në tjetrin, por nga një kohë në tjetrën. Është një udhëtim brenda vetë zemrës së tij, që e ndihmoi të kuptonte përse ai u bë siç ishte dhe të shihte se çfarë do t'i ndodhte, në qoftë se vazhdonte në shtegun e tij të egoizmit dhe mosmirënjohjes.¹

Një nga novelat e mëdha klasike të letërsisë kineze është *Udhëtimi drejt Perëndimit*. E shkruar në shekullin e 16-të, ajo tregon këndshëm ngjarjen e aventurës dhe pelegrinazhin e një murgu, i cili, me ndihmën e katër personazheve miqësorë, udhëton drejt ndriçimit shpirtëror të mendjes.

Dhe sigurisht është Bilbo Bagins, hobiti i vogël, i thjeshtë, i cili do të kishte dashur shumë të qëndronte në shtëpi dhe të hante supën e tij. Por pas një trokitje në derë, ai dëgjon thirrjen e të panjohurës së madhërishe dhe hedh një hap jashtë në botë, së bashku me një magjistar dhe një grup

xhuxhash, për të përmbushur një mision të rrezikshëm, por jashtëzakonisht të rëndësishëm.²

Një Tregim Universal

A s'na pëlqejnë këto tregime udhëtimi, sepse mund të shohim vetveten tek udhëtarët? Sukseset dhe dështimet e tyre mund të na ndihmojnë për ta gjetur vetë udhën tonë përgjatë jetës. Videoja që pamë pak minuta më parë gjithashtu tregon për një histori të bukur udhëtimi. Ndoshta këto histori edhe na kujtojnë për një udhëtim që ne të gjithë duhet ta njohim – një tregim udhëtimi në të cilin secili prej nesh luan një rol të rëndësishëm.

Ky tregim fillon shumë kohë më parë, shumë më parë se toka të fillonte të rrotullohej në orbitën e saj, shumë më parë se dielli i pandryshueshëm të fillonte t'i shtrinte krahët e tij të zjarrtë për të rrethuar të ftohtin e hapësirës, shumë më parë se krijesat e mëdha dhe të vogla ta kishin populluar planetin tonë. Në fillimin e këtij tregimi, ju jetuat në një vend shumë të largët, të bukur.

Ne nuk dimë shumë hollësi rreth jetës në atë ekzistencë para lindjes, por vërtet e dimë diçka. Ati ynë Qiellor na ka zbuluar se kush është Ai, kush jemi ne dhe kush mund të bëhemi.

Atje në atë gjendje të parë, ju e dinit me siguri të padyshimtë që Perëndia ekzistonte, sepse e patë dhe e dëgjuat Atë. Ju e njihnit Jezu Krishtin, i cili do të bëhej Qengji i Perëndisë. Ju kishit besim tek Ai. Dhe e dinit se fati juaj nuk ishte në sigurinë e shtëpisë suaj para lindjes. Edhe pse e donit shumë atë ekzistencë të përjetshme, ju e dinit se dëshironit dhe kishit nevojë të niseshit për një udhëtim. Do të largoheshit nga prania e Atit tuaj, do të kalonit përmes një veli të harresës, do të merrnit një trup të vdeqshëm dhe do të mësonit e përjetonit gjëra që, me



Kopenhagë, Danimarkë

shpresë, do t'ju ndihmonin të rriteshit për t'u bërë më shumë si Ati në Qiell dhe do të ktheheshit në praninë e Tij.

Në atë vend të shenjtë, të rrethuar nga ata që i njihnit dhe i donit, pyetja e madhërisme në buzët tuaja dhe në zemrën tuaj duhet të ketë qenë: "A do të kthehem vërtet pa rrezik në shtëpinë time qiellore?"

Pati kaq shumë gjëra që do të ishin jashtë kontrollit tuaj. Jeta e vdekshme do të ishte e vështirë herë pas here, e mbushur me kthesa të papritura në rrugë: sëmundje, dhembje, aksidente, mosmarrëveshje.

Pa një kujtesë për ekzistencën tuaj të mëparshme – pa kujtuar se dikur jetuat me Atin tuaj në Qiell – a do ta njihnit ende zërin e Tij mes gjithë zhurmës dhe hutimeve të jetës së vdekshme?

Udhëtimi përpara dukej kaq i gjatë dhe i pasigurt – kaq i mbushur me rrezik.

Nuk do të ishte e lehtë, por ju e dinit se do t'ia vllente çdo përpjekje.

Kështu, atje qëndruat në buzë të përjetësisë, duke vështruar përpara me emocion dhe shpresë të papërshkrueshme – dhe, e përfytyroj, edhe me një farë shqetësimi dhe frike.

Në fund, ju e dinit se Perëndia do të ishte i drejtë – se mirësia e Tij do të triumfonte. Ju kishit marrë pjesë në këshillat e madhërisëm qiellorë dhe e dinit se Shpëtimtari dhe Shëlbuesi juaj, Jezu Krishti, do të siguronte një mënyrë për ju që të pastroheshit nga mëkati dhe të shpëtoheshit nga vdekja fizike. Patët besim se, në fund, do të gëzoheshit dhe do ta bashkonit zërin tuaj me një kor qiellor, duke i kënduar përlehtë emrit të Tij të shenjtë.

Dhe kështu, ju morët frymë thellë . . .

Dhe një hap të madh përpara . . .
Dhe ja ku jeni!

Ju, secila prej jush, keni filluar udhëtimin tuaj të mrekullueshëm për t'u kthyer te shtëpia juaj qiellore!

Harta Juaj

Tani që jeni këtu në tokë, mund të jetë me vend ta pyesni veten se si po shkon udhëtimi juaj. A jeni në rrugën e duhur? A po bëheni njeriu që u caktuat të ishit dhe që dëshironit të bëheshit? A po bëni zgjedhje që do t'ju ndihmojnë të ktheheni tek Ati juaj në Qiell?

Ai nuk ju dërgoi në këtë udhëtim thjesht që të endeshit pa qëllim dhe

në vetmi. Ai dëshiron që ju të ktheheni në shtëpi tek Ai. Ai ju ka dhënë prindër të dashur dhe udhëheqës besnikë të Kishës, së bashku me një hartë që përshkruan terrenin dhe përcakton rreziqet; harta ju tregon se ku mund të gjendet paqe e lumturi dhe do t'ju ndihmojë ta planifikoni udhën tuaj për t'u kthyer në shtëpi.

Tani, ku do ta gjeni këtë hartë?

- Në shkrimet e shenjta.
- Në fjalët e profetëve dhe të apostujve.
- Dhe nëpërmjet zbulesës personale nga Fryma e Shenjtë.

Kjo hartë është ungjilli i Jezu Krishtit, lajmi i mirë, dhe udha plot gëzim e një dishepulli të Krishtit. Ajo është urdhërimet dhe shembulli i dhënë nga Mbrojtësi dhe Këshilltari ynë, i cili e njeh udhën, pasi Ai është udha.³

Sigurisht, thjesht të pasurit e një harte nuk ju sjell ndonjë dobi aspak, në qoftë se nuk e studioni atë – në qoftë se nuk e përdorni për t'ju udhëzuar gjatë jetës. Ju ftoj ta bëni një përparësi të rëndësishme studimin dhe zbatimin e fjalës së Perëndisë. Hapeni zemrën tuaj ndaj Frymës së Shenjtë,

që Ai të mund t'ju drejtojë përgjatë udhëtimit tuaj përmes jetës.

Harta juaj është plot me mesazhe nxitëse dhe udhëzuese nga Ati juaj Qiellor dhe Biri i Tij, Jezu Krishti. Sot do të doja të ndaja me ju tri nga këto mesazhe, të cilat do t'ju ndihmojnë të keni një udhëtim të suksesshëm për t'u kthyer te shtëpia juaj qiellore.

Mesazhi i parë: “Mos u frikësoni, sepse unë, Zoti, jam me ju”⁴.

Ju nuk jeni të vetme në këtë udhëtim. Ati juaj Qiellor ju njeh. Edhe kur askush tjetër nuk ju dëgjon, Ai ju dëgjon. Kur gëzoheni në drejtësi, Ai gëzohet me ju. Kur rrethoheni nga sprova, Ai brengoset me ju.

Interesimi i Atit Qiellor për ju nuk varet nga sa të pasura, apo të bukura, apo të shëndetshme, apo të zgjuara jeni. Ai nuk ju sheh sikurse ju sheh bota; Ai sheh se kush jeni me të vërtetë. Ai shikon zemrën tuaj.⁵ Dhe ju do⁶, sepse ju jeni fëmija e Tij.

Motra të dashura, kërkojeni Atë me dëshirë dhe do ta gjeni.⁷

Ju premtoj, ju nuk jeni vetëm.

Tani, gjeni një çast pikërisht tani dhe shihni njerëzit që ndodhen përreth jush. Disa mund të jenë udhëheqëset, shoqet ose anëtare të familjeve tuaja. Të tjera ndoshta nuk i keni takuar kurrë më parë. Megjithatë, secila që shihni rreth jush – në këtë mbledhje ose në këdo vend tjetër, sot ose në çfarëdo kohe tjetër – ishte guximtare në botën para lindjes. Ai person i përlulur dhe i zakonshëm në dukje, që është ulur pranë jush, mund të ketë qenë një nga figurat e madhërisme që deshët dhe admiruat në sferën e shpirtave. Ju mund të keni qenë vetë një shembull i tillë për t'u ndjekur!

Për një gjë mund të jeni të sigurt: çdo njeri që shihni – pavarësisht nga raca, feja, bindjet politike, forma e trupit apo pamja e jashtme – është familje. E reja të cilën shihni, ka të njëjtin Atë Qiellor sikurse ju dhe ajo u largua nga prania e Tij e dashur sikurse bëtë ju, plot dëshirë për të ardhur në këtë

tokë dhe për të jetuar, me qëllim që një ditë të mund të rikthehej tek Ai.

Megjithatë, ajo mund të ndihet vetëm, sikurse nganjëherë ndiheni edhe ju. Ka raste kur ajo madje mund ta harrojë qëllimin e udhëtimit të saj. Ju lutem ia kujtoni, me anë të fjalëve tuaja dhe veprimeve tuaja, se ajo nuk është vetëm. Ne jemi këtu për të ndihmuar njëri-tjetrin.

Jeta mund të jetë e vështirë dhe mund t'i ngurtësojë zemrat deri në pikën ku disa njerëz duken të parritshëm. Disa mund të mbushen me zemërim. Të tjerë mund t'i tallin dhe përqeshin ata që besojnë në një Perëndi të dashur. Por merrni këtë parasysh: edhe pse nuk e mbajnë mend, ata po ashtu mezi prisnin dikur të ktheheshin tek Ati i tyre në Qiell.

Nuk është përgjegjësia juaj të ktheni dikë në besim. Ajo është puna e Frymës së Shenjtë. Detyra juaj është të flisni për gjërat që besoni dhe të mos keni frikë. Jini një mike me të gjithë, por kurrë mos i rrezikoni standardet tuaja. Qëndroni të vërteta ndaj bindjeve dhe besimit tuaj. Jini krenare, sepse ju jeni bijë e Perëndisë dhe Ai qëndron me ju!

Mesazhi i dytë: “Ta doni njëri-tjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve”⁸.

A e keni vvarë mendjen ndonjëherë se çfarë gjuhe folëm ne të gjithë kur jetuam në praninë e Perëndisë? Kam dyshime të forta që ishte gjerënishtja, edhe pse mendoj se askush nuk e di me siguri. Por e di se në jetën tonë para lindjes, ne mësuam drejtpërsëdrejti, nga Ati i shpirtave tanë, një gjuhë universale – një që ka fuqinë për të kapërcyer pengesat emocionale, fizike dhe shpirtërore.

Ajo gjuhë është dashuria e pastër e Jezu Krishtit.

Është gjuha më e fuqishme në botë. Dashuria e Krishtit nuk është



Sidni, Australi

dashuri e shtirur. Nuk është dashuri si nëpër kartolina. Nuk është lloji i dashurisë që lavdërohet në muzikën dhe filmat e preferuar nga njerëzit.

Kjo dashuri shkakton ndryshim të vërtetë të karakterit. Mund ta mposhtë urrejtjen dhe ta largojë zilinë. Mund ta shërojë fyerjen dhe t'i shuajë zjarret e zemërimit. Mund të bëjë mrekullira.

Ne i morëm “mësimet [tona të] para”⁹ në këtë gjuhë të dashurisë si shpirtra në praninë e Perëndisë dhe këtu në tokë kemi mundësi për ta praktikuar dhe për ta folur rrjedhshëm. Ju mund ta dini nëse po e mësoni këtë gjuhë të dashurisë, duke vlerësuar atë që i nxit mendimet dhe veprimet tuaja.

Kur mendimet tuaja kryesore përqendrohen në mënyrën se si gjërat do t'ju sillnin përfitim juve, qëllimet tuaja mund të jenë egoiste dhe të përcipta. Kjo nuk është gjuha që dëshironi të mësoni.

Por kur mendimet dhe sjelljet tuaja kryesore përqendrohen në shërbimin ndaj Perëndisë dhe të tjerëve – kur vërtet dëshironi t'i bekonit dhe t'i lartësoni njerëzit përreth jush – atëherë fuqia e dashurisë së pastër të Krishtit mund të veprojë në zemrën dhe jetën tuaj. Kjo është gjuha që dëshironi të mësoni.

Ndërsa e flisni rrjedhshëm këtë gjuhë dhe e përdorni atë në bashkëveprimet tuaja me të tjerët, ata do të dallojnë diçka te ju, që mund të zgjojë tek ata një ndjenjë të fshehur për shumë kohë, për të kërkuar udhën e duhur në udhëtimin për t'u kthyer në shtëpinë e tyre qiellore. Në fund të fundit, gjuha e dashurisë është edhe gjuha e tyre e vërtetë amtare.

Ky ndikim i thellë dhe i qëndrueshëm është një gjuhë që arrin deri te thellësia e shpirtit. Është një gjuhë mirëkuptimi, një gjuhë shërbimi, një gjuhë lartësimi dhe gëzimi e ngushëllimi.



Mësoni ta përdorni gjuhën universale të dashurisë së Krishtit.

Dhe mesazhi i tretë: “Merrni zemër”¹⁰.

Nganjëherë bëhemi të padurueshëm kur jemi në udhëtimin tonë, apo jo? Nëse jeni 12 vjeç, mund të donit të ishit 14. Kur jeni 14, mund të donit të ishit 18. Dhe nëse jeni 18, me raste mund të donit madje të ishit 12 përsëri dhe ta fillonit nga fillimi.

Do të ketë gjithmonë gjëra për të cilat ankoheni – gjëra që duket se nuk shkojnë dhe aq mirë. Mund t'i kaloni ditët tuaja duke u ndier të trishtuara, të vetmuara, të keqkuptuara ose të padëshiruara. Por ai nuk është udhëtimi për të cilin kishit shpresuar dhe nuk është udhëtimi që Ati Qiellor ju dërgoi të ndërmerrnit. Mbani mend, ju jeni me të vërtetë bijë e Perëndisë!

Duke e njohur këtë, ju ftoj të ecni me besim dhe gëzim. Po, udha ka pengesa e devijime dhe madje disa rreziqe. Por mos u përqendroni tek ato. Kërkoni lumturinë që Ati juaj në Qiell ka përgatitur për ju në çdo hap të udhëtimit tuaj. Lumturia është vendmërritja, por është edhe shtegu. “Paqe në këtë botë dhe jetë të përjetshme në botën që vjen” është ajo që Ai premton.¹¹ Kjo është arsyeja pse Ai na urdhëron të “[marrim] zemër”.

Ndërsa e përdorni me gëzim hartën

që Ati juaj i dashur ju ka dhënë për udhëtimin tuaj, ajo do t'ju çojë në vende të shenjta dhe ju do të ngriheni tek aftësia juaj hyjnore. Ju do të rriteni për t'u bërë bija e Perëndisë që shpresuat se do të bëheshit.

Të dashura motra, të dashura të reja të Kishës, të dashura mikeshatë reja, si një Apostull i Zotit unë ju lë një bekim, se ju do ta gjeni udhën tuaj në këtë udhëtim drejt shtëpisë dhe se ju do të jeni frymëzim për bashkudhëtarët tuaja. Është gjithashtu premtimi dhe lutja ime që, ndërsa nderoni dhe jetoni të vërteta ndaj besëlidhjeve, parimeve dhe vlerave të ungjillit të Jezu Krishtit, në fund të udhëtimit tuaj Ati Qiellor do të jetë atje. Ai do t'ju përqafojë dhe ju do ta dini njëherë e përgjithmonë se jeni kthyer të sigurt në shtëpi. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Charles Dickens, *A Christmas Carol*.
2. Shih J. R. R. Tolkien, *The Hobbit*.
3. Shih Gjoni 14:6.
4. Doktrina e Besëlidhjeve 68:6; shih edhe Isaia 41:10; Gjoni 14:18.
5. Shih 1 Samueilit 16:7.
6. Shih 1 Pjetër 5:6–7.
7. Shih Jeremia 29:13.
8. Gjoni 15:12; shih edhe Gjoni 13:34; Moroni 7:45–48.
9. Doktrina e Besëlidhjeve 138:56.
10. Doktrina e Besëlidhjeve 78:18; shih edhe Gjoni 16:33; 3 Nefi 1:13.
11. Doktrina e Besëlidhjeve 59:23.

Ta Bëjmë Konferencën Pjesë të Jetës Sonë

Mbani parasysh që t'i përdorni disa nga këto aktivitete dhe pyetje si pikënisje për diskutim familjar apo meditim vetjak.

Numrat e faqeve të renditur me idenë tregojnë faqen e parë të bisedës.

Për Fëmijët

- Presidenti Tomas S. Monson foli për rëndësinë e bindjes dhe se si mosbindja gjithnjë sjell pasoja (faqe 89). Mendoni rreth një kohe kur iu bindët rregullave të familjes. Po rreth një kohe kur iu bindët



rregullave të Perëndisë? Si ju bëri të ndiheni të qenit të bindur?

- Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tregoi historinë e një vajze të vogël e cila mbollti një domate nga një farë e vogël (faqe 18). Lexojeni ose ritregojeni këtë histori si familje dhe flisni rreth asaj që ajo ju mëson për mënyrën se si ju mund të bëheni si Ati Qiellor. Ju mund të caktoni një synim për të bërë një gjë që t'i afroheni më shumë Atit Qiellor.
- Plaku Enrike R. Falabela, i Të Shtatëdhjetëve, foli rreth asaj që i bën familjet të forta (faqe 102). Ai dha mësim se disa prej fjalëve më të rëndësishme për t'u përdorur me familjen tuaj janë "Të dua", "Faleminderit shumë" dhe "Më fal". Motra Rozmari M. Uiksom, presidente e përgjithshme e Fillores, sugjeroi të thoni: "E dua gjithçka tënden" (faqe 81). Shihni se çfarë ndodh kur i përdorni këto fjalë me familjen tuaj. A i bën kjo të lumtur ata? Si ndiheni?

Për Rininë

- Presidenti Tomas S. Monson dha mësim katër parime për përgatitjen për të bërë punë misionare – jo thjesht si misionar kohëplotë, por edhe si anëtar i Kishës (faqe 66). Ju mund ta studioni bisedën e tij me këtë pyetje në mendje: Çfarë mund të bëj që të jem një misionar më i mirë tani?

- Plaku Xhefri R. Holland, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se është mirë të kemi dyshime dhe pyetje, por ai gjithashtu dha mësim: "Mbahuni fort tek ajo që tashmë e dini dhe qëndroni të pae-pur derisa vjen dija e mëtejshme. . . . [Jini të vërtetë ndaj besimit që vërtet e keni]" (faqe 93). Merrni parasysh që të shkruani në ditarin tuaj bindjet, dëshminë tuaj dhe disa përvoja shpirtërore që keni pasur. Gjithashtu shkruajini pyetjet që keni, dhe mbajini ato në mënyrë që kur t'i lexoni shkrimet e shenjtja dhe këtë botim, të mund të kërkonti përgjigje.
- Shumë folës u shprehën rreth bindjes dhe bekimeve të saj. Për shembull, Presidenti Monson dha mësim: "Një dituri për të vërtetën dhe përgjigjet për pyetjet tona më të mëdha na vijnë kur jemi të bindur ndaj urdhërimeve të Perëndisë" (faqe 89). Merrni parasysh shqyrtimin e këtij botimi



për të nënvizuar ose hedhur në letër bekimet e shumta të bindjes. Dallimi i këtyre bekimeve mund t'ju frymëzojë që të vazhdoni të jetoni me drejtësi.

- Disa folës dhanë mësim se ju mund të shërbeni në çdo kohë, jo vetëm gjatë projekteve të shërbimit. “Shërbeni çdo ditë”, dha mësim Vëllai Dejvid L. Bek, president i përgjithshëm i Të Rinjve. “Mundësitë janë kudo rreth jush.” Në bisedën e Vëllait Bek, ju mund të lexoni disa shembuj të të rinjve duke iu shërbyer të tjerëve (faqe 55).

Për të Rriturit

- Shumë nga folësit dëshmuar për Jezun Krishtin. Çfarë mund të mësoni rreth karakterit, misionit dhe shërbesës së Tij hyjnore nga bisedat në faqet 22, 70, 96, 99 dhe 109?
- Tema e programit mësimor të të rinjve për muajin maj është mbi profetët dhe zbuluesin. Nëse u jepni



mësim rinisë në kishë apo keni fëmijë adoleshentë, ju mund të diskutoni me ta mbi programin mësimor dhe këtë pyetje: Përse është e rëndësishme t'i dëgjojmë dhe t'i ndjekim profetët e gjallë? Merreni parasysh studimin e këtij botimi për të dalluar profecitë dhe paralajmërimet që, nëse u vihet veshi, do të na ndihmojnë të fuqizohemi në kohë të trazura.

- Disa folës u përqendruan mbi forcimin e familjes. Për shembull, Plaku Riçard G. Skot, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim: “Kur [Shpëtimtari është qendra e shtëpisë suaj, ka paqe dhe qetësi” (faqe 29). Kërkoni mënyra për ta bërë Shpëtimtarin qendrën e shtëpisë suaj ndërsa studioni bisedën e Plakut Skot si dhe bisedat te faqet 6, 81, 83 dhe 102. ■



MËSIMDHËNIA NGA SHKRIMET E SHENJTA

Merreni parasysh studimin e këtyre shkrimeve të shenjta, që janë cituar ose janë përmendur disa herë në konferencën e përgjithshme:

1 Samuelit 16:7*
 Mateu 7:24; 28:19
 Gjoni 13:34–35; 14:6; 16:33
 Mosia 3:19*; 18:8–9
 Helamani 5:12*
 3 Nefi 11:7

Moroni 9:9
 Doktrina e Besëlidhje 42:22; 59:23;
 64:34; 84:88; 87:8; 115:6
 Joseph Smith – Historia 1:17*
 * Vargje të zotërimit të shkrimit të shenjtë nga seminari

Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë

Lista vijuese e përvojave të përzgjedhura nga konferenca e përgjithshme mund të përdoret për studim vetjak, mbrëmje familjare dhe mësimdhënie tjetër. Numri i përket faqes së parë të bisedës.

FOLËSI	NGJARJA
Plaku Nil L. Andersen	(77) Çiftet në Mozambik ndjekin Shpëtimtarin pavarësisht traditave të tyre.
Plaku M. Rasëll Ballard	(18) Mbesa shtatëvjeçare rigjallëron një bimë të fishkur domateje.
Dejvid L. Bek	(55) Mbajtësit e Priftërisë Aarone përkrahin një të re që përballet me kërcënim. Një dhjak në Bangalor të Indisë, ndihmon në aktivizimin e të gjithë të rinjve në degën e tij.
Plaku Ted R. Kelister	(52) Shtatëmbëdhjetë vjeçari Xhorxh F. Riçards, mëson për fuqinë e priftërisë duke i dhënë së ëmës një bekim.
Plaku D. Tod Kristoferson	(109) E ëma e D. Tod Kristofersonit ndihmon një të re në nevojë për të përmbushur potencialin e saj.
Meri N. Kuk	(118) Një e re përballet me vdekjen e babait dhe betejën e nënës së saj me kancerin duke ushtruar besim.
Plaku Kuentin L. Kuk	(32) Një grua hindu ndien paqe gjatë shtëpisë së hapur të Tempullit në Suva në Fixhi.
Peshkopi Din M. Dejvis	(9) Tërmeti Loma Prieta në Kaliforni të SHBA-së në vitin 1989 ripohon në mendjen dhe zemrën e Din M. Dejvisit rëndësinë e ndërtimit të jetës sonë mbi një themel të qëndrueshëm.
En M. Dib	(115) Një e re pak aktive ndien Shpirtin gjatë kampit të Të Rejave.
Presidenti Henri B. Ajring	(62) Një djalë jetim bëhet anëtar i parë i Kishës në një qytet me 130.000 banorë. Ndërsa po shërbente në Nju-Meksiko, SHBA, dhe në Nju-Inglënd, SHBA, Henri B. Ajring sheh dorën e Perëndisë në krijimin e mbretërisë së Tij.
Plaku Enrike R. Falabela	(102) Anëtarët e Kishës në Arizona, SHBA, i japin Enrike R. Falabelës dhe bashkëshortes së tij para që ata të mund të kthehen në Guatemalë pas martesës së tyre në tempull.
Plaku Xhefri R. Holland	(93) Xhefri R. Holland i tregon një djali 14-vjeçar se kurrë nuk kishte pse të kërkonte falje ngaqë "vetëm besonte".
Presidenti Tomas S. Monson	(66) Një burrë në Kanada kërkon hollësisht dhe bashkohet me Kishën pasi dy misionarë kohëplotë ndajnë dëshmi të fuqishme për Profetin Jozef Smith. Duke shprehur dashuri në letrat e tij javore, një misionar kohëplotë e sjell të atin në Kishë. (89) Në moshën tetëvjeçare Tomas S. Monson mëson mbi bindjen pasi i vuri zjarrin një fushe. Një anëtar besnik i Kishës në Hungari i ruan të dhjetat e tij për vite derisa të mund t'ia jepte ato mësuesve të tij të shtëpisë.
Plaku Riçard G. Skot	(29) Një misionar kohëplotë dëshiron të ndjekë modelin e familjes së presidentit të tij të misionit me familjen e tij të ardhshme.
Presidenti Diter F. Uhtdorf	(70) Shenjtorët e Afrikës Perëndimore fillojnë të këndojnë himne pasi ikën energjia elektrike në shtëpinë e tyre të mbledhjeve. Ungjilli e ndihmon një të re të mposhtë errësirën e një rritjeje nën dhunim. (125) Diter F. Uhtdorf dhe anëtarët e familjes së tij largohen nga Gjermania Lindore.

Mësimet për Kohën Tonë

Mësimet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndhmës të dielave të katërta do t'u kushtohen temës “Mësimet për Kohën Tonë”. Secili mësim mund të përgatitet nga një ose më shumë biseda që janë dhënë në konferencën e përgjithshme më të fundit (shih tabelën më poshtë). Presidentët e kunjeve dhe të distrikteve mund të zgjedhin se cilat biseda duhet të përdoren, ose ata mund t'ua caktojnë këtë përgjegjësi peshkopëve dhe presidentëve të degëve. Udhëheqësit theksojnë vlerën që ka për vëllezërit e Priftërisë Melkizedeke dhe motrat e Shoqatës së Ndhmës studimi i të njëjtave biseda në të njëjtën të diel.

Ata që marrin pjesë në mësimet e të dielave të katërta, nxiten të studiojnë dhe të sjellin në klasë botimin e revistës të konferencës së përgjithshme më të fundit.

Sugjerime për Përgatitjen e një Mësimi nga Bisedat

Lutuni që Shpirti i Shenjtë të jetë me ju kur

studioni dhe jepni mësim bisedën(at). Mund të tundoheni ta përgatitni mësimin duke përdorur materiale të tjera, por bisedat e konferencës janë programi mësimor i miratuar. Detyra juaj është t'i ndihmoni të tjerët ta mësojnë dhe ta jetojnë ungjillin siç jepet mësim në konferencën e përgjithshme më të fundit të Kishës.

Shqyrtojeni bisedën(at), duke kërkuar parime dhe doktrina që plotësojnë nevojat e anëtarëve të klasës. Gjithashtu kërkonin ndodhi, referenca të shkrimeve të shenjta dhe deklarata nga biseda(t), që do t'ju ndihmojnë të jepni mësim mbi këto të vërteta.

Bëni një plan se si të jepni mësim mbi parimet dhe doktrinën. Merreni parasysh përfshirjen e pyetjeve që i ndihmojnë anëtarët e klasës:

- Të kërkojnë parime dhe doktrina në bisedë(at).
- Të mendojnë për domethënien e tyre.
- Të ndajnë kuptimet, idetë, përvojat dhe dëshmitë.
- T'i zbatojnë këto parime dhe doktrina në jetën e tyre. ■

MUAJT KUR ZHVILLOHEN MËSIMET

Prill 2013–Tetor 2013

Tetor 2013–Prill 2014

MATERIALE PËR MËSIMET E TË DIELËS SË KATËRT

Bisedat e dhëna në konferencën e përgjithshme* të prillit 2013

Bisedat e dhëna në konferencën e përgjithshme* të tetorit 2013


* Për mësimet e të dielave të katërta për prillin dhe tetorin, biseda(t) mund të përzgjidhet nga konferenca e mëparshme ose ajo më e fundit. Bisedat janë të disponueshme në shumë gjuhë në faqen conference.lds.org.

Presidencat e Përgjithshme të Organizatave Ndhmëse

SHOQATA E NDIHMËS



Karol M. Stivens
Këshilltare e Parë



Linda K. Barton
Presidente



Linda S. Rivs
Këshilltare e Dytë


TË REJAT



Karol F. Mek-Konki
Këshilltare e Parë




Boni L. Oskarson
Presidente




Nill F. Mariot
Këshilltare e Dytë


FILLORJA



Xhin A. Stivens
Këshilltare e Parë



Rozmari M. Uiksom
Presidente



Sheril A. Esplin
Këshilltare e Dytë

TË RINJTË



Leri M. Gibson
Këshilltar i Parë



Dejvid L. Bek
President

SHKOLLA E SË DIELËS



Dejvid M. Mek-Konki
Këshilltar i Parë



Rasëll T. Osguthorp
President



Methju O. Riçardson
Këshilltar i Dytë

Konferenca e Përgjithshme Vjetore e 183-të Përfshin Mbështetjen e Presidencës së Re të Përgjithshme të Të Rejave

“Zemrat tona janë prekur”, tha Presidenti Tomas S. Monson në sesionin përmbyllës të Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 183-të më 7 prill 2013, “dhe dëshmitë tona për këtë punë hyjnore janë forcuar, ndërkohë që kemi ndier Shpirtin e Zotit. Le t’i kujtojmë për një kohë të gjatë ato që kemi dëgjuar në këto dy ditë që kaluan.”

Më shumë se 100.000 njerëz morën pjesë në pesë sesionet e konferencës së përgjithshme në Qendrën e Konferencave në Solt-Lejk-Siti të Jutas në SHBA, më 6 dhe 7 prill. Miliona njerëz anekënd botës i panë ose i dëgjuan transmetimet nëpërmjet TV-së, satelitit, radios dhe internetit. Duke përfshirë transmetimet e drejtpërdrejta dhe videon, zërin dhe tekstin e shkruar të konferencës në internet në adresën LDS.org, anëtarët qenë në gjendje ta shihnin konferencën në 95 gjuhë.

Presidenti Monson e hapi konferencën vjetore duke njoftuar planet për ndërtimin e tempujve në Sidër-Siti, Juta, SHBA, dhe Rio-de-Zhanejro, Brazil – duke e çuar numrin total të tempujve ose atyre në ndërtim në 29. Aktualisht, janë 141 tempuj në funksionim.

Ndryshime të shumta u bënë në udhëheqjen e Kishës gjatë sesionit të pasdites të së shtunës. Të gjitha anëtarët e presidencës së përgjithshme të Të Rejave u liruan nga thirrjet dhe Plaku Uolter F. Gonzáles u lirua nga thirrja si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve. Gjithashtu u liruan nga

thirrjet pesëdhjetë e një Të Shtatëdhjetë Zonalë.

Plaku Ulises Soaresh, i Kuorunit të Parë të Të Shtatëdhjetëve, u mbështet si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve.

U mbështetën si presidencë e re e përgjithshme e Të Rejave Boni Li Grin Oskarson, presidente; Karol Foli Mek-Konki, këshilltare e parë; dhe Nill Fut Mariot, këshilltare e dytë.

Gjithashtu u mbështetën tre anëtarë të rinj të Kuorunit të Parë të Të Shtatëdhjetëve: Plaku Eduard Dubi nga Zimbabve; Plaku S. Giford Nilsen nga Shugër-Lend, Teksas, SHBA; dhe Plaku Arnulfo Valencuela nga Kue-retaro, Meksikë. U mbështetën edhe pesë anëtarë të rinj në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve.

JU MUND TË NDIHMONI

Si Presidenti Tomas S. Monson edhe Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorunit të Dymbëdhjetëve Apostujve, i nxitën anëtarët që të kontribuojnë në Fondin e Përgjithshëm për Misionarët. Deri më 4 prill 2013 po shërbenin 65.634 misionarë kohëplotë, me më shumë se 20.000 misionarë të tjerë që kanë marrë thirrjet për mision.

Gjatë sesionit të hapjes së konferencës së përgjithshme, Presidenti Monson shënoi: “Për të ndihmuar në ruajtjen e kësaj



Elen S. Dalton, ish-presidente e përgjithshme e Të Rejave, shërbeu në presidencën e përgjithshme të Të Rejave, qoftë si këshilltare ose si presidente, për 11 vjet përpara se të lirohej nga thirrja në prill.

Shih një listë të plotë të mbështetjeve dhe lirimeve nga thirrjet në faqen 26.

Shih biografite e udhëheqësve të sapothirrur duke filluar në faqen 139. ■

force misionare dhe për shkak se shumë prej misionarëve tanë vijnë nga rrethana të përlura, ju ftoj ju, sipas mundësisë që keni, që të dhuroni bujarisht për Fondin e Përgjithshëm të Kishës për Misionarët”.

Anëtarët mund të dhurojnë duke përdorur një mandatdhurim për të dhjetën dhe duke e vendosur shumën që dëshirojnë të kontribuojnë te Fondi i Përgjithshëm për Misionarët. Anëtarët mund të dhurojnë edhe në internet përmes ldspanthrophies.org.

Kisha ka Nevojë për Pjekurinë dhe Përvojën e Çifteve më të Moshuar

Së bashku me rritjen e numrit të misionarëve të rinj për shkak të uljes së moshës për punën misionare, çiftet më të moshuar nevojiten jashtë mase edhe në misionet kudo në botë. Me krijimin e 58 misioneve të reja së fundi, shumë më tepër çifte më të moshuar do të duhen për të ofruar përvojë udhëheqjeje dhe mbështetje të tjera, që janë kaq jetike për një mision të suksesshëm.

Në konferencën e prillit 2013, Presidenti Tomas S. Monson foli për rritjen e shpejtë të numrit të misionarëve dhe shprehu dashurinë e tij për ata njerëz të gatshëm për t'i shërbyer Zotit në terrenin e misionit (shih faqet 4, 66). Plaku Rasëll M. Nelson, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, në mënyrë të veçantë nxiti çiftet më të moshuar që të shërbejnë. "Ju çifte më të moshuar, ju bëni plane për ditën kur mund të

shkoni në misionin tuaj. Ne do të jemi shumë mirënjohës për shërbimin tuaj", tha ai (shih faqe 45).

Në çastet e hapjes së konferencës së përgjithshme të tetorit 2012, Presidenti Monson tha: "Neve vazhdojnë të na duhen shumë më tepër çifte në moshë. Si ta lejojnë rrethanat tuaja, kur ju lind e drejta për të dalë në pension dhe si t'jua lejojë shëndeti, unë ju nxis të viheni në dispozicion për shërbim misionar kohëplotë. Si bashkëshorti edhe bashkëshortja, do të kenë gëzim më të madhe kur së bashku u shërbejnë fëmijëve të Atit tonë" ("Mirësevini në Konferencë", *Ensign* ose *Liahona*, nëntor 2012, f. 5).

Për shumë vite, udhëheqësit e Kishës i kanë nxitur çiftet më të moshuar që të shërbejnë. Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:

"Misionet kudo kanë nevojë për më shumë çifte. Pjekuria dhe përvoja e tyre i bëjnë ata disa prej misionarëve më të mirë që kemi. Aftësitë e tyre të veçanta . . . u krijojnë atyre mundësinë që t'i trajnojnë në mënyrë të efektshme udhëheqësit vendorë, t'i forcojnë e riaktivizojnë anëtarët dhe t'i sjellin joanëtarët te Krishti" ("Missionary Couples—Trading Something Good for Something Better", *Ensign*, qershor 1988, f. 9, 11).

Çiftet e denja që dëshirojnë të shërbejnë si misionarë, nxiten që t'i vënë në dijeni peshkopët ose presidentët e degëve të tyre për dëshirën vetjake për të shërbyer. Koha e shërbimit mund të ndryshojë nga 6 deri në 23 muaj.

Ata të cilët kanë pyetje për misionet e njerëzve më të moshuar, mund të telefonojnë në numrin 1-800-453-3860, numrin e brendshëm 2-6741 (ose 1-801-240-6741), apo të çojnë mesazh elektronik në adresën SeniorMissionary Services@ldschurch.org për të marrë përgjigje për pyetje të veçanta. ■

Pjekuria dhe përvoja e çifteve më të moshuar i lejojnë ata t'i trajnojnë udhëheqësit vendorë dhe t'i forcojnë anëtarët si dhe t'i sjellin joanëtarët te Krishti.



FOTOGRAFINGA DON L. SEARIE © IRI

Mjetet e Reja në Internet Ndhimojnë që të Ruhen dhe Publikohen Fotot dhe Kujtimet Familjare

Vizitorët te faqja FamilySearch.org do të vërehen disa ndryshime domethënëse deri në prill 2013. Ngjyrat e gjalla e të shndritshme, fotografitë ndjellëse dhe një mori veçorish të reja ofrojnë një larmi përvojash përtej kërkimit. Ndonëse faqja do të jetë ende një pikëndalim i madh

për gjenealogjistët dhe hulumtuesit, veçoritë e reja do të tërheqin një mori edhe më të gjerë vizitorësh.

Veçoritë e reja ndihmojnë që historia familjare të ecë përtej kërkimit dhe t'i shfaqet një auditori më të gjerë kërkuesish fillestarë të rinj e të vjetër të historisë familjare. Vizitorët tani me bashkëpunim mund të ndërtojnë pemën e tyre familjare në internet dhe të ruajnë e publikojnë foto dhe histori familjare – të gjitha falas.

Fotot dhe historitë familjare u japin jetë paraardhësve. Njerëzit e vërtetë [që ndodhen] prapa të dhënave mund të japin mësim parime të tilla si vlera e punës së vështirë, si të përballemi me sfidat e jetës dhe se si zgjedhjet ndikojnë në jetën tonë.

Thjeshtësimi i regjistrimit dhe i ruajtjes së historive familjare na ndihmon të lidhemi me të kaluarën tonë dhe të krijojmë një trashëgimi për të ardhmen.

Veçori të Reja në FamilySearch.org

FamilySearch Family Tree [Pema Familjare në FamilySearch]. Për herë të parë në faqen FamilySearch.org, individët mund të fillojnë me bashkëpunim të ndërtojnë pemën e tyre të përbashkët familjare plotësisht në internet, duke filluar me shtimin e informacionit rreth vetes dhe më pas zgjerimin e tij për brezat e kaluar.

Pikat Kyçe të Pemës Familjare:

- Gjejini pemën te adresa FamilySearch.org poshtë ikonës “Family Tree” [“Pema Familjare”].
- Pema është e populluar më parë

me mbi 900 milion emra personash të ndihmuar nga përkrahësit.

- Është falas.
- Ajo u krijon individëve mundësinë që me bashkëpunim ta ndërtojnë, ta administrojnë dhe ta publikojnë historinë e tyre familjare tërësisht në internet.
- Përdoruesit mund të zbulojnë atë që të tjerët mund të kenë gjetur tani për historinë e tyre familjare.
- Përdoruesit mund të bashkëngjisin lehtësisht foto, histori dhe burime hallkash lidhëse.
- Përdoruesit mund ta ruajnë përherë pemën e tyre të përbashkët familjare për brezat e ardhshëm.
- Opsioni i lehtë “grab and pull” [“kap dhe tërhiq”] i lejon përdoruesit që ta lëvizin pemën e tyre familjare lart e poshtë me lehtësi.
- Përkrahësit do të kenë qasje ndaj miliarda të dhënave falas në FamilySearch.org që të ndihmojnë me plotësimin e degëve që mungojnë në Pemën e tyre Familjare.

Foto. Përdoruesit mund t'i ruajnë fotot e parapëlqyera të paraardhësve, t'i bashkëngjisin ato në profilet e tyre në FamilySearch Family Tree [Pema Familjare në FamilySearch] dhe t'i publikojnë ato përmes mediave shoqërore. Mbi 200.000 foto janë vendosur, ruajtur dhe publikuar tashmë.

Historitë. Përdoruesit mund të shkruajnë në FamilySearch Family Tree [Pema Familjare në FamilySearch] historitë e parapëlqyera për një paraardhës të veçantë. Kjo veçori u krijon familjeve mundësinë që t'i mbledhin, t'i publikojnë dhe t'i ruajnë përherë historitë e tyre familjare.

Grafiku i Përkrahësve Ndërveprues. Në FamilySearch 2012 u provua një veçori që u krijoi individëve mundësinë që ta shihnin veten dhe paraardhësin e tyre në përmbajtjen e një grafiku



© IRI



shumëngjyrësh të përkrahësve. Kjo veçori tani është përmirësuar dhe është e disponueshme në faqen Family Search.org.

Programi Family Tree Wizard.

Atyre që nuk kanë punuar më parë për krijimin e pemës së tyre familjare, ky mjet do t'iu duket i dobishëm. Me një stil interviste ndjellëse, mjeti bën pyetje rreth paraardhësve tuaj të gjallë e të vdekur, më pas i ndërton ato lidhje te pema familjare që ju të filloni punën.

Ndihmë në Kohë Reale. Interesi për historinë familjare po rritet në të gjithë botën. FamilySearch ka krijuar një komunitet botëror në internet që siguron ndihmë falas për programin dhe ndihmë për kërkim vetjak përmes telefonit dhe komunikimit në faqen zyrtare 24 orë në ditë – tani në 10 gjuhë.

Gjuhët. Të gjitha veçoritë dhe shërbimet e reja tani do jenë të disponueshme në 10 gjuhë. Një grup videosh falas për përdorimin dhe burime të tjera në internet janë të disponueshme për të gjitha veçoritë. Thjesht klikoni te butoni Help [Ndihmë] për më shumë hollësi. ■

Historia Familjare i Ndryshon Zemrat

Nga R. Skot Llojd

Lajme të Kishës

Shumë qendra të historive familjare për të ardhmen do t'i kemi në shtëpi, parashikoi Plaku Bredli D. Foster, i Të Shtatëdhjetëve, në një fjalim të dhënë më 23 mars në ndërthurje me Konferencën për Historinë Familjare dhe Teknologjinë RootsTech 2013 në Solt-Lejk-Siti të Jutas, SHBA.

Plaku Foster, Ndihmësdrejtor Ekzekutiv i Departamenteve të Historive Familjare, tha se së shpejti do jenë nëntë miliard njerëz në tokë dhe se Zoti ka përgatitur teknologjinë që do ta bëjë të mundur "lidhjen e të gjitha këtyre familjeve së bashku".

Ai theksoi rëndësinë e bërjes së historisë familjare, të mësuarit e historive të paraardhësve tanë – jo

thjesht gjenealogjinë, gjetjen e emrave dhe datave. Guri i varrit të çdo varreze në botë përmban një emër, datëlindje, një vizë dhe më pas një datë vdekjeje, tha ai. "Ajo vizë e vogël midis datës së lindjes dhe të vdekjes duket kaq e vogël dhe e parëndësishme, por e gjithë historia jonë shtrihet brenda saj", vërejt ai. "Ndaj ndërsa shpesh përqendrohemi te zbulimi i atyre datave, dashuria jonë për paraardhësit tanë – kthimi i zemrave tona tek etërit tanë – vjen nga zbulimi i vizës."

Historia familjare na bashkon ndërsa tregojmë histori dhe punojmë bashkërisht, shpjegoi ai. "Si rrjedhojë, gjenealogjia na i ndryshon skicat; historia familjare na i ndryshon zemrat." ■

Plaku Eldred G. Smith Vdes në Moshën 106 vjeçare

Nga Sara Xhejn Uevër
Lajme të Kishës

Plaku Eldred G. Smith, i cili shërbeu si Patriark i Kishës nga viti 1947 deri në 1979–ën, vdiq më 4 prill 2013, në shtëpinë e tij. Ai ishte 106 vjeç.

Duke besuar të ketë qenë njeriu më i vjetër në Juta, Plaku Smith jetoi më gjatë sesa ndonjë Autoritet i mëparshëm i Përgjithshëm.

Presidenti i Kishës, Tomas S. Monson, e vizitoi Plakun Smith në ditëlindjen e tij të fundit, më 9 janar 2013. “Eldred Smith është miku im i mirë”, tha Presidenti Monson. “Kemi bërë shumë kilometra bashkë. E dua dhe e respektoj këtë njeri.”

Eldred G. Smith u thirr si Patriark në Kishë më 10 prill 1947, nga Xhorxh Albert Smithi, në atë kohë President i Kishës, dhe ishte personi i fundit që e mbajti atë pozicion. Në vitin 1979 iu dha medalja e mirënjohjes profesionale pas daljes në pension. Detyra filloi në 1833–shin me thirrjen e Jozef Smith të Vjetrit, babait të Profetit Jozef Smith. Plaku Smith është stërstërnipi i vëllait të Profetit, Hajrëmit.

Gjatë shërbimit të tij si Patriark i Kishës, Plaku Smith udhëtoi në shumë zona të botës dhe dha shumë bekime patriarkale në



Presidenti Tomas S. Monson, djathtas, takohet me Plakun Eldred G. Smith, i cili shërbeu si Patriark në Kishë nga viti 1947 deri në 1979–ën, në ditëlindjen e tij të 106-të, më 9 janar 2013. Plaku Smith ndërroi jetë më 4 prill në shtëpinë e tij.

zonat ku nuk kishte një patriark. Në vitin 1966 udhëtoi me Plakun Monson (siç thirrej në atë kohë), në Australi dhe Samoa për t’iu dhënë bekime patriarkale anëtarëve atje. Ishte hera e parë që një patriark kryesues e vizitonte Samoan. Sot pjesa më e madhe e kunjeve kanë një patriark që banon brenda kunit.

Presidenti Monson edhe Plaku M. Rasëll Ballard, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, folën në ceremoninë mortore të Plakut Smith. Presidenti Monson i lexoi një letër ngushëllimi familjes nga Presidenca e Parë, më pas shtoi: “Përkohësisht, kam humbur një mik të mirë”.

Plaku Ballard, i cili është gjithashtu stërstërnipi i Hajrëm Smithit, foli për ndihmesat e Plakut Smith në mbajtjen

gjallë të historisë së familjes së tyre. “Ne e respektojmë atë si Patriark të Kishës dhe patriark të familjes sonë të madhe”, tha ai. Ai shtoi se e dinte që Plaku Smith ndjeu se arritja e tij më e madhe qe familja e tij.

Eldred Smith u martua me Xhin Audri Nesein në vitin 1932; ata kishin pesë fëmijë. Pas vdekjes së saj në qershor të 1977–ës, ai u martua me Hortens Çajllidin; në atë kohë ajo po shërbente si këshilltare në presidencën e përgjithshme të Të Rejave. Ajo vdiq në maj 2012.

Dy nga djemtë dhe dy vajzat (njëra vajzë i ka vdekur) e Plakut Smith janë ende gjallë, ka 22 nipër e mbesa (dy të tjerë i kanë vdekur), 63 stërnipër e stërmbesa dhe 22 stërstërnipër e stërstërmbesa. ■

Gerry Avant ndihmoi për këtë artikull.



Plaku Ulises Soaresh

i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Plaku Ulises Soaresh, i cili filloi të shërbente në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve në janar të 2013–ës, e ka dëshmuar vetë rritjen e shpejtë të Kishës në disa pjesë të botës.

Plaku Soaresh u lind në San–Paolo të Brazilit, në tetor 1958. Prindërit e tij, Aparekido dhe Mercedes Soaresh, u bashkuan me Kishën kur ai ishte pesë vjeç. Ata i ndoqën mbledhjet në një dhomë sipër një furre buke. Plaku Soaresh kujton entuziazmin që ndjeu në moshën tetë vjeçare kur u organizua kunji i parë në Amerikën Jugore në San–Paolo në 1966–ën. Kisha në Brazil u rrit me shpejtësi me 50 kunje nga viti 1990 dhe me më shumë se 200 kunje nga viti 2000.

Plaku Soaresh, i cili mori një diplomë universitare në kontabilitet dhe ekonomi nga Universiteti Katolik Papnor dhe master nga Instituti Kombëtar i Studimeve Pasuniversitare, po punonte për një kompani shumëkombëshe gomash kur iu ofrua pozicioni në Kishë. I punësuar për të punuar për Departamentin e Financës, ai shpejt u bë drejtor për çështjet materiale në zyrën e zonës së Kishës në San–Paolo, duke i dhënë ndihmë Presidencës së Zonës për 10 vjet. Ai gjithashtu shërbeu si president i parë i Kunjit të Kotias, në San–Paolo të Brazilit.

Ai shërbeu si president i Misionit të Portugalisë, Porto, nga viti 2000 deri në 2003–shin dhe u thirr në Kuorumin e Parë të Të Shtatëdhjetëve në prill të 2005–ës. Ai ka shërbyer në Brazil dhe në Presidencat e Zonave të Afrikës Juglindore.

“Këto përvoja më kanë dhënë largpamësinë për të parë se Kisha mund të krijohet kudo ku kemi njerëz besnikë”, tha ai, “dhe largpamësinë për të parë atë që duhet të mësoj për të shërbyer më mirë.”

Plaku Soaresh dhe bashkëshortja e tij, Rozana Fernandes Morgado, u martuan në tetor të 1982–shit, në Tempullin e San–Paolos, Brazil. Ata janë prindër të tre fëmijëve.

Plaku Soaresh shërbeu një mision kohëplotë në Misionin e Brazilit, Rio–de–Zhaneiro. Ai gjithashtu ka shërbyer si president i kuoromit të pleqve, këshilltar në një peshkopatë, këshilltar i lartë, sekretar ekzekutiv i kunjit dhe agjent rajonal për mirëqenien. ■



Plaku Eduard Dubi

i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Eduard Dubi u njoh me ungjillin në vitin 1981 nga një punëdhënës, në shtëpinë e të cilit punoi. Burri i dha atij një kopje të Librit të Mormonit. Ai nuk e lexoi atë deri në vitin 1983, por në atë kohë i la aq shumë mbresa dëshmia e Jozef Smithit për vizitën e Moronit sa që ai iu përgjigj ftesës për të marrë pjesë në një mbledhje agjërimit dhe dëshmish në shtëpinë e mbledhjeve në Kuekue në Zimbabve.

Fillimisht nuk u ndje rehat, duke menduar se ai punonte për shumicën e atyre që merrnin pjesë.

“Por kur ata ndanë dëshmitë e tyre rreth Librit të Mormonit, unë ndjeva njëfarë lidhjeje me këta njerëz”, kujtoi ai, “dhe isha në gjendje t’i ndaja ndjenjat e mia rreth Librit të Mormonit.”

Më vonë ai mori mësimet e misionarëve, u pagëzua dhe përfundimisht shërbeu në Misionin e Zimbabves, Harare.

Gjatë asaj kohe, ai i dha mësim familjes së Naum Keresija Salazanit, në atë kohë 16 vjeçe. Ata vazhduan të njiheshin pas misionit të tij dhe u martuan në Kuekue më 9 dhjetor 1989. Në maj të 1992–shit, ata u vulosën në Tempullin e Johanesburgut, të Afrikës Jugore. Ata janë prindër të tri vajzave dhe një djali.

I lindur në maj të 1962–shit në fshatin Çirumanzu të Zimbabves, nga Klement dhe Rozmari Dubi, Plaku Dubi mori një diplomë për mësuesi nga Kolegji D. E. në Zimbabve në 1992–shin dhe më pas shkoi të punonte për Sistemin Arsimor të Kishës, duke krijuar seminare dhe institute në rajonin e Zimbabves, Zambisë dhe Malavisë. Ai është bekuar të shohë shumë nga studentët të cilëve u dha certifikatat e diplomimit, që të vazhdojnë e të shërbejnë në pozicionet e udhëheqjes së Kishës në ato vende teksa Kisha rritet.

Ai ka shërbyer si president i kuoromit të pleqve, president dege, president distrikti, president kunji, këshilltar në presidencën e misionit dhe, nga viti 2009 deri në 2012–ën, president i Misionit të Zimbabves, Harare. Përpara thirrjes së tij në Kuorumin e Parë të Të Shtatëdhjetëve ai ka shërbyer si I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Plaku S. Giford Nilsen

i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Stenli Giford Nilsen është i apasionuar pas atletikës, por sportet nuk janë gjëja më e rëndësishme në jetën e tij. Ai beson se drejtpeshimi është vendimtar dhe se ungjilli është themeli për lumturi tani dhe në përjetësi.

I lindur në tetor të 1954–ës nga Heri dhe Lois Nilsen, ai jetoi në Provo të Jutas në SHBA, deri pas diplomimit nga kolegji. Prindërit e tij i mësuuan një sistem vlerash të përqendruar tek ungjilli që ia ka udhëhequr jetën.

Pas pësimit të një dëmtimi të rëndë që i dha fund karrierës së tij të futbollit në kolegji, Plaku Nilsen tha se mësoi që gjërat më të rëndësishme në jetë nuk mund të zhduken nga një dëmtim.

Pas një shërimit të plotë, ai luajti si qendërmbrojtës në Ligën Kombëtare të Futbollit, por karriera e tij përfundoi pas tre vitesh. Ai u përqesh publikisht. Ishte një kohë vetëreflektimi dhe zbulimi i asaj që ai vërtet besonte. “Mësova se Shpëtimtari asnjëherë nuk të braktis, pavarësisht gjithçkaje”, tha Plaku Nilsen, i cili tani jeton në Shugër–Lend, Teksas.

Nëse ka ndonjë shkrim të shenjtë që është përpjekur ta ndjekë gjatë gjithë jetës së tij, ai është Mateu 5:14–16: “Ju jeni drita e botës. . . . Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej.”

“Zoti i hap krahët e Tij për ne”, tha Plaku Nilsen. “Ne ia tregojmë dashurinë Atij duke e jetuar ungjillin.”

Ishte gjatë kolegjit që ai u takua me Uendi Olsonin. Ata u martuan në Tempullin e Provos në Juta më 23 prill 1975. Ai mori një diplomë për komunikim nga Universiteti “Brigam Jang”. Ai ishte qendërmbrojtës për ekipin Houston Oilers dhe regjisor i sporteve për televizionin KHOU përpara thirrjes së tij për të shërbyer me kohë të plotë për Kishën.

Babai i gjashtë fëmijëve, Plaku Nilsen ka shërbyer si mësues seminari, president i Të Rinjve, president i kuorumit të pleqve, peshkop dhe president kunji. Gjatë kohës së thirrjes së tij në Kuorumin e Parë të Të Shtatëdhjetëve ai po shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Plaku Arnulfo Valencuela

i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Arnulfo Valencuela u rrit në vendbanimet mormone në Çiuaua, Meksikë dhe u diplomua nga Akademia Huárez e zotëruar nga Kisha. Fëmijëria e tij i dha mundësi të çmuara për t’u udhëhequr nga burra e gra besnike, që iu përkushtuan ungjillit dhe shërbimit ndaj Zotit.

Mësimet e marra në atë cep të mirënjohur të Kishës në Amerikën Latine do t’i shërbejnë mjaft atij ndërsa merr detyrat e tij si anëtar i Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve.

“Ndihehem shumë i bekuar për këtë thirrje për t’i shërbyer Zotit rregullisht me kohë të plotë”, tha ai.

I lindur në maj të 1959–ës nga Gilberto dhe Roza Valencuela, Arnulfo i ri u tërhoq në moshë të re ndaj shërbimit në Kishë. Në moshën 19–vjeçare pranoi thirrjen në Misionin e Meksikës, Verakruz. Në atë rajon piktoresk të Meksikës, ai kuptoi kënaqësinë e punës së përditshme të ungjillit dhe gëzimin që merr kur i fton të tjerët te Krishti.

Pak pas misionit të tij, ai vizitoi një familje që kishte pagëzuar e që më pas u shpërngul në Meksiko–Siti. Fqinja ngjitur familjes, Pilar Porras, qe një e kthyer në besim besnike në Kishë. Arnulfo dhe Pilari u bënë miq dhe shpejt filluan të dilnin në takime. Ata u martuan në Tempullin e Mesas në Arizona më 6 prill 1982, në një kohë kur nuk kishte tempuj në vendlindjen e tyre.

Ata kanë rritur tre fëmijë, duke vazhduar të shërbejnë në Kishë teksa e kanë parë Meksikën të bëhet një komb tempujsh. “Nuk mund ta kishim përfytyruar kurrë se do të kishim 12 tempuj në Meksikë dhe një në ndërtim e sipër”, tha ai.

Gjatë kohës së shërbimit të tij si peshkop, si këshilltar edhe në presidencën e kunjit edhe të misionit, dhe si I Shtatëdhjetë Zonal, Plaku Valencuela ka qenë dëshmitar i përkushtimit të mrekullueshëm të anëtarëve të panumërt meksikanë, të cilët janë të gatshëm të japin gjithçka që kanë për kauzën e Zotit.

I diplomuar në Universitetin e Meksiko–Sitit për Kontabilitet dhe Studime Administrimi, Plaku Valencuela ka punuar në pozicione të ndryshme administrimi për shoqëri ndërkombëtare. ■



Plaku Timothy J. Daiks

i Të Shtatëdhjetëve

Një nga rolet e parapëlqyera të Plakut Timothy Xhon Daiks në jetë është të “bëhe[sh] dëshmitar” dhe t’u dëshmosh të tjerëve, duke i ndihmuar ata të vijnë te Krishti. Qoftë nëse është duke shërbyer si misionar, duke bashkëvepruar me familjen e tij, ose duke punuar në profesionin e tij, ai e pranon me gëzim atë rol e përgjegjësi dhe përpiket t’i ndihmojë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë.

I lindur në janar të 1951–shit në Murrei të Jutas, SHBA, nga Milo Fredrik dhe Meri Katherin Daiks, ai ishte i dyti nga shtatë fëmijët. Kur ishte dhjak i ri, familja e tij u shpërngul në Elko të Nevadës, ku kohën pas shkollë e kaloi duke punuar në farmacinë e të atit. Teksa punonin krah për krah, babai i tij i mësoi rëndësinë e punës së vështirë – diçka që do ishte shumë e dobishme për të si misionar i ri në Misio-nin e Gjermanisë Jugore nga viti 1970 deri në 1972.

“Ishte një mision i ashpër, por ishte një mision i mre-kullueshëm për mua”, tha ai. “Mësova vlerën e punës së vështirë, të bindjes dhe të mosdorëzimit.”

Ajo etikë pune vazhdoi pas misionit të tij gjatë studi-meve, profesionit dhe detyrave të tij në Kishë. Plaku Daiks e takoi bashkëshkorten e tij të ardhshme, Xhill Dadli, ndër-kohë që ndiqte Universitetin “Brigam Jang”. Ata u martuan më 26 prill 1974, në Tempullin e Mantit në Juta. Ata kanë tre fëmijë.

Plaku Daiks mori një diplomë universitare nga Unive-rsiteti “Brigam Jang” për studime universitare dhe vazhdoi duke marrë një diplomë mjekësore nga Fakulteti i Mjekë-sisë së Universitetit të Uashingtonit. Ai e kaloi karrierën e tij profesionale si një kirurg për veshët, hundën dhe fytnin në një klinikë private në Reno të Nevadës.

Gjatë kohës së thirrjes së tij si Këshilltar i Dytë i Të Shtatëdhjetëve, Plaku Daiks po shërbente në organizatën e Të Rinjve si një këshillues i kuorumit të dhjakëve. Ai ka shërbyer në shumë thirrje të tjera, përfshirë thirrjet si I Shta-tëdhjetë Zonal, president i Misionit të Oregonit, Portland, president kunji, këshilltar në presidencën e kunjit, këshilltar i lartë, punonjës i ordinancave të tempullit, president i Shkollës të së Dielës dhe nëpunës lagjeje. ■



Plaku Rendi D. Fank

i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Rendi Denis Fank, i Kuorumit të Dytë të Të Shta-tëdhjetëve, e ka jetuar jetën me këtë parim thelbësor: “Mirëbeso te Zoti dhe te mirësia e Tij”.

Gjatë vitit të tretë për juridik, bashkëshortja e tij ishte shtatzënë më fëmijën e dytë dhe ai ishte bashkëredaktor për shqyrtimin e ligjeve kur i erdhi thirrja për të shërbyer si president i kuorumit të pleqve. “Në këtë kohë sfiduese e pranova thirrjen dhe iu luta Atit Qiellor për të më forcuar dobësinë që të shërbeja efektshëm”, tha ai. “Kisha nevojë për ndihmë që të përmbushja thirrjen time, të përfundoja me sukses shkollën, të gjeja punë dhe të kujdesesha për familjen time të re. Bekimet që morëm qenë përtej asaj që meritonim. Ajo përvojë më dha besim të madh te mirësia e Zotit dhe te bekimet e Tij mbi ata që përpiqen me zell t’i shërbejnë Atij.”

I lindur në gusht të 1952–shit nga C. Denis dhe Rebeka Fank, ai u rrit në Manti, Juta; Madison, Uiskonsin; dhe Smithfilld, Juta, SHBA. Ai pa të atin të shërbente me be-snikëri në Kishë dhe iu mësua rëndësia e përmbushjes së detyrave të priftërisë.

Pas shërbimit në një mision në Indonezi, ai u martua me Andrea Klaidin më 29 maj 1976, në Tempullin e Loganit në Juta. Ata janë prindër të gjashtë fëmijëve. Plaku Fank mori diplomë për histori nga Universiteti Shtetëror i Jutas dhe doktoratë për jurist nga Universiteti i Jutas. Ai ishte ortak në një firmë të madhe ligjore në Denver të Kolorados, përpara shërbimit të tij me kohë të plotë në Kishë, i cili filloi me thirrjen e tij si president i Misionit të Indisë, Bangalorë në vitin 2010.

“Kur shkuam në Indi, ne kishim besim te fjalët e Shpë-timtarit: ‘Dhe përsëri, unë ju them se këdo që do ta dërgoni në emrin tim, me anë të zërit të vëllezërve tuaj, të Dymbë-dhjetëve, të rekomanduar dhe të autorizuar siç duhet nga ju, do të ketë fuqi për të hapur derën e mbretërisë sime për cilindo komb ku ju do t’i dërgoni ata’ (DeB 112:21).” Plaku Fank ka shërbyer si president i kuorumit të pleqve, pre-sident i Të Rinjve, peshkop, president kunji dhe I Shtatë-dhjetë Zonal. ■



Plaku Kevin S. Hamilton

i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Kevin Skot Hamilton e përshkruan veten si “fryt të një kthimi në besim dhe një shpëtimi”.

Lindja e tij në mars të 1955–ës në Uenatçi të Uashingtonit në SHBA, nxiti pyetje tek e ëma e tij, Kei, rreth kuptimit të jetës. Ajo foli me një shok shenjtor të ditëve të mëvonshme, Riçard Prat, i cili e lidhi me misionarët.

Bashkëshorti i saj, Norman Rasëll Hamilton, shpjegoi se ai tashmë ishte një anëtar i Kishës, edhe pse pak aktiv që nga vitet e hershme të adoleshencës. Ai u bë aktiv pasi e shoqja u bashkua me Kishën.

“Prindërit e mi qenë anëtarë të shkëlqyer, të cilët zhvilluan besimin që ne kemi sot”, tha Plaku Hamilton.


Por ai dëshmon se ishte në misionin e tij në Francë dhe Zvicër që vërtet iu ndryshua jeta. “Ai krijoi tek unë një dëshirë të zjarrtë që nuk u largua asnjëherë”, tha ai.

Ai u martua me shpirtin binjak, Klaudia Kizorin, më 27 korrik 1978, në Tempullin e Los Anxhelosit. Ndërkohë që po i edukonin gjashtë fëmijët e tyre në Kaliforni, ata e kishin bërë shtëpinë e tyre si njëfarë qendre vizitorësh.

“Thuhet se mund të kesh një predikim pa fjalë në shtëpi, dhe ne i kemi pasur këto citime të shkurtra përreth shtëpisë”, tha motra Hamilton. Korridori i shtëpisë mbahet i mbushur me kopje të Librit të Mormonit, broshura *Për Forcën e Rinisë* dhe literatura të tjetra të Kishës, që rimbushet rregullisht kur vizitorët i marrin ato.

Vendosmëria e Plakut Hamilton për të shërbyer i ka sjellë mundësi që të shërbejë si peshkop, president kunji dhe president i Misionit të Belgjikës, Bruksel e Holandës nga viti 2003 deri 2006–të. Përpara thirrjes së tij në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve, ai ishte drejtor i Këshillit të Çështjeve Publike të Kishës për Kaliforninë Jugore, duke përfshirë 64 kunje në Zonën më të Madhe Metropolitane të Los Anxhelosit.

Me diplomën universitare nga Universiteti “Brigam Jang” dhe masterin nga Universiteti i Uashingtonit, të dyja për biznes, ai e ka kaluar shumicën e karrierës së tij në industrinë e telekomunikacionit, duke shërbyer shumë herë si drejtor ekzekutiv. ■



Plaku Adrián Ochoa

i Të Shtatëdhjetëve

Ndërkohë që shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal në Meksikë, Plaku Adrián Ochoa kaloi disa ditë në qytetin Çiuaua duke u këshilluar me presidentin e kunjit dhe të tjerë, më pas hipi në një aeroplan me drejtim për në shtëpi. Por pasi zuri vend, ai mori një nxitje të fortë shpirtërore se puna e tij në Çiuaua nuk kishte përfunduar.

Ekui pazhi i fluturimit po bënte përgatitjet e fundit për t’u nisur. “Por”, tha Plaku Ochoa, “e dija se duhej të zbrisja nga ai aeroplan.” Ndaj ai zbriti. Një seri intervistash të njëpasnjëshme i dhanë informacion të rëndësishëm që zgjidhën një çështje të vështirë dhe lejuan përparimin shpirtëror të një familjeje.

Por puna e Plakut Ochoa në Çiuaua ende nuk kishte përfunduar. Shpirti e drejtoi atë edhe te shtëpia e thjeshtë e një kushërire që nuk e kishte parë prej vitesh. Ai gjeti kushërirën e tij të larguar – një anëtare joaktiv – dhe familjen e saj të vogël në nevoja të skajshme. “E dija se Kisha dhe Krishti qenë zgjidhja e tyre. Iu përgjérova kushërirës sime që të kthehej në kishë”, tha ai.

Kushëriri vërtet u bë sërish aktiv dhe u rivendos marrëdhënia e tij e çmuar familjare. Zoti që në gjendje të shpëtonte disa jetë në Çiuaua sepse një njeri ua vuri veshin nxitjeve të Shpirtit.

Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të marrin nxitje shpirtërore që ta ndryshojnë jetën, dëshmoi Plaku Ochoa, i cili ka shërbyer në një sërë thirrjesh në Kishë ndërsa punonte në fushën e reklamave. Ai kryesoi në Misionin e Hondurasit, San–Pedro, Sula nga viti 2004 deri në 2007–ën dhe, nga 2009–ta deri pas thirrjes së tij në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve, shërbeu si këshilltar i dytë në presidencën e përgjithshme të Të Rinjve.

I lindur në mars të 1954–ës në San–Francisko, Kaliforni, SHBA, nga Eduardo dhe Konsuelo Ochoa, ai u rrit në Kaliforni edhe Meksikë. Kur ishte i ri, ai u thirr për të shërbyer një mision të veçantë për çështjet publike në Meksikë. Ai dhe bashkëshortja e tij, Nensi Vijareal, u vulosën në Tempullin e Meksiko–Sittit. Ata janë prindër të pesë fëmijëve. ■



Plaku Terens M. Vinson

i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Terens M. Vinson, i sapothirur në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve, nuk e kishte dëgjuar kurrë termin *Mormon* përpara se të takonte Kei Ein Kardenin në fillimet e viteve 1970 në Sidnei, Australi. Çifti foli rreth fesë dhe përfundimisht bënë një marrëveshje. Çdo të diel, të dy do të merrnin pjesë në kishën ku shkonte Terensi në rini dhe në një degë të vogël të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Njëri grup takohej në një ndërtesë të madhe e të bukur, grupi tjetër në një hapësirë të vogël të marrë me qira që pak shenjtorë të ditëve të mëvonshme qenë në gjendje të siguronin.

Por pas pak kohe “krahasimi ishte sikletosës” dhe Terensi filloi të merrte pjesë në diskutimet e misionarëve. Ai kishte shumë pyetje. Më pas, ndërsa po merrte pjesë në konferencën e kunjit, ai ndjeu një mesazh aq qartazi sikur t’i qe thënë me zë. “Kisha nevojë të bashkohesha me Kishën me qëllim që të përparoja. Të gjitha pyetjet që kisha do të merrnin përgjigje”, tha ai.

Ai u pagëzua javën pasuese.

Terens Majkëll Vinsoni u lind në Sidnei të Australisë, në mars të 1951–shit nga Xhon Lourenc dhe Mei Theres A. Vinson. I ati, i cili punonte si zjarrfikës, sakrifkoi në mënyrë që të shtatë fëmijët e tij të mund të arsimoheshin.

Plaku Vinson mori një diplomë universitare për matematikë dhe statistikë nga Universiteti i Sidneit dhe një diplomë për mësuesi nga Kolegji Sidnei Tiçërs. Ai gjithashtu mori një diplomë për planifikim financiar nga Universiteti Dikin dhe një master për zbatimin e financave nga Universiteti Makuari. Gjatë karrierës së tij, ai ishte një mësues i njohur matematike, lektor dhe këshillues financiar dhe drejtonte një firmë financiare për planifikim dhe investime.

Ai u martua me Kei Enin, gruan që e njohu atë me ungjillin, më 2 maj 1974 në Sidnei, dhe çifti u vulos më 23 gusht 1975, në Tempullin e Hamiltonit në Zelandën e Re; ata kanë gjashtë fëmijë. Më pak se tre vjet pas pagëzimit të tij, Plaku Vinson u thirr si peshkop. Ai ka shërbyer në disa presidenca kunjë dhe si përfaqësues krahinor dhe I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Boni L. Oskarson

Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Ndërkohë që shërbente si kryekujdestare në Tempullin e Stokholmit, Suedi nga 2009–ta deri në 2012–ën, Boni Li Grin Oskarson pa shenjtorë të ditëve të mëvonshme nga Suedia, Norvegjia dhe Letonia të sakrifkoinin për të adhuruar në shtëpinë e Zotit.

Megjithatë, ajo nuk e dinte deri atëherë, se mësimet që po mësonte nga këta anëtarë “shumë të përlurur, jashtë-zakonisht të përkushtuar e të zotuar” do ta ndihmonin të drejtonte përqendrimin e saj si presidente e përgjithshme e Të Rejave të Kishës.

“Duke qenë se shumë të reja tani po zgjedhin të shërbejnë në misione dhe të frekuentojnë tempullin në një moshë të hershme, shpresoj që përvoja ime e punës në tempull do të më ndihmojë të kuptojë se si t’i ndihmoj ato të përgatiten”, tha ajo.

Boni Li Grin u lind në tetor të 1950–ës në Solt–Lejk–Siti nga Teo Xhejms dhe Xhin S. Grin. Kur prindërit e saj vendosën se dëshironin që fëmijët e tyre ta provonin Kishën jashtë Jutas, nëntëvjeçarja Boni dhe familja e saj u shpërngulën në Oklahomë të SHBA–së. Familja kaloi kohë edhe në Kolorado dhe Tenisi përpara se të shpërngulej në Misuri, ku Boni takoi Pol Kent Oskarsonin në sheshin e tempullit në Far–Uest, Misuri – një vend me rëndësi, sepse të dy kanë paraardhës që jetuan në zonën e Far–Uestit.

Pas ndjekjes së Universitetit “Brigam Jang”, çifti u martua më 19 dhjetor 1969, në Tempullin e Solt–Lejkut; shtatë fëmijë do t’i bashkoheshin përfundimisht familjes.

Motra Oskarson ishte vetëm 25 vjeçe kur bashkëshorti i saj – i cili kishte shërbyer me kohë të plotë në Misionin e Suedisë nga viti 1965 deri në 1968–ën – u thirr për të kryesuar në Misionin e Suedisë, Goteborg.

Kur familja Oskarson u kthye në Shtetet e Bashkuara, ata jetuan në Misuri, Nju–Xhërsi, Masaçuset dhe Teksas, ku vëllai Oskarson punoi si zëvendëspresident rajonal i departamentit të dyqaneve. Sikurse prindërit e saj, Motra Oskarson gjeti gëzim të madh duke jetuar në zonat ku anëtarësia e Kishës ishte e vogël.

Motra Oskarson ka shërbyer si presidente e Të Rejave tri herë, si mësuese e seminarit herët në mëngjes për nëntë vjet dhe si mësuese e Doktrinës së Ungjillit. ■



Karol F. Mek-Konki

*Këshilltare e Parë në
Presidencën e Përgjithshme
të Të Rejave*

Që kur qe e vogël, Karol Foli Mek-Konki ka pasur një “dëshirë të zjarrtë për tempullin”. Ai përqendrim i ka drejtuar veprimet e saj gjatë gjithë jetës.

E lindur në prill të 1952–shit në Spoken të Uashingtonit në SHBA nga Uilliam dhe Xhoan W. Foli, Motra Mek-Konki ishte thjesht një çupëlinë kur misionarët trokitën në derën e prindërve të saj në Uilmington, Delauer dhe e njohën familjen e saj me ungjillin. Prindërit e saj i përqafuan menjëherë mësimet pavarësisht kundërshtimit dhe detyrimit për të bërë ndryshime në stilin e jetesës.

Kur ishte fëmijë, ajo udhëtoi me familjen me tren mes-përmes vendit që të vulosej në Tempullin e Mantit në Juta.

“Kjo ishte një përvojë shumë e ëmbël”, tha ajo. “Mbjaj mend që isha veshur me të bardha dhe kuptimin që kishte ajo për familjen time. Ishte një përvojë e jashtëzakonshme, edhe pse isha shumë e vogël, i mbaj mend ndjenjat që përjetova, pamjet me të bardha dhe bukurinë e asaj dite. Ajo përvojë më dha dëshirën e parë për ta mbajtur tempullin në jetën time përgjithmonë.”

Tempulli u bë një simbol shprese gjatë kohëve të sproves dhe kur pati një familje të vetën.

Ajo u takua me bashkëshortin e saj, Oskar Uolter Mek-Konki III, ndërsa po ndiqnin Universitetin Shtetëror të Arizonës. Motra Mek-Konki mori diplomë universitare për mësuesi për gjuhën angleze. Ata u martuan më 22 dhjetor 1973, në Tempullin e Mesës në Arizona dhe janë prindër të shtatë fëmijëve.

Në kohën e thirrjes së saj si këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Të Rejave, Motra Mek-Konki po shërbente në bordin e përgjithshëm të Të Rejave. Ajo e ka kaluar pjesën më të madhe të shërbimit të saj në Kishë me thirrje që përfshijnë mësimdhënien dhe si presidente e Të Rejave të lagjes dhe si këshilltare në presidencat e Shoqatës së Ndhmës dhe të Filllores të lagjes. Ajo shërbeu me të shokun ndërsa ai kryesoi në Misionin e Kalifornisë, San-Hoze nga viti 2005 deri në 2008–ën. ■



Nill F. Mariot

*Këshilltare e Dytë në
Presidencën e Përgjithshme
të Të Rejave*

Edhe para se të bashkohej me Kishën, Nill Fut Marioti mësoi që kur ishte vajzë e vogël se kishte një Perëndi dhe se Ai e donte atë.

“Im atë ndoqi shembullin e Atit tonë Qiellor”, tha këshilltarja e dytë e re në presidencën e përgjithshme të Të Rejave. “Dashuria dhe vlerësimi i tij për të tjerët ishte i pakufizuar. Ishte një kalim i thjeshtë dhe i natyrshëm i dashurisë e mirëbesimit që kisha për atin tim tokësor te mirëbesimi dhe dashuria e Atit tim Qiellor.”

E lindur nga Xhorxh dhe Entoni Fut në tetor 1947 në Aleksandria të Luizianës në SHBA, ajo ishte motra e vetme nga gjashtë vëllezër më të vegjël. Pas diplomimit nga Universiteti Southërn Methodist në Dallas të Teksasit, me një diplomë për literaturën e gjuhës angleze dhe universitetet të dytë, ajo u shpërngul në Kembrixh, Masaçuset, ku punoi si sekretare në Universitetin e Harvardit. Atje takoi Dejvid Kenon Mariotin, i cili i tha: “Kam disa miq që dua t’i takosh”. Ai shpejt i solli misionarët që t’i jepnin mësimet asaj dhe shoqes së saj të dhomës.

Ndërsa i dëgjoi misionarët, ajo tha: “Mësimet mbushën pjesët bosh të kuptimit tim për ungjillin”. Pas pagëzimit të saj në maj të 1970–ës, ajo dhe Dejvidi mbetën miq; pas një viti ata filluan të dilnin në takime dhe u martuan në qershor të vitit 1971 në Tempullin e Solt-Lejkut.

Duke punuar bashkë me bashkëshortin e saj, Motra Mariot qëndroi në shtëpi me 11 fëmijët e tyre, ndërsa ai ndoqi karrierën për biznes. Ata kanë shërbyer në shumë thirrje të Kishës. Ajo shërbeu me të ndërsa ai kryesoi në Misionin San-Paolo, Interlagos nga viti 2002–2005, dhe shërbeu si punonjëse e ordinancave në Tempullin e Solt-Lejkut, presidente e Shoqatës së Ndhmës të kunjtit dhe të lagjes, presidente e Të Rejave të lagjes, mësuese e Doktrinës së Ungjillit dhe si specialiste e ruajtjes së ushqimit.

Në detyrën e saj të re, Motra Mariot shpreson të japë të njëjtën dëshmi që mori kur ishte e re. Ajo dëshiron që të rejtat të dinë se “Ati i tyre Qiellor i do me dashurinë më të thellë e më të lavdishme”. ■



© BRADY FAIRBANKS. NUK LEJOHET KOPIMI

“Whereas I Was Blind, Now I See” [“Isha i Verbër dhe tani Shoh”], nga Brady Fairbanks

“Kur po kalonte, pa një njeri që ishte i verbër që nga lindja. . . .

Pasi [Jezusi] kishte thënë këto gjëra, pështyu përdhe, bëri baltë me pështymë dhe leu sytë e të verbrit me të.

Pastaj i tha: ‘Shko, lahu në pellgun e Siloamit’ . . . ai shkoi atje, u la dhe u kthye duke parë. . . .

Ai atëherë u përgjigj dhe tha: ‘. . . Por di një gjë, që isha i verbër dhe tani shoh!’” (Gjoni 9:1, 6–7, 25).



“Ne jetojmë në një kohë në historinë e botës kur ka shumë sfida të vështira, por edhe mundësi dhe arsye të mëdha për t’u gëzuar”, tha Presidenti Tomas S. Monson gjatë sesionit përmbyllës të Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 183-të të Kishës. “Gjenden, sigurisht, ato kohë kur ne përjetojmë zhgënjime, dhembje dhe madje tragjedi në jetën tonë. Megjithatë, nëse vërtet do ta vendosim besimin tonë te Zoti, Ai do të na ndihmojë përmes vështirësive tona, cilatdo qofshin ato.”

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME